



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

***TEME DISERTACIONI:***

***CAKTIMI I RASAVE NË SINTAGMAT EMERORE TË  
GJUHËS ANGLEZE NË PËRQASJE ME GJUHËN SHQIPE***

Përgatiti:

JOANA TAÇI

Udheheqës Shkencor:

Prof. dr. THOMA DHIMA



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

***CAKTIMI I RASAVE NË SINTAGMAT EMERORE TË  
GJUHËS ANGLEZE NË PËRQASJE ME GJUHËN SHQIPE.***

**Punim për gradën shkencore "Doktor" në Gjuhësi/Sintaksë**

**KOMISIONI:**

- 1. Prof. As. Dr. Elida Tabaku** (Kryetare)
- 2. Prof. As. Dr. Shpresa Shambli** (Oponente)
- 3. Prof. Dr. Avni Xhelili** (Oponent)
- 4. Prof. As. Dr. Zoi Topi** (Anëtar)
- 5. Prof. As. Dr. Arben Skëndaj** (Anëtar)

**TIRANË, 2015**

## ***MIRENJOHJE***

*Të nderuar profesor!*

Ashtu si çdo punim doktoral edhe ky që ne do te ofrojme në vijim paraqet vështirësi nga më të ndryshmet. Këto vështirësi janë kapërcyer falë mbështetjes të pakursyer të studiuesve dhe sintaksologëve të njohur me të cilët kam punuar dhe bashkëpunuar.

Në këtë kuadër kam kënaqësinë t'i shpreh mirënjohjen time të përzemërt Prof. Dr. Thoma Dhimës, një ndër sintaksologët më të njohur të vendit i cili i ka kushtuar një vëmendje të veçantë drejtimit gjenerativist. Të falenderoj profesor për mbështetjen, orientimin dhe udhëheqjen tuaj të vyer si gjatë studimeve master edhe gjata atyre doktorale.

Së dyti, do të doja të falenderoja profesorin e nderuar Prof. Dr. Rami Memushaj i cili më ka mundësuar gjithë informacionin në gjuhën angleze.

Gjithashtu falenderoj departamentin e gjuhës angleze të universitetit të Tiranës e më gjerë për besimin dhe mundësinë e dhënë ndaj personit tim për ndjekjen e këtyre studimeve. Së fundi, por jo më pak i rëndësishëm, ky falenderim i shkon familjes time, në veçanti bashkëshortit tim i cili ka shërbyer si një faktor inkurajues dhe shtysë për të vazhduar më tej.

## ***DEDIKIM***

Këtë punim ia kushtoj ëngjëllit tim të vogël 3-vjeçar, Amardës, e cila është tepër e vogël për të kuptuar dhe mirëkuptuar mungesën time gjatë këtyre tre viteve.

## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	i-vii
Përligjja.....	i-iii
Objekti .....	iii-v
Metodologjia e perdorur dhe struktura e punimit.....	v-vii
<b>KREU I SINTAGMAT, LLOJET DHE NDËRTIMI I TYRE</b> .....	1-35
1.1 Sintagma: Përkufizimi, ndërtimi dhe karakteristikat dalluese të saj krahasuar me togfjalëshin.....	1
1.2 Llojet e sintagmave sipas këndvështrimit gjenerativist.....	10
1.2.1 Sintagma foljore (SF): Struktura e brendshme e saj.....	11
1.2.2 Sintagma mbiemërore (SMB): Struktura e brendshme e saj.....	13
1.2.3 Sintagma parafjalore (SP); Struktura e brendshme e saj.....	14
1.2.4 Sintagma emërore (SE): Struktura e brendshme e saj.....	15
1.3 Përbërësi determinativ (SDet): Projektion maksimal i përbërësit emëror.....	18
1.4 Përndarja e determinuesve sipas kategorisë së shquarsisë.....	21
1.4.1 Përbërësi emëror i shquar.....	23
1.4.2 Përbërësi emëror i pashquar.....	26
1.4.3 Ndërtimet emërore me emër (të shquar/pashquar) dhe përemër dëftor.....	27
1.4.3.1 Struktura e SE e ndërtuar prej një përemri dëftor dhe një emri të shquar.....	27
1.4.3.2 Struktura e përbërësit emëror e ndërtuar prej një përemri dëftor dhe një emri të shquar.....	29
Përfundime.....	34
<b>KREU II: CAKTIMI I ROLEVE TEMATIKE NË GJUHËN ANGLEZE DHE NË GJUHËN SHQIPE</b> .....	36-51
2.1 Caktimi i roleve tematike.....	36
2.2 Pozicioni i caktimit të rolit tematik .....	42
2.3 Caktues të tjerë të roleve tematike.....	46
Përfundime.....	50
<b>KREU III: TEORIA E RASËS (Njohuri të Përgjithshme)</b> .....	52-66
3.1 Kategoria e rasës në gjuhën angleze dhe në atë shqipe.....	52
3.2 Koncepti rasë dhe qëllimi i studimit të saj.....	56
3.3 Teoria e rasës sipas këndvështrimit gjenerativist. Rasa morfologjike përkundrejt rasës abstrakte.....	55
Përfundime.....	64
<b>KREU IV: RASA EMËRORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ</b> .....	66-102
4.1 Njohuri të përgjithshme mbi rasën emërore.....	66
4.1.1 Klasifikimi tipologjik i rasës emërore.....	66
4.1.2 Rasa emërore si rasa e shprehjes së subjektit.....	68
4.2 Caktimi i rasës emërore në strukturën e fjalisë.....	69
4.3 Përcaktimi i caktuesit rasor të rasës emërore.....	74
4.4 Rëndësia e tiparit [+ kohë] në caktimin e rasës emërore SE subjekt.....	81
4.4.1 Caktimi i rasës përjashtimore.....	83
4.4.2 Caktimi i rasës emërore SE subjekt kategori e zbrazët.....	89

4.4.3	Rasa emërore subjekt e kontrolluar (kategoria PRO).....	92
4.4.4	Caktimi i rasës emërore në ndërtimet me folje ngritëse.....	96
4.5	Propozim bashkëkohor mbi gjenerimin e SE subjekt në rasë emërore.....	98
	<i>Përfundime</i> .....	101
<b>KREU V:</b>	<b>RASA KALLËZORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ</b> .....	103-125
5.1	Caktimi i rasës kallëzore.....	103
5.1.1	Caktimi i rasës kallëzore përjashtimore.....	107
5.1.2	Caktimi i rasës kallëzore në ndërtimet pësore.....	110
5.1.3	Caktimi i rasës kallëzore në ndërtimet me folje joakuzative.....	114
5.2	Caktimi i rasës kallëzore SE argument i brendshëm në pozicion specifikuesi.....	118
	<i>Përfundime</i> .....	124
<b>KREU VI:</b>	<b>RASA DHANORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ</b> .....	126-1149
6.1	Njohuri të përgjithshme mbi rasën dhanore dhe caktimin e saj.....	126
6.2	Caktimi i rasës dhanore në ndërtimet me folje tre valente në gjuhën angleze .....	129
6.3	Caktimi i rasës dhanore në ndërtimet me folje tre valente në gjuhën shqipe.....	140
	<i>Përfundime</i> .....	148
<b>KREU VII:</b>	<b>RASA GJINORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ</b> .....	150-174
7.1	Rasa gjinore. Njohuri të përgjithshme.....	150
7.1.1	Zhvillimi historik i rasës gjinore në gjuhën angleze.....	151
7.1.2	Zhvillimi historik i rasës gjinore në gjuhën shqipe.....	154
7.2	Caktimi i rasës gjinore në gjuhën angleze.....	156
7.3	Teori më të thelluara në caktimin e rasës gjinore.....	160
7.4	Caktimi i rasës gjinore të gjuhës shqipe në këndvështrimin gjenerativist.....	165
7.5	Rasa strukturore përkundrejt rasës abstrakte.....	170
	<i>Përfundime</i> .....	173
<b>KREU VIII:</b>	<b>RASA RRJEDHORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ</b> .....	175-181
8.1	Caktimi i rasës rrjedhore në gjuhën shqipe.....	175
	<i>Përfundime</i> .....	181
<b>KREU IX: CAKTIMI I RASËS SË ÇUDITSHME/QUIRKY</b> .....		182-187
9.1	Rasa quirky/e çuditshme në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe.....	182
	<i>Përfundime</i> .....	187
<b>KONKLUZIONE</b> .....		188
<b>LITERATURA</b> .....		192

## **HYRJJE**

*Gjuhësia tradicionale, mbizotëruese deri aty nga mesi i shekullit të kaluar në të dyja anët e Atlantikut, përbënte një metodë me përhapje dhe përdorim të gjerë e të suksesshëm në përshkrimin e gjuhëve indoeuropiane. Në planin diakronik kjo metodë kishte arritur suksese në përcaktimin dhe ndërtimin e familjeve kryesore të gjuhëve si dhe në hartimin e gramatikës historike të tyre, ndërsa në planin sinkronik kjo metodë synonte përshkrimin deri në detaje të morfologjisë të shumë gjuhëve. Po në planin sinkronik u hodhën hapat e parë në fushën e sintaksës, përfshirë këtu analizën sintaksore të fjalisë, duke iu përkushtuar lidhjes së anës formale me atë kuptimore. Sipas teorisë gjuhësore të gramatikës tradicionale sintaksa përshkruhet thjesht si taksonimi e elementëve që nxirren nga korpusi i të dhënave. Me taksonimi të elementëve do të kuptojmë analizën klasifikuese dhe hierarkike të strukturave sintaksore të një gjuhë.*

*Si rezultat, studimi gramatikor tradicional karakterizohet nga një varg kufizimesh dhe të metash si:*

- *gramatika e gjuhëve e hartuar nga metoda të tilla, bazë e të cilave është përshkrimi dhe taksonimia e elementëve, është më tepër normative sesa shpjeguese, dmth. tregon se si duhet përdorur gjuha në përputhje me rregullat gjuhësorë.*
- *Parimet e kësaj gjuhësie janë ndërtuar duke pasur parasysh gjuhët indoeuropiane dhe zbatimi i tyre nuk mundësonte përshkrimin e gjuhëve jo indoeuropiane.*

*Këto kufizime bënë që në të dyja anët e Atlantikut një brez i ri gjuhëtarësh, duke përpunuar këto parimeve, të bëjnë të mundur lindjen e një metode dhe teorie të re më të përshtatshme për përshkrimin e gjuhëve, **strukturalizmin ose deskriptivizmin.***

*Ky model i ri i përshkrimit të gjuhëve përfshin dy drejtime të ndryshme:*

- **Strukturalizmin europian**, i cili merrej me studimin e gjuhëve të njohura si dhe me hartimin e një teorie gjuhësore shkencore, e cila do të ndihmonte në analizën e materialit gjuhësor të grumbulluar nga drejtimit e mëparshme.
- **Strukturalizmin amerikan (deskriptivizmi)**, i cili u përqëndrua në përshkrimin e gjuhëve të panjohura, duke tentuar të merret jo vetëm me teknikat e analizës, por edhe me pyetjen se çfarë është gjuha për përdoruesit e saj dhe si e kryen ajo një funksion të tillë në jetën shoqërore.

*Parimet kryesore të gjuhësisë deskriptiviste ngjallën kundërshtime midis gjuhëtarëve amerikanë, pasi ato krijojnë kufizime të tipit: përjashtimi i kuptimit nga analiza gjuhësore; përshkrimi i gjuhëve kryesisht në aspektin sinkronik duke anashkaluar diakroninë; shpalljen e përshkrimit si detyra kryesore dhe e vetme e gjuhëtarit si dhe shpalljen e distribucionit si i vetmi kriter i analizës gjuhësore.*

*Nisur nga këto kufizime lindi në SHBA, aty nga mesi i viteve '50, një drejtim gjuhësor krejt bashkohor i njohur si gjenerativizëm i cili zë fill me botimin e veprës “Syntactic Structures” (1957) të N. Chomskit.*

*Së pari, studiuesit gjenerativistë ndryshe nga deskriptivistët e përfshinë kuptimin në analizën e tyre gjuhësore, por semantikës nuk i dhanë të njëjtën rëndësi, ashtu sikundër vepruan më sintaksën.*

*Së dyti, edhe gjatë analizës gjenerativiste aspekti diakronik u shpërfill, por në të vërtetë gjatë kësaj analize u vu re një përzierje midis diakronisë dhe sinkronisë të njohur ndryshe si akroni.*

*Së treti, gjenerativistët, përveç përshkrimit, i japin një rëndësi të veçantë shpjegimit të fakteve gjuhësore. Pikërisht, kalimi nga një **gjuhësi taksonimike**, e bazuar kryesisht në inventarizimin dhe klasifikimin e njësisë gjuhësore, drejt një **gjuhësie teorike gjenerative**, e përqëndruar kryesisht në çështjen kryesore të përvetësimit të gjuhës nga individët, përbën edhe thelbin e revolucionit chomskian në gjuhësi<sup>1</sup>. Në këtë kontekst, Chomsky duke refuzuar këtë analizë taksonimike dhe përshkruese post-blumfildiane<sup>2</sup> thekson se “detyra e gjuhëtarit është krijimi i një mekanizmi gjuhësor që t’i përgjigjet të gjitha dhe vetëm fjalive të gjuhës.”*

### ***1. Përligja e studimit***

*Në këtë punim, duke marrë shkas nga studimet e suksesshme të kohëve të fundit në lëmin e sintaksës gjenerative, jemi përpjekur të ofrojmë një trajtim gjithpërfshirës dhe deri diku shterues për sa i përket caktimit të rasave **sintagmave emërore** të gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe në këndvështrimin gjenerativist.*

*Gjuhësia gjenerative e cila u shfaq fillimisht aty nga mesi i shekullit të kaluar sot njihet një shtrirje të gjerë, mbarëkombëtare. Shtrirja dhe përqafimi i kësaj gjuhësie lidhet ngushtë me*

---

<sup>1</sup> Ruwet (1968) sipas Memushaj R. *Gjuhësia gjenerative*. 2003

<sup>2</sup> Buxheli L. “Modele të caktimit rasor në gjuhën shqipe”, 2007

kontributin kryesor të saj, i cili nuk ndalet vetëm në përshkrimin e gjuhëve me struktura të ndryshme, por shkon më tej. Pra, ajo përveç përshkrimit gjuhësor, mund të dallojë, midis strukturave të ndryshme të gjuhëve të botës, parimet e përbashkëta të organizimit të tyre duke ndikuar në zbulimin e dukurive universale midis tyre.

Në këtë kontekst, ky drejtim gjuhësor synon, ashtu sikundër shprehet edhe Rei Xhakendof, **“përmbysjen e gramatikës nga themelet”** dhe rindërtimin e saj bazuar kryesisht në pesë modulet bazë të njohura ndryshe si: Teoria e lidhjes, Teoria e drejtimit, Teoria e roleve tematike, Teoria e kontrollit dhe Teoria e rasës, ku kjo e fundit përbën edhe një prej moduleve kryesore në të cilin bazohet ky studim.

Gjuha angleze si një gjuhë analitike i është nënshtruar një riformulimi dhe rindërtimi të suksesshëm gjenerativist. Përkundrazi, gjuha shqipe shfaq një realitet krejt ndryshe karakterizuar nga një reagim shumë i ngadaltë në përqafimin dhe zbatimin e këtij drejtimi gjuhësor. Përshkrimi i saj me metodat dhe teknikat e kësaj gjuhësie fillimisht është konsideruar si i pamundur, duke pohuar se konceptet gjenerativiste nuk i përshtaten kësaj gjuhe. Por studimet dhe punimet e mëvonshme të sjella nga gjuhëtarët shqiptar dhe të huaj si: Rami Memushaj, Josif Mitaj, Flora Koleci, Thoma Dhima, Giusepina Turrano etj, tregojnë të kundërtën.

## **2. Objekti i studimit**

Edhe pse i gjithë punimi do të trajtohet nën këndvështrimin gjenerativist objekti kryesor i tij do të jetë trajtimi i përndarjes së sintagmave emërore të të dyja gjuhëve sipas kategorisë së rasës. Studimi i kategorisë së rasës ka tërhequr vëmendjen e studiuesve qysh në lashtësi, gjë që vërtetohet edhe nga evoluimi i mendimit teorik mbi këtë kategori dhe pasurimi i saj me ide të reja.

Sipas Chomsky-it<sup>3</sup> dy janë detyrat kryesore të aftësisë gjuhësore të folësit në lidhje me sintagmën emërore: e para, të rregullojë distribucionin e SE; e dyta, të bëjë interpretimin kuptimor të SE. Për rrjedhojë, dy janë modulet kryesore të kësaj aftësie gjuhësore për realizimin e distribucionit dhe interpretimit kuptimor të SE: e para rasa dhe e dyta rolet tematike.

---

<sup>3</sup> Buxheli L. *Modelet e caktimit razor në gjuhën e sotme shqipe*, 2007, fq 53



## ***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përjasje me gjuhën shqipe.***

---

Gjatë këtij punimi kategoria e rasës do të trajtohet në planin strukturor si objekt studimi i sintaksës duke i shtuar aspektit morfologjik (mbizotërues i gramatikës tradicionale) edhe aspektin sintaksor i cili është po aq i rëndësishëm dhe nuk duhet nënvlerësuar.

Për arsye se, në këtë punim i largohemi teorisë tradicionale dhe zgjedhim të hulumtojmë mbi një teori e cila operon me koncepte dhe ide të reja (ato të gramatikës gjenerative), kemi hasur jo rrallë probleme për kapërcimin e të cilave na është dashur t'i referohemi përfaqësimeve rasore të hershme dhe studimeve përkatëse. Pra ky punim në vetvete është një analizë sinkronike që i bëhet strukturave sintaksore, më saktë përndarjes së SE, të të dyja gjuhëve sipas teorisë gjenerativiste të rasës. Gjithashtu, për çështje të caktuara të cilat lidhen kryesisht me zhvillimin historik të kategorisë së rasës në të dyja gjuhët, ndërtimin dhe caktimin e rasës dhanore në ndërtimet "double object constructions" të gjuhës angleze, ndërtimin dhe caktimin e rasës gjinore në të dyja gjuhët si dhe caktimin e rasës quirky në gjuhën angleze sjellim një ndërthurje të suksesshme midis analizës sinkronike dhe asaj diakronike.

Studimi në tërësinë e vet do të shoqërohet me shembuj ilustrues të cilët i kemi vjelë kryesisht nga gramatikat dhe fjalorët e të dyja gjuhëve, shkrimet publicistike dhe botimet shkencore në lëmin e drejtimit gjenerativist.

*Përmendim:*

### **Gramatika**

*Akademia e Shkencave e RSh, Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia), Tiranë, 1995.*

*Akademia e Shkencave e RSh, Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa), Tiranë, 1995.*

*Cambridge University Press, The Cambridge Grammar of English Language, 2002*

*Heageman L. Elements of grammar. Handbook in generative syntax, 1997*

*Hogg R An introduction to old English, Edinburgh university Press 2002*

*The Blackwell Companion to Syntax, Volume I-V, (version elektronik)*

### **Fjalor**

*Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave, Tiranë 1980*

*Oxford Advanced Learner's Dictionary, Oxford University Press, 1995*

### **Publicistikw**

*E përditshmja New York Time dhe Daily News*

### ***3. Metodologjia e përdorur dhe struktura e punimit***

*Për realizimin e këtij punimi është përdorur metoda analitiko-krahasuese duke analizuar korpusin e të dhënave gjuhësore, veçanërisht atyre sintaksore të të dyja gjuhëve, me qëllimin e vetëm zbulimin e strukturave të përbashkëta si dhe parimeve universale që zbatohen mbi to. Krahas sa më sipër, në këtë punim përveç analizës përshkruese, të trashëguar nga drejtimi gjuhësor tradicional, përdoret kryesisht analiza shpjeguese e cila bazohen në përpunimin dhe interpretimin e dukurisë sintaksore të caktimit të rasave.*

*Për hartimin e këtij punimi kemi shfrytëzuar një literaturë të gjerë në të dyja gjuhët duke përfshirë botimet (libra dhe artikuj shkencor) të studiuesve gjenerativistë të huaj dhe të vendit si: N. Chomsky, L. Heageman, A. Radford, S. Abney, G. Turrano, R. Manzini, L. Rizzi, J. McCloskey, G. Graffi, d. Adger, M. Baker, R. Memushaj, J. Mitaj, Th. Dhima, L Buxheli, F. Koleci, Sh. Rrokaj etj.*

#### ***3.1 Struktura e punimit.***

*Ky punim është ndërtuar në bazë të nëntë kapitujve. Kreu i parë trajton përbërësin emëror “phrase” të gjuhës angleze ose sintagmë të gjuhës shqipe duke nënvizuar përparësitë që analiza e fjalisë në sintagma ofron përkundrejt të njëjtës analizë në togfjalësha. Në vijim trajtojmë llojet e sintagmave si dhe strukturimin e tyre sipas teorisë X’. Një vëmendje e veçantë i kushtohet SE si një prej përbërësve kryesorë si dhe përfshirjes së saj në përbërjen e projekcionit maksimal funksional sintagmë e determinuesit (SDet).*

*Kreu i dytë analizon një prej moduleve kryesore të Gjuhësisë Gjenerative, Teorinë e roleve tematike, e cila ka si objekt studimi marrëdhëniet e vendosura midis përbërësit foljor, të njohur si bërthama ose qendra e fjalisë, dhe SE argumente të tij. Folja, si qendër e fjalisë, për të plotësuar ose më saktë për të përmbushur veçoritë e saj semantike e ka të nevojshme shprehjen e një, dy, tre ose asnjë SE argument. Në varësi të numrit të argumenteve foljet grupohen dhe klasifikohen në folje zero, një, dy dhe treargumentale. Gjithashtu, folja në varësi të marrëdhënieve semantike që vendos me SE u cakton këtyre të fundit një rol tematik të caktuar.*

*Në kreun e tretë synohet trajtimi i kategorisë së rasës në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe.*

*Kategoria e rasës në të dyja këto gjuhë do të shihet së pari në planin historik duke evidentuar humbjet e pësuar (kryesisht gjuha angleze) në rrasa në rrjedhën e viteve dhe*

gjithashtu gjëndjen e saj në ditët e sotme. Në vijim kategoria e rasës dhe kryesisht caktimi i rasave përbërësve emërorë do të trajtohet në këndvështrimin gjenerativist si një prej objekteve kryesore të Teorisë së rasës. Në kreun e katërt e në vijim do të trajtohen të gjitha rasat e të dyja gjuhëve si dhe veçoritë e caktimit të tyre. Së pari do të studiohet caktimi i rasës emërore përbërësit emëror i cili përfaqëson kryesisht SE subjekt të fjalisë. Nënçështja e parë e këtij kreu do t'i kushtohet rasës emërore, përkufizimit dhe klasifikimit të saj. Në vijim do të analizohet caktuesi i kësaj rase si dhe modeli strukturor apo inherent që caktimi i kësaj rase përfaqëson.

Një vemendje e veçantë do t'i kushtohet edhe rasteve përjashtimore të caktimit të rasës emërore. Objekt studimi i kreut të pestë është sintagma emërore në rasë kallëzore e cila sintaksisht përbën kundrinorin e drejtë të fjalisë. Edhe për këtë rasë do të analizohet caktuesi i saj si dhe modeli që caktimi i rasës kallëzore përfaqëson. Caktimi i rasës kallëzore do të trajtohet jo vetëm në ndërtimet përjashtimore, por edhe në ato pësore dhe joakuzative. Këto ndërtime përbëjnë përjashtim nga norma e përgjithshme e caktimit të kësaj rase.

Në kreun e gjashtë synohet trajtimi i ndërtimeve me folje trevalente të cilat përbëjnë vështirësi strukturimi në të dyja gjuhët. Kur flitet për folje trevalente nënkuptohen foljet që pranojnë dy argumente të brendshme, përkatësisht kundrinorin e drejtë dhe kundrinorin e zhdrejtë. Këtij të fundit i caktohet rasë dhanore nga folja kallëzues e fjalisë. Caktimi i rasës dhanore në të dyja gjuhët përbën një model të ndërlikuar përse i përket strukturimit të sintagmave sipas teorisë X'.

Rasa gjinore dhe caktimi i saj do të jetë objekt studimi trajtuar në kreun e shtatë. SE në rasë gjinore në të dyja gjuhët shfaq vështirësi studimi, pasi në gjuhën angleze është klitiku 's që ngre problematika strukturimi ndërsa në gjuhën shqipe janë nyja e përparme e rasës gjinore dhe ajo e prapme e emrit në gjinore që kërkojnë vemendje. Për t'i dhënë zgjidhje këtyre problemeve do t'i referohemi trajtimin historik të tyre.

Në kreun e tetë do të trajtohet caktimi i rasës rrjedhore SE plotës. Caktimi i kësaj rase do të studiohet vetëm në gjuhën shqipe, pasi gjuha angleze nuk e ka një rasë të tillë

Si përfundim, kreu i nëntë trajton caktimin e rasave të çuditshme në të dyja gjuhët. E veçanta e këtij kreu është se anglishtja e ditëve të sotme për vetë faktin se ajo është një gjuhë sintetike me rend të ngulitur nuk ka ndërtime me rasë të çuditshme. Një panoramë të ndryshme paraqet gjuha shqipe e cila ka ndërtime me rasë të çuditshme emërore dhe dhanore.

**SHKURTIME**

<b>HSB</b>	-	<i>Hipoteza e subjektit të brendshëm (Internal Subject Hypothesis)</i>
<b>SDet (DP)</b>	-	<i>sintagmë determinative (determinative phrase)</i>
<b>SDet<sub>op</sub></b>	-	<i>sintagmë e determinuesit operator</i>
<b>SDetPron (DetPossN)-</b>	-	<i>sintagmë e determinuesit të pronësisë (determinative possessive phrase)</i>
<b>SE (NP)</b>	-	<i>sintagmë emërore (noun phrase)</i>
<b>SEpt (IP)</b>	-	<i>sintagmë eptimore (inflectional phrase)</i>
<b>SF (VP)</b>	-	<i>sintagmë foljore (verb phrase)</i>
<b>Sf<sub>mes</sub></b>	-	<i>projeksion i ndërmjetëm i sintagmës foljore</i>
<b>SK (CP)</b>	-	<i>sintagmë komplementuese (complementizer phrase)</i>
<b>SKohë (TP)</b>	-	<i>sintagmë e kohës (tense phrase)</i>
<b>SMb (AdjP)</b>	-	<i>sintagmë mbiemërore (adjectival phrase)</i>
<b>SMoh (NegP)</b>	-	<i>sintagmë e mohimit (negation phrase)</i>
<b>SMën</b>	-	<i>sintagmë e mënyrës</i>
<b>SNjoh</b>	-	<i>sintagmë e njohura</i>
<b>SP (PP)</b>	-	<i>sintagmë paraqallore (prepositional phrase)</i>
<b>Spec</b>	-	<i>specifikues (specifier)</i>
<b>SpecSEpt</b>	-	<i>specifikues i sintagmës eptimore</i>
<b>SpecSF</b>	-	<i>specifikues i sintagmës foljore</i>
<b>SpecSPrKd</b>	-	<i>specifikues i sintagmës së përshtatjes së kundrinorit</i>
<b>SpecSPrKr</b>	-	<i>Specifikues i sintagmës së përshtatjes së kryefjalës</i>
<b>SpecSPrKzh</b>	-	<i>Specifikues i sintagmës së përshtatjes së kundrinorit të zhdrejtë</i>
<b>SPr (AgrP)</b>	-	<i>sintagmë e përshtatjes (agreement phrase)</i>
<b>SPrEM (AgrNP)</b>	-	<i>sintagmë e përshtatjes emërore (agreement noun phrase)</i>
<b>SPrKd (AgrOP)</b>	-	<i>sintagmë e përshtatjes së kundrinorit (agreement object phrase)</i>
<b>SPrKr (AgrSP)</b>	-	<i>sintagmë e përshtatjes së kryefjalës (agreement subject phrase)</i>
<b>SPrKZh (AgrInOP)</b>	-	<i>sintagmë e përshtatjes së kundrinorit të drejtë (agreement indirect object phrase)</i>
<b>SQ (QP)</b>	-	<i>sintagmë e kuantifikuesit (quantifier phrase)</i>

# KREU I

## ***SINTAGMA: LLOJET DHE NDËRTIMI I TYRE (NJOHURI TË PËRGJITHSHME)***

### ***1.1 SINTAGMA: PËRKUFIZIMI, NDËRTIMI DHE KARAKTERISTIKAT DALLUESE TË SAJ KRAHASUAR ME TOGFJALËSHIN***

Siç parashtuam edhe në “Hyrje” të këtij punimi, drejtimi gjenerativist i prezantuar për herë të parë nga Chomsky në veprën e tij “Syntactic Structures” (1957) ka si objekt studimi përshkrimin gjuhësor të ndërtimeve të një gjuhe. Kjo e fundit është konceptuar si “një bashkësi e pafundme frazash të ndërtura nga një numër i fundëm elementësh bazë”, ku me elementë bazë do të kuptohen fonemat dhe morfemat<sup>4</sup>. Nisur nga ky përkufizim, si njësia më e rëndësishme në përshkrimin e gjuhëve njërezore është pranuar “*phrase/fraza*” (anglisht) e cila përbën një njësi të një niveli përfaqësimi më të lartë se ai fonemor dhe morfemor. Termi *phrase/frazë* në vetvete është një përfaqësim i termit më të hershëm “*përbërës*” i përdorur për herë të parë më 1933 nga distribucionalistët amerikanë<sup>5</sup> të cilët patën si qëllim të përcaktonin ndërtimin e fjalive të një korpusi me pikënisje përbërësit e drejtpërdrejtë mbi bazën e varësisë dhe lidhjes së ngushtë të elementëve. Me përbërës të drejtpërdrejtë do të kuptohej secili prej elementeve që rezultojnë nga ndarja e parë e një njësie gjuhësore në pjesë. Ose ndryshe përbërësi i drejtpërdrejtë është njësi gjuhësore që bën pjesë në një ndërtim më të gjerë, i formuar edhe ky nga përbërës më të vegjël.

Termi aktual *phrase/frazë* nuk identifikohet vetëm me Chomskin, pasi atë e gjejmë edhe te Sosyri. Ky i fundit, duke u nisur nga përkufizimi i njohjes gjuhësore të individëve si produkt i shoqërisë, e përkufizon termin *frazë* si “*kombinime me të cilat folësi bën të ditura (shkodon) mendimet e veta*”<sup>6</sup>. Pra Sosyri *frazën* e sheh si njësi të ligjerimit, ndërsa Chomsky e trajton atë si njësi themelore të gjuhës. Përsa i përket gjuhës shqipe, për vetë faktin se përdorimi i termit *frazë*

---

<sup>4</sup> Chomsky N. *Syntactic Structures*, 2002 fq 18-33

<sup>5</sup> Dhima Th. “Çështje të sintaksës në gjuhën shqipe” Art. “Rreth analizës sintaksore të fjalisë”, Tiranë, 2013, fq. 29

<sup>6</sup> Chomsky N. *Le strutture della sintassi* (variant i versionit anglisht *Syntactic Structures*), 1974 fq. VII-XXXI

do të keqinterpretohej si fjali ose periudhe, është preferuar përdorimi i termit “sintagmë”. Për ta kuptuar më mirë shpjegojmë se termi frazë në gjuhën shqipe është përdorur për herë të parë nga M. Domi (1964)<sup>7</sup> duke nënkuptuar dy ose më shumë fjali të bashkuara me mjete të ndryshme sintaksore. M. Totoni (2000)<sup>8</sup> e përkufizon frazën si njësi sintaksore të ligjërimit të realizuar në një kontekst a situatë të karakterizuar nga kuptimi i plotë dhe intonacioni i mbaruar. Pra, sipas këtij studiuesi ajo përfaqëson fjalitë e thjeshta, pasi të përbërat konsiderohen periudha. Vitet e fundit, falë ndikimit revolucionarizues të gjuhësisë gjenerative, me termin frazë/sintagmë nënkuptohet njësia ndërtimore, kuptimore që qëndron e pozicionuar midis fjalës (e cila kryen funksion sintaksor) dhe fjalisë (e cila përmban kuptim). Në këtë kontekst, ajo përfaqëson një njësi me madhësi të pacaktuar duke përfshirë si një fjalë të vetme ashtu edhe një fjali. Gjithashtu, fraza/sintagma konceptohet si njësi ndërtimore e kuptimore e cila kur përputhet me grupin kuptimor ka intonacionin e vet që është pjesë e lakores melodike të fjalisë. Për të kuptuar më tepër se çfarë përfaqësojnë frazat/sintagmat, kufijtë e tyre si dhe për të specifikuar se cilat kombinime hierarkike brenda strukturës së një fjalie do të pranohen si të tilla studiuesit Adger<sup>9</sup>, Heageman<sup>10</sup> dhe Radford<sup>11</sup> propozojnë praktikën e mëposhtme të testimit.

### **1. Kohezioni semantik**

*Shembull.*

1.a **That bottle of water** might have been broken.

1.b **Ajo shishe uji** mund të ketë qenë e thyer.

Vargu i fjalëve **that bottle of water/ajo shishe uji** ka një kohesion semantik të cilin nuk e gjejmë te vargu **of water might/uji mund**. Vargu i parë në krahasim me vargun e dytë përmban kuptim, por nuk mund të pretendojmë se plotësia kuptimore e tyre është barazvlefshme me atë të fjalisë.

### **2. Funkzioni sintaksor i njëjtë me funksionin sintaksor të një fjale të vetme**

Një varg fjalësh, ashtu si një fjalë e vetme, mund të luajë të njëjtin rol dhe të kryejë të njëjtin funksion në fjali.

---

<sup>7</sup> Dhima Th., *Disa veçori të frazës shqipe në këndvështrimin e gjuhësisë së sotme*, Seminari i Albanologjisë, Ohër, 2007

<sup>8</sup> Po aty

<sup>9</sup> Adger D., *Core Syntax. A minimalist approach*, 2002, fq. 48-53

<sup>10</sup> Heageman L., *Introduction to government and binding theory*, 1991, fq. 23-31

<sup>11</sup> Radford A., *Minimalist Syntax. Exploring the structure of English*, 2004, fq 38-39

*Shembull*

- 2.a **The student** protested violently.
- 2.b **The first year student** protested violently.
- 2.c **Studenti** kishte protestuar fuqimisht.
- 2.d **Studenti i vitit të parë** kishte protestuar fuqimisht.

**3. Lëvizja e frazave brenda fjalisë**

Folësit e lindur të një gjuhe janë në gjendje të dallojnë nëse një varg fjalësh përbën një frazë edhe në rastet kur ky term është i panjohur për ta.

*Shembull*

- 3.a **Many students** participated in the cultural activities.  
In the cultural activities participated **many students**.  
\* **Many** participated **students** in the cultural activities (jogramatikore)
- 3.b **Shumë studentë** morën pjesë në aktivitetet kulturore.  
Në aktivitetet kulturore morën pjesë **shumë studentë**.  
\* **Shumë** morën pjesë **studentë** në aktivitetet kulturore.(jogramatikore)

Vargjet e natyrshme të fjalëve mund t'i zhvendosim, pa ndikuar në gramatikalitetin e fjalisë, nga një pikë e fjalisë në një tjetër. (E pranuar kjo për shqipen në tërësi dhe për ndërtime të veçanta dhe të kufizuara të anglishtes)

**4. Shqiptimi i veçuar .**

Një frazë mund të shqiptohet e veçuar si një thënie më vete e painkuadruar në përbërjen e fjalisë. Këtu përshijmë ndërtimet pyetëse të anglishtes të njohura si “wh-questions” dhe ato të shqipes të ndërtuara me ndihmën e përemrave pyetës Kush? Kujt? Kë? etj.

*Shembull*

- 4.a Jill will meet his fiance at the castle. (Fjalja bazë)
- 4.b *Whom* will Jill meet at the castle?  
**His fiance** - përbërës emëror, kundrinor i drejtë
- 4.c *Who* will meet his fiance at the castle?  
**Jill** - përbërës emëror kryefjalë

- 5.a Maria do të takojë të fejuarin në kështjellë.
- 5.b *Kë* do të takojë Maria në kështjellë  
**Të fejuarin** - përbërës emëror kundrinor i drejtë
- 5.c *Kush* do të takojë të fejuarin në kështjellë?  
**Maria** - përbërës emëror kryefjalë

Po tu referohemi gramatikave përkatëse të të dyja gjuhëve vërejmë se pyetjet e ndërtuara me Wh? (në gjuhën angleze) dhe përemra pyetës (në gjuhën shqipe) i drejtohen kallëzuesit të fjalisë me qëllim që të identifikohen përbërësit parësorë dhe dytësorë si dhe funksionet përkatëse (kryefjalë; kundrinor i drejtë dhe kundrinor i zhdrejtë) të kryera nga secila në strukturën e fjalisë. Këto pyetje shërbejnë për të veçuar një prej përbërësve të fjalisë i cili kryen një nga funksionet sintaksore të sipërpërmendura vërtetuar edhe nga përgjigjet e shkurtuara sipas shembujve. Pra, përveç shqiptimit të veçuar, përbërësit e mësipërm mbartin edhe funksion sintaksor.

#### **5. Mosndërprerja.**

Nëse duam të shtojmë një përcaktues kohor si “*dje/yesterday*” në përbërjen e fjalisë, atë mund ta pozicionojmë kudo, por jo midis përbërësve të një fraze.

*Shembull*

- 6.a **Many students** participated *yesterday* in the cultural activities.  
\* **Many yesterday students** participated in the cultural activities.
- 6.b *Dje shumë studentë* morën pjesë në aktivitetet kulturore.  
\* **Shumë dje studentë** morën pjesë në aktivitetet kulturore.

#### **6. Zëvendësimi me një proformë.**

Si proformë do të shërbejë një përemër vetor si dhe ndajfoljet *atje, këtu etj*, të cilat mund të përdoren në vend të grupeve emërore ose parafjalore.

*Shembull*

- 7.a **The ambassador of USA** greeted all the students.  
*He* greeted all the students.
- 7.b **Ambasadori i USA** përshëndeti të gjithë studentët.  
*Ai* përshëndeti të gjithë studentët.



## **7. Bashkërenditja.**

Vetëm sintagmat e të njëjtit tip mund të bashkërenditen.

*Shembull*

8.a **Our friends and our colleagues** are all invited in our wedding ceremony.

8.b **Shokët dhe kolegët** tanë janë të gjithë të ftuar në ceremoninë tonë të dasmës.

Nga praktikat testuese të mësipërme të ilustruara edhe me shembuj shqip vërejmë se koncepti i sintagmës mund të aplikohet dhe në terminologjinë gramatikore të gjuhës shqipe. Në gjuhën shqipe termi sintagmë përfaqëson një term të përdorur shumë më herët se zbatimi i gramatikës gjenerative. Ky term përmendet për herë të parë më 1959 nga S. Prifti kur thotë *se “njësitë sintaksore quhen sintagma apo togje fjalësh<sup>12</sup>”*. Me termin sintagmë S. Prifti jep idenë e grupit të fjalëve që ka një bërthamë e që mund të zgjerohet me tej me elemente të tjerë. Mirëpo, ky koncept tek ai është shumë i gjerë, pasi përfshin edhe fjalët e përbëra. Gjithashtu, ndarja që i bëhet fjalisë nga S. Prifti në sintagma afron më shumë me ndarjen në togfjalësh të gjuhësisë tradicionale.

Nga ana tjetër termi togfjalësh i gjuhësisë tradicionale ka hyrë në sintaksën e gjuhës shqipe që nga viti 1968 në një kumtesë të mbajtur nga S. Floqi në Konferencën e Dytë Albanologjike<sup>13</sup>. Analiza e fjalisë në togfjalësh përbën një kontribut të padiskutueshëm në gjuhën shqipe, pasi jo vetëm që i përshtatet kësaj gjuhe, por edhe disiplinoi ndërgjegjen tonë gramatikore me nocion e grupit të fjalëve se midis kategorisë së fjalës dhe fjalisë ka edhe një kategori të ndërmjetme të quajtur togfjalësh. Pra, me fjalë të tjera termi “togfjalësh” i gjuhës shqipe është përkufizuar si *“njësia sintaksore dhe strukturore e përftuar gjatë ligjërimit nga bashkimi gramatikor i dy a më shumë fjalëve kuptimplota”<sup>14</sup>*. Nga ana tjetër teoria e togfjalëshit ngre probleme si në planin teorik dhe në atë praktik të analizës së fjalisë, gjë që e bën të nevojshme zëvendësimin e këtij termi me atë të sintagmës. Sqarojmë se në gjuhën shqipe nuk kemi të bëjmë vetëm me një zëvendësim termash, por më saktë me një rikonceptim të njësisë bazë të strukturës së fjalisë duke pasqyruar përparësitë që sintagma (krahasuar me togfjalëshin) ka.

---

<sup>12</sup> Dhima Th. “Çështje të sintaksës në gjuhën shqipe” Art. “Rreth analizës sintaksore të fjalisë”, Tiranë, 2013, fq. 32

<sup>13</sup> Dhima Th. “Çështje të sintaksës në gjuhën shqipe” Art. “Probleme të njësive sintaksore (Togfjalëshi dhe sintagma)”, Tiranë, 2013, fq. 13.

<sup>14</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 2002

1. Togfjalëshi karakterizohet nga dygjymtyrësia, pra ai formohet si rezultati i bashkimit kuptimor dhe gramatikor i dy fjalëve, jo çfarëdo, por fjalë shënuese ose kuptimplota. Përkundrazi, vëllimi i sintagmës varion nga një fjalë e vetme në një fjali, struktura e së cilës ka karakter binar dukë përfshirë dy kategori sintaksore dhe jo dy gjymtyrë. Gjithashtu theksojmë se në përbërjen e sintagmës pranohen si fjalët shënuese (kuptimplota) edhe ato joshënuese (jokuptimplota).

*Shembull*

9.a The concert ended successfully.

9.b Koncerti përfundoi me sukses.

**SE** – Koncerti; the concert - përbëhet nga një fjalë e vetme.

**Togfjalëshat:** koncerti përfundoi; përfundoi me sukses; the concert ended; ended successfully.

**Sintagmat:** SE ( the concert; koncerti) SF (ended successfully; përfundoi me sukses) SN<sub>anglisht</sub> (successfully) SP<sub>shqip</sub> (me sukses)

Teoria e sintagmave pranon si përbërës të sintagmave edhe fjalë joshënuese, si: numërori, përemri<sup>15</sup>, nyja e cila është pjesë përbërëse e SE dhe parafjala, e cila jo vetëm që është përbërëse e SP por edhe kokë e saj. Në këtë kontekst, për të vërtetur më tej faktin se elementët përbërës të sintagmave janë edhe fjalët joshënuese, vlen të përmendim praninë e sintagmave funksionale si SEPT (Sintagma e Eptimit) dhe SK (Sintagma Komplomentuese).

2. Sintagmat kanë strukturë të brendshme të organizuar në mënyrë hierarkike, duke u nisur nga sintagma maksimale (fjalia) dhe duke mbëritur shkallë – shkallë te niveli më i ulët ai i kokës së sintagmës sipas rishkrimit të mëposhtëm:

**Fj** → **SE + SF**

**SE** → **Spec + E**

**SF** → **F + SE + SP**

**SE** → **Spec + E**

**S** → **NP + VP**

**NP** → **Spec + N**

**VP** → **V + NP**

**NP** → **Spec + N**

Përkundrazi togfjalëshi shënon bashkime dyshe të fjalëve pa zbuluar strukturën e tyre të brendshme. Te togfjalëshi e njëjta fjalë mund të jetë element përbërës i një, dy ose më shumë

---

<sup>15</sup> Në gjuhën shqipe përemrat dhe numërorët nuk përfshihen në togfjalësh, pasi ato nuk janë fjalë shënuese. Gjithashtu, këto pjesë të ligjëratës nuk përfshihen as në teorinë e sintagmave duke mos dalë si sintagma më vete. Ndryshe nga teoria e togfjalëshit në teorinë e sintagmës numërorët dhe përemrat pranohen si koka të sintagmës emërore. (Dhima Th. “Çështje të sintaksës në gjuhën shqipe” Art. “Probleme të njëjësive sintaksore (togfjalëshi dhe sintagma”, Tiranë,2013, fq. 18,19)

kombinimeve togfjalëshore, ndërsa te sintagma një kokë e dhënë formon sintagmë vetëm një herë.

*Shembull*

10.a Nga dashuria e madhe për Atdheun buronin ato fjalë zemre për mërgimtarët.

Kjo fjali do të zbërthehej në togfjalëshat e mëposhtëm: a) *nga dashuria e madhe*; b) *dashuria për atdheun*; c) *buronin ato fjalë*; d) *ato fjalë zemre*; e) *ato fjalë për mërgimtarët*.

Pra togfjalëshat e mësipërm janë formuar duke i lidhur fjalët dy e nga dy në mënyrë drejtvizore, pa shfaqur lidhjet hierarkike të tyre.

Sintagmat e fjalisë së mësipërme janë: SE – *nga dashuria e mashe për atdheun*; SF- *buronin ato fjalë zemre* SE – *ato fjalë zemre* SP – *për mërgimtarët*

Kjo e fundit dëshmon se, togfjalëshi përbën një nga mundësitë e realizimit të sintagmës dhe jo një njësi sintaksore të veçantë.

3. Teoria e togfjalëshit përjashton lidhjet me bashkërenditje për arsye se uniteti gramatikor dhe kuptimor i togfjalëshit zbulohet vetëm në lidhjet me nënrenditje. Përparësia e analizës në sintagma është se krahas sintagmave me lidhje varësie analizohen edhe sintagmat me bashkërenditje, tek të cilat dallojmë dy a më shumë sintagma të një lloji të lidhura me lidhjen e bashkërenditjes.

*Shembull*

11.a *në fshat dhe në qytet; in the village and in the city* → përbën sintagmën parafjalore dominuese të përbërë nga:

**SP** → *në fshat; in the village*

**SP** → *në qytet; in the city*

Dallimi midis sintagmave me lidhje varësie dhe atyre me lidhje bashkërenditje është se në të parat përbërësit e sintagmave i përkasin kategorive të ndryshme, ndërsa në të dytat i përkasin të njëjtës kategori së cilës i përket edhe sintagma dominuese.

4. Një ndër përparësitë e analizës së fjalisë në sintagma është edhe shpjegimi i fjalive njëkryegjymtyrëshe dhe fjalive të paplota duke pranuar ekzistencën e sintagmës zero.

*Shembull*

11.b Nisemi. (*fjali njëkryegjymtyrëshe*) *Përbehet vetëm nga SF me SE të munguar, të pashprehur, të nënkuptuar.*

Nga sa më sipër, përmbledhim se analiza në togfjalësia përfaqëson një analizë horizontale, johierarkike, të rrafshët deri në një farë mase edhe të mangët që nuk çon deri në fund zbërthimin e fjalisë në përbërës, Ndërsa, analiza e fjalisë sipas teorisë së sintagmave përfaqëson një analizë më të përshtatshme, reale, një analizë vertikale, hierarkike që vë në dukje në mënyrë të qartë lidhjet e përbërësve dhe mënyrën e vendosjes së tyre.

Gjatë analizës strukturore që mund t'i bëjmë një fjalië në sintagma, duhet të kemi parasysh dy parime të cilat janë të detyrueshme për ekzistencën e saj.

1. ***Parimi i Kokës*** – Çdo strukturë sintaksore (sintagmë) është projektion i një njësie kokë.
2. ***Parimi i Binaritetit*** - Çdo strukturë sintaksore (sintagmë) përbëhet nga degëzimi binar.

Njësitë leksikore (fjalët) përbërëse të leksikut potencial të një gjuhe i grupojmë në *Kategori Gramatikore* dhe *Kategori Funksionale* bazuar në veçoritë semantike, morfologjike dhe sintaksore të tyre.

***Kategoritë Gramatikore***

Emri  
Folja  
Mbiemri  
Parafjala  
Ndajfolja

***Kategoritë Funksionale***

Nyja  
Lidhëza  
Foljet modale, etj.

Një klasifikim i tillë praktikohet gjerësisht edhe nga përfaqësues dhe mbështetës të gramatikës tradicionale. Përkundrazi, **Chomsky**<sup>16</sup> në librin e tij “*Aspekte të teorisë së sintaksës*” (1965) propozon se të gjitha veçoritë gramatikore (si ato semantike, morfologjike dhe sintaksore) duhen përshkruar bazuar vetëm në një çift tiparësh binare të cilat janë ±E (emëror/joemëror) dhe ±F (foljor/jofoljor) dhe në anglisht ±N dhe ±F.


Emër [ +E;-E]	Folje [ +F;-F]	Mbiemër [+F;+E]	Parafjala [-F;+E]
Emër [ +N;-N]	Verb [ +V;-V]	Adjectiv [+V;+N]	Preposition [-V;+E]

Në planin ndërtimor sintagma shfaqet si një strukturë hierarkike me përbërës të realizuar në pozicione të caktuara në varësi të të cilave ato kryejnë edhe funksionet sintaksore përkatëse. Struktura e fjalisë shprehet më qartë dhe në mënyrë hierarkike me ana të një skeme që është e

---

<sup>16</sup> Memushaj R. *Gjuhësia Gjenerative*, Tiranë, 2008, fq. 108-115

njëjtë për të gjitha gjuhët, që quhet skema X-bar (dependency tree – pemë e varësisë)<sup>17</sup> ose teoria X-bar.



Nga kjo paraqitje skematike vihen re tre përbërës të sintagmës, specifikuesi, koka e sintagmës dhe plotësori të cilët duke u bashkuar hierarkisht japin tre nivelet e mësipërme të projektimit për çdo sintagmë. Niveli i parë ose projekcioni zero përfaqësohet nga koka e sintagmës dhe plotësori bashkimi i të cilëve formon nivelin e dytë ose projekcionin e ndërmjetëm. Niveli i tretë ose projekcioni maksimal realizohet si rezultat i bashkimit të projekcionit të ndërmjetëm me përbërësin specifikues.

Nga ky informacion i gjerë mbi karakteristikat ndërtimore të sintagmave përmbledhim:

- Koka ( $X^0$ ) përbën një element të pamungueshëm të sintagmave. Sintagma pa kokë nuk mund të ketë. Përbërësit plotësor dhe specifikues janë fakultativ, ata edhe mund të mungojnë pa patur as më të voglin ndikim mbi nivelet e projektimit të një sintagme.
- Koka përcakton llojin e sintagmës (SE, SF, SMB, SP) si dhe përzgjedh kategorinë gramatikore të plotësorit dhe specifikuesit (Në rastin e sintagmës foljore koka foljore përzgjedh si plotësor të saj një SE fakt ky që lidhet me strukturën argumentale të foljeve siç do ta shohim edhe në kapitujt në vijim).
- Në të gjitha sintagmat me lidhje varësie dëgët mund ti përkasin një kategorie tjetër të ndryshme nga nyja (për shembull SMB “zemërgjerë nga natyra” përbërësi “nga natyra” përfaqëson një sintagmë parafjalore).

<sup>17</sup> Memushaj R. *Gjuhësia Gjenerative*, Tiranë, 2008, fq. 108-115

## **1.2 LLOJET E SINTAGMAVE SIPAS KËNDVËSHTIMIT GJENERATIVIST**

Para se të kalojmë në paraqitjen dhe analizën e sintagmave si të gjuhës shqipe dhe të asaj angleze duhet të përcaktojmë rolin dhe vendin e ndajfoljeve në teorinë X-bar (teoria e projektimit të sintagmave në strukturën e fjalisë). Një nga problematikat me të cilën janë përballur gjuhëtarët gjenerativistë lidhet me pranimin ose jo të ekzistencës së sintagmave ndajfoljore.

Në gramatikën gjenerative, sidomos në ndarjen që Chomsky<sup>18</sup> u bën kategorive gramatikore në leksikore (ku përfshihet kategoria gramatikore e emrit, mbiemrit, foljes, ndajfoljes) dhe joleksikore (ku përfshihen nyjat, lidhëzat, foljet modale etj) vërehet se ndajfolja nuk përfshihet në asnjërin grupim.

Por, ky problem i ka fillimet më të hershme, që me ndarjen që i bën L. Tesnier<sup>19</sup> gjymtyrëve të fjalisë në qëndrorë të cilët i emërton si gjymtyrë aktantë (gjymtyrë që varen nga folja dhe luajnë një rol të rëndësishëm në fjali) dhe në periferikë që i emërton si gjymtyrë cirkonstantë (gjymtyrë që varen ose jo nga folja dhe që nuk luajnë një rol të rëndësishëm në fjali). Sipas tij një mjet i mirë për shprehjen e cirkonstantëve është ndajfolja<sup>20</sup>.

Në studimet e mëvonshme në lëmin e gjuhësinë gjenerative A. Radford<sup>21</sup> ndalet në diskutimin e statusit të ndajfoljeve. Ky studiues, duke parë ngjashmërinë e një grupi ndajfoljesh me mbiemrat (kur ata ndajnë të njëjtën rrënjë), ku të parat përdoren për të modifikuar përbërësit foljor dhe të dytat për të modifikuar përbërësit emërorë, arrin në përfundimin se këto dy kategori gramatikore përbëjnë variante pozicionale të njëra-tjetërs. Gjithashtu, duke qënë se ndajfoljet pranohen si një tip i veçantë mbiemri ai propozon shkrirjen e mbiemrave dhe ndajfoljeve në një kategori të vetme të cilën e emërtoi **advektiv**.

### *Shembull*

- |      |                                    |  |
|------|------------------------------------|--|
| 12.a | He thinks <b>quickly</b> than me   | His brain is <b>quicker</b> than me.         |
| 13.a | Ai mendon më <b>shpejt</b> se unë. | Truri i tij është më <b>i shpejtë</b> se imi |

Në gjuhën shqipe për një numër ndajfoljesh, përkatësisht për ato që shprehin kohë dhe vend, për shkak të homonimisë me parafjalët propozohet përfshirja e tyre në kategorinë leksikore të parafjalëve.

### *Shembull*

- |      |                                       |   |
|------|---------------------------------------|---|
| 14.a | Spitali ndodhet <b>pranë</b> shtëpisë | Spitali ndodhet <b>pranë</b> (ndajfolje). |
| 14.b | Ai priste <b>jashtë</b> dere.         | Ai priste <b>jashtë</b> .                 |

E veçanta e fjalëve “*pranë/jashtë*” është se ato pasohen nga një SE, veçori karakteristike e parafjalëve. Për të vërtetuar klasifikimin e këtij grupi ndajfoljesh të gjuhës shqipe në klasën e

<sup>18</sup> Memushaj R. *Gjuhësia Gjenerative*, Tiranë, 2008, fq 150-159

<sup>19</sup> Po aty

<sup>20</sup> Po aty, fq 151

<sup>21</sup> Po aty

parafjalëve na vjen në ndihmë një grup foljesh ku përfshihen foljet “*ha, lexoj, shkruaj*” të cilat në varësi të fjalisë shfaqen herë të ndjekura nga një SE e herë jo.

*Shembull*

14.c Ai lexon.

14.d Ai lexon gazetën.

Edhe pse folja “*lexoj*” lejon dy përdorime ajo nuk mund t’i përkasë dy pjesëve të ndryshme të ligjëratës, por përkundrazi ajo klasifikohet si folje e cila në shembullin e parë përdoret në mënyrë jokalimtare, ndërsa në shembullin e dytë përdoret në mënyrë kalimtare. Të njëjtën mund të pranojmë edhe për fjalët “*pranë, jashtë*” për të cilat theksojmë se ato nuk mund të jenë herë parafjalë e herë ndajfolje. Përkundrazi, ato janë parafjalë të cilat herë përdoren në mënyrë kalimtare e herë në mënyrë jokalimtare<sup>22</sup>.

Pra, gjatë analizës së fjalive të mësipërme në sintagma do të dallojmë qartë dy sintagma parafjalore: një sintagmë parafjalore koka e së cilës është parafjalë e ndjekur nga modifikuesi që është një SE (pranë shtëpisë/ jashtë dere) dhe një sintagmë parafjalore e cila përbëhet vetëm nga koka parafjalore pa modifikues.

Nisur nga mospërfshirja e ndajfoljeve në nëndarjen kategori leksikore ajo nuk mund të formojë sintagmë. Në gramatikën gjenerative ndajfolja si përbërës periferik jo i domosdoshëm në strukturën e fjalisë përfshihet në skemën X-bar si një përbërës i veçantë i quajtur adjunkt (plotës)

### ***1.2.1 SINTAGMA FOLJORE (SF): Struktura e brendshme e saj.***

*Shembull*

15.a Xhoni **lexoi gazetën në stol dje paradite.**

15.b John **read the newspaper in the park yesterday.**

Të dy fjalitë e mësipërme mund të rishkruhen:

Fj	→	SE	SF	S	→	NP	VP
SE	–	Spec	Emër	NP	–	Det	Noun
SF	–	Folje	SE	VP	–	Verb	NP


Bazuar në rishkrimin e mësipërm (ashtu siç pranohet edhe nga **Chomsky**<sup>23</sup>) sintagmave u bëhet paraqitja skematike si më poshtë:

---

<sup>22</sup> Dhima Th. “Çështje të sintaksës në gjuhën shqipe” Art. “Probleme të njërive sintaksore (togfjalëshi dhe sintagma”, Tiranë, 2013, fq. 24,25

<sup>23</sup> Chomsky sipas Memushaj R., *Gjuhësia Gjenerative*, Tiranë, 2008, fq 112-115

**Skema 1 (Skemë e rafshët)**



Një paraqitje e tillë skematike nuk na shfaq asnjë tregues për të vërtetuar lidhjet e brendshme hierarkike midis përbërësve të fjalisë në përgjithësi dhe të sintagmës foljore në veçanti. Për të vërtetuar egzistencën e lidhjeve hierarkike midis përbërësve i referohemi testeve të bërë nga **L. Heageman** dhe veçanërisht atij të bashkërenditjes dhe zëvendësimit<sup>24</sup>.

*Shembull*

16.a John *read the newspaper in the park yesterday* and Jill *will do so too*.

Në këtë ndërtim “*will do so too*” zëvendëson SF “*read the newspaper in the park yesterday*”.

16.b John *read the newspaper in the park yesterday* and Jill *will do so tonight*.

“*will do so*” zëvendëson “*read the newspaper in the park*”, një përbërës më i ngushtë.

16.c John *read the newspaper in the park yesterday* and Jill *will do so in the garage tonight*.

“*will do so*” zëvendëson “*read the newspaper*”, një përbërës akoma dhe më i ngushtë.

Një test i tillë mund të zbatohet lehtësisht edhe te ndërtimet në gjuhën shqipe<sup>25</sup>.

17.a Agimi *lexoi gazetën në stol dje paradite* dhe Rezarti *do të bëjë të njëjtën gjë*.

17.b Agimi *lexoi gazetën në stol dje paradite* dhe Rezarti *do të bëjë të njëjtën gjë sot paradite*.

17.c Agimi *lexoi gazetën në stol dje paradite* dhe Rezarti *do të bëjë të njëjtën gjë në park sot paradite*.


Bazuar në analizën e propozuar nga Teoria X’, analizë kjo që mëshon në raportet hierarkike që vendosen midis përbërësve të fjalisë, zbulimi i të cilave do të bëhet i mundur falë skemës X’ (skema 1), fjalitë e mësipërme 17.a dhe 17.b do të paraqiten skematikisht si më poshtë:

<sup>24</sup> Heageman, L., *Introduction to government and binding theory*, Cambridge University Press, 1991, fq. 73-87

<sup>25</sup> Mitaj J. *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Prishtinë 2005, fq. 17-21



**Skema 2**



Një paraqitje e tillë i pasqyron më së miri nivelet e projekcionit të sintagmës. SE “gazetën/the newspaper” përbëjnë argumentet e foljeve ose më saktë plotësorët e SF “lexoi/read”, ndërsa SP “në stol/ in the park” dhe Nd “dje paradije” dhe SE “this afternoon” përbëjnë plotësit ose siç i quan **J. Mita**<sup>26</sup> shtesat të cilat jo vetëm që mund të jenë fakultative, por numri i tyre ndikon drejtpërdrejtë në numrin e projeksioneve të ndërmjetme F'. Shtesat (plotësit) **L. Heageman** për t’i dalluar nga argumentet i krahason me ballkonin, pasi kur je në ballkon nuk je as tërësisht jashtë dhomës as tërësisht brenda saj, mund të marrësh pjesë në bisedën që bëhet në dhomë, por edhe mund të lagesh nga shiu që bie jashtë<sup>27</sup>.

**1.2.2 SINTAGMA MBIEMËRORE (Smb): Struktura e brendshme e saj.**

*Shembull*

18.a **Shumë i mërziur për humbjen.**


18.b Jeeves is **rather envious of Pairrot.**

Struktura e Smb është e njëjtë me atë të SF për arsye se skema e ofruar nga teoria X’ është e njëjtë për të gjitha llojet e sintagmave. Ajo që duhet të kemi parasysh është se vendi i mbiemrit ndryshon në varësi të gjuhës. Kështu në gjuhën angleze, në ndryshim me gjuhën shqipe, mbiemri është pozicionuar para emrit.

<sup>26</sup> Po aty

<sup>27</sup> Po aty

**Skema 3**



Në rastet kur kjo sintagmë është në përbërjen e një SE, për vetë faktin se ajo cilëson emrin, që shërben si kokë e kësaj sintagme, duke dhënë një të re jo të qenësishme apo të domosdoshme të tij, roli i saj nuk është shumë i ndryshëm nga ai i shtesës apo plotësit.

**1.2.3 SINTAGMA PARAFJALORE (SP): Struktura e brendshme e saj.**

Në gjuhën shqipe një nga përparësitë e analizës së fjalisë në sintagma përfshin edhe ndërtimet parafjalore në të cilat parafjala edhe pse një fjalë joshënuese shërben si kokë e sintagmës parafjalore. Sa më sipër e ka zanafillën që me kundërshtimin që H. Agani i bën pikëpamjes së S. Floqit sipas të cilit parafjala është veç një mjet lidhës<sup>28</sup>. H. Agani mendimin kundër e bazon kryesisht në vetinë që parafjala ka për ta bërë fjalën me të cilën shkon të aftë për të kryer një funksion sintaksor të caktuar, të cilin nuk do të mund ta kryente pa praninë e saj.

*Shembull.*

19.a Djali i vogël u ndal **para oborrit të shkollës**.

Përbërësi parafjalor “para oborrit të shkollës” kryen funksionin sintaksor të rrethorit të vendit. Ndërtimet parafjalore janë struktura të dallueshme që hyjnë brenda strukturave të tjera më të zgjeruara dhe që kryejnë një funksion sintaksor të caktuar.


*Shembull*

19.b Drejt përmes qytetit

19.c in the garden

<sup>28</sup> Dhima Th. “Çështje të sintaksës në gjuhën shqipe” Art. “Probleme të njësive sintaksore (togfjalëshi dhe sintagma”, Tiranë, 2013, fq. 21

**Skema 4.**




Si specifikues të parafjalëve shërbejnë pjesëzat përforcuese, si: *drejt, mu, pikërisht, që tamam, right, just, exactly*, etj., kurse si plotësorë sintagma emërore. Siç shihet nga shembujt, edhe SP mund të mos ketë specifikues, por asaj kursesi nuk mund t'i mungojë plotësori pa të cilin ajo nuk mund të formojë sintagmë më vete.

#### **1.2.4 SINTAGMA EMËRORE (SE): Struktura e brendshme e saj.**

Sintagma emërore, kokë e së cilës do të shërbejë kategoria gramatikore e emrit do të jetë boshti i këtij punimi. Ndërtimi dhe struktura hierarkike e këtij përbërësi emëror do të trajtohet si më poshtë:

Struktura e rrafshët e SE *ngjitja në mal pas darkës dhe the investigation of the corpse after lunch* do të ishte:

**Skema 5 (Skemë e rrafshët)**



Një paraqitje e tillë e SE është e papërshtatshme për arsye se ajo nuk shpesh kombinimin hierarkik të përbërësve të saj. Në këtë kontekst na vjen në ndihmë zbatimi i analizës së propozuar nga **L.Heageman**<sup>29</sup>.

<sup>29</sup> Heageman. L., *Introduction to government and binding theory*, Cambridge University Press, 1991, fq. 88-93

*Shembull*

20.a *The investigation of the corpse after lunch* was less horrible than *the one after dinner*.

20.b *Ngjitja në mal pas darkës* është më e lodhshme se *ajo pas drekës*.


Në shembujt e mësipërm përemrat “one” dhe “ajo” zëvendësojnë përkatësisht “the investigation of the corpse” dhe “ngjitja në mal”, duke dëshmuar se ky varg fjalësh dominohet nga një kokë emërore, e cila formon projektionin maksimal SE.

SE duhet të reflektojë një paraqitje hierarkike jo vetëm për sa përmendëm më lart, por edhe për shkak të lidhjeve analogjike të saj me sintagmën foljore (SF). Për të vërtetuar lidhjen analogjike midis SE dhe SF mjofton vetëm ngjashmëria që ekziston midis:

*The investigation of the corpse (SE)*                      dhe                      *Investigate the corpse (SF)*  
*Ngjitja në mal (SE)*    dhe                      *Ngjitem në mal (SF)*

Për arsyet që përmendëm më lart, paraqitja skematike e SE duhet të jetë si më poshtë:

**Skema 6**



Bazuar në faktin, se pozicioni i specifikuesit është një i vetëm dhe i papërsëritshëm, te SE ai do të zihet nga nyja shquese, e cila në gjuhën shqipe shfaqet e prapavendosur duke realizuar njëkohësisht kategoritë morfologjike të numrit, gjinisë dhe rasës. Në këtë rast ajo do të gjenerohet në pozicionin e Specifikuesit, duke bërë që emri si rezultat i një operacioni lëvizës të zhvendoset dhe të pozicionohet para saj, duke lënë një gjurmë në pozicionin bazë:

**Skema 7**



## Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përfaqje me gjuhën shqipe.


E njëjta dukuri haset edhe në gjuhën angleze, ku në pozicionin e Specifikuesit gjenerohen nyjat shqese dhe joshqese / *definite and indefinite articles (a/an dhe the)*<sup>30</sup>. Në pozicionin e specifikuesit mund të gjenerohen gjithashtu përemrat deftor (ky, kjo, këta, këto) dhe disa përemra të pacaktuar (një, disa, etj).

Theksojmë se lidhja midis kokës së SE (emrit) me argumentin e tij që zakonisht, si në gjuhën shqipe edhe në atë angleze mund të jetë një SP (PP) ose edhe një fjali e nënrenditur, formon projektionin ndërmjetëm. Lidhja midis këtij të fundit me specifikuesin formon projektionin maksimal. Në disa raste mund të ndodhë që struktura e SE të mos paraqitet e plotë, por të reflektojë mungesa në specifikues, argument ose plotës. Këto mungesa nuk përbëjnë asnjë pengesë në projektimin e të tria niveleve.

### *Shembull*

- 21.a libër            ky libër            libër me poezi            një libër me poezi (në shqip)  
21.b \*book            this book            the book in the bag            a book in the bag (në anglisht)

### **Skema 8**



<sup>30</sup> Në vijim do të paraqitet një projektion i ri (sintagma determinative) në pozicionin kokë të së cilit gjenerohen kategoritë gramatikore të njëjës, përemrit dëftor e atij pronor.

### **1.3 PËRBËRËSI DETERMINATIV (SDET); PROJEKSION MAKSIMAL I PËRBËRËSIT EMËROR**

Rishikimet e herëpashershme në kohë që iu bënë SE u fokusuan gjithnjë e më shumë në pozicionin e elementëve të tillë si nyja, përemri dëftor dhe kuantifikuesit. Hapat e para dëshmuuan përfshirjen e të tre këtyre elementeve gramatikore në një tipologji të vetme, atë të “determinuesit”. Kjo përbënte një teori gjenerativiste, e cila kishte si qëllim unifikimin e kategorive funksionale, pavarësisht ndryshimeve që ato manifestojnë.

Si rezultat i këtij unifikimi studiues të ndryshëm i referohen ndërtimeve emërore në dy mënyra krejt të ndryshme. Kështu **L. Heagman** si projektion maksimal të tyre merr SE, ku determinuesi zë pozicionin e specifikuesit<sup>31</sup>.

Për të përcaktuar elementët përbërës të kokës Det do t’i referohemi argumentimit më poshtë:

*Shembull*

22.a The letter

-a letër-

letra

Elementi “*the*” në gjuhën angleze (të cilit në gjuhën shqipe i përket nyja shquese) mund të zëvendësohet nga një numër elementesh me të cilët është në përndarje plotësuese si:

The / A / This / That / Some / Every / Each (nyja shquese/joshquese, përemri dëftor, disa, çdo)

Të gjithë këto elemente zënë një pozicion të detyrueshëm para-emëror.

\* Letter the/ a/ that / this / some / every / each

\* a-leter/ leter nje/ leter kjo/ letra disa/ letra çdo

Nëse emrin do ta vinim në numrin shumës, atëherë edhe alternativat e mësipërme do të ndryshonin si më poshtë:

The / these / those / some letters

Këta/këto/disa letra

Pra, të gjithë elementet e mësipërm të cilat kanë përndarje plotësuese me elementin “*the*”, përkufizohen si determinues.


Duke qënë se këto elemente të emërtuar tashmë si determinues janë në përndarje plotësuese, ata konkurojnë për të njëjtin pozicion duke zëvendësuar njëri-tjetrin.

---

<sup>31</sup> Heagman. L., *Introduction to government and binding theory*, Cambridge University Press 1991, fq 88-93

Në këtë kontekst, **Abney (1987)**<sup>32</sup> propozoi projektionin sintagmë determinative (SDet) duke hedhur hipotezën sipas së cilës si projektion maksimal i një emri (E) është një argument i kokës Det (si elementë që gjenerohen në kokën Det<sup>0</sup> janë kategoritë funksionale të përfshira në kategorinë e determinuesit). Sipas tij këto projeksione funksionale nga ana sintaksore shërbejnë për të ofruar pozicione të lira në rastet e lëvizjeve të mundshme të kokave ose nyjave të tjera. Sipas kësaj hipoteze përbërësit emëror si “*djali*” ose “*ky djalë*” paraqiten si më poshtë:

**Skema 9**



Gjithashtu mendohet se ekzistojnë ndërtime emërore në përbërjen e të cilave mund të ketë një determinues zero (Ø). Një mendim i tillë ka një histori të largët dhe sipas **Chomsky-it** përbërësi emëror “*sincerity*” në shembullin e mëposhtëm kryesohet nga një kokë Det zero (Ø). Ky sugjerim i hedhur nga **Chomsky** u përpunua më tej edhe nga **Abney (1987)**, **Longabardi (1994,1996, 2001)** si dhe **Bernstein (2001)**<sup>33</sup>.

*Shembull*


23.a *Sincerity* may frighten the boy.

23.b *Sinqeriteti* mund të tremb fëmijën (në këtë shembull të gjuhës shqipe në Det<sup>0</sup> pozicionohet nyja shquese-i, pasi për këto ndërtime emërore nuk mund të ketë kokë Det<sup>0</sup> Ø. Determinuesi zero në gjuhën shqipe haset në ndërtimet me emra në trajtë të pashquar (ne vijim))

<sup>32</sup> Turano. G., *A proposito del sintagma nominale in Albanese*, Artikull në botimin e Rrokaj. Sh., *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë 2007, fq. 47-87

<sup>33</sup> Po aty

**Skema 10**




Lindja e SDet jo vetëm që gjeti mbështetje, por në të njëjtën kohë iu nënshtrua rishikimeve dhe propozimeve të herëpashershme, të cilat konsistonin në përfshirjen brenda kufijve të këtij projekcioni të pozicioneve funksionale nga më të ndryshmet, një prej të cilëve është ai në të cilin gjenerohen të ashtëquajturit kuantifikues si : “some”, “any” “një”, “çdo”, “ndonjë”, “disa”. Ky projekcion lidhet me sintagmën funksionale të kuantifikuesit (SQ ose QP në anglisht).

*Shembull*

25.a disa djem

25.b some boys

**Skema 11**




Studimet e mëtejshme, sidomos ato në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe gjuhët hebre, dëshmuar se SDet dhe SQ nuk janë të vetmet projeksione funksionale. **Ritter (1991)**<sup>34</sup> propozon edhe një projekcion tjetër autonom, atë të numrit (SNum ose NumP) i cili pozicionohet midis kokës Det dhe argumentit të saj SE si më poshtë:

<sup>34</sup> Turano. G., *A proposito del sintagma nominale in Albanese*, Artikull në botimin e Rrokaj. Sh., *Cështje të gjuhës shipe*, Tiranë 2007, fq. 47-84



Përdorimi i projeksonit NumP/SNum u mbështet edhe nga Manzini (1996) e cila e bazon lindjen e tij te rëndësia e distribucionit të shumësit në gjuhën italiane

Skema 12



Propozimi i radhës vjen nga **Giusti (1992), Crisma (1990) dhe Cinque (1990;1995)**<sup>35</sup>, të cilët, duke përqëndruar studimet e tyre në gjuhët romane, hodhën idenë se strukturës së përbërësit emëror mund t'i shtojmë pozicione funksionale që do të mundësojnë realizimin e përshtatjes së emrit, të tillë si Projeksoni i Përshtatjes SPr (AgrP). (skema do të jete e njëjtë me atë më lart me një ndryshim të vogël zëvendësimin e NumP/SNum me AgrP/SPr).

#### 1.4 PËRNDARJA E DETERMINUESVE SIPAS KATEGORISË SË SHQUARSISË

Kategoria e pashquarsisë/shquarsisë është një kategori tipike e emrit e cila gjendet si në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Edhe pse kategorinë e shquarsisë/pashquarsisë e hasim në të dyja gjuhët (anglisht/shqip), ajo nuk realizohet njësoj, pasi për gjuhën angleze kjo kategori realizohet nga përdorimi i morfemave të lira nyja në pozicion paraemëror ndërsa në gjuhën shqipe shquarsia realizohet nëpërmjet morfemave të lidhura, mbaresa eptimore, ndërsa pashquarsi nëpërmjet morfemave të lira (ca, disa) në pozicion paraemëror. Kjo kategori nuk është universale për të gjitha gjuhët. Ndër gjuhët që nuk disponojnë një kategori të tillë janë ato sllave, veçanërisht gjuha ruse.

<sup>35</sup> Po aty

Shembull.

- 26.a Bleva *një libër*. I bought *a book*.  
26.b Bleva *librin*. I bought *the book*.

Në shembujt 26.a emri (*një libër/ a book*), si në gjuhën shqipe dhe atë angleze, përdoret me kuptim të përgjithësuar, pra tregon një send çfarëdo nga klasa e sendeve në të cilën bën pjesë; në shembujt 26.b ky emër (*librin/ the book*) përdoret me kuptim të individualizuar duke treguar jo një send çfarëdo, por një send të caktuar nga klasa e vet. Kategoria e shquarsisë/pashquarsisë në këto dy gjuhë shprehet formalisht me anë të nyjave shquese ose joshquese. Sistemet nyjore të gjuhëve të ndryshme nuk janë simetrike: kemi gjuhë si frengjishtja që ka nyja të veçanta për të dyja trajtat, për të dyja gjinitë dhe për të dy numrat; gjuhë si anglishtja në të cilën nyjat shquese (the) dhe joshquese (a/an) të numrit njëjës përbëjnë morfema të lira të realizuara në pozicion para-emëror, ndërsa numri shumës i trajtës së pashquar nuk ka të tilla si dhe gjuhë si shqipja në të cilën shquarsia shprehet me anë të mbaresave të veçanta për çdo rasë, të cilat përbëjnë një nyjë të prapavendosur që me kohën u shndërrua në një morfemë, në një pjesë të fjalës.

Nyja joshquese		Nyja shquese	
Nr. Njëjës	Nr. shumës	Nn. Njëjës	Nr. shumës
Gjuha frenge un (m)/une (f)	des	le (m)/la (f)	les
Gjuha angleze a/an (m/f)	the	the (m/f)	the
Gjuha shqipe një	ca/disa	morfemë e lidhur	morf. e lidhur

Përsa i përket pashquarsisë të gjuhës shqipe, kjo nuk bën dallim nga gjuhët romane. Kjo kategori në gjuhën shqipe realizohet me anën e numërorit *një* (në numrin njëjës), por vetëm në ato raste kur ky i fundit nuk krijon kundërvënie me një numëror tjetër.

*Shembull*

- 26.c Takova *një shok*

Në këtë shembull nuk duam të themi se takova *një* dhe jo *dy shokë*, por e përdorim nyjën joshquese “*një*” sepse nuk duam të individualizojmë frymorin<sup>36</sup>.

Joshquarsia në numrin shumës në gjuhën shqipe realizohet me anën e nyjave joshquese “*ca;disa*”.

<sup>36</sup> Gramatika e Gjuhes Shqipe I, Akademia e shkencave e Shqipërisë, 2002, fq. 121,129,130

### **1.4.1 Përbërësi emëror i shquar**

Për të shprehur shquarsinë e emrave në gjuhën shqipe përdoret nyja shquese e cila nuk është gjë tjetër veçse një morfemë e lidhur e realizuar në pozicionin fundor. Njëkohësisht kjo morfemë e lidhur bën të mundur edhe realizimin e kategorive të tjera morfologjike të emrit si atë të numrit, gjinisë dhe rasës si:

#### *Shembull*

27.a.	Burri	lexon	27.b.	Shoku	lexon
	Man-the; Masc; Sing	reads		Friend-the; Masc; Sing	reads
	“The man reads”			“The friend reads”	
27.c.	Vajza	lexon	27.d.	Burrat/Vajzat	lexojnë
	Girl-the; Fem; Sing	reads		Men/Girls-the; Pl	read
	“The girl reads”			“The men/girls read”	


Përkundrazi në gjuhën angleze, duke qënë se kjo e fundit është një gjuhë analitike, nyjat shquese janë morfema të lira, të cilat përveç kategorisë së shquarsisë nuk shërbejnë për të realizuar asnjë kategori tjetër morfologjike. Si e tillë ajo i përshtatet skemës 13 duke u realizuar pa krijuar probleme në pozicionin kokë Det<sup>0</sup>. Ndërsa përtaqja e kësaj gjuhë shqipe, më saktë shprehjes së shquarsisë dhe pashquarsisë në këtë gjuhë zbatimi i të njëjtit strukturim hierarkik nuk është i lehtë, por jo i pamundur.

Analizën do ta nisim me propozimet e bëra nga **Savoia** dhe **Manzini (1998;1999)**<sup>37</sup> sipas të cilëve ndërmjet kokës Det<sup>0</sup> dhe SE do të realizohet një projeksion i ndërmjetëm, në të cilin do të gjenerohet nyja shquese që në gjuhën shqipe realizon edhe kategoritë morfologjike të mësipërme. Ky projeksion funksional jo pa qëllim do të emërtohet SEpt duke iu referuar gjithashtu edhe lidhjes analogjike që ekziston midis SE dhe SF e hasur shpesh në këtë punim. Propozimet reflektohen në skemën e mëposhtme:

---


<sup>37</sup>Turano. G., *A proposito del sintagma nominale in Albanese*, Artikull në botimin e Rrokaj. Sh., *Cështje të gjuhës shqipe*, Tiranë 2007, fq. 47-84

**Skema 13**



Pra në përputhje me paraqitjen skematike të mësipërme emri në gjuhën shqipe gjenerohet në pozicionin kokë E<sup>0</sup> (N), nyja gjenerohet në pozicionin kokë Ept<sup>0</sup> (I<sup>0</sup>). Emri i shquar për t’iu bashkëngjitur nyjës në pozicionin kokë Ept<sup>0</sup> (I<sup>0</sup>) duhet t’i nënshtrohet një operacioni levizës duke u zhvendosur nga nyja E<sup>0</sup> (N) drejt nyjës Det<sup>0</sup> si më poshtë:

**Skema 14**



Krijohet përshtypja sikur lëvizja nga E<sup>0</sup> (N<sup>0</sup>) drejt Det<sup>0</sup> (D<sup>0</sup>) shkel **Kushtin e Lidhjeve Minimale (Minimal Link Condition – Chomsky; 1995)**<sup>38</sup> sipas të cilit zhvendosja e emrit në Det<sup>0</sup> (D<sup>0</sup>) duke anashkaluar pozicionin Ept<sup>0</sup> (F<sup>0</sup>) duhet të përlicjet nga një tregues i caktuar, që në këtë rast ka të bëjë me kontrollimin nga ana e emrit të vlerës referuese të pranishme në Det<sup>0</sup> (D<sup>0</sup>).


<sup>38</sup> Po aty fq. 47-87

Duke iu referuar këtij kushti **Savoia dhe Manzini (1998;1999)**<sup>39</sup> arrijnë në përfundimin se për çdo tregues të përbërësit emëror ekziston një pozicion i caktuar në të cilën ai realizohet. Për këtë arsye, nëse do të pranojmë se morfemat e lidhura të cilat realizojnë shquarsinë (-i, -u, -a, -t) gjenerohen në pozicionin kokë Ept<sup>0</sup> (F<sup>0</sup>), atëherë ky veprim nuk lejon gjenerimin në të njëjtin pozicion të emrit. Po kështu edhe nyja e gjeneruar në pozicionin Ept<sup>0</sup> (F<sup>0</sup>) nuk mund të zërrë pozicionin Det<sup>0</sup>, i cili është i zënë nga emri si rezultat i zhvendosjes së tij nga E<sup>0</sup> (N<sup>0</sup>) drejt Det<sup>0</sup>.

Vlen të theksohet se e njëjta dukuri (përbërësi emëror me emër të shquar) shihet tashmë nga një këndvështrim tjetër<sup>40</sup> sipas të cilit nyja shquese në shembujt e mësipërm (27.a; 27.b; 27.c; 27.d) gjenerohet në pozicionin kokë Det<sup>0</sup> të SDet, ndërsa emri gjenerohet në pozicionin kokë E<sup>0</sup> (N<sup>0</sup>), në pozicionin e plotësorit. Midis projeksionit maksimal SDet dhe atij minimal SE (NP) propozohet realizimi i një pozicioni të ndërmjetëm SNum ose NumP. Këto ndërtime me emër të shquar përfshijnë edhe një rregull zhvendosjeje sipas të cilit emri për t'iu bashkangjitur njëjës duhet t'i nënshtrohet një operacioni lëvizës, duke u zhvendosur nga pozicioni kokë E<sup>0</sup> (N<sup>0</sup>) në të cilin gjenerohet drejt pozicionit Det<sup>0</sup>.

Përshtatja e emrit kontrollohet në pozicionin e ndërmjetëm SNum (NumP), pozicion ky të cilin emri e përshkon gjatë zhvendosjes së tij drejt Det<sup>0</sup> si më poshtë:

**Skema 15**



Sipas këtij propozimi, në pozicionin kokë Det<sup>0</sup> gjenerohen si nyja edhe emri.

<sup>39</sup> Po aty

<sup>40</sup> Po aty

**1.4.2 Përbërësi emëror i pashquar.**

Sikurse përmendëm më lart, pashquarsia në gjuhën shqipe realizohet me anë të morfemave të lira “një, ca, çdo, disa” të cilat gjenerohen në projektionin funksional të ndërmjetën, të propozuar nga **Savoia dhe Manzini (1998;1999)**<sup>41</sup>, realizuar midis projektionit SDet (DP) dhe atij SNum (NumP). Ky projektion në gjuhën angleze njihet QP, barazvlerësi më i përshtatshëm i të cilit në shqip do të ishte SQ (sintagma funksionale e kuantifikuesit)


*Shembull.*

28.a një burrë

28.b a/one men

Struktura e ndërtimit emëror të mësipërm do të jetë:

**Skema 16**



Duhet theksuar se ky projektion ofron dy mundësi gjenerimi: Mundësia e parë ku projektioni SDet dominon projektionin SQ dhe e dyta kur projektioni SQ dominon projektionin SDet.

<sup>41</sup> Po aty, fq. 47-87


*Shembull*

29.a Këta dy burra  
 These two men-Pl

29.b Gjithë burrat  
 All men-the; Pl

Struktura e shembullit (29.a) paraqitet me SDet (DP) që dominon SQ (QP), ndërsa në shembullin (29.b) SQ (QP) dominon SDet (DP) si më poshtë.

**Skema 17**



**1.4.3 Ndërtimet emërore me emër (të shquar/të pashquar) dhe përemër dëftor.**

**1.4.3.1 Struktura e SE e ndërtuar prej një përemri dëftor dhe një emri të pashquar**

Në gjuhën shqipe të gjithë përemrat dëftor pozicionohen para kokës emërore dhe përshtaten me të në gjini, numër dhe rasë.

***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

*Shembull*


30.a.	Ky	burrë	30.b.	Kjo	vajzë
	This-Masc; Sing; Nom	man		This-Fem; Sing; Nom	girl
	“This man”			“This girl”	
30.c.	Këtë	burrë/vajzë	30.d.	Këta	burra
	This-ACC	man/girl		These-Masc; Pl	men
	“This man/girl”			“These men”	
		30.e	Këto	vajza	
			These-Fem; Pl	girls	
			“These girls”		
31.a	Ai	burrë	31.b	Ajo	vajzë
	That-Masc; Sing; Nom	man		That-Fem; Sing; Nom	girl
	“That man”			“That girl”	
31.c	Atë	burrë/vajzë	31.d.	Ata	burra
	That-ACC; Sing	man/girl		Those-Masc; Pl	men
	“That man/girl”			“Those men”	
		31.e.	Ato	vajza	
			Those-Fem; Pl	girls	
			“Those girls”		

Ndërtimet me përemër dëftor të pozicionuar pas kokës emërore janë jogramatike.

\*burrë ky / vajzë kjo / burra këta / vajza këto / burrë ai / vajzë ajo / burra ata / vajza ato.

Këto ndërtime emërore me përemër dëftor dhe emër të pashquar i përshtaten lehtë paraqitjes skematike të SDet (DP) ku përemri dëftor gjenerohet në pozicionin kokë Det<sup>0</sup> (D), ndërsa emri në pozicionin kokë E<sup>0</sup> (N<sup>0</sup>) dhe për të kontrolluar përshtatjen ai zhvendoset drejt pozicionit kokë Num<sup>0</sup> të projeksionit të ndërmjetëm SNum (NumP).

**Skema 18**





Ashtu si përemri dëftor edhe nyja joshqese pozicionohet para kokës emërore, por ajo nuk gjenerohet në pozicionin kokë Det<sup>0</sup> (D<sup>0</sup>). Siç përmendëm edhe më lart, ajo pozicionohet në një projeksion funksional të ndërmjetëm, pra në SQ (QP). Një fenomen i tillë ndodh për arsyen e vetme se, edhe pse ato pozicionohen para kokës emërore, shfaqen gjithmonë në formë të ngurosur (të pandryshueshme) e cila përkundrazi nuk përshtatet në gjini, numër dhe rasë me kokën emërore.

*Shembull*

32.a	Disa	burra	34.b	Disa	vajza
	Some-Pl	men		Some-Pl	girls

**1.4.3.2**      ***Struktura e përbërësit emëror e ndërtuar prej një përemri dëftor dhe një emri të shquar***

Në gjuhën shqipe, ndryshe nga gjuha angleze, haset një tip i veçantë i ndërtimeve emërore të përbëra nga një emër i shquar dhe një përemër dëftor, i cili përshatet me emrin në gjini, numër dhe rasë. Këto ndërtime në pamje të parë të japin idenë se mund të krijojnë problem në analizën e dëftorëve si realizues të kokës Det<sup>0</sup> (D<sup>0</sup>).

*Shembull*

33.a	ky	djali	33.b	Kjo	vajza
	This-Masc; Sing	boy-the		This-Fem; Sing	girl-the
	“This boy”			“This girl”	
33.c	Ai	djali	33.d	Ajo	vajza
	That-Masc; Sing	boy-the		That-Fem; Sing	girl-the
	“That boy”			“That girl”	

Sipas **E. Hempi**<sup>42</sup> ndërtimi përemër dëftor + emër i shquar ka shtrirje të kufizuar vetëm në gjuhën shqipe pasi në gjuhën angleze, italiane edhe gjuhë të tjera ekzistojnë rregulla sipas së cilave përemri dëftor e kufizon emrin e përcaktuar prej tij në fleksionin e pashquar.

Këto ndërtime të gjuhës shqipe janë trajtuar edhe nga disa gjuhëtarë shqiptarë si më poshtë:

**Sh. Demiraj**<sup>43</sup> trajtën e shquar të një emri të paraprirë nga një përemër dëftor e trajton si një shfaqje hiperkarakterizimi, gjë që është e vërtetë vetëm për përdorime të veçanta duke mos shpjeguar të gjitha shfaqet e tij.

**J. Rrota**<sup>44</sup> thekson se në këto përdorime përemri dëftor “*nuk e ka ma të fuqin e natyrshme të shërbimit të vet*” dhe dëfton “*një gjasend të përmendun pak para a të dijtun*”. Kjo do të thotë se në të tilla ndërtime dëftori nuk ka kuptim deiktik, por anaforik dhe shërben për të treguar një

<sup>42</sup> Agalliu F., *Çështje të morfologjisë të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1988, fq. 156-159

<sup>43</sup> Po aty

<sup>44</sup> Po aty

emër që është zënë në gojë më lart. Ripërmendja e emrit behet e njohur nëpërmjet shquarsisë si rezultat i së cilës sendi i emërtuar bëhet i njohur.

**F. Agalliu**<sup>45</sup> shprehet se përemri dëftor në këto ndërtime është i dobësuar kuptimisht dhe afrohet me tepër me nyjën e caktuar (jo me të pacaktuarën) çka bën që ai të shihet si diçka e tepërt që mund të hiqet pa ia prishur kuptimin fjalisë. Pra sipas tij në këto ndërtime përemri dëftor përdoret për të rforcuar kuptimin individualizues.

Shtirja e përdorimit të këtyre ndërtimeve është i kufizuar duke përfshirë situatat e përmendura më poshtë:

*Shembull*

34.a Pashë një djalë.            *Ky djali* punonte shumë.

Përbërsi emëror “*ky djali*” ka si funksion rimarrjen në fjalinë pasardhëse të informacionit të shprehur në fjalinë paraardhëse (favorizon lidhjet anaforike).

*Shembull*

(imagjinojmë sikur duhet të ndajmë përbërjen e klasës)

35.a *Kjo vajza* do të shkojë në grupin A, kurse *ky djali* do të shkojë në grupin B.

Në këtë rast përbërësi emëror “përemër dëftor + emër i shquar” i referohet një elementi të kontekstit ekstralinguistik (jashtëgjuhësor). Lidhja referuese garantohet nga konteksti i situatës.

Këto ndërtime emërore me përemër dëftor krijojnë probleme për arsye se për pozicionin kokë Det<sup>0</sup> (D<sup>0</sup>) kemi të shprehur dy elemente të mundshëm, përemrin dëftor dhe nyjën, të cilët janë të përfshirë në kategorinë funksionale të determinuesit. Në këtë pikë, dashur pa dashur, lind nevoja e përcaktimit në detaje të pozicioneve, në të cilët do të gjenerohen këta elementë si dhe të shpjegimit të marrëdhënieve që ekzistojnë midis tyre.

Sikur për një moment të na duhej të mendonim se këta të dy elementë gjenerohen në të njëjtin pozicion, atëherë do të duhej të pranonim se ata kryejnë të njëjtin funksion në përbërjen e fjalisë. Por një mendim i tillë, qoftë edhe për një moment të vetëm, përbën shkelje të **Parimit të Ekonomisë** sipas të cilit në asnjë gjuhë njerëzore nuk mund të pranohen dy elementë të ndryshëm, që të mund të kodifikojnë të njëjtin informacion.

Për të vërtetuar se përemri dëftor dhe nyjat shquese nuk janë pjesë përbërëse të një përbërësi të vetëm SDet (DP), na vijnë në ndihmë propozimet e ofruara nga **Turano**<sup>46</sup> bazuar paraprakisht në kryerjen e disa testeve gramatikore.

a. *Testi i Asgjësimit.*

Nëse njëri prej elementeve nuk do të shprehet fonetikisht fjalia qëndron, pra është gramatikore.

*Shembull*

36.a Pashë një djalë.            *Ky djali* punonte.  
I saw a boy                      *This boy* was working

<sup>45</sup> Po aty

<sup>46</sup> Turano. G., *A proposito del sintagma nominale in Albanese*, Artikull në botimin e Rrokaj. Sh., *Çështje të gjuhës shipe*, Tiranë 2007, fq. 47-84

36.b Pashë një djalë. *Djali punonte.*  
I saw a boy *The boy was working*

Një test i tillë dëshmon më së miri se në përbërjen e këtij ndërtimi emëror nuk ekzistojnë raporte varësie midis përemrit dëftor dhe emrit të shquar.

*b. Testi i Zhvendosjes*

Njëri prej elementëve mund të zhvendoset duke mos penguar realizimin e përemrin dëftor në pozicioni para-emëror.

*Shembull*

37.a Të kujt janë *këta djem?*  
Djali i Petros *ky*, ndërsa i Anilës *ai*.

Fakti që njëri prej elementeve përbërës mund të zhvendoset vërteton më së miri se përemri dëftor dhe emri i shquar nuk formojnë një përbërës të vetëm.

Në paragrafët e parë në të cilët prezantuar këtë dukuri, pranuar se ai haset, jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera kryesisht greqishen moderne dhe spanjishten. Në këto gjuhë përemri dëftor përbën një përbërës autonom, i cili mund të lëvizë lirisht në pozicione të ndryshme në fjali.

*Shembull*

39.a. afto to oreo to vivlio ky i bukur libër	38.a este libro ky libër
38.b to oreo afto to vivlio i bukur ky libër	38.b el liblo este libri ky
38.c to oreo to vivlio afto i bukur libër ky	

*(greqishtja moderne)*


*(spanjishtja)*

Mbi bazën e këtyre të dhënave **Bruge (1996)** dhe **Giusti (1992; 1995; 1997)**<sup>47</sup> propozojnë se përemri dëftor gjenerohet në pozicionin e specifikuesi në përbërjen e SE dhe shfaqja e tij në një pozicion para-emëror është rezultat i një operacioni lëvizës nga pozicioni SpecSE drejt pozicionit SpecSDet. Sipas studiuesve kjo lëvizje shpjegohet si nevojë për të kontrolluar karakterin referues të pozicionit Det<sup>0</sup>.

---

<sup>47</sup> Po aty

**Skema 19**



Lind pyetja: Cili është roli i dëftorit në kësi lloj përbërësish emëror?

Për t'i dhënë përgjigje propozojmë t'i referohemi strukturës binare **temë – remë**, ku tema përfaqëson të njohurën dhe rema përfaqëson informacionin e panjohur ose të prezantuar për herë të parë.

*Shembull*

40.a Pashë një djalë. Ky djali punonte shumë.

40.b I saw a boy. This boy was working hard.

E panjohura ose rema i referohet SDet me emër në trajtë të pashqar (fjalialia e parë), ndërsa në fjalinë e dytë përemri dëftor “ky” ka si funksion të nxjerrë në pah, pra të evidentojë objektin si remë i cili prezantohet nga pjesa tjetër e fjalisë. Në po këtë linjë vjen një propozim tjetër më i vonë në kohë nga **Turano (2011)**<sup>48</sup> e cila thekson se lidhja e emrit të shqar me elemente të tjerë përcaktues, si dëftori, nuk realizohet krejt lirisht. Kjo lidhje është e mundshme vetëm për kontekstet temë-koment ku tema është “një djalë” dhe komentit është “punonte shumë”. Nga sa më sipër dëftori përforcon rolin e përbërësit të zgjedhur si temë. Mes tij dhe emrit të shqar nuk ka asnjë lidhje varësie, pasi mungesa e njërit prej elementëve individualizues nuk çënon kuptimin e fjalisë.


*Shembull*

40.c Pashë një djalë. Djali punonte shumë. Ky punonte shumë.

Këto ndërtime të gjuhës shqipe vënë në pikëpyetje pozicionin në të cilin do të realizohet dëftori, pasi pozicioni Det<sup>0</sup> do të zihet nga nyja shquese të cilës do t'i bashkëngjitet më tej edhe emri. Për këtë arsye **Turano (2011)** propozon gjenerimin e një projeksioni të dytë funksional i cili do të shërbejë për realizimin e dëftorit i cili ashtu si nyja shquese ka kuptim individualizues. Këtë projeksion të dytë determinativ **Turano (2011)** e emërton **sintagma e determinuesit operator** SDet<sub>OP</sub> (DP<sub>OP</sub>) në kokën Det<sub>OP</sub> do të realizohet përemri dëftor.

<sup>48</sup> Koleci F. dhe Turano G., *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Tiranë 2011, fq 69

**Skema 20**



## ***PËRFUNDIME***

Në këtë kre do të trajtohet njësia më e rëndësishme e përshkrimit të gjuhëve njerëzore e cila emërtohet si "phrase/sintagmë". Kjo njësi sintaksoro-strukturore është e një niveli përfaqësimi më të lartë se ai fonemor dhe morfemor. Termi "phrase" në gjuhësinë angleze nuk identifikohet vetëm me Chomsky-n, por ai përdoret më herët nga Saussure. Ky i fundit, duke e trajtuar gjuhën si produkt të shoqërisë e përkufizon frazën si "kombinime me të cilat folësi shkodon mendimet e veta". Në gjuhën shqipe preferohet përdorimi i termit sintagmë, pasi termi frazë do të keqinterpretohet me fjalinë e përbërë të M. Domit (1964) dhe me fjalinë e thjeshtë të M. Totonit (2000).

Sintagma përbën një njësi ndërtimore dhe kuptimore të pozicionuar midis fjalës dhe fjalisë. Pra ajo përbën një njësi gjuhësore me madhësi të papërcaktuar, pasi mund të përfaqësohet nga një fjalë e vetme ose edhe një fjali e tërë.

Analiza strukturore e fjalisë, për vetë përparësitë që sintagma ka mbi togfjalëshin, përbën një analizë më të përshtatshme, reale, vertikale dhe hierarkike duke vënë në dukje në mënyrë të qartë lidhjen e përbërësve dhe mënyrën e vendosjes së tyre. Ndër sintagmat kryesore, koka e të cilave përfaqësohet nga një kategori leksikore, janë sintagma foljore (SF), sintagma mbiemërore (SMb), sintagma parafjalore (SP) dhe sintagma emërore (SE). Përfshihet kategoria leksikore e ndajfoljes e cila në gjuhën angleze, së bashku me kategorinë leksikore të mbiemrit, shkrimet në një kategori të vetme, atë të advektiv-it. Në gjuhën shqipe një grup ndajfoljes përfshihet në kategorinë e parafjalës dhe përfaqësohet sintaksorisht nga sintagma parafjalore (SP).

E veçanta e këtij kreu është përfshirja në kategorinë e determinuesve të të gjithë elementëve me vlera individualizuese si nyjat shquese/joshquese (gjuha e angleze), morfemat e lidhura/ te lira të gjuhës shqipe (të cilat përveç realizimit të kategorisë së shquarsisë realizojnë edhe kategoritë e numrit, gjinisë dhe rasës) si dhe përemrat dëftor të të dyja gjuhëve.

Abney (1987) në vijim të propozimit të mësipërm propozon lindjen e projeksionit funksional të sintagmës determinative (SDet) në kokën Det<sup>0</sup> të së cilës do të realizohen të gjithë ata elementë përfaqësues të kategorisë së determinuesit. Lindja e këtij projeksioni funksional nxiti më tej studiuesit e gjuhëve të ndryshme (eptimore ose jo), që në bazë të karakteristikave morfologjike të gjuhëve të tyre, të propozojnë një numër projeksionesh funksionale si: sintagma

e numrit (SNum), sintagma e emtimit emëror (SE<sub>pt</sub>), sintagma e kuantifikuesit (SQ), etj të gjeneruara midis projeksionit funksional SDet dhe atij leksikor SE. Lindja e këtyre projeksioneve funksionale shërben për të licensuar treguesit morfologjikë të përbërësit emëror si dhe ofron pozicione të lira në rast të zhvendosjeje të nyjave.

Gjithashtu, lindja e projeksioneve funksionale ndikoi më së tepërmi në gjenerimin e strukturave komplekse të gjuhës shqipe. Në këtë kre evidentohet ndërtimi emëror "përemër dëftor + emër i shquar" i karakterizuar nga prania e dy determinuesve, përemrit dëftor të paravendosur dhe morfemës së lidhur të prapavendosur.

Për këto ndërtime të veçanta të gjuhës shqipe (në gjuhën angleze determinuesit janë në përndarje plotësuese) pranohet se përemri dëftor përbën një element shtesë në përforcimin e vlerave individualizuese të SE në trajtë të shquar. Ky element mund të mungojë pa ndikuar në gramatikalitetin e fjalisë. Si e tillë Turano (2011) propozon gjënerimin e projeksionit funksional të sintagmës së determinuesit operator  $SDet_{op}$ , zgjatimit i projeksionit maksimal të SDet, në kokën  $Det_{op}$  të së cilës do të gjenerohet përemri dëftor.

## KREU II

### CAKTIMI I ROLEVE TEMATIKE NË GJUHËN ANGLEZE DHE NË GJUHËN SHQIPE (NJOHURI TË PËRGJITHSHME)

#### 2.1 CAKTIMI I ROLEVE TEMATIKE

Struktura e brendshme<sup>49</sup> e fjalisë varet nga informacioni që ndodhet në leksikun tonë mendor, i cili përbëhet jo vetëm nga lista e fjalëve që përdorim e kuptojmë, por edhe nga informacioni i veçantë dhe i detajuar për secilën prej tyre. Gjithashtu kjo strukturë varet ndjeshëm edhe nga marrëdhëniet që predikati vendos me argumentet e tij në përbërjen e fjalisë. Një sintagmë foljore (SF) mund të kombinohet me një, më shumë se një ose asnjë sintagmë emërore (SE).

#### *Shembull*

- 41.a The baby sleeps quietly. (folja “sleep – fle” e anglishtes merr vetëm një argument.)  
Fëmija fle qetësisht. (folja “fle” merr vetëm një argument)
- 41.b My mother invited all her friends. (folja “invite – ftoj” e anglishtes merr dy argumente)  
Nëna ime ftoi të gjithë miqtë e saj. (folja “ftoj” merr dy argumente)
- 41.c The stranger gave the boy a toy. (folja “give” – jap” e anglishtes merr tre argumente)  
I huaji i dha një lodër djalit. (folja “jap” merr tre argumente)

---

<sup>49</sup> Me strukturë të brendshme nënkuptohet struktura e thellë, term ky që njohu përdorim në vitin 1960 duke u konsideruar si përfaqësim strukturor i marrëdhënieve semantike të vendosura midis predikatit (me anë të së cilit shprehet një gjëndje a marrëdhënie) dhe argumentit (entiteti i cili luan një rol të caktuar mbi këtë gjëndje a marrëdhënie të shprehur nga predikati). (Sipas Chomsky's Universal Grammar, V.J. Cook dhe Mark Newson). Vetë Chomsky në botimin e tij “*Minimalist Program*” (1997) e konsideron strukturën e thellë të fjalive të gjuhës si realizim gramatikor të të dhënave leksikore.



Mungesa e njërit prej argumenteve, përkthyer ndryshe si mosrealizim në detaje i informacionit të veçantë për çdo predikat, bën që fjalia të mos ketë kuptim të plotë dhe si e tillë të mos jetë gramatikore.

*Shembull*

42.a \* The stranger gave the boy

\* The stranger gave a toy

42.b \* I huaji i dha një lodër

\* I huaji i dha djalit

Në të dyja gjuhët, anglisht dhe shqip, në ndërtimet me foljen “*dhuroj – donate*” (43.a dhe 43.b) njëri prej argumenteve mund të mos shprehet fonetiki, pasi ai bëhet i ditur nga konteksti. Pra, si folësi dhe dëgjuesi janë në dijeni të ekzistencës së tij. Argumenti që mund të mos shprehet është ai që i referohet personit që përfiton dhuratën (Adger<sup>50</sup>).

*Shembull*

43.a The boy donated his watch. (to his girlfriend)

43.b Djali (ia) dhuroi orën e tij. (të dashurës)

Në të dyja gjuhët kemi, gjithashtu, predikatë me sjellje të dyfishtë të cilët në disa ndërtime të caktuara mund të marrin dy argumente, ndërsa në të tjera mund të marrin vetëm një argument.

*Shembull*

44.a She ate an apple. (folja “eat – ha” merr 2 argumente)

44.b She has already eaten. (folja “eat – ha merr vetëm një argument)

45.a Vajza hëngri mollën (folja “ha” merr 2 argumente)

45.b Vajza ka ngrënë. (folja “ha” merr vetëm një argument)

Kjo sjellje e dyfishtë i dedikohet ngjyrave të ndryshme kuptimore që folja “*ha – eat*” mbart në shembujt (44.a; 45.a) në të cilat ajo përkufizohet: “*Përtyt ose kapërdij diçka për t’u ushqyer*”, ndërsa në shembujt (44.b; 45.b) ajo përkufizohet: “*Ushqehem, marr ushqim për një kohë të caktuar*”<sup>51</sup>.

Një predikat ka mundësi të ndryshme kombinimi të cilat ndryshojnë nga njëra-tjetra. Kështu folja “*buy – blej*” merr dy argumente të cilat mund të jenë ose dy SE ose një SE dhe një SP.

---

<sup>50</sup> Adger D., *Core Syntax: A Minimalist Approach*, Oxford University Press, 2002, fq 64-65

<sup>51</sup> Fjalor i Gjuhës Shqipe, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1980

*Shembull*

- 46.a buy the boy the book F [SE; SE]  
46.b buy the book for the boy F [SE; SP]  
47.a i bleu librin djalit F [SE; SE]  
47.b e blej librin për djalin F [SE; SP]

Sa cituam deri tani lidhen ngushtë me atë që **Chomsky (1982; 29)** e përkufizon si Parim i Projeksionit:

- *Veçoritë e fjalëve të leksikut projektohen në sintaksën e fjalisë.*

Parim ky, sipas të cilit sintaksa duhet të marrë parasysh veçoritë leksikore të elementëve të ndryshëm gjatë formimit të strukturave sintaksore.

Prania ose jo e argumenteve si dhe numri i tyre, përbën një kusht në përcaktimin e valencës së predikatit. Ky term u përdor për herë të parë nga **Tenieri (1959)**<sup>52</sup> si një metaforë e nxjerrë nga fjalori teknik i kimisë, i cili përkufizohet si veti e atomit të një elementi kimik për t'u bashkuar, kombinuar me një numër të caktuar atome të tjera. Për formimin e një molekule H<sub>2</sub>O valenca e atomit O duhet të jetë dyfish krahasuar me valencën e atomit H, e cila me fjalë të tjera do të thotë se për të formuar një molekulë H<sub>2</sub>O duhen dy atome H dhe një atom O. E njëjta dukuri ndodh edhe në formimin e strukturave fjali gramatikore, ku një predikat psh “*dëshiroj – want*” e ka të domosdoshëm praninë e dy argumenteve SE.

Numri i argumenteve të përzgjedhur nga predikati përbën valencën e tij dhe kjo e fundit përbën një kriter klasifikimi (bazuar në veçoritë kontekstuale) sipas të cilit predikatët i kemi:

- Predikat zero valent: bubullon, gjëmon
- Predikat një valent: Alison runs. Agroni vrapon..
- Predikat dy valent: see, talk; vështroj, flas
- Predikat tre valent: donate, give, tell; them, jap, dhuroj,

Siç edhe mund të vihet re, në gjuhën angleze nuk kemi predikat zero valent, sepse gjuha angleze duke qenë një gjuhë analitike (pa eptim) e ka të detyrueshme shprehjen e argumentit subjekt (i cili semantikisht nënkupton personin që kryen veprimin) edhe në rastet kur predikati (si “rain, snow, etj”) semantikisht nuk përfshin asnjë veprues (rastet e jovetorit “*it*” rolit e të cilin do ta trajtojmë edhe më poshtë).

---

<sup>52</sup> Dhima Th. *Mbi klasifikimin e foljeve sipas valencave*, Seminar Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 2003

Struktura e argumenteve të foljes shërben si një mjet për të përcaktuar se cilët përbërës janë të detyrueshëm. Jo më kot **L. Heageman**<sup>53</sup> na jep krahasimin: “*Predikatët janë si një dramë ku numri i roleve është i përcaktuar dhe u duhen caktuar aktorëve. Argumentet e predikatit janë si rolet e përcaktuara në dramë për vënien në skenë të së cilës çdo rol duhet t’i caktohet një aktori. Gjatë shfaqes së dramës nuk duhet të ketë pjesë të cilat nuk i janë caktuar një aktori si dhe nuk duhet të ketë aktorë të cilëve nuk u është caktuar një rol. Në dramë nuk është i caktuar vetëm numri i aktorëve që duhet të luajnë, por edhe karakteri i secilit aktor dmth, secilit aktor i është caktuar një rol i veçantë*”.

Një krahasim i tillë shërben si ilustrim për të na bërë të ditur se përveç njohurive që folësi ka mbi numrin e argumenteve të predikatit ai disponon gjithashtu informacion të plotë përse i përket dukurisë së caktimit të roleve tematike (*Teoria Tematike*). Ashtu sikundër në dramë, ku çdo aktori i caktohet një rol i veçantë, ashtu edhe në një fjali predikati u cakton argumenteve një rol të caktuar tematik.

Gjithashtu, Chomsky (1993) në punimet e para mbi gramatikën gjenerative pranon se, (ashtu siç ndodh edhe në gramatikën tradicionale ku SE kryejnë një funksion të caktuar gramatikor), caktimi i rolit semantik SE argumente të foljes përcaktohet pjesërisht edhe nga funksioni gramatikor që këto SE përfaqësojnë duke u identifikuar si “subjekti i..” ose kundrinori i ..”<sup>54</sup>

Në këtë kontekst dy rolet kryesore tematike, ai i vepruesit dhe i pësuesit, do të argumentohen:

- Roli Tematik i Vepruesit → me këtë rol semantik identifikohet subjekti i një numri të konsiderueshëm foljesh. Kjo SE subjekt i referohet personit që kryen veprimin e shprehur nga predikati
- Roli Tematik i Pësuesit → me këtë rol semantik identifikohet kundrinori i drejtë duke iu referuar personit a sendit mbi të cilin bie veprimi i shprehur nga folja.

*Shembull*

48.a	<b>The girl</b>	kissed	<b>the lonely boy</b>
	(subjekt-veprues)		(kundrinor i drejtë-pësues)
48.b	<b>Vajza</b>	puthi	<b>djalin e vetmuar</b>
	(subjekt-veprues)		(kundrinor i drejtë-pësues)

---

<sup>53</sup> Heageman. L., *Introduction to government and binding theory*, Cambridge University Press 1991, fq 41

<sup>54</sup> Chomsky N., *Lectures on government and binding; The Piza Lectures*, Walter de Gruyter, 1993, fq 42

***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

Për këta shembuj argumentojmë se SE (*the girl/vajza*) kryen funksionin gramatikor “subjekt i”, ndërsa SE (*the lonely boy/ djali i vetmuar*) kryen funksionin gramatikor “kundrinor i”. Tregues të veçantë leksikorë të foljes (*kiss/puth*) i caktojnë SE kundrinor i drejtë rolin tematik të pësuesit, ndërsa SE subjekt rolin tematik të vepruesit.

Nisur nga shembujt në gjuhën angleze do të pranojmë të njëjtat pohime edhe për gjuhën shqipe.

*Shembull.*

49.a	<b>John</b>	sent	<b>a letter</b>	<i>to Mary</i>
	Veprues		pësues	
49.b	<b>Joni</b>	i dërgoi	<b>një letër</b>	<i>Merit.</i>
	Veprues		pesues	

Në shembujt e mësipërm të të dy gjuhëve SE subjekt (*John/Joni*) i caktohet roli tematik i vepruesit ndërsa SE kundrinor i drejtë (*a letter/ një letër*) i caktohet roli tematik i pësuesit. Nisur nga veçoritë leksikore të foljes (*send/dërgoj*) argumentojmë se ajo është një folje trevalente e cila për të kënaqur këtë veçori e ka të nevojshme praninë e një SE argument i tretë (*to Mary/Merit*) të cilës i caktohet:

Roli Tematik i Përfituesit (*receiver/marrësit*) → me të cilin identifikohet kundrinori i zhdrejtë duke iu referuar personit a sendit për të cilin kryhet veprimi i shprehur nga predikati.

Jo të gjithave SE subjekt do t’u caktohet roli tematik i vepruesit dhe jo të gjithave SE kundrinor i drejtë do t’u caktohet roli tematik i pësuesit

*Shembull*

50.a	<b>Mary</b>	received	a letter	from John.
50.b	<b>Mari</b>	mori	një letër	nga Joni

Në këta shembuj vërejmë se SE (*Mary/Meri*) interpretohet si **marrës** dhe jo më si veprues, pasi veprimi i marrjes së letrës nuk bëhet në mënyrë të vetëdijshme dhe me dëshirën e vëtë personit (*Mary*). Pra, marrja e një letre apo e-mail nuk përbën një zgjedhje të vetëdijshme të personit. Për këtë arsye SE subjekt (*Mary/Meri*) nuk mund të shpreh nuanca semantike të pastra të vepruesit.

*Shembull*

51.a	<b>The dog</b>	chewed	<b>the slipper</b>
	Veprues		pësues

51.b	<b>The dog</b>	saw	<b>the slipper</b>
	Experiençer/Përjetues		temë
52.a	<b>Qeni</b>	kafshoi	pandoflat.
	Veprues		pësues
52.b	<b>Qeni</b>	shikonte	pandoflat.
	Experiençer/Përjetues		temë

Në shembujt (51.a/52.a) SE (*the slipper/pandoflat*) i caktohet roli tematik i pësuesit, ndërsa në shembujt (51.b/52.b) SE kundrinor i drejtë (*the slipper/pandoflat*) në varësi edhe të kuptimit leksikor që folja (*see/shikoj*)<sup>55</sup> mbart i caktohet **roli tematik i temës**. Një veçori tjetër e foljes (*see/ shikoj*), që lidhet kryesisht me kuptimin perceptiv të saj, është se SE subjekt në ndërtimet e mësipërme i caktohet **roli tematik i përjetuesit (experiençer)**. Kjo SE në strukturën e fjalisë identifikon personin i cili përjeton gjendjen perceptivë të shprehur nga këto folje<sup>56</sup>.

Pra, caktimi i roleve tematike SE argument varet nga dy faktorë: veçoritë leksikore të kokave foljore dhe funksionet gramatikore të kryera nga këto SE në strukturën e fjalisë<sup>57</sup>.

Meqënëse numri i argumenteve që merr një predikat është i paracaktuar, po ashtu edhe numri dhe llojet e roleve tematike që cakton predikati, janë të paracaktuar. Përkundrazi kategoritë leksikore me anën e të cilëve realizohen këto role tematike ndryshojnë në varësi të lidhjeve sintaksore në fjali.

#### *Shembull*

53.a	i bleva	<i>një libër</i>	<i>vëllait</i>
		Tema	Përfituesi
	bleva	<i>një libër</i>	<i>për vëllanë</i>
		Tema	Përfituesi

<sup>55</sup> Në *Gramatikën e Gjuhës Shqipe 1* folja përkufizohet si pjesë e ligjeratës që emërton veprim (termi veprim perdoret në një vështrim të gjerë, duke përfshirë edhe gjëndjen edhe ndryshimin në gjëndjen e kryefjalës) si proces që ka kategoritë gramatikore të vetës, numrit, kohës dhe diatezës. Përveç foljeve që emërtojnë veprim kemi edhe një grup foljesh që emërtojnë gjëndje ose ndryshim në gjëndjen e kryefjalës në të cilat përfshihen foljet perceptivë. Në botimin “Cambridge Grammar of English Language” foljet e këtij grupimi i referohen 5 shqisave kryesore të qënieve njerëzore (të parët; të dëgjuarit; të nuhaturit; të shijuarit dhe të prekurit). Duke qënë se semantikisht ky grup foljesh i referohet një gjëndjeje të caktuar (dhe jo një veprimi) frymorët e shprehur në strukturën e fjalisë nga SE subjekt nuk mund të përbëjë vepruesin (atë që e kryen veprimin), por ato më tepër i referohen frymorit i cili e përjeton këtë gjëndje perceptivë. Nga ana tjetër, po për të njëjtën arsye frymori a sendi i shprehur nga një SE kundrinor i drejtë nuk mund të analizohet si pësues, por si temë (nuk kemi të bëjmë me një veprim i cili duhet të bjerë mbi një SE kundrinor).

<sup>56</sup> Cook V. J. and Newson M. *Chomsky's Universal Grammar*, Third Edition, Blackwell Publishing, 2007, fq 80-85.

<sup>57</sup> Varësia e caktimit të rolit semantik nga funksioni gramatikor i kryer nga SE argumente në strukturën e fjalisë qëndron më shumë për gjuhën angleze, por nuk përjashtohet përshtatshmeria edhe në gjuhën shqipe.

- 53.b waited *the friends*  
Theme  
waited *for the friends*  
Theme

Pra, shembulli 11.a na bën të ditur se predikati “blej” cakton dy role tematike, atë të temës dhe të përfituesit: në rastin e parë roli tematik i përfituesit realizohet nga një SE, ndërsa në rastin e dytë ai realizohet nga një SP (në këtë të fundit roli tematik realizohet në mënyrë të përbërë nga veprimi i kombinuar i predikatit dhe parafjalës).

## 2.2 POZICIONI I CAKTIMIT TË ROLIT TEMATIK


Para se të kalojmë te caktimi i roleve tematike, do të trajtojmë me pak fjalë *sintagmën funksionale të eptimit (SEpt)* rëndësia e së cilës do të ndihet edhe në kapitujt në vijim. Lindja e kësaj sintagme funksionale lidhet ngushtë me përgjigjen që i është dhënë pyetjes se cila do të ishte struktura e fjalisë dhe se a mund të njehtësohej ajo me SF. Fjalja e mëposhtme me foljen dyvalente “takoj” mund të paraqitet si SF.

*Shembull*

54.a The boy met his mother

54.b Djali takoi nënën

**Skema 21**



Në fakt, kjo fjali nuk përbën një SF, por, përkundrazi, ajo ka një strukturë më të ndërlikuar.

Çdo fjali e thjeshtë, sipas gjuhësisë gjenerative, është identifikuar si frazë më një strukturë më të ndërlikuar se ajo e sintagmave foljore<sup>58</sup>. Për të vërtetuar sa më sipër do të bazohemi, së pari te ekzistenca e foljeve ndihmëse të cilat nuk shfaqin karakteristikat e foljeve të tjera (mëvetësi leksikore), pasi ato gjithmonë do të duhet të shoqërohen nga një pjesore

Shembull

55.a Djali lexoi librin

55.b The boy read the book.

55.b Djali e ka lexuar librin

55.c The boy has read the book.

Në këta shembujt vërejmë se nuk kemi asnjë ndryshim përse u përket roleve tematike që u caktohen SE argumentë (*Djali/the boy-veprues; librin/the book-pësues*), fakt që dëshmon mbi paaftësinë e foljeve ndihmëse për të caktuar role tematike.

Së dyti, që fjalia paraqet një strukturë më të ndërlikuar se çka ofron struktura SF dëshmohet edhe nga prania e detyrueshme e subjektit edhe në rastet kur ai nuk përbën argument të foljes, pra nuk kërkohet prej saj. Për këto raste i referohemi ndërtimeve me folje zerovalente të gjuhës angleze të cilat e kanë të detyrueshëm praninë e *impersonal-it* me funksionin sintaksor të subjektit. Për këto ndërtime ky subjekt *-it* nuk mund të realizohet brenda projekcionit SF, pasi nuk kërkohet nga folja.


Së treti, një fakt tjetër bindës është edhe lidhja që ekziston midis SE subjekt dhe predikatit të fjalisë të cilën me të drejtë në gramatikën e gjuhës shqipe e kemi parë si lidhje bashkëpërshtatje. Kjo lidhje është e pranishme edhe për ndërtimet e ashtuquajtura zerovalente të anglishtes të cilat krahas *impersonal -it* të vetës së tretë njëjës te foljet shfaqet edhe mbaresa *-s* e vetës së tretë njëjës, gjë që vërteton bashkëpërshtatjen subjekt – predikat. Për të njëjtën kategori foljesh zerovalente të gjuhës shqipe vërehet se folja vendoset në vetë të tretë njëjës, edhe pse SE subjekt nuk shprehet. Nga faktet e radhitura përmbledhim se si foljet ndihmëse, edhe mbarestat foljore ofrojnë informacion të rëndësishëm mbi kategoritë foljore të kohës, mënyrës dhe vetës të cilat do të përshtaten me SE subjekt të fjalisë. Këto tipare përfaqësojnë të ashtëquajturin fleksion dhe rrjedhimisht fjalia shfaqet si një projekcion i sintagmës së fleksionit/eptimit SEpt.

Nisur nga këto të dhëna shembujt(54.a/54b) skema 24 do të riprojektohet si më poshtë:

---

<sup>58</sup> Dhima Th. “Disa veçori të frazës shqipe në këndvështrimin e gjuhësisë së sotme”, 2007

**Skema 22**



Në kokën Ept<sup>0</sup> gjenerohen mbaresat foljore, foljet ndihmëse si dhe foljet modale<sup>59</sup>. Si plotësor i SEpt shërben SF, ndërsa në pozicionin e specifikuesit realizohet SE kryefjalë e fjalisë. (fillimisht ajo gjenerohet në pozicionin SpecSF në të cilin i caktohet roli tematik dhe me anën e një operacioni lëvizës zhvendoset drejt pozicionit SpecSEpt për të marrë rasë)

Sipas Teorisë së Lidhjes dhe Drejtimit argumentohet se për caktimin e roleve tematike SE argumente të foljes duhet të realizohen në një pozicion të caktuar. Para se të përcaktojmë pozicionin në të cilin do të caktohen rolet tematike, duhet të përcaktojmë caktuesin e këtyre roleve tematike.

*Shembull.*

- 56.a John broke a leg last week
- 56.b John broke a vase last week
- 57.a Agimi theu krahun
- 57.b Agimi theu xhamin

Në shembujt (56a&57a) të të dyja gjuhëve (gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze) SE “John/Agimi” i caktohet roli tematik i vepruesit ndërsa në shembujt (56.b&57.b) po kësaj sintagme i caktohet roli tematik i përjetuesit/experiencer. Nëse do të pranohet që SE në pozicionin e subjektit të fjalisë roli tematik i caktohet nga predikati, atëherë si është e mundur që në fjalitë e mësipërme në të cilat predikati është i njëjtë rolet tematike të tij janë të ndryshme?

<sup>59</sup> Foljet modale përkufizohen si folje që shërbejnë për të shprehur modalitetet, qëndrimin e folësit mbi veprimin e emërtuar nga folja ndjekëse. Pra ato e kanë humbur mëvetësinë e tyre si folje të zakonshme; nuk mund të kryejnë funksionin sintaksor të kallëzuesit; përdoren të ndjekura nga një folje me kuptim leksikor të plotë.



Po të përqëndrohemi dhe të analizojmë në detaje shembujt e mësipërm, do të shohim se ajo që ndryshon është vetëm argumenti i gjeneruar në pozicionin motër me predikatin (*krahun / xhamin; a leg / a vase*), ndryshim ky që na bind mbi faktin se roli tematik i vepruesit (subjektit) caktohet si rezultat i bashkëpunimit midis predikatit dhe argumentit të tij të brendshëm (objektit).

Në përmbledhje të asaj sa thamë më lart, konkludojmë se SE kundrinor i drejtë i caktohet një rol tematik i brendshëm. Kjo SE që e merr këtë rol tematik të brendshëm identifikohet si argument i brendshëm. Roli tematik i vepruesit që i caktohet SE subjekt nga predikati së bashku me argumentin e saj të brendshëm/objektin (nga projeksioni i ndërmjetëm (V'/F')) quhet rol tematik i jashtëm dhe SE argument që e merr këtë rol tematik quhet argument i jashtëm.

Përsa i përket pozicionit në të cilin këto role semantike caktohen na vjen në ndihmë **Hipoteza e Subjektit të Brendshëm** e përhapur aty nga fundi i viteve '80. Kjo hipotezë e mbështetur si teorikisht edhe empirikisht nga Koopman dhe Sportiche (1991) i thjeshton parimet mbi caktimin e roleve tematike duke pranuar si parim kryesor për pozicionet e caktimit të roleve tematike Kushtin e Motërsisë (Sisterhood Condition)<sup>60</sup>. Sipas këtij kushti:

- *Caktuesi i roleve tematike ia cakton rolet tematike përkatëse SE të pozicionuar në nyja motra me të.*

Për ta kuptuar më mirë argumentojmë se SE argument i brendshëm për të marrë rolin tematik të pësuesit/temës realizohet në pozicionin motër (në të majtë) me kokën foljore, ku kjo e fundit shërben si caktues theta.


Ndërsa SE argument i jashtëm e cila e merr rolin tematik të vepruesit nga projeksioni i ndërmjetëm (V'/F' i VP/SF) do të duhet gjithashtu të realizohet në një pozicion motër (në të djathtë) me të. Si pozicion i tillë shërben pozicioni i specifikuesit të VP/SF<sup>61</sup>. Pohimet e deritanishme na shtyjnë ta ripunojmë skemën 25 duke pasqyruar pozicionet e caktimit të roleve tematike.

---

<sup>60</sup> Cook V. J. and Newson M. *Chomsky's Universal Grammar*, Third edition, Blackwell Publishing, 2007, fq 80-85

<sup>61</sup> Realizimi i SE argument të foljes në këto pozicione bazë përbën edhe strukturën e thellë të një fjalie.

**Skema 23**



Pra, SE argument i jashtëm në strukturën e thellë do të realizohet në pozicionin Spec SF për të marrë rolin tematik të vepruesit dhe më pas ajo do të zhvendoset drejt pozicionin SpecSEpt pozicion ky në të cilin ajo do të licensojë treguesit eptimorë si rezultat i caktimit rasor.

Për më tepër caktimi i roleve tematike do të bazohet edhe në një parim të dytë sipas të cilit një argument nuk mund të përfshihet në strukturën e fjalisë pa u pajisur më parë me një rol tematik të caktuar. Kjo lidhet me Kriterin Theta sipas së cilit:

- Çdo argumenti i caktohet një dhe vetëm një rol tematik
- Çdo rol tematik i caktohet një dhe vetëm një argumenti.

Përmbledhim se për caktimin e roleve tematike argumenteve (të brendshëm/të jashtëm) të foljes duhet të bazohemi në dy parime: Kushti i Motërsisë dhe Kriteri Theta.

### **2.3 CAKTUES TË TJERË TË ROLEVE TEMATIKE.**

Valenca nuk përbën një tipar semantiko-sintaksor që lidhet kryesisht me foljen, por ajo shtrihet edhe në një numër të kufizuar emrash dhe mbiemrash duke i bërë ata të shihen si qendra të strukturave relacionare (marrëdhëniesore)<sup>62</sup>. Ashtu sikurse foljet, emrat shprehin strukturën e tyre argumentale e cila në kontekste të caktuara i nënshtrohet parimit të përzgjedhjes. Emrat që në ligjërim kanë fuqi ndërtuese të barabartë me shumicën e foljeve, përfshirë këtu ata emra që rrjedhin prej foljesh ose mbiemrash prejfoljorë, kanë marrë emërtime të ndryshme si;

<sup>62</sup> Me strukturë relacionare do të kuptohet nevoja (kryesisht e foljeve) për të pasur valenca të ngopura.

argumentalë/joargumentalë, noms recteurs/noms deverbaux, emra valentë/emra jo valentë. (Ky i fundit parapëlqehet të përdoret).

Në përgjithësi pranohet se emrat e prejardhur nga foljet shfaqin pak a shumë të njëjtën bazë argumentale me foljet përkatëse si: *ardhje/arrival, prodhim/production*, etj, ndërsa emrat e ashtuquajtur jovalentë, të cilët nuk vijnë nga foljet, përbëjnë klasën e emrave konkret si: *shtëpi/house; zemër/heart; kukul/doll*, etj

Struktura argumentale e emrave valentë dëshkohet nga analiza e mëposhtme e cila i përball këta emra me ata jovalentë:

- Emrat valentë dhe ata jovalentë mund të ndiqen nga plotës specifikues, përfaqësimi fonetik i të cilit nuk është i detyrueshëm në ndërtimet me emra joargumentalë, ndërsa për emrat argumentalë (ashtu siç ndodh edhe me foljet valente) ai është i detyrueshëm. Mund të mos shprehet vetëm për ato raste kur bëhet i ditur nga konteksti.

*Shembull*

58.a *The boy's house* was robbed

The **house** was robbed. (emra jovalentë)

58.b **Shtëpia** e djalit u grabit

Shtëpia u grabit

59.a **The destruction** of the city was a devastating news

**The destruction** was a devastating news. (kjo fjali mund të pranohet vetëm nëse specifikuesi “of the city” është bërë i ditur nga konteksti)

59.b **Shkatërrimi** i qytetit ishte një lajm i hidhur.

**Shkatërrimi** ishte një lajm i hidhur.

- Ky plotës specifikuesi kur lidhet me emra valentë përbën një argument të vërtetë duke realizuar një rol tematik të caktuar.

*Shembull*

60.a The departure of **the train...**

veprues

**The train** departed

Veprues

60.b Nisja **e trenit ...**

Veprues

**Treni** u nis...

Veprues

- Emrat valentë dhe jovalentë mund të shoqërohet edhe nga përemra pronorë, por marrëdhëniet e pronësisë të shprehura nga këto dy kombinime nuk janë të njëjta. Kombinimi emër jovalent + përemër pronor shpreh marrëdhënie të qarta pronësie, ndërsa kombinimi emër valent + përemër pronor shpreh marrëdhënie subjektore.

*Shembull*

- 61.a *His arrival* (e barasvlefshme) **The arrival of the student** (the student=subjekt)  
61.b **Mbërritja e tij** (e barasvlefshme) **Mbërritje e studentit** (studenti = subjekt)

Emrat foljorë, ose të quajtur ndryshe emra valentë, kanë një status të veçantë: morfologjikisht ata janë emra, ndërsa sintaksorisht kanë tipare emërore dhe foljore. Ky fakt dëshmon se kundërvënia folje-emra, si nga ana morfologjike, sintaksore dhe semantike, nuk është dhe aq e prerë, gjë që tregon se kemi të bëjmë me forma gramatikore që nga njëra anë i kundërvihen njëra tjetrës dhe nga ana tjetër hyjnë në marrëdhënie plotësimi. **Graffi**<sup>63</sup> thekson se kjo përkitshmëri midis emrave dhe foljeve është kaq sistematike, sa në disa raste mundëson që klasa të caktuara emrash të hyjnë në klasa të caktuara foljesh.

Por përveç ngjashmërive, midis emrave valentë dhe foljeve prej të cilave këta emra kanë rrjedhur ka ndryshime përsa i përket shprehjes së valencës. Kjo duket në:

*Së pari*, emri trashëgon prej foljes dy vlera të valencës, numrin e argumenteve që varen prej tij si dhe veçorinë e zgjedhjes të cilat njihen ndryshe si shtrëngesa sintaksore të zgjedhjes.

*Së dyti*, ndryshimi ka të bëjë me forcën e valencës. Për një folje vetore subjekti është i qartë ndërsa për një emër valent ai mund të jetë i nënkuptuar.

*Shembull*

- |      |   |   |
|------|---|---|
| 84.a | Zbulimi i tyre<br>Their discovery                 | Ata zbulojnë<br>They discover               |
| 84.b | Zbulimi i tyre<br>Their discovery                 | Zbulojnë diçka<br>They discover something   |
| 84.c | Zbulimi i kërkuesit<br>The researcher's discovery | Kërkuesi zbulon<br>The researcher discovers |
| 84.d | Zbulimi i virusit<br>The virus discovery          | Zbulojnë virusin<br>They discover the virus |

Në varësi të argumenteve që merr emri ata i klasifikojmë në:

**Emra një valentë:** arrival; departure; expansion; ecje, ardhje, hyrje, nisje etj.

*Shembull*

His health care program, the most significant **expansion** of social safety net era. (New York times – titull artikulli)

“..... nuk e ka aprovuar ende **hyrjen** politike të vendit tonë në BE”

**Emra dy valentë:** production; decision; rejection; largim, takim, prodhim, vendim, verifikim etj.

*Shembull*

Parliament **rejection** of Referendum on Independence. (New York times – titull artikulli)

“*Takimi* me të birin ishte prekës.”

**Emra tre valentë:** donation, contricution, dhënie etj.

<sup>63</sup> Dhima. Th., *Valenca e emrave dhe çështje të klasifikimit të tyre*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë 2007

Student's **donation** of puppies and toys to the hospitalized children was an act to be appreciated.  
“Dhënia e tokës fshatarëve nga reforma u prit me gëzim”

Pra, deri sa këto kategori gramatikore marin argumente dhe, si rrjedhim ato klasifikohen sipas valencës, detyrimisht ato duhet t’u caktojnë këtyre SE argumente edhe role tematike. Si rrjedhim i logjikës së ndjekur në këtë drejtim dhe fakteve të propozuara në kapitujt e mëparshëm do të pranohen si caktues të roleve tematike emrat dhe mbiemrat prejfoljorë.

*Shembull.*

85.a	Agimi	shqetësohej	për të motrën.
	Veprues		Tema
85.b	Anna	envies	her sister
	Ana	e ka zili	të motren
	Veprues		Tema

Predikati “*shqetësoj*” cakton dy role tematike atë të vepruesit (SE “*Agimi*”) si dhe rolin tematik të temës (SP “*për të motrën*”).

Po ashtu edhe ndërtimet e njëjta me emrin prejfoljor “*shqetësimi/envy*” dhe mbiemrin prejfoljor “*i shqetësuar/envious*” caktojnë dy role tematike përkatësisht atë të vepruesit dhe temës si:

*Shembull*

86.a	Agimi është	i shqetësuar	për motrën
86.b	Anna is	envious	of her sister
	Veprues		Temë
	i shqetësuar/envious [Veprues;Temë]		
86.c	Shqetësimi	i Agimit	për motrën
		Vepruesi	Tema
86.d	Anna’s	envy	of her sister
	Vepruesi		Tema
	Shqetësimi/envy [Veprues;Temë]		

Edhe pse midis foljes nga njëra anë dhe emrit dhe mbiemrit nga ana tjetër ka ngjashmëri, midis tyre asnjëherë nuk vendoset shenja e barazisë, sepse SE argumente, të cilave roli tematik u caktohet prej predikatëve duhet të jenë gjithmonë të shprehura fonetikisht, se folja ka nevojë për valenca të ngopura, gjë që nuk ndodh në rastet e caktimit të roleve tematike prej emrit dhe mbiemrit, siç e vërteton edhe shembulli i poshtëcituar.

*Shembull*

87.a	Shqetësimi i Agimit për shokun u mor vesh.		
	Shqetësimi i Agimit u mor vesh.		
	Shqetësimi u mor vesh.		

## ***PËRFUNDIME***

Ky kre i kushtohet një prej moduleve kryesore të gjuhësisë gjenerative të njohur si Teoria e Roleve Tematike e cila trajton marrëdhëniet që predikati vendos me argumentet e tij si dhe rolin semantik që ky i fundit i cakton secilit. Për sa më sipër Heageman shprehet se " *Predikatët janë si një dramë, ku numri i roleve është i përcaktuar dhe u duhen caktuar aktorëve. Argumentet e predikatit janë si rolet e përcaktuara në dramë për vënien në skenë të së cilës çdo rol i duhet caktuar një aktori. Gjatë shfaqes nuk duhet të ketë pjesë të cilat nuk i janë caktuar një aktori dhe aktor pa rol. Gjithashtu, është përcaktuar edhe karakteri i secilit aktor pra roli i tij i veçantë.*"

Diçka e ngjashme ndodh edhe me argumentet në strukturën e fjalisë numri i të cilëve varet nga informacioni leksikor që çdo predikat mbart, pra nga korniza nënkategorizuese e tyre. Për këtë arsye predikatët për të përmbushur kuptimin e tyre e kanë të nevojshme praninë e një, dy, tre ose asnjë argumenti. Numri i argumenteve që një predikat merr lidhet kryesisht me valencën e tij sipas së cilës predikatët klasifikohen më tej në zero, një, dy apo tre valentë. Ashtu sinkundër ndosh edhe në dramë, predikati i cakton secilit argument një rol tematik të veçantë. Ndër rolet tematike më kryesore janë: roli tematik i vepruesit, roli tematik i pësuesit ose temës, roli tematik i përfituesit, roli tematik i përjetuesit, roli tematik i marrësit, etj.

Chomsky (1993) shprehet se roli tematik i përcaktuar nga predikati lidhet pjesërisht edhe me funksionin sintaksor që këto SE argumente përfaqësojnë duke e identifikuar vepruesin si subjekt i ... ose pësuesin si kundrinor i ...

Edhe pse si caktues i roleve tematike pranohet folja predikat, përta i përket rolit tematik të vepruesi shembulli i mëposhtëm vërteton të kundërtën.

Shembull.

<b>John</b>	broke	the leg
Veprues		temë
<b>John</b>	broke	the vase.
Përjetues		temë

Predikati është i njëjtë ndërsa rolet tematike janë të ndryshme. Në fjalitë e mësipërme ndryshimi qëndron te përmbajtja leksikore e argumentit "leg/vase", gjë që na bind se roli tematik i vepruesit caktohet nga projeksioni i ndërmjetëm F'. Pra, është predikati i cili në bashkëpunim

### ***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

---

me argumentin e brendshëm i caktojnë rolin tematik të vepruesit SE argument i jashtëm subjekt. Nga ana tjetër predikati i cakton rolin tematik të pësuesit/temës SE argument i brendshëm kundrinor.

Përveç predikatëve si caktues të roleve tematike janë pranuar edhe një grup i kufizuar emrash dhe mbiemrash të cilët shihen si qendra të strukturave relacionare. Ky grup emrash dhe mbiemrash, që kanë fuqi ndërtuese të barabartë me shumicën e foljeve, janë ata që rrjedhin prej këtyre të fundit dhe përfshihen në grupin e emrave të prejardhur. Statusi i tyre është i veçantë, pasi ato morfologjikisht janë emra, ndërsa sintaksorisht kanë tipare emërore dhe foljore.

## KREU III

### TEORIA E RASËS

#### (NJOHURI TË PËRGJITHSHME)

#### 3.1 KATEGORIA E RASËS NË GJUHËN ANGLEZE DHE ATË SHQIPE.

##### (KËNDVËSHTRIM HISTORIK)

Emri në fjali përdoret në funksione të ndryshme sintaksore në varësi të të cilave ndryshon edhe forma e tij. Format e ndryshme rasore që SE marrin në strukturën e fjalisë, me anë të së cilave shprehen edhe lidhjet e nje sintagme me sintagmat e tjera në fjali, quhen rasa.

Sistemi rasor ndryshon, jo vetëm nga gjuha në gjuhë, por edhe brenda së njëjtës gjuhë si rezultat i evoluimit në kohë të strukturës së brendshme të saj. Kështu, duke u nisur nga gjuha angleze e cila është më e prekur nga këto ndryshime do të evidentojmë edhe hendekun e madh i cili e largon së tepërmi këtë të fundit nga gjuha shqipe.

Po të krahasojmë sistemin aktual rasor të gjuhës angleze me atë të gjuhës shqipe vërejmë se gjuha shqipe karakterizohet nga caktimi morfologjik i pesë rasave (emërore, gjinore dhanore kallëzore dhe rrjedhore), ndërsa në gjuhën angleze (përfshijmë këtu kategorinë e përemrit i cili shfaq tre përfaqësime fonetike të ndryshme që i përgjigjen katër rasave kryesore p.sh. he - rasa emërore Nominative; his – rasa gjinore Genitive dhe him – rasa kallëzore Accusative + rasa dhanore Dative) kemi të bëjmë me caktim rasor pozicional<sup>64</sup> të katër rasave, Nominative (emërore), Genitive (gjinore), Accusative (kallëzore) dhe Dative (dhanore).

Ky ndryshim i dukshëm i gjuhës angleze përkundrajt asaj shqipe lidhet ngushtë me thjeshtimin deri në zhdukje që paradigma e eptimit (qoftë emëror, qoftë foljor) ka pësuar në rrjedhën e kohës. Sa më sipër, nënkupton se në fazat e hershme të zhvillimit të gjuhës angleze, përkatësisht anglishtes së vjetër, kjo e fundit, përtaqet kategorisë së rasës, shfaq një sistem rasor të plotë dhe të mirëdiferencuar si në morfema eptimi (të ndryshme për çdo rasë) edhe në forma rasore (përveç katër rasave të mësipërme Nominative, Genitive, Dative dhe Accusative ekzistonte edhe një rasë e pestë Instrumental case)

---

<sup>64</sup> Me rase pozicionale kuptohet rasa që një SE merr në varësi të pozicionit/vendit që ajo zë në strukturën e fjalisë. Buxheli. L., *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2007, fq. 53-54



Në këtë kontekst anglishtja e vjetër karakterizohet nga ekzistenca e lakimeve të ndryshme në varësi të përfaqësimit fundor fonetik të SE duke u klasifikuar në dy grupime kryesore: në lakimin e fortë – i cili përfshin të gjithë emrat që përfundojnë me zanore dhe në lakimin e dobët – i cili përfshin të gjithë emrat që përfundojnë me bashkëtingëllore.

Për më tepër, karakteristikë e anglishtes së vjetër është edhe vendosja para emrit gjatë lakimit të tij të mjetit morfologjik “se” i cili shfaqet në katër forma: se- për gjininë mashkullore njëjës; “seo” për gjininë femërore njëjës; “paet” për gjininë asnjëanëse; “pa” për të tria gjinitë të numrit shumës.

Ky mjet morfologjik në anglishten e vjetër kryen funksionin e dëftorit “that”, por për më tepër ai luan rolin e njëjës shquese “the”. Historikisht “se” ka ardhur si rezultat i përdorimit anaforik të dëftorit, i cili në anglishten e vjetër përdorej si një shquese me funksion kryesor atë të individualizimit. Në këtë kontekst gjatë lakimit jo vetëm emri por edhe nyja shquese do të merrte forma të ndryshme në varësi të rasës.

*Lakimi i parë (i fortë) i emrave në anglishten e vjetër<sup>65</sup>.*

*Se stan (the stone)*

<i>Singular</i>	<i>Plural</i>
<b>Nom</b> se stan	pa stanas
<b>Gen</b> paes stanas	para stana
<b>Dat</b> paem stane	para stanum
<b>Acc</b> pone stan	pa stanas

*Lakimi i dytë (i dobët) i emrave në anglishten e vjetër.*

*seo hunta (the hunter)*

<i>Singular</i>	<i>Plural</i>
<b>Nom</b> seo hunta	pa huntan
<b>Gen</b> paere huntam	para huntana
<b>Dat</b> paere huntan	para huntum
<b>Acc</b> pa huntan	pa huntan

---

<sup>65</sup> Hogg R., *An introduction to old English*, Edinburgh University Press, 2002, fq 14-19.  
Bezhani H., *A short historical grammar of English*, SHBLU, Tiranë 2002, fq 47-57

Siç mund të vihet re, elementet sintaksorë më të rëndësishëm të një SE lidhen më rasën dhe numrin. Këto elemente të SE në anglishten e sotme, përveç rasës gjinore e cila del e mirë diferencuar, nuk i gjejmë më të përfaqësuara në sistemin rasor të kësaj gjuhe.

*Shembull*

88.a Paet wif geaf paem menn pa boc.<sup>66</sup>  
Nom Acc Dat

krahasuar me ekuivalentin e anglishtes së vjetër

88.b The woman gave the man the book<sup>67</sup>.  
Nom Acc Dat

Në periudha të ndryshme të zhvillimit të strukturave gjuhësore, gjuha angleze paraqitet si një gjuhë e destinuar për t'i humbur format e ndryshme rasore që emri merrte gjatë përdorimit të tij në fjali. Humbja e fleksionit rasor çoi në humbjen e aftësisë së SE për të lëvizur lirshëm në strukturën e fjalisë, humbjen e fleksibilitetit që i karakterizonte.

Në ditët e sotme paradigma e rasës në gjuhën angleze shfaqet e reduktuar në maksimum pasi edhe pse ajo prezantohet e përbërë nga të katër format rasore e sipërpërmendura, përveç rasës gjinore (genitive case) e cila del në formë rasore të ndryshme, të tre rasat e tjera dalin me të njëjtin përfaqësim fonetik. Kjo ngjashmëri formash rasore, jo vetëm midis lakimeve të ndryshme, por edhe brenda të njëjtit lakim ka ndikuar në humbjen e kategorisë gramatikore të lakimit dhe të gjinisë.

Për shprehjen e marrëdhënieve midis sintagmave dhe për përndarjen e tyre në strukturën e fjalisë në gjuhën angleze sot do të na duhet t'i referohemi përdorimit të mjeteve sintaksore si: rendi i ngulitur i fjalëve dhe parafjalës.

Nga ana tjetër gjuha shqipe shfaq një realitet krejt ndryshe nga gjuha angleze, pasi për shprehjen e marrëdhënieve midis sintagmave dhe për përndarjen e tyre ajo i referohet përdorimit më së tepërmi të mjeteve morfologjike (eptimi), pa anashkaluar edhe përdorimin e mjeteve sintaksore. Kjo është një prej arsyeve të përkufizimit të gjuhës shqipe si një gjuhë sintetiko-analitike duke ruajtur deri në një farë mase ndërtimin e saj si gjuhë me fleksion.

---

<sup>66</sup> Hogg R., *An introduction to old English*, Edinburgh University Press, 2002, fq 14-19

<sup>67</sup> Po aty

Emri në gjuhën e sotme shqipe shfaq kategoritë e numrit, gjinisë, shquarsisë/pashquarsisë dhe rasës. Sistemi rasor i gjuhës shqipe përbëhet nga pesë rasat e sipërpërmendura të formuara në mënyrë sintetike me anë ndajshitesash.

Gjuha shqipe edhe pse trashëgon një paradigmë eptimi rasor të plotë me morfema eptimore të diferencuara në varësi të rasave ajo i është nënshtruar gjithashtu evolucionit fonetik (proces i njëjtë të cilit i është nënshtruar edhe gjuha angleze) i cili rezultoi në sheshimin e një numri formash rasore deri në daljen e tyre nga sistemi rasor.

Në shqipen e hershme është pranuar si një rasë e veçantë edhe rasa thirrore<sup>68</sup> e cila në gramatikën e latinishtes dhe të greqishtes së vjetër konsiderohet si një formë rasore e emrit e cila përdoret në rastet kur i drejtohem një frymori ose sendi të personifikuar. Në këtë kontekst, ajo përfaqëson formën rasore të adresimit<sup>69</sup>. Në disa gramatika e studime të gjuhës shqipe pasqyrohen dy qëndrime lidhur me thirroren. Disa studiues si K. Kristoforidhi, I.D. Sheperi, Gj. Pekmezi, S. Riza<sup>70</sup> e pranojnë thirroren si rasë të veçantë. Nga ana tjetër shumë të tjerë e përjashtuan atë nga paradigma e lakimit. Përsa i përket ndërtimit të kësaj rase Sheperi<sup>71</sup> thekson se *“rasa thirrore shfaqet kurdoherë me trajtën e emërores prej së cilës ndryshon vetëm nga prania (para ose pas) e një pasthirme thirrore”*. Të njëjtin fakt e gjejmë edhe te O. Mydeziri<sup>72</sup> sipas së cilit *“rasa thirrore nuk ka trajtë më vete, por ajo është një emërore e pashquar që shoqërohet nga “o” e para ose prapavendosur. Kjo pjesëz ose pasthirmë shoqëruese nuk shërben si mjet morfologjik për ndërtimin e kësaj rase”*. Gjithashtu nga këndvështrimi sintaksor sintagma emërore në këtë rasë nuk mund të shprehë marrëdhënie ndërmjet dy objekteve dhe si e tillë ajo shërben si përbërës i veçuar.

Nisur nga këto arsyetime rasa thirrore u përfshi te rasa emërore me të cilën përputhet nga forma si në trajtën e shquar ashtu edhe në të pashquarën.

Gjithashtu edhe për rasën vendore të dikurshme të ndërtuar nëpërmjet parafjalëve vendore “në, mbi etj” dhe ndajshitesës –t në fund të temës: në malt, në fushët etj., e cila shërben si rrethanor

---

<sup>68</sup> Rasa thirrore është trajtuar nga një numër gramatikash si para dhe pas çlirimit të evidentuara kryesisht te artikulli i M. Çelikut “Kontribut për dy probleme të morfologjisë të gjuhës së sotme shqipe”, Studime Filologjike 1971, fq 138-140

<sup>69</sup> B. J. Blake, Case 1994 sipas L. Buxhelit *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme Shqipe, Tiranë, 2007*, fq 30

<sup>70</sup> Të gjithë këta studiues bashkë me argumentimet e tyre paqyrohen në artikullin e mësipërm të M. Çelikut si dhe botimin e mësipërm të L. Buxhelit. fq. 30

<sup>71</sup> Çeliku M. “Kontribut për dy probleme të morfologjisë të gjuhës së sotme shqipe”, Studime Filologjike 1971, fq 138

<sup>72</sup> Po aty

vendi u ndoq e njëjta logjikë. Duke qënë se kjo formë rasore nuk mundi të përgjithësohej në gjuhën letrare, por mbeti një formë dialektore, ajo u pranua si rasë kallëzore më parafjalë ose si rrjedhore për format: malit, fushës.

Të dy gjuhët edhe pse historikisht i janë nënshruar ndryshimeve që prekën ndërtimin dhe përfaqësimin rasor ato sot pozicionohen shumë larg njëra tjetrës, njëra analitike (anglishtja) dhe tjetra sintetiko-analitike (shqipja).

### **3.2. KONCEPTI RASË DHE QËLLIMI I STUDIMIT TË SAJ**

Studimet e para mbi rasën i gjejmë te grekët e vjetër e më pas te latinët, ku përkatësisht gjuha greke dhe latine kanë qënë gjuhë flektive, me mbaresa të cilat ndërthenin në vetvete disa kuptime gramatikore.

Termi i përdorur nga grekët ishte “ptosis”<sup>73</sup> i cili në latinisht u përkthye “causus” (rënie) duke nënkuptuar rënie ose devijim nga e ashtquajtura formë standarte e fjalës së ndryshueshme.

Në gjuhësinë moderne termi rasë përdoret me disa kuptime. Krahas termit rasë morfologjike ose rasë eptimore që i referohet rasës të realizuar nëpërmjet eptimit përdoren edhe terma të tjerë:

- Rasë Sintetike – përdoret për të treguar rasat morfologjike të cilat karakterizohen nga përzierje funksionesh ose formash morfologjike.
- Rasë ndajfoljore – përdoret për të emërtuar format rasore të emrit që specifikojnë marrëdhënie kohore
- Rasë e thellë – përdoret për të treguar marrëdhëniet semantike të një predikati me argumentin e tij i cili është një SE. Sistemi i rasës së thellë njihet ndryshe edhe si Teoria e Roleve Tematike një nga modulet e gramatikës gjenerative sidomos i Teorisë së Lidhjes dhe Drejtimit.
- Rasë abstrakte – përdoret në gramatikën gjenerative duke iu referuar rasës që realizohet në një pozicion strukturor të caktuar të SE.

Mendimi bashkohor i mbështetur në konceptin gjenerativist për rasën ka evoluar duke pasqyruar dy faza kryesore.

---

<sup>73</sup> Buxheli L. *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2007. fq. 42

Faza e parë – deri në fund të viteve 80' gjatë së cilës koncepti gjenerativist për rasën nuk shfaqet i shkëputur nga ai tradicional pasi në këtë fazë pranohet roli i lidhjes sintaksore të drejtimit për caktimin rasor dhe caktimi rasor shihet si një dukuri që ndodh vetëm në strukturën sipërfaqësore. Faza e dytë – vitet 90' e këtej ku me futjen e programit minimalist koncepti gjenerativist për rasën shkëputet nga ai tradicional, pasi për realizimin e saj nuk shihet si kusht caktimi rasor dhe drejtimi. Sintagma emërore mendohet se hyn në strukturën e fjalisë e veshur me tipare rasore të cilat duhet të përshtaten diku në pemën strukturore që përmban sintagmën emërore plotësuese.

Sipas Chomsky<sup>74</sup> dy janë detyrat kryesore të aftësisë gjuhësore të folësit në lidhje me sintagmën emërore: e para, të rregullojë distribucionin e SE; e dyta, të bëjë interpretimin kuptimor të SE. Për rrjedhojë, dy janë modulet kryesore të kësaj aftësie gjuhësore për realizimin e distribucionit dhe interpretimit kuptimor të SE: e para rasa dhe e dyta rolet tematike.

Më poshtë do të përshkruajmë sistemin rasor të të dyja gjuhëve sipas teorisë së rasës, ku kjo e fundit përfaqëson edhe modulën e parë më të rëndësishëm të gramatikës gjenerative. Ky modul karakterizohet nga një sërë parimesh dhe parametrash që lidhen me përndarjen ose distribucionin e sintagmave emërore, proces ky që mundësohet nëpërmjet caktuesit rasor .

Kategoria e rasës do të trajtohet në planin strukturor si objekt studimi i sintaksës. Ky studim do t'i shtojë aspektit morfologjik (mbizotërues i gramatikës tradicionale) edhe aspektin sintaksor i cili është po aq i rëndësishëm dhe nuk duhet nënvlerësuar. Gjithashtu duke u ndalur në një prej çështjeve të gramatikës gjenerative, atë të caktimit rasor si kusht për përndarjen dhe distribucionin e emrit në fjali, do të përshkruajmë se si funksionon sistemi rasor i gjuhës angleze dhe asaj shqipe si dhe do të shpjegojmë se përse sistemet rasore të këtyre dy gjuhëve funksionojnë sipas rregullave të caktuara, herë të përbashkëta (universalet gjuhësore) herë për dukuri të njëjta gjuhësore kërkohet përdorimi i rregullave të ndryshme (parametrat gjuhësore). Theksojmë se ky modul përbën një prej moduleve më të rëndësishme e gjithpërfshirëse, pasi për të analizuar përndarjen e sintagmave emërore në strukturën e fjalisë sipas teorisë së rasës i referohemi edhe moduleve të tjera: Teoria e Lidhjes dhe Drejtimit, Teoria e Rasës, Teoria e Roleve Tematike si dhe Teoria e Kontrollit, tërësia e të cilave përbën të ashtquajturën gramatikë gjenerative. Është i dukshëm fakti që sistemi rasor i të dyja gjuhëve ka tërhequr vëmendjen e studiueve qysh në lashtësi, gjë që përcaktohet më tej edhe nga evoluimi në vazhdimësi i mendimit teorik mbi këtë kategori dhe pasurimi i saj më ide të reja.

---

<sup>74</sup> Po aty, fq 53

Më hollësisht gjatë këtij punimi do të synohet studimi i kategorisë së rasës, si dhe modeli i caktimit rasor të të dyja gjuhëve të cilat kanë ndjekur rrugë të ndryshme zhvillimi duke rezultuar sot, njëra si gjuhë sintetiko-analitike (gjuha shqipe) dhe tjetra si gjuhë analitike (gjuha angleze). Si rezultat edhe zhvillimi i kategorisë së rasës i është nënshtruar ndryshimeve të thella duke u shndëruar nga një rasë dikur eptimore në rasë abstrakte. Për këto arsye dhe gjithashtu për probleme të tjera që do të dalin rrugës shpesh do të na duhet t'i referohemi edhe përfaqësimeve rasore të hershme. Pra, teoria që do të zbatohet në këtë punim edhe pse operon me koncepte dhe ide të reja (ato të gramatikës gjenerative), për arsye se sistemi rasor në përgjithësi përbën një burim të pashtershëm problemesh, nuk shfaqet tërësisht e shkeputur nga trajtimi tradicional i rasës.

### ***3.3 TEORIA E RASËS SIPAS KËNDVËSHTRIMIT GJENERATIVIST RASA MORFOLOGJIKE PËRKUNDREJT RASËS ABSTRAKTE***

Teoria e rasës përbën një nga teoritë që bën të mundur shpjegimin e disa prej veçorive të SE dhe përfshirjen në gramatikën gjenerative të konceptit tradicional të rasës. Ekzistojnë tre drejtime kryesore të studimit të rasave të cilat pasqyrojnë edhe evolucionin e zhvillimit të mendimit teorik për rasën<sup>75</sup>:

- *Analiza tradicionale.* Tradicionalisht termi rasë i referohet formave të ndryshme që emri merr në strukturën e fjalisë. Gjithashtu po sipas kësaj analize rasa trajtohet si shprehje e një numër funksionesh ose kuptimesh.
- *Analiza e Hjelmslevit dhe Jakobsonit,* të cilët i shohin rasat si pjesë të një sistemi ku secila prej tyre ka një kuptim abstrakt të përgjithshëm, i cili konkretizohet gjatë përdorimit të emrit në fjali në kundërvënje opozicionale me kuptimet e tjera rasore.
- *Analiza bashkëkohore* e cila e shikon rasën si një kategori abstrakte universale që ekziston, pavarësisht nga gjithë mjetet e shprehjes së saj si: eptimi, rendi i fjalëve etj.

---

<sup>75</sup> Buxheli L., *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë 2007, fq 42-61

Kur flitet për rasë në gramatikën gjenerative, i referohemi asaj që njihet si rasë abstrakte. Për ta kuptuar më mirë këtë term dhe për ta dalluar atë nga ajo që në gramatikën tradicionale njihet si rasë morfologjike, do ti referohemi disa shembujve të ofruar nga **L. Heageman**<sup>76</sup>.

*Shembull*

- 89.a The thief attacked the old man
- 89.b That the thief attacked the old man is horrible.
- 89.c For the thief to attack the old man would be horrible
- 89.d Hajduti sulmoi burrin plak.
- 89.e Që hajduti sulmoi burrin plak është e tmershme.
- 89.f Për hajdutin të sulmonte burrin plakë ishte e tmershme

Në këta shembuj folja “*sulmoj*” në gjuhën shqipe dhe folja “*attack*” në gjuhën angleze caktojnë dy role tematike:

- a. rolin tematik të brendshëm SE “*the old man*” dhe “*burrin plak*”
- b. rolin tematik të jashtëm SE “*the thief*” dhe “*hajduti*”

Nëse krahasojmë përbërjen fonetike të SE argumente (i brendshëm/ i jashtëm) të shembujve në gjuhën shqipe me ato në gjuhën angleze vërejmë se SE argumente në gjuhën angleze u mungon markimi rasor morfologjik të cilin gjuha shqipe e ka të mirëdiferencuar.

Në vijim të argumentimit, SE argumente të mësipërme do t’i zëvendësojmë me përemra për të bërë të mundur dallimin që ekziston midis dy SE në përbërjen e secilës prej fjalive.

*Shembull*

- 90.a He attacked him
- 90.b That he attacked him is horrible
- 90.c For him to attack him would be horrible.
- 90.d Ai sulmoi atë
- 90.e Që ai sulmoi atë, është e tmershme

Në varësi të pozicionit në fjali përemri<sup>77</sup> merr forma të ndryshme. Si argument i brendshëm i foljes përemri merr formën “*him; atë*” që në gramatikën tradicionale njihet me termin rasë kallëzore. Si argument i jashtëm i foljes përemri merr formën “*he; ai*” dhe në

---

<sup>76</sup> Heageman, L., *Introduction to government and binding theory*. Cambridge University Press 1991, fq. 141-145

<sup>77</sup> Përdoret përemri për të bërë të mundur dallimin e formave rasore në fjalitë e gjuhës angleze për arsye se kategoria gramatikore e emrit në këtë gjuhë nuk ka një sistem rasor fonetiksht të dallueshëm.

ndërtime të caktuara “*him*” (në 89.c), ku forma e parë përemërore në gramatikën tradicionale përbën rasën emërore dhe forma e dytë përemërore përbën rasën kallëzore.

Pëveç dy rasave të mësipërme në gjuhën angleze ekziston edhe një formë e tretë rasore e cila përbën rasën gjinore.

*Shembull*

91.a The villager’s goat was too big

Dhia e fshatarit ishte shumë e madhe

91.b His goat was too big.

Dhia e tij ishte shumë e madhe

Qëllimi i këtyre shembujve është të nxjerrim në pah se anglishtja duke qenë një gjuhë analitike, (gjuhë pa fleksion) nuk ka forma rasore të diferencuara, pra nuk ka një sistem rasor aq të pasur sa gjuha shqipe. Realizimi morfologjik i rasave (karakteristikë e gjuhës shqipe) të emrave në gjuhën angleze kufizohet vetëm në rasën gjinore, e cila është e diferencuar plotësisht. Duke u nisur nga këto fakte mund të mendohet se anglishtja, ashtu si edhe disa gjuhë të tjera, përbën një gjuhë pa rasa, mendim ky i papranueshëm. Edhe pse ajo nuk disponon një sistem rasor të plotë, kjo nuk do të thotë se ajo nuk ka rasë.

Vetë Chomsky citon: “*In some languages, Case is morphologically realized, in others not, but we assume that it is assigned in a uniform way whether morphologically realized or not*”<sup>78</sup>

Në këtë kontekst gjuhëtarët, të shtyrë edhe nga mungesa e caktimit rasor morfologjik në disa gjuhë, e konsideruan si domosdoshmëri lindjen dhe përdorimin e një koncepti më të përgjithshëm të njohur si rasë abstrakte. Si rrjedhim rasa morfologjike u konsiderua si një prej mjeteve të realizimit të rasës abstrakte, e cila është një parim universal që ka të bëjë me funksionet e sintagmave në fjali.

Caktimi rasor ose më saktë caktimi i rasës abstrakte të quajtur ndryshe si rasë pozicionale ose konfiguracionale<sup>79</sup> përbën një prej moduleve kryesore të gjuhësisë gjenerative, atë të Teorisë së Rasës. Teoria e rasës ka dy aspekte kryesore, së pari, caktimin e rasës vetëm SE me përmbajtje fonetike dhe së dyti parimin e filtrit rasor. Sipas aspektit të parë të gjitha sintagmat emërore të realizuara fonetikiisht tradicionalisht realizojnë një numër tiparësh formale si ato të

---

<sup>78</sup> Cook V. J. and Newson M. *Chomsky’s Universal Grammar*, Third edition, Blackwell Publishing 2007, fq 146

<sup>79</sup> Buxheli L. *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2007, fq 53-54



numrit, gjinisë dhe trajtës. Këtyre tipareve u shtohet edhe tipari gramatikor i rasës (pra rasa shihet si një tipar gramatikor i emrit që realizohet brenda lidhjes së drejtimit), ku të gjitha bashkë i mbishtrohen kuptimit leksikor. Por në gjuhësinë gjenerative tipari gramatikor i rasës ka një ndryshim thelbësor nga tiparet e tjera gramatikore të emrit.

Tipari gramatikor i rasës shihet si një tipar i painterpretueshëm i cili nuk lidhet me kuptimin leksikor të emrit, kurse tiparet e tjera gramatikore në një mënyrë ose tjetër lidhen me këtë të fundit<sup>80</sup>.

Pra, tiparet e rasës ndryshe nga ato të numrit apo gjinisë trajtohen vetëm si mjet për shprehjen e lidhjeve sintaksore nënrenditëse të emrave dhe për përmbushjen e një funksioni sintaksor të caktuar

Aspekti i dytë i Filtrit të Rasës përbën një parim universal përsa i përket caktimit rasor në të gjitha gjuhët. Chomsky dhe Lasnik (1977)<sup>81</sup> propozuan një numër filtrash sipërfaqësorë për ta bërë sa më të dukshëm distribucionin e SE në strukturën e fjalisë, por Vergnaud (1982)<sup>82</sup>, pasi i analizoi këto filtra të caktimit rasor, i unifikoi nën emërtimin e Filtrit të Rasës.

### **Filtri i Rasës**

*1. Çdo sintagmë emërore e shprehur fonetiki duhet të jetë e paisur me rasë*

*2. Çdo SE për të marrë rasë duhet të ketë një caktues rasor. Si caktues rasor shërben koka strukturore e një sintagme me vlerën e një projekcioni maksimal, e cila i cakton rasë një SE në kuadrin e lidhjes së drejtimit. (si kokë strukturore rasë caktuese shërbejnë kategoritë leksikore [-E] ku përfshihet kategoria e foljes dhe parafjalës)*

Pra sipas pikës 2 të Filtrit të Rasës një kategori X rasë caktuese i cakton rasë një SE nëse:

- a. kjo kategori është kokë strukturore  $X^0$
- b. është rasëcaktues
- c. kategoria  $X^0$  drejton një SE

---

<sup>80</sup> Te botimi “Ç’është gramatika gjenerative” të G. Grafit (2008, përkthyer nga R. Memushaj, fq. 79-83) analizohen tiparet e interpretueshme dhe të painterpretueshme. Sipas këtij gjuhëtari Programi Minimalist dallon tre lloj tiparesh: -tipare fonetike që interpretohen në ndërfaqësin fonetik; tipare semantike që përfaqësohen në ndërfaqësin semantik dhe tipare të painterpretueshme (ku futet tipari i rasës) që nuk interpretohen në asnjë ndërfaqës meqë u përkasin tipareve që nuk i shtojnë asnjë element të ri interpretimit të fjalisë. Si rezultat i procesit Merge (bashkim i një objekti sintaksor (përbërësi) me një objekt tjetër sintaksor me tipare të interpretueshme, përputhja e tiparit të painterpretueshëm me atë të interpretueshëm bën që ky i fundit të verifikojë (check-anglisht) tiparin e painterpretueshëm duke e eliminuar atë. Kjo procedurë e verifikimit të tipareve të painterpretueshme përbën një rast të lidhjes së përgjithshme Agree e cila vendos një lidhje midis një zëri leksikor *a* dhe një tipari T brenda një hapësire të kufizuar kërkimi.

<sup>81</sup> Chomsky N., *The Minimalist Program*, 1995, The MIT Press, fq 110-124

<sup>82</sup> Po aty (Këto filtra merrnin kryesisht në analizë pozicionin e subjektit të fjalive infinitive.)

Si në gjuhën angleze dhe në atë shqipe<sup>83</sup> caktuesi rasor duhet të përmbushë dy kritere: Së pari midis tij dhe SE që merr rasë nuk duhet të ketë asnjë projektion tjetër maksimal (SX), për arsye se ky i fundit do të shërbejë si barrierë për caktimin rasor.

Së dyti, caktuesi rasor për t'i caktuar rasë një SE nuk duhet vetëm ta drejtojë, por edhe ta komandojë<sup>84</sup> atë.

Filtri i rasës zbatohet mbi të gjitha SE të shprehura fonetakisht duke eliminuar ato të cilave nuk u është caktuar një rasë abstrakte (PRO kategori e zbrazët). Për të shpjeguar filtrin e rasës gjuhëtarët janë munduar ta lidhin atë me dukuri të tjera gramatikore. Një nga hipotezat bazohet në vëzhgimet lidhur me kriterin tematik, sipas të cilit çdo SE argument i duhet caktuar një dhe vetëm një rol tematik. Ideja qëndron në faktin se folja u cakton rol tematik SE të cilat bëhen të dukshme dhe, që ato të bëhen të dukshme duhet t'u caktohet një rasë abstrakte. Sipas këtij këndvështrimi caktimi i rasës nuk përbën një dukuri të pavarur, por ajo rrjedh nga kriteri i dukshmërisë së SE. Kjo veçori lidhet në vetvete me teorinë theta, në mënyrë që një SE të pranohet si argument i foljes duhet të bëhet e dukshme. SE të padukshme nuk mund t'u caktohet rol tematik. **Baker (1988)**<sup>85</sup> propozon zëvendësimin e kriterit të dukshmërisë me kriterin e identifikimit morfologjik ose m - identifikim.

Sa më sipër, gjatë trajtimit të *Teorisë e Roleve Tematike* pranuar se emrat dhe mbiemrat caktojnë role tematike, por ndryshe nga foljet, që u caktojnë role tematike SE, emrat dhe mbiemrat u caktojnë role tematike SP.

#### *Shembull*

- 92.a (Agimi është) i shqetësuar për një mikun tim.
- 92.b Shqetësimi për një mikun tim.
- 92.c John is envious of his friend
- 92.d John's envy of his friend
- 93.a \*(Agimi është) i shqetësuar një mikun tim.
- 93.b \* Shqetësimi një mikun tim.
- 93.c \* John is envious his friend
- 93.d \* John's envy his friend

---

<sup>83</sup> Buxheli L., *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, 2007, fq 55-57

<sup>84</sup> Sipas kushtit të komandimit një një A komandon një një B nëse dhe vetëm nëse A nuk dominon B dhe B nuk dominon A; vetëm dhe vetëm nëse nyja e parë degëzuese C që dominon A dominon edhe B (Memushaj 2008).

<sup>85</sup>

Në shembujt (92.a; 92.b; 92.c dhe 92.d) emrat dhe mbiemrat u caktojnë rolin tematik të temës SP “*për një mikun tim; of his friend*”. Në shembujt (93.a, 93.b, 93.c dhe 93.d) mungesa e parafjalës e kthen fjalinë nga gramatikore në jogramatikore kjo për arsye se emrat dhe mbiemrat nuk mund të caktojnë rasë, gjë që bën që SE “*një mikun tim; his friend*” të mos marrë rasë dhe si e tillë të shkelet Filtri i Rasës. Arsyeja për të cilën parafjala “*për dhe of*” ndërvendosen, është ajo e mosshkeljes së Filtrit të Rasës. Duke qënë se, vetëm kategoritë leksikore F dhe P caktojnë rasë, në shembujt e mësipërm emrat dhe mbiemrat u caktojnë role tematike SP, koka P<sup>0</sup> e të cilave u cakton rasë SE.

Në gjuhën angleze kemi gjithashtu shembuj ku ndërfutja e parafjalës “*of*” nuk mund ta konvertojë një fjali jogramatikore në gramatikore.

*Shembull*

94.a \*I am proud of Bill to be here.

94.b \*Bill believed sincerely of Mary to be here.

Këto ndërtime të gjuhës angleze mbeten jogramatikore edhe pas futjes së parafjalës –of, pasi kjo e fundit futet në ato ndërtime, në të cilat si kokë leksikore drejtuese do të shërbejë një kategori e karakterizuar nga tipari [+E] (E ose Mb).

## ***PËRFUNDIME***

Emri në fjali përdoret në funksione të ndryshme sintaksore në varësi të së cilave ai merr forma të ndryshme rasore. Këto forma rasore të ndryshme shprehin lidhjet e sintagmave si dhe ndikojnë në distribucionin e tyre në strukturën e fjalisë . Sistemet rasore ndryshojnë nga gjuha në gjuhë, por edhe brenda së njëjtës gjuhë në varësi të periudha të ndryshme të zhvillimit gjuhësor. Sistemi rasor i gjuhës angleze njih aktualisht katër forma rasore të diferencuara vetëm për kategorinë e përemrave, ndërsa gjuha shqipe karakterizohet nga një paradigmë lakimi e pasur në mbaresa rasore dhe e përbërë nga pesë forma rasore të mirëdiferencuara.

Përsa i përket gjuhës angleze pranojmë ekzistencën e katër rasave kryesore: emërore (Nom), kallëzore (Acc), dhanore (Dat) dhe gjinore (Gen), ndërsa në gjuhën shqipe katër rasave të mësipërme i shtohet edhe një rasë e pestë, rrjedhorja.

Mendimi bashkëkohor për rasën sipas konceptit gjenerativist ndahet në dy faza:

Faza e parë – deri në fund të viteve 80’ gjatë së cilës koncepti gjenerativist për rasën nuk shfaqet i shkëputur nga ai tradicional.

Faza e dytë – vitet 90’ e këtej, ku me futjen e programit minimalist koncepti gjenerativist për rasën shkëputet nga ai tradicional, pasi mendohet se sintagma emërore hyn në strukturën e fjalisë e veshur me tipare rasore të cilat duhet të përshtaten diku në pemën strukturore që përmban sintagmën emërore plotësuese.

Si rrjedhim dy janë edhe detyrat kryesore të gjuhëtarit: të rregullojë distribucionin e SE në strukturën e fjalisë si dhe bëjë interpretimin kuptimor të SE. këto detyra lidhen me dy modulet kryesore gjenerativiste, përkatësisht Teorinë e rasës dhe Teorinë e roleve tematike.

Gramatika gjenerative i referohet caktimit të rasës abstrakte e cila ngërthen në vetvete edhe gjuhët me realizim morfologjik. Në këtë kontekst Chomsky (1995) citon: *“In some languages, Case is morphologically realized, in others not, but we assume that it is assigned in a uniform way whether morphologically realized or not”*.

Teoria e rasës lidhet kryesisht me Filtrin e Rasës

### **Filtri i Rasës**

1. Çdo sintagmë emërore e shprehur fonetikisht duhet të jetë e paisur me rasë

***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

---

2. Çdo SE për të marrë rasë duhet të ketë një caktues rasor. Si caktues rasor shërben koka strukturore e një sintagme me vlerën e një projekzioni maksimal, e cila i cakton rasë një SE në kuadrin e lidhjes së drejtimit.

## KREU IV

### RASA EMËRORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ

#### 4.1 NJOHURI TË PËRGJITHSHME MBI RASËN EMËRORE

##### 4.1.1 KLASIFIKIMI TIPOLOGJIK I RASËS EMËRORE

Rasa emërore është konsideruar si rasë e një tipi të veçantë e cila, përveç formës së dubluar (një për trajtën e shquar dhe një për trajtën e pashquar), iu kundërvihet të gjitha rasave të tjera si kuptimisht ashtu dhe funksionalisht.

Kjo rasë, në traditën gjuhësore qoftë kjo e huaj apo shqiptare, i nënshtrohet një klasifikimi tipologjik si më poshtë:

- a. **Rasa emërore si rasë e referencës së pastër.** Ky klasifikim bëhet i ditur nga emërtimi që kjo rasë ka marrë qysh në periudhat e hershme të zhvillimit të studimeve gjuhësore si “kuantjoretore<sup>86</sup> ose emnore”. Ky klasifikim mbështetet në grupimin e rasave të emrit sipas aftësisë që ato kanë në realizimin e funksionit quajtës ose emërtues të cilët përbëjnë edhe tiparet dalluese të rasës emërore. Funksioni quajtës lidhet ngushtë me të qënë të ose të përcaktuarit të kësaj rase si rasë e drejtë në ndryshim me rasat e tjera që futen në grupin e rasave të zhdrejta. Selman Riza<sup>87</sup> duke e krahasuar rasën emërore me formën e pashtjelluar paskajore (e cila nuk përfshihet në paradigmen e zgjedhimit foljor) pretendon mospërfshirjen e kësaj rase në paradigmen e lakimit emëror. Ky pretendim i ka rrënjët më të hershme, në traditën e vjetër greke. Përkatesisht, Blake (1994)<sup>88</sup> duke iu referuar Aristotelit thekson se emërorja përfaqëson thjesht emrin dhe jo një formë rasore të tij, ndërsa format e tjera njihen si rasa të emrit. Ky konceptim lidhet me funksionin quajtës të emërores i cili konsiston në dhënien e një informacioni të njohur si dhe në emërtimin e një entiteti. Ky përshkrim i rasës emërore vazhdon të mbizotërojë edhe në gjuhësinë e

---

<sup>86</sup> S. Frashëri “*Shkronjëtores e Gjuhës Shqipe*” 1986 sipas L. Buxhelit “*Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*” 2007, fq. 67

<sup>87</sup> L. Buxhelit “*Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*” Tirane, 2007, fq 68

<sup>88</sup> Blake sipas L. Buxhelit “*Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*” Tirane, 2007, fq 68

sotme bashkëkohore nën një emërtim të ri sipas së cilit rasa emërore konsiderohet si rasë e referencës së pastër.

b. **Rasa emërore si rasë gramatikore ose sintaksore.** Ky klasifikim tipologjik mbështetet kryesisht në funksionin gramatikor, përkatësisht atë sintaksor. Si në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe rasa emërore shihet si në rasë gramatikore ose më saktë si një rasë sintaksore, pasi funksioni i saj gramatiko-sintaksor është ai i shprehjes së kryefjalës (subjektit) të fjalisë.

c. **Rasa emërore si formë gramatikore.** Ky klasifikim i tretë tipologjik mbështetet në formën rasore dhe kuptimin e saj gramatikor. Rasa emërore në gjuhët eptimore del me një formë të veçantë gramatikore të realizuar nëpërmjet mbaresave rasore (të cilat në gjuhën shqipe janë të dyfishta: e shquar/e pashquar). Në këto gjuhë emërorja shihet si një rasë që u kundërvihet rasave të tjera për shkak të formës dhe kuptimit të saj gramatikor.

Ky klasifikim i trefishtë tipologjik i rasës emërore përkundrejt rasave të tjera, mbështetur në raportet kuptimore dhe funksionet sintaksore, edhe pse është i përligjur, nuk mjafton për të shpjeguar distribucionin e emrit në këtë rasë.

Pra, funksioni quajtës nuk mjafton për të karakterizur këtë rasë si një rasë e një tipi të veçantë. Për më tepër, klasifikimi i saj i dytë si rasë gramatikore, edhe pse provon lidhjen e ngushtë që ekziston midis emrit në rasë emërore dhe funksionit sintaksor të subjektit, nuk mjafton për të shpjeguar se si realizohet ky caktim rasor. Nga ana tjetër, përse i përket klasifikimit të saj sipas formës gramatikore, theksojmë se ekzistojnë gjuhë eptimore në të cilat rasa emërore paraqitet pa mbaresa rasore që do të thotë se nuk mund ta trajtojmë formën rasore të shkëputur nga funksioni sintaksor.

Duke iu rikthyer edhe një herë klasifikimit të dytë tipologjik, përgjatë të cilit pranuar si funksion kryesor të rasës emërore atë gramatiko-sintaksor, theksojmë se kjo rasë si në traditën gjuhësore të anglishtes dhe në atë të gjuhës shqipe ( në gjuhën shqipe me këtë formë rasore mund të përfaqësohet edhe përcaktori kallëzuesor i kryefjalës) përfaqëson kryefjalën/ subjektin e fjalisë.

#### **4.1.2 RASA EMËRORE SI RASË E SHPREHJES SË SUBJEKTIT**

Termi subjekt/kryefjalë është thelbësor si në logjikën Aristoteliane edhe në traditën perëndimore të të menduarit mbi filozofinë dhe gramatikën. Megjithatë, gjatë kalimit nga “Teoria Standarte” dhe “Teoria Standarte e Zgjeruar” drejt “Teorisë së Parimeve dhe Paramentrave” këtij nocioni nuk i është kushtuar vëmendja e duhur, pasi në këto teori nuk hasim ndonjë përkufizim konkret lidhur me veçoritë karakterizuese të tij. Për më tepër, vihet re një rindërtim i informacionit të mbledhur mbi subjektin i cili përfshin një sërë përkufizimesh<sup>89</sup> si:

- Subjekti përbën pozicionin më të lartë në strukturën e fjalisë.
- Subjekti përfaqëson argumentin e jashtëm.
- Subjekti merr rasë emërore.
- Subjekti përshtatet me foljen kallëzues.
- Subjekti shërben si paraprijës në rast lidhjesh anaforike.

Studiuesi Jim McCloskey<sup>90</sup> gjatë trajtimit të dukurive që përfaqëson subjekti në strukturën e fjalisë thekson se, duke qënë se këto dukuri përfaqësojnë një shumëllojshmëri informacioni ai na ofron në ristrukturim të kësaj vorbulle informacioni duke përfshirë: informacionin kategorial (subjekti është emëror); informacionin që lidhet me caktimin e roleve tematike (subjekti është veprues/agjent); informacionin hierarkik (rëndësia e subjektit në fjali reflektohet në lidhjet vetvetore); informacionin morfologjik (subjektit i caktohet rasë emërore dhe përshtatet me foljet vetore)

Po sipas këtij studiuesi termi subjekt përfshin një numër dukurish:

- Ai është mbartës i një numri të caktuar rolesh tematike, kryesisht atij të vepruesit.
- Është më i dukshëm se çdo argument tjetër i foljes.
- Subjekti markohet/shënjohe si formalisht, morfologjikisht edhe sipas pozicionit.
- Çdo fjali duhet të përmbajë subjekt të shprehur fonetikut (kjo nuk përbën një parim të përgjithshëm për të gjitha gjuhët, pasi për gjuhët me eptim si shqipja ai mund të mos

---

<sup>89</sup> Këto përkufizime do të gjejmë të trajtuara në detaje në artikujt e mëposhtëm:

Baker M. C. “*Thematic roles and syntactic structure*” kapitull te Heageman L. “*Elements of grammar. Handbook in generative syntax*” Cambridge University Press, 1997, fq 72-137;

McCloskey J. “*Subjecthood and subject position*” kapitull te Heageman L. “*Elements of grammar. Handbook in generative syntax*” Cambridge University Press, 1997 fq. 197-235

<sup>90</sup> Po aty



shprehet fonetikisht, por prania e tij është e domosdoshme dhe e përfaqësuar nga eptimi i foljes kallëzues.)

- Subjekti është kryesisht një kategori emërore [+ E; -F].
- Të qënë subjekti ka rëndësi në sistemin e përfaqësimit të kategorive emërore.

#### **4.2 CAKTIMI I RASËS EMËRORE NË STRUKTURËN E FJALISË**

Qëllimi kryesor i këtij kreu do të jetë identifikimi i caktuesit të rasës emërore si dhe i modelit që ky caktim rasor përfaqëson. Para se të kalojmë në trajtimin e këtyre dy çështjeve kryesore (pika kyç të këtij kreu), do të analizojmë strukturimin e sintagmave përbërëse të fjalisë bazuar në marrëdhëniet që këto të fundit vendosin midis tyre. Në varësi të marrëdhënieve që sintagmat vendosin në strukturën e fjalisë, atyre u caktohet roli tematik dhe rasa.


Gjithashtu për të reflektuar këto marrëdhënie të vendosura midis përbërësve të një fjalisë propozohet që paraqitja strukturore e fjalisë të organizohet në tre rrafsh të ndryshme:

- **Rrafshin leksikor (SF)**<sup>91</sup> me të cilin do të kuptojmë atë rrafsh të drejtuar nga folja i cili identifikohet me sintagmën foljore dhe është përgjegjës për caktimin e roleve tematike. Dihet që foljet në bazë të valencës së tyre mund të marrin një numër të caktuar argumentesh (pra, mund të jenë njëvalente, dyvalente ose trevalente), ku secilit prej tyre u caktohet një rol tematik. Rolet tematike i ndajmë në dy grupe: role tematike të brendshme, të cilat caktohen drejtpërdrejt nga folja dhe janë përkatësisht roli tematik i temës dhe përfituesit, si dhe role tematike të jashtme, që caktohen nga folja në bashkëpunim me argumentin e saj të brendshëm, përkatësisht roli tematik i vepruesit.
- **Rrafshin eptimor (SEpt)**<sup>92</sup>. Në këtë rrafsh treguesve morfosintaksorë u jepet vetëm përfaqësim sintaksor. Ky rrafsh drejtohet nga koka funksionale dhe është përgjegjës për liçensimin e treguesve argumentalë flektivë si rasa dhe përshtatje
- **Rrafshi i komplementuesit (SK)**<sup>93</sup>. Ky rrafsh drejtohet nga një morfemë e lirë funksionale duke përfshirë topikën dhe elementët operatorë si përemrat pyetës, përemrat lidhorë, lidhëzat, elementët e fokalizuar etj.

---


<sup>91</sup> Rizzi L., "The fine structure of the left periphery" kapitull te Heageman L. "Elements of grammar. Handbook in generative syntax" Cambridge University Press, 1997, fq 281

<sup>92</sup> Heageman L. "Elements of grammar. Handbook in generative syntax" Cambridge University Press, 1997, fq 4-6



Në vitet 1980<sup>94</sup>, si model përfaqësues i strukturës së fjalisë u pranua SEpt, propozim ky që u bazua në dy pohime: së pari, fjalia përbën një projektion mbi informacionin eptimor dhe së dyti, ky projektion përbën një projektion të rregullt X'. Ç'ka është e përbashkët për të gjitha ndërtimet SEpt lidhet me pozicionin unik të realizimit të SE subjekt, pra me pozicionin e specifikuesit të projektionit sintagmë eptimore (Spec SEpt).

**Skema 24**



Duke qënë se, në përbërje të rrafshit eptimor përfshihet gjithashtu edhe rrafshi leksikor SF, përbërësi emëror (në këtë rast SE subjekt e fjalisë) i cili gjenerohet në pozicionin e specifikuesit të projektionit SEPT, do të komandojë të gjitha pozicionet e tjera gjeneruese të projektionit SF, përfaqësues i rrafshit leksikor. Ky komandim nuk bën gjë tjetër veçse siguron ose mbështet rëndësinë e SE subjekt të fjalisë përkundërt gjithë argumenteve të tjerë. Pozicioni i specifikuesit është i vetmi pozicion i cili është gjithmonë i gjeneruar; është një pozicion unik, pasi është i vetmi pozicion argumenti ekzistenca e të cilit licensohet edhe në mungesë të caktimit


<sup>93</sup> Po aty

<sup>94</sup> McCloskey J. "Subjecthood and subject position" kapitull te Heageman L. "Elements of grammar. Handbook in generative syntax" Cambridge University Press, 1997 fq. 197-235

të roleve tematike (rasti i ekspletivëve të gjuhës angleze); është i vetmi pozicion i cili mund të shërbejë edhe si kokë për zhvendosje argumentesh (lëvizja e SE).

Nisur nga nevoja për t'i ndarë dhe identifikuar funksionet përkatëse të rrafshit leksikor dhe atij eptimor lindi **Hipoteza e Subjektit të Brendshëm (HSB)**<sup>95</sup> sipas së cilës çdo SE argument fillimisht do të duhet të gjenerohet brenda rrafshit leksikor për të marrë rol tematik. Në shumë gjuhë, për të mos thënë në të gjitha, SE subjekt (sipas kësaj hipoteze) do të gjenerohet në një pozicion të ulët specifikuesi, pra SpecSF, ku kjo SE do të pajiset me rolin tematik përkatës dhe pas përmbushjes së procesit të caktimit të rolit tematik, ajo do të duhet të zhvendoset drejt një pozicioni specifikuesi më lart në skemën X'. Një pozicion i tillë është ai i specifikuesit të projeksonit SEpt, projeksim ky përfaqësues i rrafshit eptimor<sup>96</sup> dhe përgjegjës në licensimin e treguesve morfosintaksorë. Ky pozicion mbërritës i SE subjekt (SpecSEpt) përbën një pozicion të prejardhur.

### **Skema 25**



Përsa i përket HSB (Hipoteza e Subjektit të Brendshëm) ajo përfshin dy klasa argumentesh<sup>97</sup> si më poshtë:

- **Lower Origin Arguments** (argumente të një origjine më të ulët). Argumentet subjekt të kësaj klase të cilat karakterizohen nga zhvendosja SpecSF drejt SpecSEpt e kanë të

<sup>95</sup> McCloskey J. "Subjecthood and subject position" kapitull te Heageman L. "Elements of grammar. Handbook in generative syntax" Cambridge University Press, 1997 fq 203-204

<sup>96</sup> Duke qënë se një pjesë e rëndësishme e rrafshit eptimor përbëhet nga projeksimi në të cilin kontrollohet binomi kryefjalë – kallëzues, kjo marrëdhënie kërkon përfaqësimin e SE nga një SDet. Prandaj kur do të flasim për SE dhe lëvizjen e kësaj të fundit shkaktuar nga kërkesa për të kontrolluar treguesit eptimorë do të nënkuptohet gjithmonë përfaqësimi i SE nga SDet

<sup>97</sup> Po aty.

domosdoshme vendosjen e një ure lidhëse midis pozicionit të origjinës dhe atij të prejardhur

- **Lower Position Argument** (argumente te një pozicioni më të ulët). Kjo klasë përfshin ndërtime të veçanta të disa gjuhëve si dhe ato gjuhë që karakterizohen nga rendi VSO/Folje-Subjekt-Objekt për të cilat argumentohet se subjekti nuk zhvendoset nga SpecSF drejt SpecSEpt.

Sipas hipotezës së mësipërme SE subjekt si në strukturën sintaksore të gjuhës angleze dhe në atë të gjuhës shqipe përfshihet në klasifikimin e parë, pasi gjenerimi fillestar i kësaj SE është pozicioni Spec SF (pozicion ky i argumentit të jashtëm). Më pas ajo do të zhvendoset drejt pozicionit të prejardhur SpecSEpt. Kjo zhvendosje lidhet me dukurinë e lëvizjes  $\alpha$  nën ndikimin e së cilës krijohet një **urë lidhëse** midis këtyre dy pozicioneve specifikuasi.

Sipas Mc Closkey (1997) këtë lidhje e vërtetojnë më së miri shembujt e mësipërm marrë nga gjuha frënge si gjuhë flektive me rend të lirë të sintagmave në fjali:

*Shembull*


**95.a** *Toutes les filles* ont gagné le prix.

Të gjitha vajzat fituan çmimin.

**95.b** *Les filles* ont *toutes* gagné le prix

Vajzat të gjitha kanë fituar çmimin.

**Skema 26**



Në shembullin 95.b kuantifikuesi "toutes" pozicionohet në një pozicion specifikuasi më të ulët se SE kryefjalë "les filles". Pretendohet se si kuantifikuesi edhe SE kryefjalë në strukturën e thellë

***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

gjenerohen në të njëjtin pozicion specifikuuesi të SF në të cilin u caktohet roli tematik i vepruesit. Në shembullin 95.a ky përbërës emëror “*toutes les filles*” lëviz si një e tërë drejt pozicionit SpecSEpt, ndërsa në shembullin 95.b drejt po këtij pozicioni zhvendoset vetëm SE “*les filles*” me qëllimin e vetëm atë të caktimit të rasës emërore. Në përfundim të kësaj lëvizjeje (për shembullin 95.b) në pozicionin bazë të gjenerimit mbetet i pazhvendosur kuantifikuesi “*toutes*”.

Në gjuhën angleze një dukuri e tillë mbështetet nga strukturat e mëposhtme subjekti i të cilave përfaqësohet nga një ekspletiv (gjë që nuk haset në gjuhën shqipe pasi në ndërtimet me SE subjekt të munguar është eptimi foljor i kësaj gjuhe që e bën të dukshëm).

*Shembull*


96.a. ***Three people*** were arrested at the airport.

Tre njerëz u arrestuan në aeroport

96.b. ***There*** were ***three people*** arrested at the airport.

[ekspletiv] u arrestuan tre njerëz në aeroport.

**Skema 27**



Vlen të theksojmë se, për SE subjekt të fjalisë nuk kemi një pozicion unik në të cilin do të licensoheshin të gjithë treguesit (qoftë ata leksikorë qoftë atë morfosintaksorë), por përkundrazi këta tregues licensohen përgjatë një zinxhiri të krijuar midis pozicioneve bazë dhe atyre të prejardhuara.

### **4.3 PËRCAKTIMI I CAKTUESIT RASOR TË RASËS EMËRORE**

Eptimi foljor përbën një tregues dallues të vlefshëm gjuhësor, edhe pse realizimi morfologjik i tij nuk është i njëjtë për gjuhë të ndryshme. Për këtë arsye paradigma foljore ka tendencë të ndahet në dy klasa: atë të foljeve të shtjelluara (kategoria e foljes në gjuhën shqipe karakterizohet nga një eptim i pasur, ndërsa kategoria e foljeve të gjuhës angleze nuk shfaq të njëjtën pasuri, përkundrazi ajo karakterizohet nga një eptim i varfër) të markuara nga tiparet morfologjike të mënyrës, kohës dhe vetës të cilat nga ana tjetër bëjnë të mundur përshtatjen subjekt-predikat. Klasa e dytë e foljeve përfshin foljet e pashtjelluara të cilat nuk shfaqin markim morfologjik të mënyrës, kohës dhe vetës si dhe nuk mundësojnë përshtatjen subjekt-predikat.

#### *Shembull*

97.a The boy arrives in the evening

Djali mbërin në mbrëmje.

97.b \*The boy to arrive in the evening.


\* Djali për të mbëritur në mbremje.

Ndërtimet e markuara (\*) 97.b janë jogramatikore, edhe pse ato kanë një SE subjekt të shprehur fonetikisht. Jogramatikaliteti qëndron në faktin se binomi kryefjalë – kallëzues nuk funksionon, pasi si folje kallëzues të këtyre ndërtimeve kemi një formë pashtjelluar, pa eptim.

Në shembujt 97.a, ekzistenca në përbërjen e tyre e një foljeje të shtjelluar me eptim mundëson shfaqjen e treguesve foljorë si dhe përshtatjen e këtyre të fundit me SE subjekt.

Duke qënë se projeksioni SEpt përbën një zgjatim të sistemit foljor si dhe përfaqësohet nga treguesit morfologjikë foljorë, atëherë ky projeksion do të karakterizohet nga tiparet [+ kohë] dhe [+përshtatje] të cilat mundësojnë caktimin e rasës emërore.

**Skema 28**



Tiparet e mësipërme, kryesisht të kohës dhe përshtatjes (vetës) nuk përbëjnë tipare karakterizuese të SF, përkundrazi ato pranohen si tipare dalluese të fjalisë të cilat gramatika gjenerative i trajton si përgjegjëse në caktimin e rasës emërore SE subjekt. Ky propozim bën që fjalia e përfaqësuar strukturalisht nga SEpt dhe e karakterizuar nga tiparet e mësipërme të ketë një strukturë më abstrakte nga sa është pranuar deri në këtë pjesë të punimit. Me strukturim më abstrakt kuptohet një paraqitje në mënyrë të pavarur me projeksione funksionale të diferencuara të tipareve të mënyrës, kohës, vetës dhe përshtatjes, tipare këto karakterizuese të fjalisë. Ky propozim haset për herë të parë nga fundi i viteve ‘80 në punimet e Pollock(1989)<sup>98</sup> dhe Chomsky (1993, 1995)<sup>99</sup> të cilët iu referuan strukturave fjali (SEpt), përkatësisht të gjuhës frënge dhe asaj angleze. Pollock<sup>100</sup>, nisur nga propozimi i Baker (1988)<sup>101</sup>, sipas së cilit folja e gjeneruar fillimisht në pozicionin F<sup>0</sup> duhet të zvendoset drejt pozicionit Ept<sup>0</sup> për t’iu bashkuar tipareve morfologjike (kohë, vetë, numër), përgjithëson se foljet e shtjelluara ndërtohen në mënyrë të prejardhur. Në këtë kontekst, Pollock (1989) duke iu referuar foljeve të gjuhës frënge arsyeton: Folja “*mangait*” formohet nga rrënja “*mange*” + mbaresën “*ait*” të kohës imparfait (e pakryer). Po sipas Pollock (1989) rrënja “*mange*” e foljes e gjeneruar në kokën F<sup>0</sup> duhet të zvendoset drejt kokës Ept<sup>0</sup> për t’iu bashkangjitur mbaresave eptimore. Kjo zvendosje nga koka F<sup>0</sup> drejt

<sup>98</sup> Heageman L. “*Elements of grammar. Handbook in generative syntax*” Cambridge University Press, 1997 fq 6-8

<sup>99</sup> Po aty


<sup>100</sup> Po aty.

<sup>101</sup> Po aty

kokës Ept<sup>0</sup> u konsiderua si një prej karakteristikave dalluese të gjuhëve eptimore ku përfshihet edhe gjuha shqipe. Pra, edhe në gjuhën shqipe folja për të kënaqur kornizën morfologjike nënkategorizuese duhet të zhvendoset drejt kokës Ept<sup>0</sup> si më poshtë:

Folja “*hante*” formohet nga rrënja foljore “*ha*” + mbaresën “*nte*” veta e tretë, numri njëjës, koha e pakryer

**Skema 29**



Përsa i përket gjuhës angleze Pollock (1989) arsyeton se kjo gjuhë, ndryshe nga gjuha frënge, (e për rrjedhojë ndryshe edhe nga gjuha shqipe) e karakterizuar nga eptimi foljor zero nuk mundëson zhvendosjen e rrënjës së foljes nga koka F<sup>0</sup> drejt kokës Ept<sup>0</sup> (kjo bindje e Pollock bie, pasi, edhe pse me një eptim foljor të varfër, gjuha angleze ka mbaresën –s të vetës së tretë njëjës koha e tashme dhe mbaresën –ed të të gjithë vetave të kohës së shkuar). Për më tepër ky studiues propozon uljen e mbaresave eptimore të foljes drejt kokës F<sup>0</sup>. Sa më sipër mbështetet edhe nga fjalitë e mëposhtme, shembuj të gjuhës frënge krahasuar me gjuhën angleze.

*Shembull*

- 98. a Jean ne mange **pas** du chocolate
- 98. b John **does not** eat chocolate.
- 99. a Jean mange **souvent** du chocolate
- 99. b John **often** eats chocolate

Në gjuhën frënge foljet e shtjelluara i paraprijnë si markuesit mohor “pas” edhe ndajfoljes “souvent”, gjë që vërteton ngritjen e kësaj foljeje nga pozicioni bazë drejt një pozicioni më lart në skemën X-bar. Nga ana tjetër, në gjuhën angleze janë markuesi mohor “not” edhe ndajfolja



“often” që i paraprijnë foljes gjë që vërteton se foljet në këtë gjuhë nuk i nënshtrohen operacioneve zhvendosëse.

Ndërtimet mohore të gjuhës shqipe në përbërjen e të cilave hasen edhe ndajfolje, shfaqin sjellje të përafërta me gjuhën frënge dhe angleze.

100.a Joni **nuk** ha çokollatë. *ndërtim i njëjtë me gjuhën angleze (markuesi mohor i paraprin foljes); e kundërta është jogramatikore.*

100.b Joni ha **gjithmonë** çokollatë. *ndërtim i njëjtë me gjuhën frënge (folja i paraprin ndajfoljes); e kundërta është gjithashtu gramatikore.*

100.c Joni **gjithmonë** ha çokollatë. *ndërtim i njëjtë me gjuhën angleze (ndajfolja i paraprin foljes)*

Pra, gjuha shqipe na jep ndërtime me folje të pozicionuar para (që lejon ngritjen e kokës  $F^0$  drejt kokës  $Ept^0$ ) dhe pas (gjë që në parim e pengon ngritjen e kokës  $F^0$  drejt kokës  $Ept^0$ , por që sipas Pollock (1989) janë mbaresat  $Ept^0$  që zbresin drejt kokës  $F^0$ ) ndajfoljeve.

Në vijim argumentojmë se operacionet zbritëse të propozuara nga Pollock (1989), referuar kryesisht ndërtimeve të gjuhës angleze (por që përfshijnë edhe ndërtime të caktuara të gjuhës shqipe) janë problematike dhe të papranueshme për shumë arsye:

Së pari, shkelet parimi i drejtimit sipas së cilit gjatë një operacioni zhvendosës pozicioni pritës i përbërësit të zhvendosur (në këtë rast  $Ept^0$ ) duhet të drejtojë pozicionin e gjurmës, gjë që për operacionet zbritëse është pozicioni i gjurmës që drejton pozicionin e prejardhur pritës.

Së dyti, Pollock (1989), Chomsky (1995) dhe Roberts (1996)<sup>102</sup> argumentojnë se kokat funksionale janë dy llojesh: morfema të lidhura (mbaresa eptimore) të cilat për të kënaqur kornizën morfologjike nënkategorizuese të foljes zhvendosen drejt  $Ept^0$ ; morfema të lira (foljet gjysmëndihmëse) të cilat gjenerohen në kokën  $Ept^0$  dhe nuk lejojnë zhvendosjen e kokës  $F^0$  drejt kokës  $Ept^0$ .

Së treti, Rizzi (1996)<sup>103</sup> e kundërshton Pollock-un (1989) duke sugjeruar zhvendosjen e mësipërme edhe për gjuhën angleze edhe pse kjo është një gjuhë pa eptim. Për të vërtetuar sa më sipër Rizzi (1996) i referohet lëvizjes së SE subjekt nga pozicioni i specifikuesit të projeksionit leksikor SF drejt pozicionit të specifikuesit të projeksionit funksional SEpt. Në këtë kontekst, duke qënë se SE subjekt dhe koka foljore janë në marrëdhënie bashkëreferuese specifikues-kokë,

---

<sup>102</sup> Heagman L., “Elements of grammar” Heagman L. “Elements of grammar. Handbook in generative syntax” Cambridge University Press 1997, fq 19-20

<sup>103</sup> Po aty, fq 39

atëherë kjo marrëdhënie duhet të trashëgohet edhe pas operacionit zhvendosës të SE subjekt. Rrjedhimisht marrëdhëniet e vendosura midis SE subjekt në pozicionin e prejardhur SpecSEpt dhe kokës Ept janë gjithashtu bashkëreferuese të tipit specifikues-kokë. Për këtë arsye Rizzi (1996) propozon ngritjen e kokës foljore drejt kokës eptimore edhe për gjuhë si anglishtja. Ky propozim i Rizzi (1996) mund të pranohet edhe për ndërtimet e gjuhës shqipe në të cilat ndajfolja i paraprin foljes (shembulli 100.c).

Duke iu rikthyer edhe një herë shembujve të mësipërm (98.a/b; 99.a/b dhe 100.a/b/c) Edmonds (1978)<sup>104</sup> vëren se ndryshimi i tyre qëndron në pozicionin që folja zë në strukturën e thellë dhe aftësinë që ajo ka për t'u zhvendosur në strukturën sipërfaqësore.

Për ndërtimet e gjuhës frënge në të cilat foljet i paraprijnë markuesit mohor “*pas*” dhe ndajfoljes “*souvent*” pretendohet se zhvendosja e kësaj të fundit nga pozicioni bazë F<sup>0</sup> drejt një pozicioni koke më lart i cili nuk mund të jetë Ept<sup>0</sup>, pasi po në këtë gjuhë ekzistojnë ndërtime të rralla në të cilat është ndajfolja që i paraprin foljes.

#### *Shembull*

101.a **Souvent** mange du chocolate c'est mouvais pour la peau.

I vënë para ndërtimeve të tilla Pollock (1989)<sup>105</sup> arrin në konkluzionin se struktura e ndërtimeve fjali nuk mund të jetë [SEpt[Ept[SF[F]]]], pasi ky strukturim është tepër i thjeshtë dhe i pamjaftueshëm për gjenerimin e të gjitha tipareve morfosintaksore. Në vijim ai propozon ndarjen e projeksionit SEpt në një numër projeksionesh funksionale ku më të rëndësishmit janë: projeksioni funksional i kohës (SKohë) dhe projeksioni funksional i përshtatjes (SPr)<sup>106</sup>. Për të kompletuar studimin e tij Pollock (1989) shkon më tej duke argumentuar gjithashtu edhe mbi renditjen e këtyre projeksioneve funksionale në skemën X-bar, bazuar kryesisht në fjalitë me folje të shtjelluar të gjuhës frënge.

#### *Shembull*

102.a Ils travaillaient travail + “ai” mbaresë eptimore koha e ardhme + “ent” mbaresë eptimore veta e tretë shumës.


---

<sup>104</sup> Po aty, fq 34


<sup>105</sup> Po aty fq 35-37

<sup>106</sup> Përveç këtyre dy projeksioneve janë propozuar gjithashtu edhe projeksioni i mohimit (SMoh), projeksioni i sintagmes së mënyrës (SMën) të cilat të gjitha së bashku trajtohen si zgjatim i projeksionit maksimal SEpt.

**Skema 30**



Renditja e këtyre dy projeksioneve funksionale përbën një parametër i cili reflekton morfologjinë e gjuhëve. Jo pa qëllim Belletti (1990)<sup>107</sup>, nisur nga Parimi i Pasqyrimit (Mirror Principle) të propozuar nga Baker (1986)<sup>108</sup> dhe gjithashtu nga fakti se tiparet e përshtatjes realizohen jashtë morfologjisë së tipareve të kohës propozon fillimisht gjenerimin e projeksionit SKohë dhe më pas gjenerimin e projeksionit SPr



Me ndarjen e SEpt në SKohë dhe SPr vërehet se SE subjekt, pasi gjenerohet në SpecSF zhvendoset fillimisht drejt pozicionit të specifikuesit të SPr, më tej atij të specifikuesit të SKohë

<sup>107</sup> Pollock J-V., "Notes on clouse structure" fq 252, kapitull te Heageman L. "Elements of grammar. Handbook in generative syntax" Cambridge University Press, 1997 fq 36-38 .

<sup>108</sup> Po aty

duke përfunduar në pozicionin e specifikuesit të SEpt. SE subjekt, duke vizituar të gjitha këto pozicione specifikuesi, licenson treguesit morfologjikë të përshtatjes dhe caktimit rasor. Pozicioni i subjektit nuk përbën një pozicion unik dhe të vetëm, por ai shpërndahet në një numër pozicione të prejardhura si rezultat i ndërveprimit të dy hipotezave kryesore: Hipotezës së Subjektit të Brendshëm dhe Hipotezës së Ndarjes së SEpt.

Realizimi i tipareve kohë dhe përshtatje në projeksione funksionale SKohë dhe SPr na vë para pyetjes se në cilin prej këtyre projeksioneve funksionale licensohen tiparet e rasës, pra në cilin prej pozicioneve të specifikuesit të projeksioneve SKohë dhe SPr i caktohet rasë emërore SE subjekt.

Giorgio Graffi (2008)<sup>109</sup> propozon se pozicioni i vërtetë i subjektit është ai i specifikuesit të SKohë i cili nuk duhet të mbetet i zbrazët pasi sipas parimit universal të Projeksionit të Zgjeruar të gjitha fjalitë duhet të kenë një kryefjalë. Në vijim, veçoria e kokës Kohë<sup>0</sup> e SKohë për të pasur SE subjekt në pozicionin e specifikuesit karakterizohet nga aftësia e caktimit të rasës kësaj SE subjekt. Nisur nga këto veçori të kokës Kohë<sup>0</sup> është propozuar zëvendësimi i projeksionit SEpt me SKohë<sup>110</sup>. Nëse folja është në një formë të shtjelluar atëherë koka Kohë<sup>0</sup> i cakton SE subjekt rasë emërore dhe si e tillë ajo karakterizohet nga tipari [+cakto em] i cili duhet të eliminojë tiparin e painterpretueshëm [± Em] të SE subjekt.

---

<sup>109</sup> SKohë përbën një projeksion funksional në të cilin gjenerohen tiparet e kohës të cilat në disa ndërtime realizohen fonetikisht, në të tjera realizohen si morfema të lira:

*Shembull*


John met Maria                      Joni takoi Marian

John will meet Maria              Joni do të takojë Marian.

Në shembujt e dytë “will/do të” do të realizohen si morfemë e lirë në kokën Kohë<sup>0</sup>. Po për këta shembuj tipari i vetës (përshtatjes) është i painterpretueshëm, por duke qënë se ajo është në lidhje c-komandë me SE subjekt “John/Joni” të cilat përfaqësojnë vetën e tretë njëjës (he/ai) që përmban një tipar të interpretueshëm me zbatimin e rregullës “agree” bën që tipari i painterpretueshëm i vetës të “will/do të” të interpretohet.

<sup>110</sup> Graffi G., *Ç’është gramatika gjenerative*, 2008, fq 109-110

**Skema 31**



**4.4 RËNDËSIA E TIPARIT [+ KOHË] NË CAKTIMIN E RASËS EMËRORE SE SUBJEKT**

Deri nga mesi i viteve '80, para propozimit të ndarjes së SEpt dhe SF (të cilën do ta trajtojmë në kreun në vijim) pranohet përparësia e tiparit kohë mbi tiparin përshtatje. Pas ndarjes së SEpt dhe SF, të cilat ndikuan gjithashtu në karakterizimin e gjuhëve si gjuhë me eptim të fortë (shqipja) dhe gjuhë me eptim të dobët (anglishtja), njohu përparësi tipari përshtatje. Si fillim, përparësia që tipari [+kohë] ka në caktimin e rasës emërore SE subjekt dëshmohej nga të ashtquajturat ndërtime “accusative+to infinitiv” të gjuhës angleze ose fjali të varur me folje në lidhore; ndërtimet me subjekt kategori të zbrazët “pro”; ndërtimet me subjekt kategori të zbrazët të kontrolluar “PRO” si dhe ndërtimet me folje ngritëse. Para se të trajtojmë modelin e caktimit të rasës emërore në secilin prej këtyre ndërtimeve do të përqëndrohemi fillimisht në trajtimin e strukturave to-infinitiv të anglishtes dhe ndërtimeve me folje në lidhore të shqipes.

Në fund të viteve 1980 Chomsky (1981)<sup>111</sup> argumenton se midis to-infinitiv dhe foljeve modale “should, would” ekziston një ngjashmëri e cila reflektohet fillimisht në pozicionin që ato zënë në strukturën e fjalisë.

<sup>111</sup> Radford A., *Minimalist syntax. Exploring the structure of English*, Cambridge University Press, 2004 , fq 51

*Shembull*

103.a It's vital that John should show an interest.

103.b It's vital for John to show an interest.

Elementi "to" dhe folja modale "should" pozicionohen midis SE "John" dhe SF "show an interest" si dhe ndiqen nga forma foljore të pashtjelluara. Në studimet e bëra në vitet '90 ky mendim jo vetëm që u mbështet, por u përpunua më tej. Në këtë kontekst, pranohet që të dy këta elementë do të shfaqen në dy forma të ndryshme: një për kohën e tashme dhe një për kohën e shkuar. To-infinitiv, e konsideruar si një formë e pashtjelluar, sipas këtij propozimi shfaqet e karakterizuar nga vlera pozitive të tiparit kohë.

*Shembull*

104.a We believe the President may have been lying.

104.b We believe the President to have been lying.

Në këta shembuj si folja modale edhe to-infinitiv shprehin një veprim në të tashmen.

105.a The Feds believed the youngsters to have destroyed the building.

Në këtë shembull ndërtimi to-infinitiv shpreh një veprim që është kryer në të shkuarën.

Nisur nga këta shembuj Radford (2004) i shtyrë edhe nga argumentimi i Stowell (1982)<sup>112</sup>, sipas së cilit ndërtimet infinitive të anglishtes karakterizohen nga vlera pozitive të tiparit [kohë], propozon se to-infinitiv shfaq tipare abstrakte dhe të padukshme të kohës. Këto tipare, ndryshe nga tiparet kohore të foljeve modale të cilat janë të zgjedhueshme, në ndërtimet to-infinitiv ato janë të pazgjedhueshme.

Një situatë të komplikuar dhe jo të mirëdiferencuar paraqet edhe lidhësja e gjuhës shqipe. L.Buxheli (2007)<sup>113</sup>, për ndërtimet me folje lidhore të gjuhës shqipe mendon se ato kanë zëvendësuar ndërtimet me formë të pashtjelluar ose infinitiv. Paradoksi qëndron në faktin se në këtë gjuhë folja në lidhore edhe pse morfologjikisht pranohet si një formë e shtjelluar, ajo nuk sillet si e tillë, por si një formë e pashtjelluar. Folja në lidhore e gjuhës shqipe karakterizohet nga një eptim i pafuqishëm me vlera negative të tiparit kohë.

*Shembull.*

106.a Pashë djalin të qante.

---

<sup>112</sup> Radford A., *Minimalist syntax. Exploring the structure of English*, Cambridge University Press, 2004, fq 49-52

<sup>113</sup> Buxheli L., "Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe", Tiranë, 2007, fq 83

Në shembullin e mësipërm folja në lidhore në fjalinë e varur nuk shpreh modalitetin e lidhores, por ajo karakterizohet më tepër nga modaliteti i dëftores, duke shprehur më tepër një veprim real dhe jo një veprim të mundshëm. Kjo bën që këto ndërtime shpesh të zëvendësohen nga ndërtime të ngjashme me folje në formë të pashtjelluar.

106.b Pashë djalin duke qarë.

Përsa i përket të dyja gjuhëve mund të themi se si to-infinitiv, që përbën një formë të pashtjelluar të gjuhës angleze karakterizohet nga tipare të zbehta kohore, dhe lidhorja e cila përbën një formë të shtjelluar karakterizohet nga të njëjtat tipare për të mos thënë nga vlera negative të tiparit kohë.

#### **4.4.1 CAKTIMI I RASËS PËRJASHTIMORE**

##### *Shembull*

107.a Cindi believes Marcia to be a genius.

107.b Dëgjova djalin të qante.

Tradicionalisht, në gjuhën angleze ndërtime të tilla si “*Marcia to be a genius*” njihen si kallëzore (accusative) + to infinitiv, ndërsa në gjuhësinë gjenerative ekzistojnë dy hipoteza të ndryshme për trajtimin e tyre.

Hipoteza e parë:

Në hapat e para të gjuhësisë transformacionore Rosenbaum (1967), Mc.Closkey (1970), Kiparsky (1970) dhe Postal (1974) dhe me pas Johnson (1991), Lasnik dhe Saito (1991), Koizumi (1993) dhe Runner (1995)<sup>114</sup> prezantojnë hipotezën sipas së cilës “*Marcia*” në shembullin (107.a) shfaq tipare kundrinore duke dalë në rasë kallëzore. Pra, kjo SE në një nivel të caktuar përfaqësimi përbën kundrinorin e foljes “*believe*”. Nga ana tjetër, mendohet gjithashtu se tiparet e saj kryefjalore kjo SE i manifeston në një nivel tjetër përfaqësimi. Ajo që mbetet për t’u përcaktuar janë këto nivele përfaqësimi dhe lidhja që ekziston midis tyre.

---

<sup>114</sup> Runner T. J., “*The accusative plus infinitive constructions*”, artikull te “*The Blackwell companion to syntax*”, Blackwell publishing, 2006, Chapter II, fq 73,  
Chomsky N., “*The Minimalist Program*”, The MIT Press, 1997, fq112-115.

Nëse ndërtimin (107.a) do ta transformojmë në një ndërtim me fjali të varur në formë të shtjelluar (shembulli 108.a), atëherë SE “*Marcia*” do të përfaqësojë SE subjekt në rasë emërore. SE “*Marcia*” i caktohet rasa emërore nga tipari [+Kohë] i kokës Ept<sup>0</sup> në pozicionin e specifikuesit të projeksonit SEpt. Pra, ky ndërtim me folje kallëzues në formë të shtjelluar përfaqëson strukturën e thellë, atë nivel përfaqësimi në të cilin SE “*Marcia*” i caktohet roli tematik i vepruesit. Në vijim, si rezultat i veprimeve transformacionore (lëvizja e SE) të cilave u nënshtruhet fjalia strukturë e thellë SE “*Marcia*” mendohet se zhvendoset drejt pozicionit të kundrinës së foljes kallëzues të fjalisë kryesore, ku i caktohet edhe rasa kallëzore nga kjo e fundit.

*Shembull*

107.c Cindy believes Marcia (her) to be a genius.

Ky shembull përbën strukturën sipërfaqësore, pra atë nivel përfaqësimi ku mundësohet caktimi i rasës kallëzore prej foljes kallëzues të shtjelluar të fjalisë kryesore

Hipoteza e dytë lidhet me trajtimin e këtyre ndërtimeve si ndërtime me rasë përjashtimore.

Pra, struktura e mësipërme mendohet të jetë ndërtuar nga një folje (*believe*) e ndjekur nga një SE. Më tej e gjitha kjo strukturë do të ndiqet nga një ndërtim kallëzuesor infinitiv (*to be a genius*) i cili mund të përfaqësohet edhe nga një fjali e nënrenditur në formë të shtjelluar.

*Shembull*

108.a Cindy believes (that) Marcia is a genius. (Në këtë shembull “*Marcia*” përbën një SE kryefjalë në rasën emërore)

108.b Dëgjova që djali qau. (ndërtim analog i gjuhës shqipe në të cilin SE subjekt “*djali*” del në rase emërore si rezultat i eptimit të shtjelluar të foljes së fjalisë së varur)

Nisur nga sinonimia semantike që ekziston midis këtyre dy shembujve jo pa qëllim është menduar se në një nivel të caktuar përfaqësimi SE “*Marcia*” përfaqëson subjektin e fjalisë së varur infinitive (*to be a genius*). Gjithashtu, në mbështetje të këtij pohimi vjen edhe përdorimi i një numri shprehjesh të cilat reflektojnë tipare të përbashkëta me SE kryefjalë të fjalisë si ekspletivët.

*Shembull*

109.a Greg believes **there** to be a genius.

109.b Peter believes it to be raining cats and dogs.



Së dyti, nëse SE “*Marcia*” do ta zëvendësonim me një element anaforik bashkëreferues me kryefjalën e foljes “*believe*”, atëherë ajo do të paraqitej me një formë vetvetore dhe jo përemërore si në shembullin (110.a)

*Shembull*

110.a Cindy believes **herself** to be a genius.

110.b Cindy believes she is a genius.

Së treti, nëse fjalinë shembull në veprorë do të kthejmë në pësore atëherë SE “*Marcia*” do të bëhej kryefjalë e foljes “*believe*” në pasive.

*Shembull*

111.a **Marcia** is believed to be a genius.

111.b **Djali** u dëgjua të qante. (ndërtim analog me shembullin 111.a të gjuhës angleze. Kthimi i fjalisë nga veprorë në pësore në gjuhën shqipe shoqërohet me daljen e SE “*djali*” në pozicionin e subjektit të fjalisë.)

Tiparet e shfaqura nga SE “*Marcia/djalin*” si rezultat i tre testeve të mësipërme (ndërtimet përkatëse në gjuhën shqipe për vetë karakteristikat e lidhore nuk i nënshtrohen të tre këtyre testeve) ngrenë dilemën me të cilën është përballur gjuhësia gjenerative: A përbën kjo SE një subjekt apo kundrinë.

Heageman (1991)<sup>115</sup> për ndërtimet e mësipërme propozon se to-infinitivi i fjalive të varuara karakterizohet nga tipare kohore të zbehta të cilat i përgjithëson si tipare negative të paafta për t’i caktuar rasë emërore SE subjekt “*Marcia*” (e dukshme edhe nga zëvendësimi i kësaj SE me përemrin her-accusative (107.c)). Nga ana tjetër, duke iu referuar shembullit (108.a), në të cilin fjalia e varur to-infinitiv është transformuar në një fjali të varur me folje të shtjelluar, vërehet se SE “*Marcia*” përsa i përket rrafshit semantik përfaqëson argumentin e jashëm të cilit i caktohet roli tematik i vepruesit nga folja “*to be (jam)*”. Ndërsa në rrafshin eptimor kësaj SE, falë tipareve pozitive [+kohe;+përshtatje] të foljes “*to be*” të fjalisë së varur në formë të shtjelluar, i caktohet rasë emërore.


Por, nga ana tjetër, folja “*believe*” e fjalisë drejtuese e ka të nevojshme praninë e një SE argument të brendshëm të cilit i cakton si rolin tematik edhe rasën kallëzore. Në ndërtimet to-infinitiv funksionin e argumentit të brendshëm e kryen e gjithë fjalia e varur (*Marcia to be a genius*). Pra, për të plotësuar kushtet e mësipërme SE “*Marcia*” do të gjenerohet fillimisht në

---

<sup>115</sup> Heageman L., “*Introduction to government and binding theory*” Cambridge University Press, 1991, fq 158

pozicionin SpecSF të fjalisë së varur, pozicion ky në të cilin i caktohet roli tematik i vepruesit. Për të marrë rasë SE "Marcia" do të zhvendoset drejt një pozicioni specifikuesi më lartë, përkatësisht drejt pozicionit Spec SEpt. Duke qënë se eptimi i fjalisë së varur karakterizohet nga tiparet [-kohë;-përshtatje] ai e ka të pamundur caktimin e rasës emërore kësaj SE në pozicionin Spec SEpt. Gjithashtu janë këto tipare negative të cilat bëjnë që ky eptim i dobët i përfaqësuar nga projeksioni SEpt të mos shërbejë si barrierë për drejtimin dhe caktimin e rasës kallëzore nga folja e fjalisë drejtuese. Caktimi i rasës kallëzore SE "Marcia" e pozicionuar në SpecSEpt të fjalisë së varuar nga folja e fjalisë drejtuese njihet si **caktim i rasës përjashtimore**.

**Skema 32**



Arsyeja sipas së cilës SE “*Marcia*” shfaq tipare kryefjalore qëndron në faktin se ajo shfaqet në pozicionin strukturor të SE subjekt në të gjitha nivelet e përfaqësimit. Tiparet kundrinore rrjedhin nga fakti se këto tipare nuk bien mbi kundrinorin, por ato kanë si pikë referimi ato SE që mbartin një farë lidhjeje strukturore me foljen më të afërt. Kjo lloj marrëdhënieje ekziston si për kundrinorin e drejtë edhe për subjektin me rasë përjashtimore e cila mendohet të jetë më afër foljes se çdo SE subjekt tjetër. E veçanta e këtyre ndërtimeve është se folja e fjalisë drejtuese në mënyrë përjashtuese i cakton rasë kësaj SE e cila nuk përbën argumentin e saj të brendshëm duke mos i caktuar rol tematik.

Idenë e këtij trajtimi (si rasë përjashtimore) e hodhi Chomsky (1973) i cili më pas u përpunua në një version të ngjashëm nga Bresnan (1972)<sup>116</sup>. Të dy këta studiues bien dakort në një pikë të përbashkët dhe tepër të rëndësishme sipas së cilës SE “*Marcia*” nuk gjenerohet në një pozicion kundrine në të gjitha nivelet e përfaqësimit.

Trajtimi i këtyre ndërtimeve sipas analizës së caktimit të rasës përjashtimore afron disi me atë të ngritjes së kundrinës, pasi është pranuar se SE “*Marcia*” përbën një subjekt të nënshtresuar. Nga ana tjetër, mbështetja e faktit se kjo SE pasfoljore përbën një SE subjekt të nënshtresuar edhe në strukturën sipërfaqësore e ndan teorinë e caktimit të rasës përjashtimore nga ajo e ngritjes së kundrinorit.

Chomsky (1973) në hapat e para të kësaj teorie pohon se gjatë kalimit të ndërtimeve me folje kallëzues “to-infinitiv” në ato me formë të shtjelluar ndryshimet do të preknin çdo SE e cila do të pozicionohej menjëherë pas foljes.

#### *Shembull*

112.a Cindy believes **Marcia** to be a genius.

112.b Cindy believes **Marcia** is a genius.

112.c Dëgjova djalin të qante.

112.d Dëgjova që djali qante.

Në vijim, ai dalloi një ndryshim shumë të madh midis shembujve (112.a dhe 112.c) dhe atyre (112.b dhe 112.d), ndryshim ky që qëndron në faktin se në shembujt (112.b dhe 112.d) folja kallëzues e fjalisë së nënrenditur është në formë të shtjelluar, ndërsa në shembujt (112.a dhe 112.c) foljet kallëzues “to be dhe qaj” të fjalive të varura janë në forma të pashtjelluar infinitiv (për gjuhën angleze) dhe lidhore (për gjuhën shqipe e cila sillet si e pashtjelluar). Sipas kësaj

---

<sup>116</sup> Chomsky N., *Minimalist Program*, The MIT Press, 1997, fq 111-115

teorie midis foljes dhe SE më të afërt pranohet një farë lidhje strukturore e veçantë e cila njihet si lidhje drejtimi. Pra, në shembujt (112.a dhe 112.c) foljet “*believe* dhe *dëgjoj*” e drejtojnë SE subjekt të fjalive infinitiv/lidhore.

Në shembujt (112.b dhe 112.d) foljet “*believe* dhe *dëgjoj*” të fjalisë kryesore nuk mund të drejtojnë SE “*Marcia* dhe *djalin*”, pasi është eptimi i shtjelluar i foljeve kallëzues të fjalive të varura që bëhet pengesë.

Ky model i caktimit të rasës përjashtimore haset edhe në gjuhën shqipe, por ndryshe nga gjuha angleze në të cilën caktimi i rasës përjashtimore përfshin ndërtimet me formë të pashtjellur to-infinitiv, në gjuhën shqipe atë e hasin në ndërtimet me formë të shtjelluar lidhore. Sipas L. Buxhelit (2007)<sup>117</sup> lidhësja edhe pse përfaqëson një formë të shtjelluar ajo sillet si një formë e pashtjelluar e karakterizuar nga tipare negative të kokës dhe tipare positive të përshtatjes.

#### *Shembull*

113.a Pashë **djalin** të qante.

113.b Pashë **djemtë** të qanin (nga këta shëmbuj vërehet se SE “*djalin/djemtë*” përshtaten në vetë e numër me foljen në lidhore “*të qante*” (vetë e tretë, numri njëjës –ai)/ të qanin (veta e tretë, numri shumës – ata)

SE subjekt “*djalin/djemtë*” edhe pse përshtaten në vetë e numër me foljen kallëzues të fjalisë së varur, ndryshe nga ç’ mund të pritej, këto SE subjekt dalin në rase kallëzore dhe jo emërore, gjë që vërteton se tipari [+përshtatje] nuk mjafton për caktimin e rasës emërore.

Për më tepër, SE “*djalin/djemtë*” nuk është kundrinor i foljes “*pashë*”, pasi folje të tilla të njohura si folje perceptimi pranojnë si kundrinor një SE që i referohet një situatë të caktuar dhe jo një entiteti. Nga ana tjetër, folja në lidhore e fjalisë së varur e ka të nevojshme shprehjen fonetike të SE subjekt, rolin e të cilës e luan SE “*djalin/djemtë*” në rasë kallëzore. Kjo e fundit rolin tematik të vepruesit dhe marrëdhënien gramatikore të subjektit e realizon brenda fjalisë së varur. Pra, roli tematik i vepruesit SE “*djalin/djemtë*” i caktohet nga folja “*qaj*” e fjalisë së varur në pozicionin SpecSF, ndërsa rase kësaj SE i caktohet në një pozicion strukturor më lartë (Spec SEpt të fjalisë së varur) nga folja “*pashë*” e fjalisë drejtuese. Vetkuptohet se, edhe pse SE “*djalin/djemtë*” shërben si subjekt i fjalisë së varur (pozicionuar në SpecSEpt të kësaj të fundit) rolin tematik e merr nga folja e fjalisë së varur, ndërsa rase i caktohet nga folja e fjalisë drejtuese. Sjellja e lidhore si një formë e pashtjelluar e karakterizuar nga një eptim i pafuqishëm bën që

---

<sup>117</sup> Buxheli L., “*Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*”, Tiranë, 2007, fq 83

projeksioni SEpt fjali e varur të mos shërbejë si barrierë për caktimin e rasës kallëzore SE “*djalin/djemtë*” nga koka F<sup>0</sup> e fjalisë drejtuese. Pra, në këto ndërtime të gjuhës shqipe eptimi i fjalisë së varur i karakterizuar nga tipari [+ Pr] kërkon shprehjen fonetike të SE subjekt, ndërsa tipari [-kohë] e bën të pamundur caktimin e rasës emërore si dhe nuk bëhet pengesë për caktimin e rasës kallëzore kësaj SE subjekt nga koka F<sup>0</sup> e fjalisë drejtuese.

Një caktim i tillë rasor përbën një përjashtim nga norma e përgjithshme, pasi rasa kallëzore u caktohet SE kundrinor të drejtë, ndërsa realizimi i caktimit të kësaj rase i dedikohet lindjes dhe zbatimit të një rregulli përjashtimor me veprim të kufizuar, atij të Eptimit të Zbehtë/Dobët.

#### **4.4.2 CAKTIMI I RASËS EMËRORE SE SUBJEKT "Pro" KATEGORI E ZBRAZËT.**

Nisur nga Parimi i Projektionit të Zgjerruar<sup>118</sup> (Extended Projection Principle), sipas të cilit të gjitha fjalitë e gjuhës (në këtë rast të gjuhës angleze) e kanë të domosdoshme praninë e SE subjekt, propozohet se prania ose mungesa e kësaj të fundit varet nga veçoritë që shfaqin gjuhët e ndryshme. Mungesa e SE subjekt në strukturën e fjalisë përbën të ashtëquajturën dukuri pro-drop që në gjuhën shqipe njihet si rënie e SE subjekt. Kjo dukuri nuk shfaq të njëjtën shkallë përdorimi në të gjitha gjuhët. Përsa i përket gjuhës angleze vërehet një përdorim i kufizur në ndërtime të caktuara si ato me folje në mënyrë urdhërore; ndërtime të shkëputura nga e folmja e përditshme ose ndërtime të shkëputura nga ditarët personalë të individëve të ndryshëm.

##### *Shembull*

114.a Do your homework. (ndërtime në mënyrë urdhërore)

**You** do your homework.

114.b Can't find my book. (ndërtime të shkëputura nga e folmja e përditshme)

**I** can't find my book.

114.c Got up at 8 o'clock. (ndërtime të shkëputura nga ditarët personalë)

**I** got up at 8 o'clock.

---

<sup>118</sup> Heageman L., "Introduction to government and binding theory" Cambridge University Press, 1991, fq 59-63.

Në këta shembuj vërehet se SE subjekt kategori e zbrazët përfaqëson një dukuri stilistike të nënkuptuar nga konteksti dhe që mund të shprehet fonetikisht pa ndikuar në gramatikalitetin e fjalisë.

Dukuria pro-drop trajtohet si një parametër gjuhësor, pasi ajo gjen aplikime të ndryshme në gjuhë të ndryshme. Rizzi (1982)<sup>119</sup> argumenton se një gjuhë për të licensuar elementët "pro" duhet të karakterizohet nga një sistem eptimor i pasur<sup>120</sup>, me fjalë të tjera të karakterizohet nga një përfaqësim morfologjik i pasur i markuesve eptimorë. Mungesa ose prania e kufizuar e dukurisë pro-drop në gjuhën angleze i referohet morfologjisë së varfër eptimore të foljes në këtë gjuhë, ku kjo e fundit shfaq mbaresa eptimore vetëm për vetën e tretë, njëjës, koha e tashme (s) dhe për te gjitha vetat, koha e shkuar (ed). Ky eptim i varfër nënkupton gjithashtu një marrëdhënie përshtatjeje të zbehtë midis SE subjekt dhe foljes predikat.

Mendohet që subjekti i këtyre ndërtimeve përbën një SE kryefjalore të rënë ku treguesit fonetikë të së cilës nuk shqiptohen. Në këto ndërtime mungon SE kryefjalë në pozicion SpecSEpt, pozicion ky i karakterizuar nga tiparet [+rase], pasi koka Ept<sup>0</sup> e projekcionit SEpt shfaq tiparet pozitive [+kohë] dhe [+përshtatje], tipare këto që bazuar edhe në Parimin e Visibilitetit/Dukshmërisë<sup>121</sup> e kanë të domosdoshme praninë e një SE kryefjalë në rasën emërore. Por, duke qënë se, në këto ndërtime të gjuhës angleze SE kryefjalë nuk shprehet fonetikisht ajo përfaqësohet nga një kategori e zbrazët "pro".

Pra, SE subjekt i rënë e shënuar konvencionalisht 'pro' përfaqëson një kategori të papajisur me tipare fonetike dhe të pajisur me tipare semantike<sup>122</sup>.

Nga ana tjetër, përta i përket gjuhës shqipe (një gjuhë kjo sintetiko-analitike me një sistem eptimor të pasur) në të cilën një SE në rasën emërore e pozicionuar në SpecSEpt, ku koka Ept<sup>0</sup> e kësaj të fundit karakterizohet nga tiparet [+kohë;+përshtatje], mund të mos shprehet fonetikisht, pasi ajo nënkuptohet ose përfaqësohet nga eptimi foljor. Në këtë gjuhë kjo dukuri njihet si dukuri e rënies së kryefjalës (pro-drop) të cilën Selman Riza<sup>123</sup> e trajton si një dukuri stilistike të mundësuar nga sistemi i pasur eptimor i foljeve. Kjo pasuri eptimore e gjuhës shqipe

---

<sup>119</sup> Cook V. J. and Newson M *Chomsky's universal grammar*, Third edition, Blackwell Publishing, 2007, fq 92

<sup>120</sup> Ky argumentim i Rizzi (1982) nuk mund të pranohet si një përgjithësim gjuhësor, pasi kemi gjuhë të tilla si gjuha kineze e cila është një gjuhë pro-drop edhe pse ajo karakterizohet nga një sistem eptimor (përshtatje) i varfër.

<sup>121</sup> Buxheli L. *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*. Tiranë, 2007, fq 53

<sup>122</sup> Graffi G., *Ç'është gramatika gjenerative*, 2008, fq 110

<sup>123</sup> Buxheli L. *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2007, fq 99

e bën të panevojshme shprehjen fonetike të SE subjekt në rasën emërore në struktura të caktuara.

*Shembull*

115.a Unë punoj në Universitet


115.b Pro punoj në universitet.

Pra, duke qënë se dukuria e rënies së subjektit në gjuhën shqipe përbën një dukuri disi të zakonshme arsyetojmë se ajo është e mundshme për ato ndërtime me SE në rasën emërore të gjeneruar në pozicionin Spec SEpt, ku koka eptimore e këtij projekcioni karakterizohet nga tiparet [+kohë;+përshtatje].

*Shembull*

116.a Joni ka haruar pro të shlyejë borxhin

**Skema 32**



*Mungon sintagma e komplementuesi mbi projektionin SEpt më të ulët pasi ajo është zero.*

Dukurinë e rënies së subjektit në gjuhën shqipe e hasim edhe te ndërtimet me rasë përjashtimore si:

*Shembull*

117.a Unë e dëgjova djalin të qante.

117.b Unë e dëgjova Pro të qante.

117.c \*Unë dëgjova të qante.

Në shembullin 116.a SE subjekt në rasë përjashtimore rimerret nga trajta e shkurtër e përemrit vetor e pozicionuar para foljes së fjalisë drejtuese. Në shembullin 116.b SE subjekt e fjalisë së varur në rasë përjashtimore përbën një kategori të zbrazët “pro”. Prania e trajtës së shkurtër para foljes së fjalisë kryesore (qëllimi i së cilës është rimarrja e SE subjekt) nuk lejon që kjo fjali të kthehet në jogramatikore, fakt ky që vërtetohet më së miri nga shembulli 116.c, ku rënia e SE kryefjalë në rasë përjashtimore dhe mos realizimi i trajtës së shkurtër të përemrit vetor e kthejnë këtë fjali në jogramatikore. Vlen për t’u vërtetuar fakti se në ndërtimet me rasë përjashtimore dukuria pro-drop është e pamundur. Ky mosrealizim i kësaj dukurie i dedikohet tipareve [+Pr; -Kohë] të kokës eptimore të fjalisë së varur duke përforcuar edhe më tej bindjen se kjo dukuri realizohet vetëm te ndërtimet me folje kallëzues në formë të shtjelluar të karakterizuar nga tiparet [+Pr; +Kohë].

#### **4.4.3 RASA EMËRORE SUBJEKT E KONTROLLUAR (KATEGORIA PRO)**

Si në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze hasim ndërtime me SE subjekt kategori e zbrazët PRO, e cila ndryshe nga kategoria “pro” e dukurisë pro-drop, shfaqet në ndërtime të caktuara infinitiv për gjuhën angleze dhe ndërtime me forma foljore të pashtjelluara për gjuhën shqipe.

*Shembull*

118. a I am sorry Ø to have kept you waiting

118.b Unë shkoj Ø për të notuar çdo ditë.

Simboli Ø tregon se në shembujt e mësipërm kemi të bëjmë me një kategori të zbrazët/zero e cila nuk mund të zëvendësohet me një SE kryefjalë të shprehur në rasën emërore, pasi në rast të kundërt fjalitë do të ktheheshin në jogramatikore.



*Shembull*

118.c \*I am sorry I to have kept you waiting

118.d \*Unë shkoj unë për të notuar çdo ditë.

Pamundësia e realizimit të një SE në rasë emërore i dedikohet pamundësisë së eptimit të fjalisë së varur (infinitiv/formë e pashtjelluar) të karakterizuar nga tiparet [-Pr; -Kohë] për t'i caktuar rasë emërore SE kryefjalë të fjalisë së varur. Nga ana tjetër, kjo kategori e zbrazët nuk mund të marrë rasë nga folja e fjalisë kryesore pasi nuk pozicionohet në nyjën motër të kokës F<sup>0</sup>, pra nuk drejtohet nga kjo e fundit.

Foljet “*keep/notoj*” që futen në grupin e foljeve njëvalente e kanë të nevojshme praninë e argumentit të jashtëm për t'i caktuar atij rolin tematik të vepruesit. Por në këta shembuj, duke qënë se eptimi i tyre karakterizohet nga tiparet negative të përshtatjes dhe kohës caktimi i rasës emërore SE subjekt të fjalisë së varur është i pamundur.

Për këto ndërtime me folje në infinitiv/formë të pashtjelluar pozicioni SpecSept karakterizohet nga tipari [-rasë] si dhe, duke qënë se ky pozicion nuk mund të drejtohet as nga koka eptimore e fjalisë drejtuese dhe as nga koka eptimore e fjalisë së varur, atëherë kjo SE nuk mund të përbëjë një SE të hapur (të realizuar fonetikisht), por veçse një kategori PRO.

*Shembull*

119.a Poirot needed a lot of courage PRO to abandon the investigation.

119.b Joni nxirrte lloj-lloj justifikimesh PRO për të mos bërë detyrat.

Në këtë shembull kategoria PRO lidhet me një referent specifik që përfaqësohet nga SE subjekt “*Poirot/Joni*” duke u sjellë si një anaforë. Kategorisë PRO, në këta shembuj, i caktohet rol tematik referencial ose anaforik i cili kontrollon nga roli tematik i subjektit të fjalisë drejtuese.

*Shembull*

120.a PRO To abandon the investigation would be regrettable.

120.b PRO Për të pasur sukses në jetë duhet punë.

Kategoria PRO në shembujt (119.a/119.b) interpretohet si ekuivalent i një përemri arbitrar. Këta shembuj nxjerrin në pah veçoritë anaforike dhe përemërore të kategorisë PRO të karakterizuar nga tiparet [+anaforë; +përemëror].

Pra, për këto ndërtime mendohet se pozicioni i SE kryefjalë i fjalisë së varur me folje kallëzues në infinitiv/formë të pashtjelluar përfaqëson një kategori të zbrazët PRO të karakterizuar nga


tiparet [+ rol tematik;-rasë], pasi kjo SE nuk mund të marrë rasë as nga eptimi i fjalisë së varur e as nga ai i fjalisë kryesore.

*Shembull*

121.a Poirot was glad PRO to abandon the investigation.

121.b Une shkoj për të notuar çdo dite.

**Skema 33**



Përsa u përket këtyre ndërtimeve me SE kategori e zbrazët PRO gjuha shqipe ndryshe nga ajo angleze shfaq ndërtime të njëjta edhe për një numër të kufizuar fjalish të varura në lidhore.

*Shembull*

122.a Unë shkoj në bibliotekë PRO të lexoj.

Struktura të tilla provojnë se, edhe pse folja e fjalisë drejtuese ka kuptim kalimtar, subjekti i fjalisë së varur nuk mund të jetë një SE e hapur e realizuar fonetikisht, sepse pozicioni Spec Sept i fjalisë së varur në të cilin ajo do të gjenerohet përbën një pozicion të padrejtuar qoftë nga eptimi i fjalisë së varur qoftë nga folja e fjalisë drejtuese.

Për këtë arsye në këto ndërtime është i pamundur realizimi fonetik i SE subjekt, pasi ato do të ktheheshin në jogramatikore.

*Shembull*

122.b \*Unë shkoj në bibliotekë unë të lexoj.

Kjo SE kryefjalë e munguar nuk mund të konsiderohet një pro-drop duke qënë se ajo nuk mund të jetë në përndarje plotësuese me ndonjë SE të realizuar fonetikisht e cila mund të futet lehtë në strukturën e fjalisë. Pamundësia e realizimit të SE subjekt në rasë emërore kushtëzohet nga tipari negativ i kohës [-kohë] të foljes lidhore të fjalisë së varur. Kjo kategori PRO edhe për këto fjali të varura në lidhore karakterizohet nga tiparet [+rol semantik referencial (anaforik); -rasë].

Për këtë kategori të zbrazët PRO themi se kemi të bëjmë me një SE kryefjalë të fjalisë së varur të kontrolluar, ku si kontrollues shërben SE subjekt e fjalisë drejtuese, ndërsa foljet kallëzues të fjalive të varuara infinitiv/formë e pashtjelluar/lidhore (ndërtimet me PRO referenciale ose arbitrare në fjalitë e varura me folje në lidhore janë dukuri specifikuuese e gjuhës shqipe) do të emërtohen si folje kontrolli (ndërtimet me forma të pashtjelluara).

Kjo kategori PRO shfaqet jo vetëm në strukturën e thellë, por edhe në strukturën sipërfaqësore. Ajo përbën një kategori referenciale të kontrolluar nga SE subjekt (dhe objekt) i fjalisë kryesore. Ajo nuk mund të marrë rasë, pasi nuk drejtohet as nga Ept<sup>0</sup> i foljes së fjalisë së varur dhe as nga folja e fjalisë drejtuese

#### **4.4.4 CAKTIMI I RASËS EMËRORE NË NDËRTIMET ME FOLJE NGRITËSE.**

##### *Shembull*

123. a It would seem that senator has been lying to the congress

123.b Senator would seem to have been lying to the congress.

124. a Duket se kanë mbëritur njerëzit.

124.b Njerëzit duket të kenë mbëritur.

Në këto ndërtime të gjuhës angleze dhe shqipe SE “*the Senator*” dhe “*njerëzit*” shërbejnë si kryefjalë të foljeve “*seem*” dhe “*duket*”, pasi ato jo vetëm që përshtaten me të, por kjo e fundit karakterizohet nga tipari pozitiv i kohës. Në shembujt e mësipërm SE kryefjalë e fjalisë së varur përbën në vetvete një kategori të zbrazët pasi prania e saj në pozicionin SpecSEpt do t’i kthente në jogramatikore këto ndërtime.

##### *Shembull*

125.a \*It would seem Senator to have been lying to the congress


125.b \*Duket njerëzit të kenë mbëritur.

Argumentojmë se, nëse SE “*Senator/ njerëzit*” do të realizohej si fillim në SpecSEpt të fjalisë drejtuese do të duhej të pranohet që foljet kallëzues “*seem/duket*” do t’i caktonin kësaj SE si rolin semantik edhe rasën. Një dukuri e tillë është e pamundur, pasi në thelb foljet “*seem/duket*” sillen si folje pësore të cilat edhe pse karakterizohen nga tipari [+Kohë] ato caktojnë vetëm rasë dhe jo rol semantik, kështu që SE të mësipërme do t’u duhej që rolin semantik të vepruesit ta marrin nga foljet “*lie/mbërrij*” të fjalisë së varur.

Për këta shembuj realizimi i SE subjekt në pozicionin SpecSEpt të fjalisë së varur është i pamundur pasi folja kallëzues e kësaj të fundit në infinitiv/lidhore, karakterizuar nga tiparet [-Pr; -Kohë] (infinitivi) dhe [+Pr;-Kohë] (lidhorja), e bën të pamundur caktimin e rasës emërore kësaj SE dhe si rrjedhojë e bën gjithashtu të pamundur shprehjen e kësaj të fundit fonetiki.

Foljet “*lie/mbërrij*” të fjalisë të varur u caktojnë SE “*Senator/njerëzit*” rolin semantik të vepruesit, proces ky që është i mjaftueshëm për të krijuar bindjen se këto SE të markuara semantiki si argumente të jashtme të foljeve “*lie/mbërrij*” duhet të jenë ngritur ose zhvendosur drejt pozicionit SpecSEpt të fjalisë drejtuese për të marrë rasë duke lënë pas si gjurmë një kategori të zbrazët.

**Skema 34**



Përmbledhim se është tipari [+ Kohë] i cili karakterizon kokën eptimore të foljeve kallëzues të fjalisë drejtuese i cili i ngre SE “Senator/njerëzit” nga pozicioni Spec SEpt i fjalisë së varur i karakterizuar nga tiparet [+ rol semantik;-rase] drejt pozicionit të prejardhur SpecSEpt të fjalisë drejtuese të karakterizuar nga tipari [+rasë]. Në këtë pozicion kjo SE realizon funksionin sintaksor të kryefjalës të cilin e bën të dukshëm vetëm caktimi rasor (parimi i visibilitetit).

Kjo zhvendosje njihet me termin Lëvizja  $\alpha$  dhe karakterizohet nga tiparet<sup>124</sup>:

- Lëvizja  $\alpha$  është rezultat i ngritjes së një SE nga një pozicion më i ulët drejt një pozicioni më të lartë.
- Ngritja është e detyrueshme.
- Pozicioni ku ngrihet është i zbrazët i tipit [+argumet i jashtëm], [+emëror], [+rasë; -rol semantik].
- Pozicioni nga i cili lëviz është pozicion [-rasë].
- Ngritja bëhet duke lënë pas një gjurmë, ku si SE dhe gjurma (t) krijojnë një varg A.

#### ***4.5 PROPOZIM BASHKËKOHOR MBI GJENERIMIN E SE SUBJEKT NË RASËN EMËRORE.***

Duke u mbështetur në propozimin e Pallock (1987)<sup>125</sup> sipas së cilit projeksioni maksimal funksional SEpt shpërbëhet në varësi të tipareve përbërëse [ $\pm$ Kohë] dhe [ $\pm$ Përshtatje] në dy projeksione funksionale, përkatësisht SKohë (identifikuar shpesh me SEpt) dhe SPr merr hov një argumentim i ri i hedhur nga Chomsky (1997)<sup>126</sup>. Ky argumentim lidhet më pozicionin në të cilin SE subjekt duhet të gjenerohet për të marrë rasë emërore. Në këtë kontekst, Pollock (1987), Chomsky (1991) dhe Belletti (1982)<sup>127</sup> e sfidojnë propozimin sipas së cilit SE subjekt argument i jashtëm i caktohet rasë emërore nga koka Ept<sup>0</sup> në pozicionin e specifikuesit të SEpt. Si rezultat i lindjes dhe ndërveprimit të Hipotezës së Subjektit të Brendshëm dhe Hipotezës së Ndarjes së Ept u propozua se SE subjekt nuk mund të gjenerohet në një pozicion të vetëm dhe unik, por përkundrazi ajo për të licensuar të gjithë treguesit e saj realizohet në një numër projeksionesh të prejardhura.

---

<sup>124</sup> Buxheli L., “Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe”, Tiranë, 2007, fq 147

<sup>125</sup> “Pollock J-Y “Notes on clause structure” fq 241-243, Heageman L., “Elements of grammar. Handbook in generative syntax”, Cambridge University Press 1997, fq 34-34

<sup>126</sup> Ky propozim i Chomskit mbi pozicionin e caktimit të rasës emërore jepet i detajuar në botimin “Minimalist Program” The MIT Press (1997) të N. Chomsky (fq 121-122) si dhe në artikullin e J. McCloskey “Subjecthood and subject position”, Heageman L., “Elements of grammar. Handbook in generative syntax”, Cambridge University Press 1997, fq 197-235.

<sup>127</sup> Po aty

Në vijim, Belletti (1982) duke iu referuar ndarjes së SEpt në dy projeksione funksionale SKohë dhe SPr propozon (bazuar në shembullin e gjuhës frënge: *mangaient = mange + ai tregues kohor, e ardhme + ent tregues i përshtatjes, veta III, shumes*) si renditje hierarkike SPr dhe SKohë duke mbështetur marrëdhëniet që vendosen midis SE subjekt dhe projektionit SEpt.

Në këtë kontekst, Chomsky (1997) i jep më tepër rëndësi kategorisë së përshtatjes duke e njohur atë si të vetmen kategori përgjegjëse në licensimin e treguesve rasorë (në rastin tonë të rasës emërore), pra përgjegjëse në caktimin e kësaj rase. Kjo bindje e tij bazohet në faktin se të dyja si rase dhe përshtatja përbëjnë mekanizma në shprehjen e marrëdhënieve gramatikore. Nga ana tjetër, po ky studiues thekson se për caktimin e rasës emërore projektioni SPr nuk është unik dhe i vetëm, por caktimi i kësaj rase është lidhur gjithashtu edhe me kategorinë e kohës kur koka e kësaj të fundit zhvendoset drejt kokës  $Pr^0$  të SPr.

Ai propozon dy rrafshet përshtatjeje, atë të caktimit të rasës emërore SE kryefjalë të fjalisë, i cili identifikohet me projektionin e sintagmës së përshtatjes së kryefjalës (SPrKr) dhe atë të caktimit të rasave përkatëse argumenteve të brendshëm kundrinë e drejtë dhe kundrinë e zhdrejtë (të cilat do të trajtohen në kapitujt në vijim). Lidhur me projektionet SKohë dhe SPr ky i fundit mendohet të jetë pozicionuar më lart jo vetëm si rezultat i përshtatjes morfologjike që ekziston midis SE kryefjalë dhe foljes kallëzues, por edhe sepse caktimi i rasës emërore analizohet si përshtatje specifikes-kokë. Kjo bindje e Chomskit (1997) mbështetet edhe nga Pollock (1987) i cili këtë projektion e konsideron si përgjegjës në licensimin e treguesve të përshtatjes të SE subjekt

Kjo teori është kundërshtuar disa herë, por Chomsky (1997) e mbështet duke sugjeruar se të gjitha lëvizjet e SE subjekt drejt pozicionit SpecSPrKr dhe zhvendosja e foljes nga koka  $F^0$  drejt gjithë këtyre pozicioneve kokë janë universale, pra, hasen në të gjitha gjuhët. Sipas tij universalizimi i zhvendosjeve të mësipërme ndodh në një nivel abstrakt të formës logjike e cila ka si kusht funksionimin dhe kontrollin e të gjithë treguesve.


Sa cituam më sipër do ta paraqesim në mënyrë të skematizuar:

*Shembull*

126.a The boy arrives in the evening

126.b Djali mbërrin në mbrëmje

Skema 35



Pra, përmbledhim se SE subjekt e fjalisë në strukturën e thellë do të gjenerohet në SpecSF për të marrë rolin tematik të vepruesit dhe më pas do të zhvendoset drejt SpecSEpt për licensimin e treguesve eptimorë dhe si përfundim, për marrjen e rasës emërore asaj do t'i duhet të zhvendoset drejt SpecSPrKr.

Nga materiali i analizuar deri tani mbi caktimin e rasës emërore SE kryefjalë të fjalive të shtjelluara si në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe është pranuar se modeli i caktimit të kësaj rase përbën një model strukturor, pra, ajo përfaqëson një rasë strukturore, e cila do të realizohet gjithmonë në një pozicion të caktuar.

Ky pozicion përbën një pozicion specifikuesi si fillim SpecSF, më pas Spec SEpt (projeksioni SEpt i gjuhës angleze identifikohet edhe me projektionin SKohë) për licensimin e tipareve eptimore dhe në përfundim, si rezultat i propozimit të ardhur nga Chomsky (1997), drejt pozicionit Spec SPrKr. Nisur nga të gjitha hipotezat e hedhura më sipër ajo që i bashkon dhe që



***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

---

është universale për të gjitha gjuhët është realizimi i rasës emërore subjekt të fjalisë në kuadrin e lidhjeve specifikes-kokë të cilat karakterizohen si marrëdhënie përshtatjeje.

## ***PËRFUNDIME***

Në këtë kre pamë se rasa emërore i caktohet SE kryefjalë të fjalisë në pozicionin SpecSEpt. Si në gjuhën angleze dhe në atë shqipe, për caktimin e kësaj rase duhet që folja kallëzues e fjalisë të jëtë në formë të shtjelluar, pra, të karakterizohet nga tiparet pozitive [+Pr; +Kohë]. Gjithashtu caktimi i rasës emërore në gjuhën shqipe përveç caktimit nga kategoria funksionale e eptimit caktohet gjithashtu edhe nga kategori të tilla leksikore si parafjala (karakteristikë për caktimin e kësaj rase janë parafjalët nga, te, tek).

127.a Këto janë pamje nga Tirana.

SE “Tirana” përbën një SE në rasën emërore të caktuar në pozicionin e plotësorit të parafjalës [SP; SE] në funksionin sintaksor jo të kryefjalës së fjalisë por të rrethanorit të vendit.

Por në këtë kre jemi përqëndruar më tepër në caktimin e rasës emërore SE kryefjalë të fjalisë si dhe modelin strukturor që ai përfaqëson.

Theksojmë se SE kryefjalë fillimish do të realizohet në pozicionin SpecSF për t’iu caktuar nga koka leksikore  $F^0$  roli tematik i vepruesit dhe më pas ajo do të zhvendoset drejt një pozicioni të prejardhur SpecSEpt me qëllim që të marrë rasë emërore nga koka  $Ept^0$  vetëm në rastet kur kjo e fundit do të karakterizohet nga tiparet [+Pr;+Kohë]. Në vijim theksojmë se për caktimin e rasës emërore tipari [+kohë] ka përparësi mbi tiparin tjetër të përshtatjes, përparësi kjo që në shumë studime në gjuhën angleze projeksioni SEpt do të zevendësohet nga projeksioni funksional SKohë.

Caktimi i rasës emërore SE në pozicionin SpecSEpt, i cili karakterizohet nga tipari [+Rasë] bën që ky caktim rasor të përfaqësojë më së miri një model të caktimit të rasës strukturore.

Rasa emërore e një SE kryefjalë licensohet në një pozicion strukturor indiferent ndaj rolit tematik, ku vetëkuptohet se caktimi i një roli tematik specifik nuk përbën domosdoshmëri për caktimin e rasës emërore. Është eptimi i foljes i cili ka aftësinë e të caktuarit të kësaj rase SE kryefjalë brenda konfiguracionit specifikues-kokë.

Tipari [+kohë] i kokës eptimore është tipar i vetëm në caktimin e rasës emërore SE kryefjalë, gjë që vërtetohet edhe nga ndërtimet me rasë përjashtimore, ndërtimet me kryefjalë kategori të zbrazët dhe ndërtimet me SE në ngritje.

***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

---

Nga ana tjetër, Chomsky (1997) na sjell një ristrukturim mbi caktimin e rasës emërore SE kryefjalë duke pranuar si të vetmen kategori të licensimit të treguesve rasorë atë të përshtatjes. Ky propozim bazohet në bindjen se rasa dhe përshtatja përbëjnë dy mekanizma për shprehjen e marrëdhënieve gramatikore. Sipas po këtij propozimi SE kryefjalë për t'iu caktuar rasë emërore e shohim të pozicionuar në SpecSPrKr. Po Chomsky thekson se projeksioni SpecSPrKr nuk është një dhe i vetëm, por është i lidhur edhe me kategorinë e kohës në rastet kur koka e projeksionit Skohë do të zhvendoset drejt kokës së projeksionit SPrKr duke formuar kështu një zinxhir (zhvendojse-gjurmë).

## KREU V

### RASA KALLËZORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ

#### 5.1 CAKTIMI I RASËS KALLËZORE

Në kapitujt e mëparshëm kemi trajtuar caktimin e roleve tematike nga folja kallëzues argumenteve të saj (të brendshëm dhe të jashtëm). Por, që këto SE argumente të bëhen të dukshme në strukturën e fjalisë, ato duhet patjetër të pajisen me rasë. Ky proces është i ngjashëm me vënien në skenë të një pjese teatrore, ku ashtu si personazhet bëhen të dukshëm nga pamja e jashtme, ashtu edhe SE bëhen të dukshme duke marrë rasë. SE që nuk janë argumente të foljes nuk e kanë të nevojshëm as caktimin e rolit tematik as caktimin e rasës.

Gjithashtu trajtuam caktimin e rasës emërore SE argument të jashtëm në funksionin sintaksor të subjektit të fjalisë në konfiguracionin strukturor specifikues-kokë ( $Koh^0$  ose  $PrKr^0$ ). Në këtë kre do të trajtojmë caktimin e rasës kallëzore SE argument të brendshëm të foljeve kalimtare. Përveç foljeve kalimtare si caktues të rasës kallëzore do të pranohet edhe kategoria leksikore e parafjalës e cila ua cakton këtë rasë SE plotësor të kokës  $P^0$  të projektionit SP.

Nisur nga kategoritë leksikore caktuese të rasës kallëzore, parafjalë dhe folje kalimtare, SE argument i brendshëm karakterizohet nga një përndarje e funksioneve sintaksore si më poshtë:

*Shembull*

127.a The woman kissed **the boy (him)**.

127.b Gruaja puthi **djalin**.

SE në rasën kallëzore është në funksionin sintaksor të kundrinorit të drejtë.

*Shembull*

127.c. The woman was worried *for* **the little boy (him)**.

127.d Nëna fliste gjithmon *për* **Xhimin (atë)**.

SE në rasën kallëzore është në funksionin sintaksor të kundrinorit me parafjalë.


*Shembull*

127.e For **him** to attack Bill would be surprising.

127.f Për **atë** të sulmonte Billin do të ishte e pabesueshme.

SE në rasë kallëzore është në funksionin sintaksor të subjektit së fjalisë së varur to-infinitiv. Si fillim, do të përqëndrohemi te dy ndërtimet e para të cilat do të përshtaten si më poshtë në skemën X'.

**Skema 36**



Në kreun e mëparshëm si caktues të rasës emërore pranuar kokën Ept<sup>0</sup> të projekSIONIT SEpt të karakterizuar nga tiparet [+kohë; +përshtatje]<sup>128</sup>. Si caktues të rasës kallëzore nuk mund të pranojmë të njëjtën kategori, për arsyen e vetme se SE argument i brendshëm në rasë kallëzore gjenerohet në përbërje të projekSIONIT SF (si motër e kokës F<sup>0</sup>) duke mos mundësuar drejtimin e kësaj SE nga koka Ept<sup>0</sup> e projekSIONIT SEpt. Pra, drejtimi është një nga kushtet kryesore për caktimin e rasës kallëzore. Termi i drejtimit ka njohur përdorim shumë të hershëm. Fillimisht, Stowell (1981) duke e trajtuar drejtimin në këndvështrimin tradicional e ka konsideruar atë si një marrëdhënie unike të vendosur midis dy elementëve të afërt të tillë që nëse X drejton Y, atëherë Z e pozicionuar më lart X nuk mund të drejtojë Y<sup>129</sup>. Më pas Chomsky (1981; 1986) dhe Rizzi

<sup>128</sup> Fillimisht, si caktues i rasës emërore u pranua tipari [+kohë], pra koka Kohë<sup>0</sup> e projekSIONIT funksional SKohë. Rëndësia e këtij projekSIONI në caktimin e rasës emërore ka bërë që ky projekSION të zëvendësojë projekSIONIN SEpt.

<sup>129</sup> Cook V.J and Newson M., *Chomsky's Universal Grammar*, Third Edition, Blackwell Publishing, 2007, fq 151-153

(1990)<sup>130</sup> e trajtojnë drejtimin si një koncept të rëndësishëm të përfshirë në të gjitha modulet e gramatikës gjenerative. Sipas tyre drejtimi shihet si një lloj komande e tillë që:

- A drejton B nëse A m-komandon B dhe asnjë barrier nuk ndërhyr midis Adhe B
- Projektionet maksimale shërbejnë si barriera për realizimin e drejtimit.
- Si drejtues shërbejnë kokat e sintagmave

Në shembujt 127.a, 127.b nuk përmbushet ky kusht, pasi SE në rasë kallëzore nuk mund të drejtohet nga koka  $Ept^0$  e projektionit SEpt, për arsye se projektioni maksimal SF në të cilin përfshihet kjo SE do të shërbejë si barriera e drejtimit të kësaj të fundit nga koka  $Ept^0$ .

Si rrjedhim, si caktues i rasës kallëzore SE argument i brendshëm do të shërbejë koka  $F^0$  e projektionit SF, pra rasa kallëzore do të caktohet nga kategoria leksikore e foljes e cila duhet të përfaqësohet nga një folje kalimtare.

Përsa u përket shembujve 127.c dhe 127.d, lind vetvetiu pyetja se cila prej kategorive leksikore, folje apo parafjalë, do të shërbejë si caktues i rasës kallëzore SE argument të brendshëm.

Nga trajtimi i mësipërm dhe informacioni që dhamë mbi kushtin e drejtimit nuk e kemi të vështirë të përcaktojmë si caktues të rasës kallëzore kokën  $P^0$  të projektionit SP.

Në këta shembuj si koka  $P^0$  dhe koka  $F^0$  drejtojnë SE në rasë kallëzore, por sipas pikës së dytë të kushtit të drejtimit “*projeksionet maksimale shërbejnë si barriera për realizimin e drejtimit*” atëherë projektioni maksimal SP do të shërbejë vetvetiu si barriera për drejtimin e SE në fjalë nga koka  $F^0$  e projektionit SF. Në ndërtimet e mësipërme me SE plotësor të kategorive leksikore parafjalë është koka  $P^0$  që i cakton rasë kallëzore kësaj SE argument i brendshëm. Ashtu sikundër projektioni maksimal SF shërben si barriera për drejtimin e SE argument të foljes nga koka  $Ept^0$ , ashtu edhe projektioni SP shërben si barriera e drejtimit të SE plotësor i parafjalës nga koka  $F^0$  e projektionit SF. Në këtë mënyrë duke përjashtuar drejtuesit e shumëfishtë prezantojmë Kushtin e Minimalitetit përmbushja e të cilit përbën domosdoshmëri në caktimin e rasës kallëzore.

Kushti i Minimalitetit i formuluar nga Rizzi<sup>131</sup>:

A drejton B nëse aty nuk pozicionohet asnjë kokë Z e tillë që:

- Z të jetë një drejtues potencial
- Z m-komandon B

---

<sup>130</sup> Chomsky N., *Minimalist Program*, The MIT Press 1997, fq 269-297

<sup>131</sup> Kushti i Minimalitetit (Relativized Minimality) i propozuar nga Rizzi (1982;1990) sipas Chomsky N. “Minimalist Program”, 1995, fq 78-79.

- Z nuk m-komandon A

Sipas këtij kushti, përcaktohet fusha e ndikimit jashtë të cilës nyjet koka nuk mund të drejtojnë. SE në pozicionet strukturore [SE; SP] dhe [SE; SF], edhe pse në rasën kallëzore, kryejnë funksione sintaksore të ndryshme si dhe marin role tematike të ndryshme. Caktimi i rasës kallëzore në një prej pozicioneve të mësipërme, pavarësisht funksionit sintaksor jo të njëjtë, vërteton faktin se ajo përfshihet në grupin e rasave strukturore. Caktimi strukturor i rasës kallëzore nga foljet kalimtare ose parafjalët brenda lidhjes së drejtimit kërkon përqëndrimin e vëmendjes në marrëdhëniet strukturore, të cilat për caktimin e kësaj rase janë të tipit kokë-SE plotësor dhe jo të tipit specifikues-kokë (fakt që do të vërtetohet në vijim të këtij kreu). Nga ana tjetër, ndodh shpesh që për caktimin e rasave strukturore, në rastin në fjalë për caktimin e rasës kallëzore, lidhja e drejtimit dhe kushti i minimalitetit mund të mos mjaftojnë. Deri tani kemi pranuar që një rasëcaktues për të qënë i tillë duhet të jetë drejtues dhe të lidhet sintaksorisht me SE të cilës i cakton rasë. Kjo do të thotë se midis caktuesit rasor dhe SE që merr rasë të mos futet asnjë kategori tjetër leksikore. Kjo përbën një tjetër kusht, atë të fqinjësisë.<sup>132</sup> Kushti i Fqinjësisë<sup>132</sup> përfaqëson një universale gjuhësore, e cila në gjuhë të caktuara si anglishtja me rend të ngulitur zbatohet me përpikmëri për të gjithë caktuesit rasorë dhe SE që marin rasë, ndërsa në disa gjuhë, përmendim këtu gjuhën shqipe me rend të lirë, ky kusht gjen zbatueshmëri sidomos në ndërtimet emërore me caktues rasor kokën P<sup>0</sup> të projeksionit SP, ku midis caktuesit rasor parafjalë dhe SE që merr rasë, nuk mund të futet asnjë kategori tjetër leksikore, pasi në rast të kundërt fjalia do të kthehet në jogramatikore.

#### *Shembull*

128.a He speaks English fluently

128.b \*He speaks fluently English. (fjali jogramatikore, pasi midis foljes dhe argumentit të saj të brendshëm futet ndajfolja “fluently”)

128.c Nëna fliste gjithmon për Xhonin

128.d \*Nëna fliste për gjithmon Xhonin. (fjali jogramatikore pasi midis parafjalës “për” dhe SE “Xhonin” futet ndajfolja “gjithmon”)

Pra, duke përjashtuar ndërtimet parafjalore të gjuhës shqipe, pranojmë se ky kusht në raste të tjera nuk zbatohet, për arsye se gjuha shqipe, duke qënë një gjuhë flektive e cila karakterizohet nga caktimi i rasës morfologjike, lejon një rend të lirë të fjalëve në fjali. Vendi ose pozicioni i SE

---

<sup>132</sup> Buxheli L., *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë 2007, fq 185-187

që merr rasë në gjuhën shqipe nuk varet nga rasëcaktuesi, por varësia e kësaj SE në raport me fjalën nga e cila varet, ruhet. Në gjuhën shqipe një SE në rasë kallëzore mund të pozicionohet para ose pas foljes që ia cakton këtë rasë, lirshmëri kjo të cilën ia jep mbaresa rasore. Edhe pse kjo SE del në pozicione të ndryshme, ajo nuk humbet lidhjet sintaksore me fjalën nga e cila varet.

Duke iu referuar sa më sipër (shembujve 127.e;127.f) mbi pozicionet strukturore në të cilat licensohet rasa kallëzore, i referohemi disa ndërtimeve disi të veçanta të caktimit të kësaj rase në pozicionin [SpecSEpt]. Në kreun e mëparshëm këto ndërtime i kemi pranuar si caktim i rasës përjashtimore.

Në vijim do t'u referohemi ndërtimeve të ngjashme të caktimit të rasës kallëzore nga koka P<sup>0</sup> SE kryefjalë të fjalive të varura me folje kallëzues to-infinitiv.

### **5.1.1 CAKTIMI I RASËS KALLËZORE PËRJASHTIMORE**

Në gjuhën angleze hasim gjithashtu një dukuri tjetër sintaksore atë të caktimit të rasës kallëzore nga parafjala “for” SE kryefjalë të fjalive të varuara me folje kallëzues to-infinitiv.

#### *Shembull*

129.e For **him** to attack Bill would be surprising<sup>133</sup>.


129.f Për **atë** të sulmonte Billin do të ishte e habitshme.

---

<sup>133</sup> Heagman L., "Introduction to government and binding theory" Cambridge University Press, 1991, fq 154-160



Skema 37



Për të vërtetuar që përemri “*him*” në rasën kallëzore përfaqëson një SE kryefjalë të fjalisë së varur, mjafton ta kthejmë formën e pashtjelluar to-infinitiv të fjalisë së mësipërme në një formë të shtjelluar.

*Shembull*

130.a That **he** attacked Bill was surprising.

130.b Që **ai** sulmoi Billin ishte e habitshme

Struktura argumentale e foljes “*attack*” kërkon praninë e dy argumenteve një të jashtëm dhe një të brendshëm dhe përkatësisht të përemrit “*him*” argument i jashtëm dhe SE “*Bill*” argument i brendshëm. Duke qënë se, kjo folje pranon SE “*Bill*” si argument të brendshëm, i cakton kësaj të fundit rasë kallëzore, gjë që nga ana tjetër e pengon këtë folje për të shërbyer si caktues i rasës kallëzore për përemrin “*him*”, pasi ajo nuk mund të caktojë kallëzore të dyzuar. Për më tepër, folja “*attack*” në infinitiv e karakterizuar nga tiparet [-Pr; -Kohë] e ka të pamundur caktimin nga ana e saj të rasës emërore SE kryefjalë të fjalisë së varur. Gjithashtu, mungesa e parafjalës “*for*” do ta kthente këtë fjali në jogramatikore dhe do ta bënte të detyrueshëm heqjen e përemrit “*him*” në kallëzore.

*Shembull*

131.a \*him to attack Bill would be surprising.

131.b To attack Bill would be surprising.

Nisur nga faktet e renditura më sipër dalim në konkluzionin se prania e parafjalës “for” si parafjalë komplementuese/lidhëzore e gjeneruar në pozicionin kokë të projeksonit sintagmë komplementuese SK/sintagmë lidhëzore SL e bën ndërtimin e mësipërm gramatikor. Duke qënë se parafjalët përbëjnë kategori leksikore të karakterizuar nga tiparet [+folje;+emër], të afta për të caktuar rasë, pranojmë se është kjo kategori leksikore që i cakton rasë kallëzore SE plotësor të projeksonit SK.

Caktimi i rasës kallëzore SE kryefjalë të fjalisë së varur nga koka  $K^0$  e projeksonit SK argumentohet si më poshtë:

Duke u bazuar në Kushtin e Minimalitetit projeksoni SE<sub>pt</sub> përbën një projektion drejtues, dhe në të tilla kushte, me të drejtë do të pranohej se ky projektion do të shërbente si barrierë për drejtimin e SE “him” nga projeksoni maksimal SK. Për rrjedhojë do të pranohej caktimi i rasës kallëzore kësaj SE nga koka  $K^0$  e projeksonit SK.

Nga ana tjetër, duke qënë se koka E<sub>pt</sub><sup>0</sup> përbën një kokë infinitiv të karakterizuar nga tipare negative të përshtatjes dhe të kohës, atëherë ajo përbën një kokë të dobët për të drejtuar dhe për t’i caktuar rasë SE kryefjalë “him”. Si e tillë, ajo lejon përfshirjen e parafjalës “for” duke mos shërbyer si barrierë për drejtimin si dhe për caktimin nga kjo e fundit të rasës kallëzore SE kryefjalë të fjalisë së varur në infinitiv.

Ndërtime të ngjashme hasim edhe në gjuhën shqipe të cilat gjithashtu do t’i nënshtrohen të njëjtës analizë gjeneruese.

*Shembull*

132.a Për atë të humbte garën do të ishte fatale.

Duke qënë se sipas L. Buxhelit (2008)<sup>134</sup> mënyra lidhore e gjuhës shqipe sillet si një formë e pashtjelluar infinitiv ajo karakterizohet nga një eptim i dobët i markuar nga tiparet [+Pr;-Kohë]. Si e tillë kjo folje në lidhore nuk mund të shërbejë si barrierë për drejtimin e SE “atë”, të gjeneruar në pozicionin SpecSE<sub>pt</sub> të subjektit të fjalisë së varur në lidhore, nga  $K^0$  e SK. Për

---

<sup>134</sup> Buxheli L., "Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe", Tiranë 2007, fq 53

këtë arsye eptimi i fjalisë së varur nuk mund të bëhet pengesë për caktimin e rasës kallëzore SE subjekt në pozicionin SpecSEpt nga koka  $K^0$  e projeksonit SK (skema 43).

### **5.1.2 CAKTIMI I RASËS KALLËZORE NË NDËRTIMET PËSORE.**

Për të kuptuar më mirë caktimin e rasës kallëzore një SE argument të brendshëm nga foljet kalimtare në pozicionin [SE; SF] duhet më parë t'u referohemi argumentimeve të mëposhtme<sup>135</sup>:

a. *Strukturës së argumentit ose formës logjike*,<sup>136</sup> sipas së cilës një SE për të marrë rasë duhet të jëtë në një pozicion [+ Argument], pra, në një pozicion të detyrueshëm për plotësimin e kuptimit të foljes kallëzues. Më konkretisht, me strukturë argumentale kuptohet numri i argumenteve ose numri i pjesëmarrësve të domosdoshëm në realizimin e veprimit të shprehur nga folja/predikati (në gjuhësinë gjenerative përdoret më tepër termi predikat duke iu referuar çdo njësie e cila për realizimin e saj kuptimor e ka të domosdoshëm praninë e argumentit).

b. *Struktura semantike*<sup>137</sup> lidhet me strukturën semantike të predikatit i cili u cakton argumenteve që merr nga një rol semantik si: veprues, temë, pësues, etj. Kjo dukuri lidhet ngushtë me parimin universal të njohur si Teoria Theta ose Teora e caktimit të Roleve Tematike. Strukturat e mësipërme së bashku me parimin e projeksonit do të na vijnë në ndihmë për të kuptuar proceset sintaksore që shoqërojnë kalimin e ndërtimeve nga veprorë në pësore dhe për më tepër çfarë ndodh në caktimin e dy rasave strukturore kryesore, atë të rasës emërore dhe kallëzore.

*Shembull*

133.a **The boy** wrote a letter.

133.b **The letter** is written (by the boy).

133.c **Djali** shkroi një letër

133.d **Një letër** u shkrua nga djali.

Nga sa më sipër, vërejmë se foljet “write/shkruaj” për të realizuar kuptimin e tyre e kanë të domosdoshme praninë e dy argumenteve, një të jashtëm dhe një të brendshëm, të cilëve u

---

<sup>135</sup> Buxheli L. *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, 2007, fq 196-198.

<sup>136</sup> Po aty

<sup>137</sup> Po aty

caktojnë rolet tematike përkatëse. Gjithashtu këtyre argumenteve u caktohet përkatësisht rasa emërore nga koka Ept<sup>0</sup> e projeksonit SEpt dhe rasa kallëzore nga koka F<sup>0</sup> e projeksonit SF.

Po ti referohemi sërish shembujve vërejmë se kalimi i këtyre ndërtimeve veprare në pësore shoqërohet së pari, me ndryshime morfologjike që pëson folja kallëzues ( e cila në gjuhën shqipe karakterizohet nga zgjedhimi pësor që në kohët e përbëra ndërtohet nga përdorimi i foljes “*jam*” në vend të asaj “*kam*”, ndërsa në gjuhën angleze ndërtimi i pësore (pasive voice) realizohet në sajë të përdorimit të foljes ndihmëse “*to be*” (*jam*)).

Së dyti, edhe pse kemi të bëjmë me të njëjtën folje kallëzues, e cila ofron të njëjtin informacion si për ndërtimet veprare edhe për ato pësore, ndryshimet prekin strukturën e argumentit. Mendohet që gjatë kalimit nga ndërtimet veprare në pësore preket struktura e argumentit të foljes duke bërë që informacioni leksikor i foljes kallëzues të pasqyrohet pjesërisht me praninë e vetëm një argumenti.

#### *Shembull*

134.a **The letter** is written.

134.b **Letra** u shkrua.

Në ndërtimet pësore vërehet si dukuri realizimi i SE argument i brendshëm në pozicionin Spec SEpt, pozicion ky i përfaqësuar nga SE subjekt në rasën emërore. Roli tematik i brendshëm i kundrinorit të drejtë tashmë realizohet nga një SE e cila nuk është më në funksionin sintaksor të plotësorit të foljes, por e gjejmë të shfaqet në pozicionin sintaksor të subjektit së fjalisë pësore.

Së treti, roli tematik i jashtëm i vepruesit<sup>138</sup> nuk realizohet nga një SE në rasën emërore në funksionin e kryefjalës. Kjo SE subjekt nuk ndodhet në pozicionin [+Argument i jashtëm] pozicion ky, ku roli semantik i caktohet nga folja kalimtare dhe rasa emërore i caktohet nga koka eptimore, por përkundrazi ajo ndodhet e pozicionuar brenda projeksonit SP ku koka P<sup>0</sup> i cakton rasë kallëzore.

Nëse kalimi i ndërtimeve veprare në pësore nuk do të shoqërohej nga këto dukuri atëherë do të kishim ndërtime jogramatikore.

#### *Shembull*

135.a \*The boy is written the letter.

135.b \* Djali u shkrua një letër.

---

<sup>138</sup> Jeaglli (1986) dhe Roberts (1987) sipas Heageman L. “*Introduction to government and binding theory*”, Cambridge University Press, 1991 propozojnë se roli tematik i vepruesit në ndërtimet pësore nuk mungon. Ky rol tematik edhe pse i absorbuar nga morfologjia pasive e foljes ai është i nënkuptuar.

Gjithashtu, një veçori tjetër e ndërtimeve pësore është fakti që parapëlqehet mosrealizimi fonetik i SE me rolin tematik të vepruesit, që në ndërtimet pësore përfaqësohet nga një SP.

Pra, mendohet që ky rol tematik absorbohet nga zgjedhimi pësor i foljes kallëzues. Në vijim theksojmë se, absorbimi i rolit tematik të jashtëm shoqërohet edhe nga pamundësia e foljes në pësore për t'i caktuar rasë kallëzore një SE e cila përfaqëson argumentin e brendshëm.

Po t'u referohemi fjalive të mësipërmë jogramatikore në pësore del se është e pamundur për SE argument të jashtëm "*the boy/djali*" të qëndrojë në pozicionin SpecSEpt, pasi roli tematik i argumentit të jashtëm, pra roli tematik i vepruesit, është absorbuar nga folja kallëzues. Nga ana tjetër, SE argument i brendshëm "*the letter/një letër*", ndonëse e merr rolin tematik të argumentit të brendshëm nga folja kallëzues "*write/shkruaj*" nuk mund të qëndrojë brenda projeksionit SF, pasi ky pozicion përbën një pozicion [-Argument] të karakterizuar nga tiparet [+rol tematik; -rasë] (-rasë për arsye se folja pësore e humb aftësinë për caktimin e rasës argumentit të brendshëm).

Që këto ndërtime të kthehen në gramatikore duhet që SE "*the letter/ një letër*", pasi t'i caktohet roli tematik i argumentit të brendshëm nga folja "*write/shkruaj*" të zhvendoset drejt një pozicioni tjetër argumenti, ku mund të marrë rasë. I vetmi pozicion argumenti [+Rasë] i lirë është ai i specifikuesit të projeksionit SEpt, pasi argumenti i jashtëm i realizuar në këtë pozicion në ndërtimet pësore nuk mund të shprehet fonetakisht si rezultat i absorbimit të rolit tematik të jashtëm.

Zhvendosja e SE argument i brendshëm drejt pozicionit SpecSEpt të karakterizuar nga tiparet [-rol tematik; +rasë] mbështetet edhe nga fakti që kjo SE rolin tematik e merr në strukturën e thellë në pozicionin [SE;SF] duke mos krijuar përplasje të dy roleve tematike gjatë zhvendosjes, pra duke mos shkelur parimin theta. Kjo zhvendosje është e detyrueshme sepse vetëm në këtë formë SE argument i brendshëm mund të marrë rasë nga koka Ept<sup>0</sup> në respektim të filtrit rasor.

Duke krahasuar edhe njëherë ndërtimet veprorë me ato pësore theksojmë se ato përfaqësohen nga e njëjta strukturë e thellë, ndryshimi qëndron vetëm në strukturën sipërfaqësore. Ndërtimi bazë i cili përfaqëson strukturën e thellë, atë strukturë sintaksore para lëvizjes së SE, është ai vepror, ndërsa struktura sipërfaqësore, ajo strukturë sintaksore e prejardhur, përfaqësohet nga ndërtimi pësor. Gjatë zhvendosjes së SE argument i brendshëm nga pozicioni i plotësorit të SF drejt pozicionit Spec SEpt krijohet brenda pozicionit SF një gjurmë/


hapësirë boshe e cila i ruan lidhjet me këtë SE të zhvendosur duke krijuar kështu një zinxhir [SE;E] i cili bashkon këto dy komponentë përkatësisht: një pozicion argumenti [+rasë] me një pozicion tjetër argumenti [+rol semantik]. Kjo lidhje zinxhir në fjalitë pësore paraqitet si një lidhje dygjymtyrëshe pasi SE në pozicion e prejardhur SpecSEpt rasën dhe rolin tematik e merr në dy pozicione të ndryshme përkatësisht SpecSEpt (rasën) dhe [SE; SF] (rolin tematik).

*Shembull*

136.a The letter was written

136.b Letra u shkrua

**Skema 38**



Mbështetur në këto dy karakteristika themelore të ndërtimeve pësore del se kalimi i ndërtimeve veprare në pësore shoqërohet nga:

- humbja e aftësisë së foljes pësore për të caktuar rasë kallëzore
- humbja e aftësisë së foljes pësore për të pasur argument të jashtëm duke mos mundur t'i caktojë atij rolin tematik

Gjuhëtari Burzio (1986) ka formuluar rregullin e njohur si “Rregullat e Burzios”<sup>139</sup> i cili lidhet kryesisht me dy dukuri gjuhësore: ndërtimet pësore dhe ndërtimet me folje joakuzative (jokallëzore)

<sup>139</sup> Heagman L., “Introduction to government and binding theory, Cambridge University Press, 1991, fq 296-297.

- Foljet që nuk mund të marri argument të jashtëm nuk mund të caktojnë rasë kallëzore
- Foljet që nuk mund të caktojnë rasë kallëzore nuk mund t'i caktojnë rol semantik argumentit të jashtëm.

### **5.1.3 CAKTIMI I RASËS KALLËZORE NË NDËRTIMET ME FOLJE JOAKUZATIVE**

Rregullat e mësipërme të njohura si Rregullat e Burzios (1986) lindën si rezultat i analizës gjeneruese që ky gjuhëtar i kushtoi ndërtimeve fjali me folje joakuzative të gjuhës italiane e cila, ashtu si gjuha shqipe, karakterizohet nga caktimi morfologjik i rasës dhe rendi i lirë i përbërësve në strukturën e fjalisë.

#### *Shembull*

137.a Gianni conosce me (\*io), non lui (\*egli)<sup>140</sup>.

137.b Xhani më njeh mua (\*unë), jo atë (\*ai)

138.a Per primo sonno arrivato io (\*me), non tu (\*te).

138.b I pari mbërrita unë (\*mua), jo ai (\*atë).

Foljet kalimtare si “*conoscere/njoh*” që shprehin veprime dhe gjëndje i caktojnë SE argument të brendshëm kundrinor i drejtë rolin tematik të temës dhe rasën kallëzore. Ndërsa foljet jokolimtare si “*arrivare/mbërrij*” i caktojnë SE argument i brendshëm rolin tematik të temës (pasi në të vërtetë kjo SE nuk mund të jetë as veprues e as pësues) dhe rasën emërore. Në këtë këndvështrim do të ishte krejt e arsyeshme të pranohim se argumentet tema në 137.a dhe 137.b (*me;lui/mua;atë*) janë kundrina të drejta ndërsa argumentet tema të shembujve 138.a dhe 138.b (*io;tu/unë;ai*) përfaqësojnë SE subjekt.

Nga sa më sipër, del si detyrë rishikimi i ndarjes së foljeve në dy klasa: *folje kalimtare*, struktura argumentale e të cilave pranon një argument të jashtëm dhe një të brendshëm; *folje jokolimtare* struktura argumentale e të cilave pranon vetëm një argument, qoftë ky i jashtëm i shprehur me një SE në rasë emërore ose qoftë ky një argument i brendshëm. Pra, foljet “*conoscere/arrivare*” (njoh/mbërrij) edhe pse përbëjnë folje njëargumentale ato ndryshojnë nga njëra-tjetra. Për ta bërë sa më të dukshëm këtë ndryshim Burzio (1986), për këto ndërtime të

---

<sup>140</sup> Graffi G., *Ç’është gramatika gjenerative*. 2008, fq 100-103

Heageman L., “*Introduction to government and binding theory*”, Cambridge University Press, 1991, fq 299-305

gjuhës italiane, propozon dy mënyra testimi të cilat lidhen konkretisht me përdorimin e elementit “*ne*” dhe përzgjedhjen e foljeve ndihmëse për formimin e kohëve të përbëra.

Përsa i përket elementit “*ne*” Heageman (1991)<sup>141</sup> propozon se ai përfaqëson një element përemëror i cili i duhet bashkangjitur një koke foljore. Pra “*ne*” përfaqëson një element të shkëputur nga një SE argument në pozicion pas-foljor. Në të njëjtën linjë Graffi<sup>142</sup> thekson se ky element përemëror ka kuptim partitiv pasi përfaqëson dhe shpreh një pjesë të së tërës.

*Shembull*

139.a In questo luogo arrivano molti ragazzi.

139.b In questo luogo ne arrivano molti.

140.a In questo luogo camminano molti ragazzi.

140.b \*In questo luogo ne camminano molti.

Nga këta shembuj vërehet se elementit përemëror “*ne*” pranohet në ndërtimin me foljen jokalmimtare njëargumentale “*arrivare*”, ndërsa përdorimi i tij në shembujt 140.a dhe 140.b me foljen jokalmimtare njëargumentale “*camminare*” është i pamundur, pasi fjalia kthehet në fjali jogramatikore. Prania ose jo e “*ne*” me këto folje të cilat i përkasin të njëjtit grup foljesh mbështet faktin se klasa e foljeve jokalmimtare duhet të ndahet më tej.

Gjithashtu, për të vërtetuar se foljet “*arrivare/camminare*”, folje jokalmimtare njëargumentale, i përkasin klasave të ndryshme mjafton që foljen kallëzues në shembujt e mësipërm ta kthejmë në kohët e përbëra.

*Shembull*

141.a In questo luogo **sono arrivati** molti ragazzi.

141.b In questo luogo **ne sono arrivati** molti ragazzi

142.a In questo luogo **hanno camminato** molti ragazzi.

142.b \*In questo luogo ne **hanno camminato** molti.

Nga këta shembuj vërejmë se folja “*arrivare*” për të ndërtuar kohët e përbëra përzgjedh foljen ndihmëse ‘*essere (jam)*’ ndërsa folja “*camminare*” po për të njëjtin qëllim përzgjedh foljen ndihmëse “*avere (kam)*”

Nisur nga këto testimet del se foljet (si *arrivare*), të cilat pranojnë përdorimin e elementit përemëror “*ne*” si dhe preferojnë përdorimin e foljes ndihmëse “*essere/jam*” në vend të

---

<sup>141</sup> Heageman L., “*Introduction to government and binding theory*”, Cambridge University Press, 1991, fq 299-305

<sup>142</sup> Graffi G., *Ç’është gramatika gjenerative*. 2008, fq 100-103



“*avere/kam*” për formimin e kohëve të përbëra, përfshihen në klasën e foljeve joakuzative/jokallëzore. Ky grup foljesh, ashtu si foljet në pësore, karakterizohen nga mungesa e argumentit të jashtëm dhe si rrjedhojë nga paaftësia për të caktuar rol tematik të jashtëm. Argumenti i vetëm që këto folje pranojnë për të plotësuar kuptimin e tyre leksikor përbën argumentin e brendshëm të cilit i caktojnë rolin tematik të temës. Foljet joakuzative këtij argumenti të brendshëm i caktojnë rasë emërore dhe jo rasë kallëzore.

Klasifikimi i grupimit jokallimtar të foljeve në folje jokallimtare dhe folje joakuzative pranohet si për gjuhën angleze dhe për gjuhën shqipe, por këto gjuhë për vetë karakteristikat e tyre nuk mund t’i referohen të njëjtave modele testimi.

Si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe nuk mund të gjejmë një element përemëror të njëjtë me “*ne*” të gjuhës italiane. Ndërsa, përtaqja e përket përzgjedhjes së foljes “*jam*” për formimin e kohëve të përbëra në gjuhën angleze hasim gjurmë që vërtetojnë një përdorim të hershëm të saj.

*Shembull*

143.a *Poirot is gone*<sup>143</sup>. Përdoret folja “*to be/jam*” me kuptim e foljes “*to have/kam*”

143.b *Poirot është ikur.*

Kur flasim për gjurmë të një përdorimi të hershëm i referohemi anglishtes së vjetër (OE) në të cilën foljet e lëvizjes dhe ndryshimit të gjendjes të njohura si folje joakuzative (*come, go, return, grow, fall*) për formimin e kohëve të përbëra përzgjidhnin foljen “*to be/jam*”.

*Shembull*

144.a Se halge faeder waes inn agan<sup>144</sup>  
The Holy father was in gone.

The holy father had gone in.

144.b **Is** nu gewarden.  
Is now happened.

It has happened now.

Gjithashtu, një tjetër dëshmi, që vërteton se foljet e mësipërme të lëvizjes dhe të ndryshimit të gjendjes përfshihen në klasën e foljeve joakuzative në anglishten e sotme, është edhe përdorimi i ekspletivit “*there*”<sup>145</sup>.

<sup>143</sup> Heagman L., “*Introduction to government and binding theory*”, Cambridge University Press 1991, fq 306-307

<sup>144</sup> Po aty

*Shembull*

145.a Three men arrived at the palace

145.b There arrived three man at the palace.

145.c Three men bought a book.

145.d \*There bought three men a book

Në shembullin 145.a me folje kallëzues “arrive” vërejmë se SE kryefjalë “three men” e cila i paraprin foljes argumentohet të ketë si pozicion të saj parësor atë pasfoljor, gjë që e vërteton edhe jogramatikaliteti i shembullit 145.b. Përkundrazi, për shembullin 143.b nuk mund të pranojmë të njëjtën gjë nisur nga jogramatikaliteti i tij. Në 145.b duke qënë se SE subjekt nuk zhvendoset nga pozicioni i saj parësor, bën që në pozicionin SpecSEpt të gjenerohet ekspletivi “there” në rolin e argumentit të jashtëm.

Ekzistenca e klasës së foljeve joakuzative është pranuar edhe për gjuhën shqipe me një ndryshim nga gjuhët e sipërpërmendura, pasi ajo e ka të pamundur përcaktimin në bazë testimesh të foljeve që e përbëjnë këtë klasë. Sipas Buxhelit (2007)<sup>146</sup> si folje joakuzative do të pranohen ato folje të cilat e kanë të pamundur caktimin e rasës kallëzore argumentit të saj të brendshëm. Klasa e foljeve joakuzative në gjuhën shqipe përfshin foljet njëargumentale që shprehin lëvizje ose ndryshim të gjendjes si: *arrij, mbërrij, eci, dal, shëtis, lëviz, qëndroj*, etj; përfshin foljet kalimtare me kuptim vetvetor si: *lahem, vishem, krihem, ngrihem*, etj; si dhe foljet në diatezen pësore.

Lind pyetja se si realizohet dhe argumentohet strukturimi i këtyre ndërtimeve me folje joakuzative të cilat nuk marin argument të jashtëm, por vetëm argument të brendshëm rase e të cilit meriton vëmendje për mënyrën e licensimit. Foljet joakuzative nuk mund t’i caktojnë rasë kallëzore argumentit të tyre të brendshëm dhe nga ana tjetër nuk mund të caktojnë rol tematik të jashtëm pasi nuk marin SE argument të jashtëm në pozicionin Spec SEpt. Duke qënë se ky pozicion është i zbrazët atëherë kjo e bën të detyrueshme zhvendosjen<sup>147</sup> gjatë përfaqësimit sipërfaqësor të SE argument të brendshëm drejt pozicionit Spec SEpt të subjektit për të marrë

---

<sup>145</sup> Heagman L., “Introduction to government and binding theory”, Cambridge University Press 1991, fq 306-307

<sup>146</sup> Buxheli L. "Modelet e caktimit rasor nëgjuhën e sotme shqipe" Tiranë, 2007, fq 209-212

<sup>147</sup> Nga fundi i viteve '70 Chomsky evidentoi tre tipe operacionesh lëvizëse: - zhvendosjen e SE subjekt nga SpecSF drejt SpecSEpt; - zhvendosjen e SE subjekt në ndërtimet me folje ngritëse dhe – zhvendosjen e SE argument i brendshëm drejt pozicionit të subjektit në ndërtimet me folje joakuzative. Graffi G. “Ç’është gramatika gjenerative”, 2008, fq 97-107

rasë. Burzio (1986) propozon se kjo SE subjekt i fjalive joakuzative gjenerohet në të njëjtin pozicion bazë të strukturës së thellë si kundrina e drejtë e foljeve kalimtare.

Kjo SE nuk mund të qëndrojë në pozicionin [SE;SF] pasi ky përbën një pozicion të karakterizuar nga tipari [-rasë]. Për këtë arsye, ajo duhet të zhvendoset drejt pozicionit Spec SEpt të karakterizuar nga tipari [-rol semantik; +rasë] ku i caktohet rasë emërore nga koka Ept e projekcionit SEpt.


Kjo analizë vlen edhe për grupin e foljeve joakuzative të gjuhës shqipe të cilat shprehin lëvizje dhe ndryshim të gjëndjes.

*Shembull*

146.a She has arrived.

Ajo ka ardhur.

**Skema 39**



## **5.2 CAKTIMI I RASËS KALLËZORE SE ARGUMENT I BRENDSHËM NË POZICION SPECIFIKUESI**

Nisur nga *hipoteza e kryefjalës së brendshme* dhe tendenca për t'i ndarë dhe specifikuar funksionet përkatëse të rrafshit leksikore dhe atij eptimor u propozua se, rrafshi leksikor përbën domenin në të cilin realizohen argumentet e foljes si rezultat i caktimit të roleve tematike,

ndërsa rrafshi eptimor përbën rrafshin në të cilin treguesit morfosintaksorë licensohen duke u përfaqësuar sintaksorisht. Për të gjitha gjuhët pranohet pozicionimi bazë i argumenteve të foljes në një pozicion më të ulët foljor për t'iu caktuar roli tematik përkatës dhe më pas, për licensimin e treguesve morfosintaksorë, ato do të zhvendosen drejt projeksioneve funksionale të pozicionuara më lart në pemën strukturore të fjalisë. Në këtë kontekst, propozohet si pozicion i licensimit të treguesve morfosintaksorë dhe për rrjedhojë, si pozicion i caktimit rasor, një pozicion më i lartë specifikuesi. Në vija të përgjithshme, kjo hipotezë përbën një përpjekje për t'i venitur ndryshimet strukturore që mendohet se ekzistojnë midis argumentit të jashtëm dhe atij të brendshëm. Kjo zbehje, nga sa do të argumentojmë edhe më poshtë, do të bazohet në modelin e caktimit të roleve tematike në përbërjen e projeksionit leksikor SF si dhe në modelin e caktimit të rasës emërore dhe asaj kallëzore në përbërje të projeksioneve funksionale.

Në këtë kontekst, Angelika Kratzer (1994;1996)<sup>148</sup> nisur nga fakti se SE subjekt i caktohet roli tematik përkatës nga projeksioni i ndërmjetëm F' i projeksionit maksimal SF, si dhe duke qënë se kjo SE subjekt cilësohet si argument i jashtëm propozon një projeksion funksional të cilin e emërton si sintagma "voice"<sup>149</sup> dhe e shënon si vP (Sv). Një propozim deri diku të ngjashëm me atë të Kratzer ofron edhe Chomsky<sup>150</sup> (1993;1995) sipas të cilit në përbërjen e projeksionit leksikor SF ekziston një element foljor morfologjikisht i zbrazët përgjegjës për caktimin e rolit tematik të jashtëm SE argument i jashtëm. Këto dy propozime njihen si përpjekje të suksesshme që çuan në ndarjen e projeksionit leksikor SF në dy të tillë SF më e ulët (e pozicionuar më poshtë në skemën X') dhe Sf më e lartë (e pozicionuar më lart në skemën X') në pozicionin e specifikuesit të së cilës do të realizohet SE subjekt për të marrë rolin tematik përkatës.

Gjithashtu, nisur nga propozimi sipas së cilit treguesit morfosintaksorë të SE subjekt licensohen në një numër pozicionesh të prejardhura propozohet gjenerimi brenda projeksionit eptimor (SEpt), përveç projeksionit të përshtatjes së kryefjalës (SPrKr) (në të cilin licensohen

---

<sup>148</sup> Mc Closkey J., *Subjecthood and subject position*, Heageman L., "Elements of grammar. Handbook in generative syntax", Cambridge University Press 1997, fq 197-235


<sup>149</sup> "Voice" ose më saktë "passive/active voice" i referohet diatezës pësore/veprore ë gjuhës shqipe.

<sup>150</sup> Këto dy propozime lidhen në mënyrë indirekte me *hipotezën e subjektit të brendshëm* të Koopman dhe Sportiche (1995;1998) të cilët ishin të parët që propozuan se argumentit të jashtëm roli tematik nuk i caktohet brenda projeksionit SF, por përkundrazi ky argument për të marrë rol tematik i bashkëngjitet projeksionit SF. Pra, realizohet në pozicionin e specifikuesit. Ajo që i ndan këto dy propozime (Kratzer dhe Chomsky) nga *hipoteza e subjektit të brendshëm* është gjenerimi i këtij projeksioni të dytë leksikor me kokë foljore të zbrazët, me të vetmin synim organizimin dhe shprehjen e marrëdhënieve semantike të SE subjekt. Por, nga ana tjetër këto dy propozime nuk shënjojnë ndarje radikale nga HSB pasi ruhet argumentimi sipas së cilit roli tematik argumentit të jashtëm i caktohet në një pozicion specifikuesi më të ulët (SpecSf) se ai i licensimit të treguesve morfosintaksorë (SpecSPrKr).

treguesit e përshtatjet së kryefjalës përgjegjës në caktimin e rasës emërore SE kryefjalë), të një projeksoni të dytë përshtatjeje, atij të sintagmës së përshtatjes së kundrinorit të drejtë SPrKd (AgrOP), me qëllim licensimin e rasës kallëzore që i caktohet SE argument i brendshëm

Ky projektion do të ndërfitet midis dy projektioneve leksikore Sf me e lartë, në pozicionin e specifikuesit të së cilës do t'i caktohet roli tematik SE argument i jashtëm, dhe SF më e ulët në pozicionin [SE;SF] të së cilës, jo vetëm që do të realizohet argumenti i brendshëm, por atij do t'i caktohet edhe roli tematik përkatës.

**Skema 40**



Sipas skemës së mësipërme SE kundrinor i drejtë i realizuar fillimisht në pozicionin e argumentit të brendshëm [SE;SF] për të marrë rolin tematik nga koka  $F^0$  do të duhet të zhvendoset drejt pozicionit Spec SPrKd për të licensuar treguesit morfosintaksorë si dhe për të marrë rasë kallëzore nga koka  $PrKd^0$  në të cilën zhvendoset koka foljore. Pra, SE argument i brendshëm zhvendoset nga pozicioni bazë i strukturës së thellë [SE;SF] drejt një pozicioni të prejardhur SpecSPrKd të formës logjike (FL). Një strukturim i tillë i cili ndërthet në vetvete si

***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqsje me gjuhën shqipe.***


ndarjen e projeksonit SF edhe gjenerimin e projeksonit funksional SPrKd do të pranohet edhe për ndërtimet fjali me folje dyargumentale të gjuhës shqipe.

*Shembull*

147.a The boy kissed the girl

147.b Djali puthi vajzën

**Skema 41**



Chomsky (1997), në një fazë të mëvonshme, strukturimin e mësipërm i cili përfshin zhvendosjen e SE argument i brendshëm kundrinor i drejtë nga pozicioni [SE;SF] drejt

pozicionit SpecSPrKd duke kapërcyer pozicionin bazë të gjenerimit të SE subjekt, SpecSF, e ka konsideruar shkelje të Parimit të Lëvizjes së Shkurtër<sup>151</sup>.

Ky strukturim i papërligjur kundërshtohet gjithashtu edhe nga studiuesit Collins dhe Thrainsson (1993), Koizumi (1993) dhe Bobaljik (1995)<sup>152</sup> të cilët ofrojnë një propozim alternativ. Ata propozojnë se pozicioni bazë i gjenerimit të SE argument i jashtëm subjekt do të jetë brenda projeksionit Sf më të lartë dhe konkretisht pozicioni bazë i kësaj SE do të jetë SpecSf. Në këtë pozicion specifikuesi kësaj SE argument i jashtëm i caktohet roli tematik përkatës nga koka  $f^0$ , ndërsa pozicioni bazë i gjenerimit të SE argument i brendshëm kundrinor i drejtë do të jetë ai i specifikuesit të projeksionit SF më të ulët, pozicion ky i pranuar deri tani si pozicioni bazë i SE subjekt. Në këtë pozicion SE argument i brendshëm kundrinor do t'i caktohet roli tematik përkatës nga koka  $F^0$  e projeksionit SF. Pas caktimit të rolit tematik kjo SE argument i brendshëm do të zhvendoset drejt pozicionit SpecSPrKd ku do t'i caktohet rasa kallëzore. Ky propozim adoptohet edhe nga Chomsky (1997) i cili argumenton se zhvendosja e kokës  $F^0$  drejt pozicionit kokë PrKd<sup>0</sup> krijon një konfiguracion *kokë-kokë* sipas së cilit duke qënë se SpecSF dhe SpecSPrKd janë të baraslarguara (Chomsky përdor termin "equidistant") e bëjnë të detyrueshëm zhvendosjen e SE kundrinor i drejtë nga pozicioni SpecSF drejt atij SpecSPrKd. Sipas hipotezës së ndarjes së projeksionit leksikor SF vihet re se projeksionet leksikore përgjegjëse për caktimin e roleve tematike do të ndërpritet nga projeksione funksionale përgjegjëse për licensimin e treguesve morfosintaksorë.

Në këtë kontekst, Jim Mc Closkey (1997)<sup>153</sup> argumenton se një zhvillim i tillë i rindërtimit të strukturës së SE subjekt do të shoqërohej patjetër nga një rindërtim përkatës i strukturës së SE kundrinor i drejtë. Ajo që e bashkon SE subjekt me SE kundrinor i drejtë është se të dy këto SE argumente të foljes realizohen në një pozicion më të ulët specifikuesi, përkatësisht SpecSf dhe SpecSF (u caktohet roli tematik) dhe më pas zhvendosen drejt një pozicioni më të lartë specifikuesi, përkatësisht SpecSPrKr dhe SpecSPrKd (licensohen treguesit morfosintaksorë dhe u caktohet rasa)

---

<sup>151</sup> Chomsky N., "Minimalist Program", The MIT Press 1997, fq 182-183

<sup>152</sup> Heagman L., "Elements of Grammar; Handbook in generative syntax, Cambridge University Press 1997, fq 39


<sup>153</sup> Mc Closkey J., "Subjecthood and subject position", Heagman L., "Elements of grammar. Handbook in generative syntax", Cambridge University Press 1997, fq 197-235

*Shembull*

148.a The boy kissed the girl

148.b Djali puthi vajzën

**Skema 42**





## **PËRFUNDIME**

Këtë kre ia kemi kushtuar caktimit të rasës kallëzore SE kundrinor të drejtë e cila përfaqëson argumentin e brendshëm të foljes. Në fillim të punimit pranuar si caktues të rasës kallëzore kokën  $F^0$  të projeksonit SF e cila është përgjegjëse edhe për caktimin e rolit tematik. Për caktimin e kësaj rase është e detyrueshme përmbushja e parimit të drejtimit dhe Kushtit të Minimalitetit, gjë që mbështetet më së miri edhe nga caktimi i rasës përjashtimore SE në pozicion kryefjale. Rasa përjashtimore do t'i caktohej SE “*him*” nga parafjala “*for*” në ndërtimet “*For him to attack Bill would be surprising*”. Tiparet negative të përshtatjes dhe kohës të foljes “*attack*” nuk mundësojnë caktimin e rasës emërore kryefjalës “*him*” në pozicionin SpecSEpt të fjalisë së varur. Një ngërç i tillë zgjidhet nga futja e parafjalës “*for/për*” e cila në këto ndërtime të gjuhës angleze luan edhe rolin e lidhëzës/ komplementuesit, ndërsa në gjuhën shqipe përfaqëson kategorinë e parafjalës duke u pozicionuar në kokën  $K^0$  të projeksonit të sintagmës së komplementuesit. Ky element parafjalor do të bëjë të mundur caktimin e rasës kallëzore kësaj SE. Mungesa ose heqja e kasaj parafjale do ta kthejë fjalinë e mësipërme në jogramatikore.

Në vijim, trajtuam caktimin rasor të SE argumente të foljes gjatë kalimit nga ndërtimet veprorë në ato pësore. Duke përmbledhur shkurt, theksojmë se gjatë këtij transformimi folja në pësore humbet aftësinë për t'i caktuar rol tematik argumentit të saj të jashtëm. Si e tillë ajo humbet gjithashtu aftësinë për t'i caktuar rasë argumentit të saj të brendshëm, pra ajo humbet aftësinë për të caktuar rasë kallëzore. Për këtë arsye argumentit të brendshëm roli tematik i caktohet në strukturën e thellë në pozicionin motër të kokës  $F^0$  të projeksonit SF. Më pas ajo do të zhvendoset drejt një pozicioni të prejardhur të strukturës sipërfaqësore të karakterizuar nga tiparet [+argument; +rasë]. Pozicioni i vetëm që mbart këto tipare është ai i argumentit të jashtëm, ku kësaj SE argumenti i brendshëm gjatë zhvendosjes drejt këtij pozicioni i caktohet rasë emërore.

Nënçështja e fundit të këtij kreu sjell një trajtim risi përse i përket caktimit të rasës kallëzore SE argument të brendshëm, duke e paralelizuar atë me caktimin e rasës emërore. Kjo përbën një përpjekje të Chomsky për të dhënë të njëjtin model të caktimit rasor si për argumentin e jashtëm edhe për atë të brendshëm. Bazuar në këtë arritje të fundit, kur do të flasim për caktim

### *Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përfaqje me gjuhën shqipe.*

---

strukturor rasor përveç përkufizimit të saj të dikurshëm, si caktim i rasave në një pozicion të caktuar, shkojmë më tej duke e specifikuar këtë pozicion si pozicion specifikuesi si dhe duke e përcaktuar caktimin e rasës strukturore si të realizuar në konfiguracionin specifikues-kokë. Në kuadër të këtij propozimi, ashtu si vepruam me projektionin SE<sub>pt</sub> të cilin e paraqitëm të ndarë në projeksione funksionale (ku më i rëndësishmi është ai i përshtatjes së kryefjalës SPrKr në pozicionin e specifikuesit të të cilit do të realizohet SE kryefjalë e fjalisë për të licensuar treguesit rasor si dhe për të marrë rasë emërore), ashtu do të veprojmë edhe me projektionin SF të cilin do të paraqesim të ndarë në dy projeksione funksionale Sf më të lartë dhe SF më të ulët, ndërmejt të cilëve do të gjenerohet projektioni i përshtatjes së kundrinorit të drejtë SPrKd në pozicionin e specifikuesit të të cilit do të zhvendoset SE kundrinor i drejtë për të licensuar treguesit rasorë si dhe për të marrë rasë kallëzore. Në fund të këtij kreu ritheksohet se rasa kallëzore si rasë strukturore do t'i caktohet SE argument i brendshëm në funksionin sintaksor të kundrinorit të drejtë në pozicionin SpecSPrKd nga koka PrKd<sup>0</sup> e cila është rimarrje e kokës F<sup>0</sup>.

## KREU VI

### RASA DHANORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ

#### 6.1 NJOHURI TË PËRGJTHSHMË MBI RASËN DHANORE DHE CAKTIMIN E SAJ.

Përbërësi emëror në dhanore përfaqëson personin a objektin i cili ndikohet indirekt nga veprimi i shprehur nga folja. Në gjuhën angleze për vetë karakteristikat e saj si gjuhë analitike rasa dhanore shfaqet si formë e diferencuar aty nga vitet 1066, që përkon me periudhën e paspushtimit Norman. Gjatë periudhës së anglishtes mesjetare kjo rasë së bashku me rasën kallëzore u përfshi në një formë rasore të vetme të njohur si “*obligative*” e cila, duke qënë një shkrirje e të dy këtyre formave rasore, përdorej e paraprirë nga të gjitha parafjalët e gjuhës angleze<sup>154</sup>. Në anglishten e ditëve të sotme e vetmja gjurmë që vërteton ekzistencën e dikurshme të një forme rasore të mirëdiferencuar për dhanoren është përemri pyetës “*Whom?/Kujt?*”. Gjithashtu, për ndërtime të caktuara në anglishten e sotme, si tregues dhe për më tepër si markues i rasës dhanore shërben edhe parafjala “*to*”, e cila ndryshe njihet si mjet morfologjik për caktimin e kësaj rase. Nga ana tjetër, gjuha shqipe ofron një panoramë historike të ndryshme, pasi në këtë gjuhë rasa dhanore ka ekzistuar gjatë gjithë periudhave të zhvillimit të saj si një formë rasore e diferencuar nga format e tjera.

Por, përveç karakteristikave morfologjike që rasa dhanore shfaq në këto dy gjuhë përbërësi emërore në dhanore semantikisht përfaqëson një SE të cilës i caktohet roli tematik i përfituesit nga folja kallëzues e fjalisë. Si në gjuhën angleze dhe në atë shqipe kjo SE në rasë dhanore të cilës i caktohet roli tematik i përfituesit nga folja këllëzues e fjalisë përbën argumentin e dytë të brendshëm (përveç argumentit temë në rasë kallëzore).

#### *Shembull*

149.a They smiled *to* **their children**.

149.b Ata u folën **fëmijëve**.


Ndërtimet e mësipërme konsiderohen si ndërtime të thjeshta në të cilat folja kallëzues për të plotësuar kuptimin e ka të nevojshëm praninë e dy argumenteve, një të jashtëm dhe një të

---

<sup>154</sup> Material nga internet [http://en.wikipedia.org/wiki/Dative\\_case](http://en.wikipedia.org/wiki/Dative_case)


brendshëm, të cilëve u cakton përkatësisht rolin tematik të vepruesit dhe rolin tematik të përfituesit. SE të cilës i caktohet roli tematik i përfituesit sintaksorisht përfaqëson kundrinorin e zhdrejtë në rasë dhanore. Kësaj SE në gjuhën angleze roli tematik i caktohet nga folja kallëzues e fjalisë, ndërsa rasa nga parafjala “to” e paravendosur”. Në gjuhën shqipe është folja kallëzues që i cakton SE kundrinor i zhdrejtë rolin tematik të përfituesit dhe rasën dhanore. Caktimi i rasës SE argument i brendshëm kundrinor i drejtë në gjuhën angleze kryhet nga parafjala “to” në pozicionin [SE;SP], ndërsa në gjuhën shqipe është folja kallëzues që i cakton rasën kësaj SE në pozicionin [SE;SF]. Në fazat e para të zhvillimit të gjuhësisë gjenerative propozohet caktimi i rasës dhanore SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë sipas strukturës së mëposhtme X’.

**Skema 43**



Në vijim me lindjen e hipotezës së subjektit të brendshëm; hipotezës së ndarjes së projeksionit SEpt dhe hipotezës së ndarjes së projeksionit SF, sintagmat emërore argumente të foljes në strukturën e mësipërme do t’i nënshtrohen zhvendosjes nga pozicionet leksikore bazë (projeksione përgjegjëse për caktimin e roleve tematike) drejt projeksioneve funksionale të prejardhura (projeksione përgjegjëse për licensimin e treguesve morfosintaksorë si dhe për caktimin rasor). Në këtë kontekst, dhe si rrjedhim i lindjes së projeksioneve funksionale të përshtatjes së kryefjalës SPrKr (në pozicionin e specifikuesit të së cilës zhvendoset SE subjekt për të marrë rasë emërore) dhe të përshtatjes së kundrinorit të drejtë SPrKd (në pozicionin e specifikuesit të së cilit realizohet SE kundrinor i drejtë për të marrë rasë kallëzore) propozohet

gjithashtu lindja e një projeksoni të tretë funksional të përshtatjes së kundrinorit të zhdrejtë SPrKzh.



Propozimi i këtij projeksoni do të bëjë të mundur gjenerimin e SE argumenti i brendshëm kundrinor i zhdrejtë në pozicion specifikuesi. Sa më sipër, do të mundësojë strukturimin e ndërtimeve trivalente me folje të tilla si “*give/jap*” të cilat për të plotësuar kuptimin e tyre e kanë të nevojshme praninë e tre argumenteve (një të jashtëm dhe dy të brendshëm).

*Shembull*

150.a **Martha** gave **Mirna** **a letter**

150.b **Marta** i dha **Mirnës** **një letër**.

Caktimi i ndërlikuar rasor për këto ndërtime me folje trivalente, të cilat në gjuhën angleze njihen si ndërtime me folje ditranzitive, kanë qënë objekt studimi për shumë studiues të huaj<sup>155</sup> dhe të vendit<sup>156</sup>.

---

<sup>155</sup> Chomsky “Minimalist Program” The MIT Press, 1997, ; Vasquez E., “Case assignment in double object constructions” 1997; Rill J., “A unified analysis of Dative shift in English and the applicative construction in Chichewa” 2011. Në këtë punim përmenden gjuhëtarët Baker (1988); Marantz (1993); Larson (1988) si dhe propozimet e tyre.

Inoue K., “Case” (with special reference to Japanese). Në këtë punim përmenden gjuhëtarët Watanabe (1996); Chomsky (1991; 1993) si dhe Ura (1996; 1999; 2000; 2001) si dhe propozimet e tyre për ndërtimet me dy kundrina të gjuhës angleze.

<sup>156</sup> Mitaj J., “Hyrje në gjuhësinë gjenerative” 2005; Buxheli L., “Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe”, 2007

## **6.2 CAKTIMI I RASËS DHANORE NË NDËRTIMET ME FOLJE TREVALENTE NË GJUHËN ANGLEZE.**

Në gjuhën angleze, ndryshe nga ajo shqipe, do të përballemi me një përdorim të alternuar të SE në dhanore e cila për një grup foljesh del në dy variante realizimi të ndryshme. Më konkretisht, ndërtimet me folje ditranzitive të gjuhës angleze shfaqen në dy konfigurime të ndryshme sintaksore, herë si ndërtime me dy kundrina (*double object construction*) dhe herë si ndërtime parafjalore në të cilat kundrina e zhdrejtë paraprihet nga parafjala “to”.

*Shembull*

151.a Martha gave **Mirna** a letter.

151.b Martha gave a letter **to Mirna**.

Këto dy variante alternative janë bërë objekt diskutimi, pasi për to janë ngritur pyetjet:

A janë këto dy variante semantikisht ekuivalente? A kanë të njëjtën strukturë? Çfarë modeli të caktimit rasor përfaqësojnë ato?

Përsa i përket pyetjes së parë, edhe pse këto dy variante lejojnë dy realizime të ndryshme argumentale, ato janë semantikisht ekuivalente për arsye se SE argumente të këtyre dy fjalive, pasi marin pjesë në të njëjtin veprim, rrjedhimisht u caktohen të njëjtat role tematike<sup>157</sup>. Nisur nga ky argumentim, jo pa të drejtë mendojmë se kjo ngjashmëri duhet të reflektohet edhe në strukturimin sintaksor të këtyre dy varianteve.

Para se të kalojmë te strukturimi i këtyre dy ndërtimeve më parë duhet të ndalemi te ndërtimet me dy kundrina për të cilat ngrihet një problem. Konkretisht, kur kemi folur për caktimin e rasës kallëzore fillimisht kemi pranuar caktimin e kësaj të fundit nga foljet kalimtare SE argument i brendshëm në pozicionin e plotësorit të kokës F<sup>0</sup>. Për më tepër, kemi cituar gjithashtu që për caktimin e kësaj rase duhet të plotësohen dy kushte ai i drejtimit dhe i fqinjësisë. Në shembujt e mësipërm pozicionimi i kundrinorit të zhdrejtë midis predikatit dhe kundrinorit të drejtë bën që për caktimin e rasës kallëzore këtij të fundit të mos përmbushet kushti i fqinjësisë, si rrjedhim jo pa të drejtë nga Chomsky<sup>158</sup> hidhet mendimi që SE “a letter” në

---

<sup>157</sup> Jackendof (1983) dhe Baker (1988) propozojnë se këto dy variante sipas “Uniformity of theta assignment” (caktimit të roleve tematike të njëjta), shprehin një kuptim të vetëm dhe shihen si variante të prejardhura të strukturës bazë me përbërës parafjalor abstrakt.

Hovav R.M. “English dative alternation: The case of verbs of sensitivity”, Journal of linguistics, 2008


<sup>158</sup> Vasquez E., “Case assignment in double object constructions”, Revista Alicantina de Estudios Ingleses, 1997.

shembullin 151.b i caktohet rasë inherente. Ne kemi pranuar që caktimi i rasës kallëzore SE argument i brendshëm realizohet brenda një pozicioni strukturor të caktuar pa u ndikuar nga caktimi i rolit tematik. Gjithashtu dimë që caktimi rasor inherent lidhet pazgjidhshmërisht me rolin tematik që i caktohet kësaj SE.

Pra, arsyetojmë se SE “*a letter*”, qoftë në shembullin 151.a në të cilin ajo shfaqet e pozicionuar në pozicionin e argumentit të brendshëm të foljes (përmbushet kriteri i fqinjësisë), qoftë në shembullin 151.b në të cilin ajo shfaqet e pozicionuar pas SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë (nuk përmbushet kriteri i fqinjësisë) ajo merr rasë kallëzore strukturore, pasi kësaj SE nuk mund t’i caktohet rasë inherente.

Justin Rill (2011)<sup>159</sup> në mbështetje të mendimit të mësipërm propozon se për këto ndërtime ditranzitive të gjuhës angleze caktimi i rasës SE argumente të brendshme i plotëson të dy kushtet si atë të drejtimit dhe atë të fqinjësisë. Për të vërtetuar përmbushjen e këtyre dy kriterëve ai argumenton se koka foljore së bashku me argumentin e saj të brendshëm kundrinor i zhdrejtë formon një strukturë komplekse të njohur si **predikat kompleks**. Folja kallëzues e pozicionuar në kokën F<sup>0</sup> e drejton dhe i cakton rasë SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë. Ky predikat kompleks ( i përbërë nga koka foljore dhe argumenti i brendshëm kundrinor i zhdrejtë) do të lidhet me SE argument i brendshëm kundrinor i drejtë të cilën, jo vetëm që e drejton, por i cakton edhe rasë. Ky konfigurim dhe strukturim i SE argumente të brendshme të foljes i kënaq të dyja kushtet për caktimin e rasës dhanore SE “*Mirna*” dhe asaj kallëzore SE “*a letter*”.

**Skema 44**



<sup>159</sup> Rill J., “*A unified analysis of Dative shift in English and the applicative construction in Chichewa*”, Master Thesis, 2011

Ky propozim, edhe pse mund të konsiderohet një zgjidhje e pranueshme, nuk përkrahet e as përqafohet, por mbetet thjesht në kuadrin e një propozimi të mundshëm.

Në kërkim të zgjidhjeve, jo vetëm të mundshme, por edhe të debatueshme dhe universale do të duhet t'i rikthehemi sërisht shembujve me folje trivalente të cilat për të plotësuar strukturën e tyre argumentale pranojnë një argument të jashtëm (SE kryefjalë në rasë emërore) dhe dy argumente të brendshëm (SE kundrinor i drejtë në rasë kallëzore dhe SE kundrinor i zhdrejtë në rasë dhanore). Këto folje u caktojnë atyre, përkatësisht rolet tematike të vepruesit (SE kryefjalë), të temës (SE kundrinor i drejtë) dhe të përfituesit (SE kundrinor i zhdrejtë). Të njëjtat role tematike u caktohen të njëjtave SE argumente të foljes edhe në variantin parafjalor.

*Shembull*

152.a	<b>Mary</b>	gave	<i>a letter</i>	<b><u>to Mirna</u></b>
	Veprues		Temë	Përfitues
152.b	<b>Mary</b>	gave	<b><u>Mirna</u></b>	<i>a letter</i>
	Veprues		Përfitues	Temë

Duke qënë se midis këtyre dy shembujve nuk ekzistojnë ndryshime në rrafshin semantik, atëherë një prej hipotezave të hedhura mbi strukturimin dhe caktimin rasor SE argumente të brendshme, do të pranonte si strukturë të thellë sa më poshtë:

*Shembull*

153.a Mary gave (SP (P0)) a letter to Mirna

Sipas këtij strukturimi, struktura e thellë e të dy ndërtimeve të mësipërme (152.a; 152.b) pranon ekzistencën e një sintagme parafjalore të padukshme të pozicionuar para të dy kundrinave (153.a). Kjo SP e padukshme nuk ndikon në caktimin rasor strukturor. Lëvizja e SP “*to Mirna*” nuk është e detyrueshme, por në rastet kur kjo zhvendosje kryhet ne do të përfitojmë dy variante të ndryshme të përfaqësimit në strukturën sipërfaqësore. Kur kjo SE do të zhvendoset, do të përfitohet ndërtimi:

*Shembull*

154.a Mary gave Mirna a letter.

Në këtë nivel përfaqësimi sipërfaqësor parafjala “*to*” nuk do të shfaqet ajo do të konsiderohet një kategori semantike boshe. Nga ana tjetër, nëse SP “*to Mirna*” nuk do të zhvendoset, atëherë do të përfitohet ndërtimi:



*Shembull*

154.b Mary gave a letter to Mirna

Për rastet e zhvendosjes SE “*Mirna*” nuk e thyen kushtin e filtrit rasor, pasi asaj i është caktuar rasa dhanore nga parafjala “*to*” para se ajo të zhvendosej, duke bërë që folja “*give*” t’i caktojë rasë kallëzore argumentit të saj të brendshëm “*a letter*”. Pra, folja “*give*” dhe argumenti i saj i brendshëm “*a letter*” përmbushin si kushtin e drejtimit dhe atë të fqinjësisë, pasi SP përbën një sintagmë të padukshme duke mos penguar caktimin e rasës strukturore kallëzore argumentit të brendshëm “*a letter*”. Nga ana tjetër, SE “*Mirna*” edhe pse argument i brendshëm i foljes, nuk mund t’i caktohet rasë strukturore.

*Shembull*

155.a Mary gave a letter.

155.b \*Mary gave Mirna.

Në shembullin 155.b, edhe pse kjo SE në pozicionin e plotësorit të foljes, duke plotësuar si kushtin e drejtimit dhe atë të fqinjësisë nuk mund të marrë rasë, fakt i vërtetuar nga jogramatikaliteti i kësaj fjalie.


Caktimi rasor kësaj SE kryhet nga parafjala “*to*” funksioni i vetëm i së cilës është caktimi/markimi rasor pa pasur asnjë vlerë semantike. Edhe gjatë zhvendosjes kjo SP “*to Mirna*” realizohet në një pozicion të prejardhur, i cili nuk lidhet me caktimin rasor.

Sa më sipër njihet si hipoteza e “**Unifikimit me anë të zhvendosjes të SP**”<sup>160</sup> e cila pranon caktimin e rasës dhanore nga parafjala “*to*” në ndërtimet parafjalore, ku këto të fundit përbëjnë strukturën e thellë. Për ndërtimet e prejardhura me dy kundrinorë të cilët përbëjnë strukturën sipërfaqësore pranohet zhvendosja e SE “*Mirna*”, e pajisur tashmë me rasë dhanore, në pozicionin e plotësorit të foljes. Midis foljes dhe dy argumenteve të brendshëm pranohet gjithashtu ekzistenca e një SP të padukshme e cila shfaqet vetëm gjatë zhvendosjes, pa ndikuar në caktimin rasor.

---

<sup>160</sup> Vasquez E., “*Case assignment in double object constructions*”, Revista Alicantina de Estudios Ingleses, 1997

**Skema 45**



Në vijim, nisur edhe nga ngjashmëria semantike që ekziston midis këtyre dy ndërtimeve, na vjen një propozim tjetër deri diku i përafërt me sa më sipër mbi caktimin rasor dhe strukturimin sintaksor të të dy argumenteve të brendshëm.

Larson (1988)<sup>161</sup> mbështet idenë e prejardhjes së ndërtimeve me dy kundrina nga ndërtimet parafjalore. Kjo bindje e tij lidhet ngushtë edhe me rolet tematike të njëjta që u caktohen SE argumente të foljes në këto dy ndërtime alternative. Pra, SE argumente, duke qënë se përfshihen në të njëjtën veprimtari semantike, u caktohet i njëjti rol tematik dhe si e tillë strukturimi i këtyre dy fjalive duhet të jetë i njëjtë, të paktën përsa i përket rrafshit semantik. Larson (1988) ndërtimet me folje ditranzitive, duke pranuar prejardhen e tyre nga ndërtimet parafjalore, i analizon sipas dukurisë së “**Heavy NP Shift**”<sup>162</sup> (zhvendosja e SE të fortë) dhe dukurisë “**Light verb raising**”

<sup>161</sup> Hovav R.M. “English dative alternation: The case of verbs of sensitivity”, Journal of linguistics, 2008.

Larson R., "On the double object constructions" Linguistic Inquiry, Volume 19, Nr 3, fq 335-391, 1988.

<sup>162</sup> Rill J., “A unified analysis of Dative shift in English and the applicative construction in Chichewa”, Master Thesis, 2011


<sup>163</sup>(ngritja e foljes së dobët) sipas së cilave folja e realizuar në kokën F<sup>0</sup> së bashku me argumentin e saj (SE të parë të pozicionuar në të djathtë) formon një kombinim kompleks i cili i nënshtrohet lëvizjes nga koka në kokë. Si rezultat i kësaj lëvizjeje ky kombinim kompleks zhvendoset drejt kokës f<sup>0164</sup>.

*Shembull*

156.a I gave everything to John.

156.b I gave John everything.

**Skema 46**




Po Larson (1988) ofron edhe një propozim të dytë duke e trajtuar caktimin rasor të ndërtimit me dy kundrina të njëjtë me modelin e caktimit rasor për ndërtimet me folje kallëzues në pësore.

*Shembull.*

157.a Mary gave Mirna a letter.

<sup>163</sup> Po aty  
<sup>164</sup> Po aty

**Skema 47**



Sipas strukturimit X' të mësipërm SE subjekti i SF (SE “*temë*” a letter) lidhet si plotësor në të djathtë. Sipas përgjithësimin të Burzio (1986) folja “*give*” nuk mund t’i caktojë rasë komplementit të saj. Për këtë arsye SE “*Mirna*” duhet të zhvendoset drejt SpecSF për të marrë rasë (siç ndodh me kalimin nga ndërtime veprorë në pësore ku SE argumenti i brendshëm kundrinor i drejtë nuk mund t’i caktohet rasë nga folja kallëzues në pësore). Këto ndërtime (ashtu si dhe ndërtimet në pësore) karakterizohen nga tërheqja e SE kundrinor i zhdrejtë drejt pozicionit të SE subjekti (Spec SF) si dhe nga trysnia që ushtrohet nga folja kallëzues mbi rolin tematik të vepruesit që i caktohet SE në pozicionin e subjektit. Ndryshimi i vetëm midis ndërtimeve me dy kundrina dhe atyre pësore qëndron në faktin se rrafshi i caktimit rasor SE kundrinor i drejtë në ndërtimet pësore është ai SEpt, ndërsa rrafshi i caktimit rasor SE kundrinor i zhdrejtë për ndërtimet me dy kundrina është ai i SF.


Baker (1988)<sup>165</sup>, e trajton caktimin e rasës dhanore duke e konsideruar atë si rasë të absorbuar nga folja kallëzues të cilën e licenson vetëm ndërfutja e parafjalës. Në këtë kontekst, argumenti i brendshëm “*temë*” duhet të zhvendoset drejt një pozicioni jashtë SF të brendashtresuar për të marrë dhe kontrolluar rasën kallëzore.

<sup>165</sup> Baker M., “*Thematic roles and syntactic structure*”, Artikull në seminarin e sintaksës në Universitetin Mc Gill, vol 2, 1996.

Hovav R. M., “*The English dative alternation. The case for verbs sensitivity*”, Journal of linguistics, 2008

Rill J., “*A unified analysis of dative shift in English and the applicative construction in Chichewa*”, Master thesis 2011.

Skema 48



Pra, në kokën  $f^0$  të projeksonit Sf pretendohet prania e elementit parafjalor bosh si markues i rasës dhanore. SE “a letter” e cila gjatë zhvendosjes së argumentit të brendshëm nuk lëviz, shfaqet e pozicionuar në projeksinin e ulët SF në pozicion specifikuesi.


Propozimet e mësipërme i trajtojnë ndërtimet me dy kundrina dhe ato parafjalore të gjuhës angleze si ndërtime simetrikisht të njëjta. Kjo simetri lidhet me kuptimin semantik që ato shprehin i cili përbën një faktor influencues për mbërritjen te propozimi sipas të cilit edhe struktura e thellë e tyre duhet të jetë e njëjtë. Veçoritë karakteristike të këtyre propozimeve gjeneruese përmblihen:

- Së pari, pranohet ndërtimi parafjalor si strukturë e thellë, ndërsa ndërtimi me dy kundrina si ndërtim i prejardhur.
- Së dyti, pranohet ngjashmëria e strukturimit të argumenteve gjatë kalimit nga ndërtimi parafjalor në atë me dy kundrinorë me kalimin nga ndërtimet veprorë në ato pësore. Në këtë pike pranohet absorbimi i rolit tematik të jashtëm dhe i rasës dhanore.

- Pranohet caktimi i rasës dhanore nga parafjala “to” e cila në analizën e parë pretendohet se përfaqësohet nga një projektion SP i zbrazët hipotetik i pozicionuar para dy argumenteve të brendshëm për të siguruar caktimin e kësaj rase edhe pas zhvendosjes të kësaj SE, ndërsa në analizën e fundit hedhur nga Baker (1988) në kokën F<sup>0</sup> të projektionit SF pranohet ekzistenca e zbrazët e këtij elementi parafjalor për të njëjtin qëllim.

Ura (1996;1999; 2000; 2001)<sup>166</sup> ndjek një drejtim të kundërt, pasi sipas tij edhe pse këto dy ndërtime janë pranuar si ndërtime semantike simetrike, ato nuk janë kryekëput të tilla<sup>167</sup>. Midis tyre ekzistojnë nuanca kuptimore të ndryshme të cilat lidhen me qëllimin e theksimit, nxjerrjes në pah të njërit prej argumenteve të brendshëm si më të rëndësishëm nga konteksti a situata e përdorimit. Ky studiu i përkushtohet vetëm ndërtimeve me dy kundrina dhe jo atyre parafjalore, pasi për këto të fundit është parafjala që i cakton rasë dhanore SE kundrinor i zhdrejtë. Ura (1996;1999; 2000; 2001) caktimin rasor SE argumente të foljes në ndërtimet me dy kundrina të gjuhës angleze e sheh disi të ndërlikuar, por jo të pamundur. Fillimisht ai zgjidhjen e gjen te propozimi i tij i projektionit leksikor SF me specifikues të shumëfishtë.

**Skema 49**




Sipas këtij strukturimi SE kundrinor i drejtë do të realizohet në pozicionin më të ulët të specifikuesit në të cilin do t'i caktohet roli tematik nga folja kallëzues e fjalisë, ndërsa SE kundrinor i zhdrejtë do të realizohet në pozicionin më të lartë të specifikuesit, ku do t'i caktohet

<sup>166</sup> Inoue K., “Case (with special reference to Chinese)”, The Blackwell Companion to Syntax, 2005  
<sup>167</sup> Ura për asimetritë e ndërtimeve të mësipërme i referohet propozime të Hyle& Keyser (2003) si dhe Pinker (1998). Hovav R. M., “The English dative alternation. The case for verbs sensitivity”, Journal of linguistics, 2008

roli tematik i përfituesit nga folja kallëzues. Një projektim i tillë do ta bënte më të lehtë zhvendosjen e SE argumente të brendshëm të foljeve nga pozicionet semantike ku u caktohet roli tematik drejt pozicioneve të specifikuesit të projeksioneve funksionale ku u caktohet rasa përkatëse.

Ura (1996;1999; 2000; 2001) duke e përpunuar më tej këtë model të tij gjenerues del me një propozim të dytë sipas së cilit ndarja e SF, përveç SF më të ulët dhe Sf më të lartë, duhet të përfshijë edhe një projeksion të ndërmjetëm leksikor foljor të cilin e shënon me  $Sf_{mes}$ . Në pozicionin e specifikuesit të  $Sf_{mes}$  do të gjenerohet SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë për të marrë rolin tematik të vepruesit.

### Skema 50




Këtij propozimi Ura (1996;1999; 2000; 2001) i bashkëngjit propozimin e Chomsky (1997) që lidhet me gjenerimin e projeksioneve funksionale të përshtatjes, përgjegjëse për licensimin e treguesve morfosintaksorë, duke i dhënë kështu zgjidhje përfundimtare çështjes mbi gjenerimin e SE argumente të foljes për ndërtimet me dy kundrina të gjuhës angleze. Chomsky (1997) projeksionit të përshtatjes së subjektit SPrKr (të gjeneruar midis projeksionit SKohë dhe Sf) dhe projeksionit të përshtatjes së kundrinorit të drejtë SPrKd (të gjeneruar midis Sf dhe  $Sf_{mes}$ ) i shton edhe një projeksion të tretë të përshtatjes së kundrinorit të zhdrejtë SPrKzh (të gjeneruar midis  $Sf_{mes}$  dhe SF).

Këto propozime risi na bindin përfundimisht se projeksionet leksikore përgjegjëse për caktimin e roleve tematike SE argumente të foljes do të ndërpriten nga projeksione funksionale

***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

përgjegjëse për licensimin e treguesve morfosintaksorë dhe për caktimin e rasës përkatëse. Në këtë kontekst, SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë e realizuar fillimisht në pozicionin e specifikuesit të Sf<sub>mes</sub>, ku i caktohet roli tematik i përfituesit do të zhvendoset drejt pozicionit të specifikuesit të SPrKzh në të cilin i caktohet rasia dhanore.

**Skema 51**





### **6.3 CAKTIMI I RASËS DHANORE SE ARGUMENT I BRENDSHËM NË GJUHËN SHQIPE.**

Caktimi i rasës dhanore në gjuhën shqipe përbën një model të parametrizuar, pasi ai duhet patjetër t'u përshtatet veçorive të kësaj gjuhe.

Ashtu sikundër pohuam në gjuhën angleze, edhe në gjuhën shqipe SE në rasën dhanore semantikisht përbën një argument të brendshëm të foljes të cilit i caktohet roli tematik i përfituesit, ndërsa sintaksorisht ajo përfaqëson kundrinorin e zhdrejtë. Si caktues i kësaj rase (edhe në gjuhën shqipe) fillimisht është pranuar folja kalimtare e zhdrejtë e cila i cakton kësaj SE në pozicionin [SE;SF] rasë dhanore.

Por për caktimin e kësaj rase, përveç pozicionit [SE;SF] kërkohet edhe plotësimi i kriterit të caktimit të rolit semantik të përfituesit që kjo SE e merr nga folja kalimtare e zhdrejtë. Në gjuhën shqipe pozicioni strukturor i argumentit të brendshëm si dhe roli semantik i përfituesit lidhen në mënyrë të pamotivueshme me caktimin e rasës dhanore. Këtë lidhje inherente të rolit semantik të përfituesit me kokën rasëcaktuese e vërteton gjithashtu edhe krahasimi i ndërtimeve veprorë me ato pësore përkatëse<sup>168</sup>.

#### *Shembull*

- |       |                               |         |
|-------|-------------------------------|---------|
| 158.a | Maria i dha një letër Mirnës. | veprorë |
| 158.b | Një letër iu dha Mirnës.      | pësore  |
| 158.c | Mirnës iu dha një letër       | pësore  |

Në ndërtimet pësore të gjuhës shqipe ndryshe nga rasia kallëzore caktuar një SE në strukturën [SE; SF] me rasëcaktues një folje kalimtare të drejtë, rasia dhanore e një SE në [SE; SF] nuk absorbohet prej pësorës së foljeve kalimtare të zhdrejta (shembulli 158.c). Nëse këto ndërtime të gjuhës shqipe do ti krahasojmë me ato të gjuhës angleze do të vërejmë se kjo e fundit si një gjuhë pa fleksion na shfaq një panoramë më të ndërlikuar, pasi është tepër e vështirë të argumentosh nëse rasia dhanore absorbohet apo jo gjatë transformimit të ndërtimeve ditranzitive veprorë në ndërtime pësore.

---

<sup>168</sup> Buxheli L., "Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe" Tiranë 2007, fq 227-229

*Shembull.*

- 158.d Martha gave Mirna a letter                      veprore  
158.e A letter was given to Mirna                      pësore  
158.f Mirna (she) was given a letter.                      pësore

Përsa i përket shembullit 158.e të gjuhës angleze argumentojmë se folja ditranzitive në pësore, pasi absorbon rolin tematik të vepruesit e ka të pamundur caktimin e rasës kallëzore argumentit të saj të brendshëm. Si rezultat kjo folje e tërheq SE argument të brendshëm, të cilës i është caktuar roli tematik i temës nga folja “give” në veprore, drejt pozicionit bosh të SE subjekt duke i caktuar rasë emërore. Përsa i përket shembullit 158.f të gjuhës angleze situata paraqitet e ndërlikuar, pasi folja ditranzitive në pësore absorbon rolin tematik të vepruesit, por nuk absorbon rasën kallëzore. Në këtë ndërtim pranohet se folja në pësore absorbon rasën dhanore vërtetuar gjithashtu edhe nga zëvendësimi i SE “Mirna” me përemrin vetor “she” në emërore. Pra, argumentojmë se folja ‘give’ në pësore në shembullin 158.f absorbon rolin tematik të vepruesit dhe rasën dhanore duke mos ndikuar mbi rasën kallëzore të SE argument i brendshëm “a letter”. Ajo i reziston absorbimit duke bërë që në të njëjtën kohë absorbimi i rolit semantik të jashtëm të mos ndikojë në caktimin e rasës SE që përfaqëson argumentin e brendshëm foljor.

Në shembujt e mësipërm të gjuhës shqipe folja “jap” gjatë kalimit nga ndërtimi vepror në ndërtimet pësore përkatëse absorbon rolin tematik (veprues) të argumentit të jashtëm si dhe rasën kallëzore të argumentit të brendshëm kundrinor i drejtë (në shembullin 158.b). Ndërsa si në shembullin 158.b dhe në atë 158.c ky kalim nga vepror në pësor nuk ka as më të voglin ndikim mbi rolin semantik të përfituesit dhe rrjedhimisht mbi rasën dhanore caktuar argumentit të brendshëm (*Mirnës*).

Nisur nga këta shembuj të gjuhës shqipe është e dukshme lidhja që ekziston midis SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë, rolit semantik të përfituesit si dhe caktimit të rasës dhanore. Por, ky fakt i rolit përcaktues që roli tematik i përfituesit ka mbi caktimin e rasës dhanore ka ndikuar fillimisht në përfshirjen e kësaj rase në grupin e rasave inherente.

Me zhvillimet e mëtejshme që njohu gjuhësia gjenerative dhe që lidhen kryesisht me lindjen e hipotezës së ndarjes së SEpt dhe SF si dhe me lindjen e projeksioneve funksionale të përshtatjes u pranua se SE argumente të foljes u caktohet rasë strukturore.

Një zhvillim i tillë nuk mund të mos prekte edhe caktimin rasor në gjuhën shqipe. Në këtë kontekst, përse i përket caktimit të rasës dhanore SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë në gjuhën shqipe është J. Mita<sup>169</sup> që përfaqon modelin strukturor të caktimit rasor.


Ky studiues, nisur nga hipotezat e mësipërme, argumenton se të gjitha SE argumente të foljes i licensojnë treguesit morfosintaksorë si dhe kontrollojnë rasën duke u zhvendosur nga pozicionet bazë drejt pozicioneve të prejardhura të specifikuesit. Kështu në ndërtimet me dy argumente jo vetëm SE kundrinor i drejtë por edhe SE kundrinor i zhdrejtë për të marrë rasë duhet të zhvendoset drejt një pozicioni specifikuesi më lart brenda sintagmës së përshtatjes së kundrinorit të zhdrejtë SPrKzh.

*Shembull*

159.a Maria i dha një letër Mirnës


Sipas tij folja “*jap*” fillimisht do të kombinohet me SE argument i brendshëm “*një letër*” duke formuar projektionit e ndërmjetëm F’ “*i dha një letër*”.

**Skema 52**



Ky projektion i ndërmjetëm F’ do të kombinohet me SE “*Mirnës*” të realizuar në pozicionin e specifikuesit të SF duke formuar projektionin maksimal SF “*Mirnës i dha një letër*”.


**Skema 53**



<sup>169</sup> Mitaj J., “Hyrje në gjuhësinë gjenerative”, 2005, fq. 102-116


Kjo SF e zgjeruar do të kombinohet me projektionin funksional të përshtatjes së kundrinorit të drejtë SPrKd duke tërhequr drejt kokës PrKd foljen “*jap*” e cila lë një gjurmë në pozicionin bazë. Ky projektion tërheq gjithashtu, për t’i caktuar rasë kallëzore, SE argument të brendshëm “*një letër*” të cilës i është caktuar më parë roli tematik i temës në pozicionin [SE;SF]

**Skema 54**



Më tej, këtij projektioni do t’i bashkangjitet sintagma e përshtatjes së kundrinorit të zhdrejtë e cila do të tërheq foljen “*jap*” në kokën PrKzh<sup>0</sup>, ndërsa në pozicionin e specifikuesit do të zhvendoset SE kundrinor i zhdrejtë “*Mirnes*” së cilës do t’i caktohet rasia dhanore.

**Skema 55**




Folja ‘*jap*’ e këtij ndërtimi do të lidhet me një folje abstrakte të shënjuar “Ø” e cila mbart kuptim shkakor duke formuar projektionin Sf. Pretendohet që kjo folje abstrakte “Ø” i shton ndërtimit të mësipërm vlera shkakore<sup>170</sup> duke bërë që ky ndërtim të interpretohet:

*Shembull*

159.b Maria bëri që Mirnës t’i jepej një letër.

Në kokën f<sup>0</sup> të Sf do të tërhiqet folja “*jap*” e cila do të kombinohet me markuesin shkakor “Ø”. Në pozicionin e specifikuesit të Sf do të gjenerohet SE subjekt “*Maria*” të cilës në këtë pozicion do t’i caktohet roli tematik i vepruesit.

**Skema 56**



Si përfundim struktura Sf e përfutur deri tani në të cilën janë projektuar të tre argumentet e foljes do t’i bashkëngjitet projektionit funksional të përshtatjes së kryefjalës (SPrKr) (në pozicionin e specifikuesit të së cilës do të zhvendoset SE subjekt “*Maria*” për të marrë rasë emërore) si dhe projektionit SEpt. Projektioni SEpt përbëhet nga dy projeksione funksionale

<sup>170</sup> Mitaj J., “Hyrye në gjuhësinë gjenerative”, 2005, fq. 102-116

SKohë (në të cilin licensohen treguesit kohorë të foljes) dhe SPr (në të cilin licensohen treguesit e vetës) të cilat për efekt hapësire do t'i paraqesim si tipare me vlera pozitive brenda projekcionit SEpt.

Ky propozim i J. Mitës (2005)<sup>171</sup> i cili përputhet në një farë mase me propozimin e Larson (1988) është i dyshimtë, pasi J. Mita (2005) nuk argumenton zhvendosjen e SE argument i brendshëm kundrinor i drejtë nga pozicioni [SE; SF] drejt pozicionit SpecSPrKd duke kapërcyer pozicionin SpecSF. Së dyti, zhvendosja e SE argument i brendshëm kundrinor i drejtë nga një pozicion koke drejt një pozicioni specifikuesi mbetet e papërligjur. Për këtë arsye për të njëjtat ndërtime me folje trivalente të gjuhës shqipe, mendoj se do të ishte më i drejtë propozimi i Ura-s. Pra, të pranohet gjenerimin e një Sf<sub>mes</sub> të ndërmjetme në pozicionin e specifikuesit të së cilës do të gjenerohet SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë për të marrë rolin tematik të përfituesit.

Gjithashtu lindja e projeksioneve funksionale të përshtatjes së argumenteve të foljes do të bënte që kjo SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë e realizuar fillimisht në pozicionin e specifikuesit të projekcionit leksikor Sf<sub>mes</sub> të zhvendoset drejt pozicionit të specifikuesit të projekcionit funksional SPrKzh, ku do t'i caktohet rasia dhanore.

---

<sup>171</sup> Mitaj J., "Hyrje në sintaksën gjenerative", Prishtinë, 2005, fq 109-115



pozicionet e specifikuesve të së cilave do të zhvendosen SE argumente të foljes për të kontrolluar rasën përkatëse.

Ky model i caktimit rasor në pozicionin e specifikuesit të projeksioneve funksionale të përshtatjes përfaqëson gjërësisht dhe kryesisht modelin strukturor të caktimit rasor. Si e tillë rasat emërore, kallëzore dhe së fundmi rasa dhanore përfshihen në të ashtuquajturat rasa strukturore. Kjo risi vlen më tepër për rasën dhanore e cila fillimisht shihej si rasë inherente për shkak të lidhjes që ekziston midis SE që mban këtë rasë dhe rolit tematik të përfituesit. Falë zhvillimeve të mësipërme që prekën gjuhësinë gjenerative, të cilat lidheshin me caktimin e saj në një pozicion të caktuar, u propozua se SE kundrinor i zhdrejtë i caktohet rasë dhanore strukturore (jo inherente).

Mendoj se është më se e pranueshme përfshirja e të tre këtyre rasave në grupin e rasave strukturore (pavarësisht rolit tematik), pasi ato u caktohen SE të njohura si argumente të foljes. Për më tepër këto SE bashkohen nën një emërues të përbashkët “plotësor”.



## ***PËRFUNDIME***

SE në rasë dhanore identifikon personin ose objektin i cili ndikohet indirekt nga veprimi i shprehur nga folja.

Kjo SE përfaqëson argumentin e brendshëm të cilit i caktohet roli tematik i përfituesit. Gjithashtu kjo SE kryen funksionin e kundrinorit të zhdrejtë. Si në gjuhën angleze dhe në atë shqipe argumenti i brendshëm kundrinor i zhdrejtë shfaqet i përdorur kryesisht me folje trivalente të cilat marrin një argument të jashtëm dhe dy të brendshëm.

Në gjuhën angleze këto ndërtime tre argumentale shfaqen në dy variante: së pari si argument i brendshëm i paraprirë nga parafjala “to” dhe në variantin e dytë me dy kundrina ku i zhdrejti renditet para të drejtit.

### *Shembull*

- 1.a Martha gave an apple to Mirna
- 1.b Martha gave Mirna an apple

Duke qënë se midis këtyre ndërtimeve nuk ekzistojnë ndryshime në rrafshin semantik, atëherë pranohet se shembulli i dytë me dy kundrina përbën një ndërtim treargumental të prejardhur nga ndërtimi parafjalor me ‘to’. Për këtë arsye midis këtyre dy SE kundrinor (i drejtë dhe i zhdrejtë) do të pranohet gjenerimi i një SP të padukshme në kokën  $P^0$  të së cilës pretendohet gjenerimi i kokës parafjalore (edhe në rastet kur ajo është një kategori e zbrazët), ndërsa në projeksionin SE plotësor të kokës  $P^0$  do të gjenerohet SE në rasë dhanore. Kjo strukturë do të përbëjë strukturën e thellë në të cilën kësaj SE do t’i caktohet rasë nga koka  $P^0$ . Pas pajisjes me rasë kjo SE do të zhvendoset drejt një pozicioni tjetër për të dhënë variantin e dytë me dy kundrina.

Një propozim i dytë vjen nga Larson (1988) me ndarjen e SF i cili propozon se në pozicionin e specifikuesit të SF më të ulët do të realizohet SE argument i brendshëm kundrinor i zhdrejtë e cila më pas do të zhvendoset drejt pozicionit të projeksionit funksional sintagmë e përshtatjes së kundrinorit të zhdrejtë SPrKzh. Në këtë pozicion specifikuesi kjo SE do të marrë rasë dhanore.

Midis SE në rasë dhanore dhe rolit tematik të përfituesit ekziston një lidhje e fortë duke krijuar bindjen se ky model caktimi rasor përbën një model inherent. Por, Chomsky edhe pse

***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përfaqje me gjuhën shqipe.***

---

fillimisht ishte i këtij mendimi, pas propozimit të tij të gjenerimit të argumenteve të foljes në pozicion specifikuesi propozoi dhe gjithashtu mbështeti caktimin rasor strukturor të rasës dhanore në konfiguracionin specifikues-kokë. Ky propozim i Chomskit u përpunua edhe më tej nga Ura i cili propozon ndarjen e projeksionit leksikor SF në tre të tillë (Sf; Sfmes dhe SF) në pozicionet e specifikuesve të së cilëve do të realizohen SE argumente të foljes për të marrë rol tematik. Më tej këto SE argumente do të zhvendosen drejt projeksioneve funksionale (SPrKr; SprKzh; SprKd) për të licensuar treguesit morfosintaksorë si dhe për t'iu caktuar rasi përkatëse.

## KREU VII

### RASA GJINORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ

#### 7.1 RASA GJINORE. NJOHURI TË PËRGJITHSHME.

Si në gjuhën angleze dhe atë shqipe rasa gjinore zë një vend të veçantë duke pësuar ndryshime të dukshme në krahasim me gjëndjen e saj burimore, ndryshime këto që janë të mirëdokumentuara historikisht në të dyja gjuhët. Në pjesën e parë të këtij kreu do të japim disa njohuri të përgjithshme mbi këtë rasë disi të ndërlikuar. Në fazat e hershme ajo që e bënte një gjinore të tillë ishte pozicioni që zinte emri i përcaktuar në lidhje me emrin që e përcaktonte, pozicion ky që për gjuhë të ndryshme është i ndryshëm. Disa gjuhëtarë pranojnë si renditjen më të përshtatshme përcaktues-i përcaktuar (tipike për ndërtimet ‘s të gjuhës angleze) i cili, edhe pse për gjuhën shqipe përbën një rend të pazakontë, mendohet të ketë qënë i mundshëm në hershmërinë e saj<sup>172</sup>.

Duke qënë se, si gjuha angleze dhe gjuha shqipe, siç kemi theksuar edhe në kretë e mëparshëm, përbëjnë përkatësisht një gjuhë analitike përkundrajt një gjuhe sintetike, ato sjellin modele të ndryshme në ndërtimin e rasës gjinore. Në gjuhën angleze, për shprehjen e marrëdhënieve karakteristike të ndërtimeve emërore në rasë gjinore kemi dy struktura: gjinoren posesive me ‘s dhe strukturën parafjalore me –of. Ndërsa, në gjuhën shqipe kemi të bëjmë me një gjinore lokucionale në përbërjen e së cilës hasim praninë e nyjës së përparme “i, e, të, së” e cila përbën treguesin kryesor të rasës gjinore, pasi treguesit gramatikorë të numrit dhe gjinisë i shpreh nyja e prapavendosur që është e njëjtë edhe për rasat e tjera si rasa dhanore dhe rrjedhore. Përsa i përket përkufizimit të kësaj rase mjaftohemi me pohimin<sup>173</sup> se rasa gjinore përfaqëson atë SE e cila modifikon një SE tjetër duke shprehur kryesisht marrëdhënie pronësie midis tyre. Nga ana tjetër, me anë të këtyre ndërtimeve shprehen edhe një sërë marrëdhëniesh të tjera si: marrëdhënie farefisnie, marrëdhënie të pjesës me të tërën, të pjesëve të trupit të cilat në gjuhën

---

<sup>172</sup> Likaj E., “Mbi formimin e gjinores së emrave në gjuhën shqipe” Studime Filologjike, 1998, Nr 3-4, fq 125

<sup>173</sup> Walk CH., Bresnan J., Rosenbach A., Szmrecsanyi B., “Dative and genitive variability in Late Modern English. Exploring cross-constructed variation and change”, marrë nga web.stanford.edu/bresnan/WBRS Akademia e shkencave të Shqipërisë “Gramatika e gjuhës shqipe I” 2002 (per gjuhën shqipe)

angleze favorizojnë përdorimin e 's gjinore. Të gjitha marrëdhëniet e tjera që vlerësohen si jotopike realizohen më tepër me përdorimin e parafjalës *-of*.

### **7.1.1 ZHVILLIMI HISTORIK I RASËS GJINORE NË GJUHËN ANGLEZE.**

Në gjuhën angleze qysh prej shek IX si ndërtimet gjinore të realizuara morfologjikisht (me anë të 's) edhe ato të realizuara si rezultat i përdorimit të parafjalës *-of* kanë bashkëzistuar. Si varianti më i përgjithshëm është pranuar gjinorja morfologjike, pasi në periudhat e hershme të zhvillimit të saj gjuha angleze ka qënë një gjuhë sintetike.

Në anglishten e vjetër (OE) rasa gjinore, përveç faktit të bashkimit të dy përbërësve emëror duke formuar një përbërës emëror të vetëm më të zgjeruar, i njohur ky i fundit si gjinore emërore (adnominal genitive), i ka rezistuar ndryshimeve deri në ditë e sotme si:

*Shembull*

160.a John's book.

Nga ana tjetër në këtë periudhë (OE) nuk mungojnë ndërtimet në të cilat një përbërës emëror në gjinore lidhet me një folje si komponent i saj duke formuar një gjinore foljore (adverbial genitive) si:

*Shembull*

161.a Pæs hælendes moder (adnominal genitive)

The saivor's mother

161.b On ðisum life we behafiað hlafes & lares and huselganges (adverbial genitive)

In this life we need bread, teaching and communication<sup>174</sup>.

Shembujt e mësipërm, në të cilët emri në rasën gjinore mund të identifikohet nga mbaresa *-es* e kësaj rase, përbëjnë më së miri një dëshmi për të vërtetuar se anglishtja e vjetër përbën një gjuhë eptimore ku mbaresat rasore ndryshojnë në varësi të numrit, gjinisë dhe lakimit.

Në varësi të lakimit të emrit për rasën gjinore në numrin njëjës do të kemi këto mbaresa:

---

<sup>174</sup> Koike I., "The history of genitive case in English as a grammaticalisation of the determinative function", English Language and Linguistics, 2006, Cambridge University Press

Mbaresa e rasës gjinore

-es	cuning - cuninges – king
-e	giefu – giefe – gift
-an	guma – guman – man
-Ø	fæder – fæderØ – father
-a	sunu – suna – son

Në varësi të lakimit të emrit për rasën gjinore në numrin shumës do të kemi këto mbaresa:

-a	cuning – cuninga – king
-ena	guma - gumena – man <sup>175</sup>

Në anglishten e vjetër rása gjinore ishte pjesë e një sistemi, ku marrëdhinet midis SE të një fjalie realizoheshin nëpërmjet eptimit. Gjatë fundit të periudhës së anglishtes së vjetër ky sistem i pasur eptimor i gjuhës angleze si shënjeshtër i marrëdhënieve gramatikore dhe semantike filloi të zbehej deri në humbje, proces ky që pashmangshmërisht preku edhe rasën gjinore. Si fillim ranë të gjitha mbaresat eptimore të mësipërme të diferencuara sipas lakimit, numrit dhe gjinisë të rasës gjinore të cilat u njehsuan me mbaresën *-es* të numrit njëjës të po kësaj rase. Gjatë periudhës së anglishtes mesjetare zanorja *-e* e mbaresës *-es* të rasës gjinore të numrit njëjës bie dhe zëvendësohet nga apostrofi. Po gjatë kësaj periudhe u vu re një zbehje në sistemin eptimor në përgjithësi e cila ndikoi në rritjen e rëndësisë së rendit të ngulitur të fjalëve duke shkaktuar zhdukjen gjatë viteve 1200 të gjinorës së prapavendosur dhe zëvendësimin e saj aty nga vitet 1300 me një gjinore në pozicion paraemëror. Gjatë viteve 1200-1300<sup>176</sup> njohu ngritje përdorimi parafjalor i gjinorës, tendencë kjo që gjithashtu ndikoi në zbehjen deri në zhdukje të gjinorës eptimore. Por, në fillim të periudhës së anglishtes moderne (ME) (aty nga shek XIV) gjinorja posesive me *-’s* fitoi teren duke u përdorur gjithashtu edhe në shkrimet publicistike. Ky model i të ndërtuarit të rasës gjinore i ka rezistuar kohës duke ardhur e pandryshuar në anglishten e ditëve të sotme. Ajo që e karakterizon markuesin *’s* të rasës gjinore është shfaqja e tij e veçuar nga tema e fjalës dhe vendosja menjëherë pas gjithë përbërësit emëror në gjinore duke humbur karakteristikat ndajshesore, gjurmë të të cilave i hasim vetëm në ndërtimet emërore, ku SE në gjinore është në numrin shumës.

---

<sup>175</sup> Koike I., “*The history of genitive case in English as a grammaticalisation of the determinative function*”, English Language and Linguistics, 2006, Cambridge University Press

<sup>176</sup> Kreyer R., *Genitive and –of constructions in modern written English. Processability and human involvement*”, International Journal of Corpus Linguistics, 2003 (pdf from sjsu.edu)

Përsa i përket variantit 's të realizimit të gjinore posesive në gjuhën angleze nuk mund të përcaktohet me saktësi se kur ky variant njohu ngritje dhe zhvillim. Ajo që është e dokumentuar lidhet me momentin e largimit të 's nga kategoria e mbaresave morfologjike dhe sjellja e saj si klitik. Për më tepër gjatë shek. XIV dhe XVII<sup>177</sup> hasen gjurmë të një përdorimi tranzicional të 's si mbaresë eptimore në zbehje dhe si element klitik në zhvillim. Me termin klitik do të nënkuptohet ajo klasë morfemash të lidhura të cilat lidhen me fjalë të pavarura nëpërmjet rregullave sintaksore. Në këtë kontekst, ajo nuk përbën një mbaresë eptimore, por përkundrazi ajo përbën një klitik të prapavendosur me funksion të njëjtë me atë të parafjalës, përveç faktit se ajo i prapavendoset një emri. Në përgjithësi, markuesi –'s do të përshkruhet si një element që nuk gëzon pavarësinë e një emri, por që nga të njëjtat rregulla pozicionohet si fjalë e pavarur. Kjo logjikë e ndjekur e kalimit të një morfeme eptimore në një klitik, nëse vërtet ka ndodhur kështu, është e pazakontë. Prejardhja historike e markuesit të rasës gjinore -'s nga morfema eptimore –es e të njëjtës rasë të anglishtes së vjetër përfaqëson një zhvillim historik të kalimit të një elementi morfologjik në një element sintaksor (e kundërta mund të jetë gjithashtu e mundshme).

Një teori e dytë simetrikisht e mundshme përse i përket prejardhjes së markuesit -'s të rasës gjinore vjen nga Kellner (1956)<sup>178</sup> i cili pranon prejardhjen e këtij markuesi nga përdorimi i përemrit pronor të vetës së tretë njëjës mashkullor pas SE e cila shpreh pronarin. Ky përdorim i dedikohet faktit se nga të gjithë përemrat pronor ai i vetës së tretë njëjës "his" përdorej më dendur pavarësisht kategorisë së numrit, vetës apo gjinisë së pronorit si:

*Shembull*

- 162.a be John Poston **is** wordys (by John Poston's words)  
162.b to defende othir men **is** causis (to defend other men's causis)  
162.c I dide myn maisteress youre moder **is** erandis (I did my mistress, your mother's errands).

Ai gjithashtu argumenton se përdorimi i pronorit "his" lindi si nevojë për të plotësuar boshllëkun e krijuar nga zbehja dhe zhdukja e mbaresave eptimore. Nga ana tjetër, përdorimi i mësipërm, për një periudhë të shkurtër dhe mostrasformimi i saj asnjëherë në një formë përgjithësuese, e vë në pikëpyetje prejardhjen e -'s nga përemri pronor "his". Në këtë kontekst,

---

<sup>177</sup> Rosenbach A., "Aspect of iconicity and economy in the choice between 's genitive and –of genitive of English", Topics of English language, 2003

<sup>178</sup> Koike I., "The history of genitive case in English as a grammaticalisation of the determinative function" English Language and Linguistics, 2006, Cambridge University Press

do të duhej të pranohej e njëjta strukturë edhe për përemrat pronor “her” dhe “their” për të cilat me të drejtë do të kishim \**“the queen’r children”*, strukturë kjo që nuk haset në asnjë dokument historik<sup>179</sup>.

Duke përfunduar, vlen të theksojmë se pavarësisht prejardhjes së markuesit –‘s të rasës gjinore ky i fundit identifikon marrëdhëniet midis pronarit të paravendosur dhe pronës së prapavendosur.

### **7.1.2 ZHVILLIMI HISTORIK I RASËS GJINORE NË GJUHËN SHQIPE.**

Në fillim të këtij kreu rasën gjinore e kemi përshkruar si një rasë të një tipi të veçantë e të vështirë për t’u trajtuar, vështirësi kjo të cilës nuk mund t’i shmanget as gjuha shqipe. Dimë që sistemi rasor i gjuhës shqipe përcaktohet nga format rasore me të cilat kihen parasysh mbaresat rasore, pasi gjuha shqipe është një gjuhë flektive me caktim, në pjesën dërmuese të saj të rasave morfologjike. Por, përveç treguesve morfologjikë (mbaresë rasore) emri në rasën gjinore paraprihet edhe nga një element sintaksor ndihmës i njohur si një e përparme, funksioni kryesor i së cilës është ai i shprehjes së marrëdhënieve të pronësisë duke përfaqësuar vetëm kuptimin gramatikor të rasës, pasi kuptimet gramatikore të numrit dhe gjinisë do të shprehen nga nyjat e prapavendosura ose mbaresat.

Nyjat e rasës gjinore në sistemin rasor të gjuhës shqipe janë “*i, e, të, së*” ku lindja, zhvillimi historik dhe përdorimi i tyre do të trajtohet në vijim.

Së pari, në periudha të hershme të zhvillimit të gjuhës shqipe, si rezultat i procesit të sinkretizimit, rasa gjinore del me të njëjtën formë rasore me atë të rasës dhanore, ku për arsye të ridiferencimit u pa si domosdoshmëri ndërfitja e një elementi formalo-gramatikor, i cili u njoh si një e përparme. Për këtë element ka mjaft diskutime. E. Çabej<sup>180</sup> është i mendimit se ai përbën një element të ngulitur vonë në gjuhën shqipe duke theksuar se shfaqja e një artikulli (nyjë) midis një emri dhe atributit të tij nuk ka qënë kurrë zakon për gjuhën shqipe.

Nga ana tjetër, Cipo dhe Dozoni<sup>181</sup> mbështesin mendimin sipas të cilit *nyja e përparme përfaqëson një përemër atributiv*, ndërsa S. Riza<sup>182</sup> në mbështetje të këtyre mendimeve e

---

<sup>179</sup> Po aty.

<sup>180</sup> Agalliu F., “*Sa rasa ka gjuha shqipe*”, Studime filologjike, Nr. 3, 1980, fq 164

<sup>181</sup> Po aty, fq 164

<sup>182</sup> Po aty (fq 164) si dhe te Riza S., “*Probleme të nyjave të shqipes*” Studime filologjike Nr. 1, 1982, fq 129-133

emërton *nyjën e përparme të gjinore si dëftorth, pra, “përemër dëftor i dikurshëm i rëgjuar që iu parav u gjinore së lashtë pa nyjë”*

Ky përbën edhe një prej diskutimeve jo vetëm më të rrahur por edhe më afër së pranueshmes sipas të cilit nyja e përparme e rasës gjinore përbën një përemër dëftor të çintegruar si nga përbërja fonetike ashtu edhe nga kuptimi.

Mendohet gjithashtu se përemrat e sotëm dëftor “*ky, kjo, këta, këto, ai, ajo, ata, ato*” janë të pathjeshtë, pasi etimologjikisht analizohen si të ndërtuar nga parashtesa “*k ose a*” plus dëftorët “*y, o, ta, to*”, të cilët përbëjnë dëftorë të thjeshtë, që në shqipen e lashtë duhet të kenë pasur ekzistenca të mëvetësishme e që në të vonën nuk kanë dalë nga përdorimi pa lënë gjurmë.

Pra, dëftori i thjeshtë i shqipes së lashtë mendohet të jetë reduktuar në përmbajtjen e nyjës së përparme e cila në ndërtime të caktuara ka ruajtur, jo pa zbehje, kuptimin e një përemri dëftor që për sa më sipër S. Riza (1982) i ka emërtuar me termin zvogëlues *deftorth*.

#### *Shembull*

163.a Dikur në dyqanet e privatit paguhej më lirë se në **të** shtetit.

Sipas tij në përbërësin emëror “*dyqanet e privatit*” dhe në përbërësin tjetër emëror “*në të shtetit*” nëse elementët “*e dhe të*” do të trajtohen si nyja të rasës gjinore atëherë ato do ta shquanin emrin që i ndjek, të cilin në të vërtetë e shquan mbaresa rasore.

Që këto elemente gramatikore të ishin në gjinore do të duhet të përkonin me emrin që i ndjek në gjini, numër dhe rasë, gjë që e realizon vetëm elementi “*e*” ndërsa elementi “*të*” nuk mund të jetë nyjë e rasës gjinore pasi paraprihet nga parafjala “*në*” e rasës kallëzore.

Ky element i njohur si nyjë e rasës gjinore është një përemër dëftor i cili në situata sintaksore të caktuara e ka ruajtur kuptimin demonstrativ origjinal (*në të shtetit*), ndërsa në situata të tjera merr një kuptim fare të ri atë të bashkëtrëguesit të gjinore (*në dyqanet e privatit*) e cila në të kundërt do të ishte e padallueshme nga rasa dhanore. Por, midis dëftorthit të prirë nga një emër kuptimplotë dhe atij që nuk prihet nga një emër i tillë (*në të shtetit*) dallimi kuptimor është jo vetëm i mundshëm por edhe i dukshëm, pasi sa herë që brenda përbërësit emëror “*në të shtetit*” do të ndihej nevoja për të theksuar dëftorthin e patheksuar aq herë do të hyjë në përdorim dëftori i pathjeshtë i theksuar (*në atë të shtetit*), mundësi kjo që nuk mund të praktikohet te ndërtimi “*në dyqanet e privatit*”, pasi në këto ndërtime kemi të bëjmë me një dëftorth të degruar dhe të shndërruar nga një element leksikor i rëndësishëm në një mjet morfologjik ndihmës.



Pra, në përbërësin emëror “*në të shtetit*” dëftorthei “*të*” me përjashtim të momentit të theksimit ka vlerën e përemrit dëftor “*ato*” duke ruajtur, jo pa zbehje, kuptimin demonstrativ origjinal.

Përkundrazi në përbërësin emëror “*në ato të shtetit*” dhe “*në dyqanet e privatit*” elementët “*të*” dhe “*e*”, jo vetëm për nga gjeneza sintaksore e dikurshme, por edhe për nga përkimi i sotëm sintaksor përbëjnë një përsëritje të dëftorit “*ato*” përkatësisht të emrit “*dyqanet*”. Këto elemente do të identifikohen si pjesë e gjinore së re.

## **7.2 CAKTIMI I RASËS GJINORE NË GJUHËN ANGLEZE**

Panorama historike e paraqitur deri tani do të na vijë në ndihmë për të analizuar më mirë caktimin e rasës gjinore, për të përcaktuar caktuesin rasor si dhe për t’u njohur me modelin e caktimit të kësaj rase e cila në thelb paraqitet e ndërlikuar për të dyja gjuhët.

Së pari, trajtimin do ta nisim me caktimin e rasës gjinore në ndërtimet emërore posesive –‘s klitik të gjuhës angleze, pasi ndërtimet me –of parafjalë nuk paraqesin vështirësi, për arsye se parafjala –of e karakterizuar nga tiparet [+folje;+emër] shërben si kokë e sintagmës parafjalore, duke i caktuar rasë gjinore SE plotësor të saj.

Ndërtimet në rasën gjinore të gjuhës angleze janë bërë pjesë e studimeve gjenerative qysh në hershmëri me Lees (1960) dhe Chomsky (1970)<sup>183</sup>.

Duke qënë se në ndërtimet emërore gjinore kemi të bëjmë me marrëdhënie pronësie që vendosen midis dy emrave, atëherë do të na duhet të analizojmë kategorinë e emrit duke e përfshirë në të grupimin e emrave marrëdhëniesorë<sup>184</sup> ku hyjnë të gjithë ata emra që krijojnë marrëdhënie me përbërësin emëror që i shoqëron, si emrat e prejardhur, emrat e farefisnisë, emra që tregojnë marrëdhënie të pjesës me të tërën.

---

<sup>183</sup> Antila A. & Fong V., " *Variation Ambiguity and Noun classes in English*", artikull ne [www.elseiver.com](http://www.elseiver.com) , 2003

<sup>184</sup> Alexiadou A., Heageman L., Stavrou M., “*Noun phrase in the genitive perspective*”, 2007. Në kapitullin “DP internal argument” të këtij botimi pohohet ndarja e kategorisë së emrit në dy nënklasa: Emra marrëdhëniesor – emra të cilët vendosin marrëdhënie të trashëgueshme me emrin që i prin. Në këtë nënklasë përfshihen emrat e prejardhur, emrat e farefisnisë, si dhe emrat që hyjnë në marrëdhënie të pjesës me të tërën. Emrat absolute – emra të cilët krijojnë marrëdhënie me emrin që i prin por që këto marrëdhënie nuk janë të trashëgueshme

*Shembull*

- 164.a Caesar's destruction of the city (Shkatërrimi i qytetit nga Cesari)  
164.b John's sister (Motra e Xhonit)  
164.c the chair's leg (Këmba e karriges)

Përsa i përket nëndarjes së parë (emra të prejardhur) pretendohet se ata ofrojnë një strukturë argumentale të njëjtë me ndërtimet foljore përkatëse:

*Shembull*

- 165.a Caesar's destruction of the city  
165.b Caesar destroyed the city.

Duke qënë se emri “*destruction*” shfaq dukuri karakteristike foljore duke marrë si argument të jashtëm të saj SE “*Ceasar-veprues*” dhe si argument të brendshëm SE “*the city – temë*”, propozohet se këta emra shfaqin të njëjtën kornizë semantike nënkategorizuese dhe si rezultat shfaqin të njëjtën strukturë argumentale si foljet kallëzues. Emrat prejfoljor trashëgojnë të njëjtin informacion kategorial duke pranuar, ashtu si foljet, subjekt dhe komplement, të cilave u caktojnë rolet tematike respektive.

Nga ana tjetër, ajo që i ndan këto dy kategori leksikore është caktimi rasor, pasi foljet u caktojnë rasë emërore argumenteve të tyre të jashtëm dhe rasë kallëzore argumenteve të tyre të brendshëm pa caktuar rasë gjinore. Grimshaw (1990)<sup>185</sup> këtë hendek e thellon më tej, pasi sipas tij në ndërtimet foljore shprehja e argumentit të jashtëm kryefjalë është e detyrueshme edhe në rastet kur ai përfaqësohet nga një kategori e zbrazët, ndërsa në ndërtimet emërore ai mund të mungojë duke mos përbërë një element të detyrueshëm, gjë që po sipas tij vërteton faktin se këtyre të fundit u mungon struktura argumentale.


Në vijim, Abney (1987)<sup>186</sup> te këto struktura komplekse evidenton një sjellje të dyfishtë midis fjalisë dhe SE, duke argumentuar se ashtu siç kemi kryefjalë të fjalisë, ashtu edhe “*Ceasar's*” do të sillet si kryefjalë e SE, e cila vërtetohet nga fakti se asaj i caktohet rasë gjinore dhe jo emërore. Nga ana tjetër, pjesa e mbetur e përbërësit emëror “*destruction of the city*”, duke qënë se kemi të bëjmë me një emër prejfoljor, do të përfaqësojë një SF.

---

<sup>185</sup> Alexiadou A., Heagman L., Stavrou M., “*Noun phrase in the generative perspective*”, Walter de Gruyter 2007.


<sup>186</sup> Abney S., “*English noun phrase in its sentential aspect*”, Doctoral dissertation, MIT, Cambridge, 1987

**Skema 58**



Një strukturim i tillë është problematik dhe si rrjedhim i papranueshëm, pasi SE projektion maksimal i mungon koka rolin e të cilës nuk mund ta luajë koka F<sup>0</sup>. Duke iu referuar paralelizmit që ekziston midis fjalisë dhe këtyre ndërtimeve emërore në gjinore, do të ishte më e drejtë të pranohim ekzistencën e një kategorie të zbrazët të përshtatjes e cila do të bënte të mundur caktimin e rasës gjinore.


**Skema 59**



Për të identifikuar këtë kategori X, nisur nga paralelizmi i mësipërm, pranojmë se ajo është e njëjtë me SEpt duke përfshirë si kokë të saj tipare të përshtatjes që mundësojnë caktimin e rasës gjinore. Si e tillë, ekuivalenti për këto ndërtime emërore do të ishte kategoria e determinuesit e realizuar nëpërmjet projektionit funksional SDet. Pranimi i barazimit X=Det na vjen në ndihmë: Së pari, për t'i dhënë një përfaqësim leksikor kategorisë X dhe së dyti për t'i dhënë kategorisë së determinuesve aftësinë për të marrë specifikes (pronorët) dhe komplementues (projeksione të emrit).

Në realitet sintagma determinative (SDet) përbën një projeksion maksimal të kokës emërore ku koka Det<sup>0</sup> ka të gjitha tiparet e një elementi funksional duke përbërë një kategori leksikore të mbyllur të cilës i mungon përmbajtja përshkruese. Si e tillë u pa e arsyeshme gjenerimi në këtë kokë funksionale Det<sup>0</sup> i njave shquese/joshquese, përemrave dëftorë dhe atyre pronorë, për arsye se të gjithë këta elementë në gjuhën angleze kanë kuptim individualizues. Në vijim të këtij propozimi risi të ofruar nga Abney (1987), Richard Larson<sup>187</sup> pretendon realizimin e klitikut –‘s në pozicionin kokë të SDet

### Skema 60



Në këtë kontekst, sipas tij caktimi i rasës SE që shpreh pronorin është i ngjashëm me caktimin e rasës SE argument i jashtëm i fjalisë, ku –‘s përfaqëson kategorinë e përshtatjes e cila brenda SEpt është përgjegjëse për caktimin e rasës emërore SE subjekt.

Në vazhden e argumentave mbi pranimin ose jo të klitikut –‘s si markues rasor Abney (1987) preferon argumentimin pro duke e bazuar në dy arsye të forta:

1. Klitiku –‘s përbën një markues rasor, pasi historikisht ai ka përfaqësuar morfemën eptimore të rasës gjinore –es.
2. Pranimi i klitikut –‘s si determinues nuk përbën një universale gjuhësore.

Gjatë kalimit nga anglishtja e vjetër në anglishten e ditëve të sotme lindi një ristrukturim i ri i SE e cila tanimë do të shihej si një përbërës i projeksionit maksimal SDet, ku kategoria e determinuesit nuk ishte e mirëpërcaktuar në fillimet e anglishtes moderne, por më pas ajo njohu lindjen dhe përdorimin e njave shquese dhe joshquese, përfaqësuese tipike të kësaj kategorie.

Me lindjen e këtij ristrukturimi përbërësit emërorë në gjinore u rianalizuan si përbërës të kategorisë së determinuesit, gjë që shpjegon edhe ndryshimet që pësoi pozicionimi i SE në gjinore (paraemëror) si dhe zhdukja e morfemave eptimore.

<sup>187</sup> Abney S., “English noun phrase in its sentential aspect”, Doctoral dissertation, MIT, Cambridge 1987, fq 79

### **7.3 TEORI MË TË THELLUARA NË CAKTIMIN E RASËS GJINORE.**

Para se të fillojmë me trajtimin në detaje të caktimit të rasës gjinore do të na duhet të përcaktojmë se termi “gjinore” (genitive), përsa i përket ndërtimeve të tilla në gjuhën angleze, është më i gjerë duke përfshirë si ndërtimet para-emërore me *-‘s* ashtu dhe ndërtimet me *-of* parafjalë. Duke qënë se, thelbin e këtij punimi do ta përbëjnë ndërtimet me gjinore *-‘s* të cilat shprehim marrëdhënie të pastra pronësie këto të fundit do t’i emërtojmë si gjinore posesive.

#### *Shembull*

- 166.a John’s/**his** book
- 166.b John’s/**his** criticizing the book
- 166.c The barbarian’s destruction
- 166.d The house **of** the rich man

Të gjithë përbërësit e nënvizuar më sipër, qofshin ato SDet në gjinore në pozicion paraemëror, përemra pronor ose SP me parafjalën *-of* në rasën gjinore, shprehin marrëdhënie pronësie.

Në gjuhën angleze si gjinorja posesive dhe përemrat pronorë i nënshtrohen të njëjtit interpretim duke u pozicionuar në të njëjtin pozicion strukturor atë të determinuesit. Për më tepër, po në këtë gjuhë këto dy kategori janë në përndarje plotësuese, ku prania e pronorit e përjashton praninë e SE në gjinore dhe anasjelltas. Kjo dukuri e bën shumë të lehtë praninë në kategorinë e determinuesit edhe të përbërësve emërorë në gjinore. Nga ana tjetër kjo dukuri nuk është gjithpërfshirëse, pasi kemi gjuhë të tilla si shqipja në të cilën përfaqësuesit e kategorisë së determinuesit dhe përbërësi emëror në gjinore bashkekzistojnë duke kërkuar pozicione të lira për gjenerimin e tyre.

Në këtë kontekst, duke u nisur nga veçoritë e këtyre gjuhëve në të cilat përbërësi emëror në gjinore shfaqet në pozicion pasemëror, sugjerohet se këta përbërës nuk përkojnë me kryefjalën e kokës emërore por me komplementin e saj.

#### *Shembull*

- 167.a Shtëpia e Xhonit


Nëse do të pranojmë që këta përbërës emërorë në gjinore në pozicion pasemëror përfaqësojnë komplemente, atëherë do të duhet të pranojmë se ky pozicion përbën pozicionin bazë të

realizimit të tyre, ndërsa pozicioni paraemëror si rrjedhim do të përbëjë një pozicion të prejardhur.

Por, nëse gjinorja posesive do të pranohej si komplement i kokës emërore, atëherë si të gjithë komplementët ajo do të duhej të lidhej me kokën emërore nëpërmjet marrëdhënie tematike, me të cilat nënkuptohet shoqërimi i këtyre emrave nga një gjinore posesive, ku ato do të shfaqnin një strukturë argumentale të mirëdiferencuar (dukuri kjo që shfaqet vetëm te emrat prejfoljorë). Me strukturë argumentale do të kuptohen karakteristikat semantike të cilat emrat si “*book, dog, etj*”, edhe pse hyjnë në marrëdhënie pronësie në ndërtimet në gjinore, nuk mund t’i kenë. Nga sa më sipër, del qartë se pronari nuk mund të përbëjë komplemente e as argument të kokës emërore duke iu rikthyer sërishit propozimit se në gjuhën angleze ai është më afër kryefjalës dhe si e tillë, ashtu sikundër ndodh me subjektin e fjalisë të realizuar në pozicionin në të majtë të projeksionit SEpt, ashtu dhe përbërësi emëror në gjinore paraemërore (pronari) do të realizohet në të majtë të përbërësit emëror.

Nga ana tjetër, siç kemi arsyetuar për SE kryefjalë të fjalisë ku midis saj dhe rolit tematik nuk ekziston ndonjë lidhje e ndërsjelltë, në mënyrë analoge edhe gjinorja paraemërore nuk mund të realizojë një argument specifik të emrit.

**Skema 61**




Ky gjenerim mendohet se përbën një gjenerim bazë, ku SE në gjinore realizohet në një pozicion specifikuesi të projeksionit SEpt, pozicion ky më i ulët në të cilin licensohen marrëdhëniet semantike të pronësisë dhe në një hap të dytë zhvendoset drejt pozicionit të prejardhur SpecSDet.

Në vazhdën e këtyre propozimeve, një tjetër i tillë na vjen nga Den Dikken<sup>188</sup> i cili duke u nisur nga marrëdhëniet e vendosura midis përbërësve pronar dhe pronë të një ndërtimi në gjinore, si marrëdhënie predikative ku pronari përfaqëson kryefjalën dhe prona funksionon si predikat emëror, i sheh ato si të këmbëra ku pronari përfaqëson predikatin dhe prona përbën kryefjalën.

Sipas tij, roli i pronësisë mendohet të caktohet nga markuesi i pronësisë *-of*. Kjo hipotezë u vjen në ndihmë gjuhëve si latinishtja në të cilat marrëdhëniet e pronësisë vendosen ndërmejt bërthamës dhe pronarit në gjinore ku SDet “*John’s car*” përbën një projeksion të prejardhur “*the car of John*”

### Skema 62



Pra, nga të gjitha propozimet e mësipërme, të cilat padiskutim kanë vlerën e tyre duke ndikuar në propozimin që vijon, ky i fundit përbën një prej propozimeve më universale. Tashmë, është e qartë ngjashmëria gati simetrike midis përbërësit emëror në gjinore dhe strukturës së fjalisë. Dimë gjithashtu që Larson (1988), Hale dhe Keyser (1993)<sup>189</sup> dhe Chomsky (1995) gjatë analizës së strukturës komplekse të përbërësit foljor e kanë ndarë atë në përbërësin e jashtëm Sf të drejtuar nga një folje e lehtë f dhe përbërësin e brendshëm SF të drejtuar nga një folje leksikore.

Sipas tyre ndërtimi “*he roll the ball down the hill*” realizohet si rezultat i bashkimit në fillim të foljes “*roll*” me komplementin e saj “*down the hill*” dhe specifikuesin e saj “*the ball*” duke formuar projeksionin SF “*the ball roll down the hill*”. Më tej, ky projeksion do të lidhet me një folje abstrakte me kuptim shkakor duke formuar projeksionin Sf në pozicionin e specifikuesit të së cilës do të realizohet SE kryefjalë “*he*” ndërsa folja “*roll*” do të ngrihet drejt nyjës kokë F<sup>0</sup> duke formuar projeksionin “*he roll the ball down the hill*”.

<sup>188</sup> Den Dikken sipas Alexiadou A., Heagman L., Stavrou M., “*Noun phrase in the generative perspective*”, Walter de Gruyter, 2007, fq 563

<sup>189</sup> Po aty, fq 560


Në këtë kontekst, duke iu referuar simetrisë ndërkategoriale midis strukturave foljore dhe atyre emërore të përfaqësuara nga projektioni SDet me të drejtë do të pretendohet ndarja e projektionit SE në dy projeksione funksionale: **Se** (si projektioni Sf e ulet) të drejtuar nga një kokë funksionale e zbehtë dhe SE të drejtuar nga një kokë emërore leksikore, ku Se e jashtme do të përbënte projektionin e leksikalizimit të treguesve funksionalë të kokës emërore si gjinia, numri ose përshtatja.

Sipas Radford (2000)<sup>190</sup> një projektim i tillë jo vetëm që është gjithpërfshirës por ndihmon shumë në strukturimin e ndërtimeve emërore komplekse si:

*Shembull*

168.a The enemy's destruction of the city.

**Skema 63**




Në vijim, Borer (1993)<sup>191</sup> bazuar në këtë strukturim, sipas të cilit “*the enemy's*” interpretohet si kryefjalë-veprues i emrit prejfoljor, propozon një strukturim ndryshe ku sipas tij, ashtu si argumenti i jashtëm kryefjalë i një koke F<sup>0</sup> i cili merr rolin tematik të vepruesit në SpecSF (dhe më pas lëviz drejt një pozicioni funksional më lart për të marrë rasë), ashtu mund të pranohet edhe për marrjen nga përbërësi emëror në gjinore të rolit semantik të pronarit në SpecSe dhe më pas zhvendosjen e tij drejt një pozicioni funksional më lart që do të ishte ai i

<sup>190</sup> Po aty  
<sup>191</sup> Po aty




specifikuesit të projeksonit të përshtatjes emërore SPrEM (AgrNP). Një strukturim i tillë me të drejtë do të përbënte një shtrirje paralele të strukturës foljore mbi atë emërore.

**Skema 64**



Ndryshimi i fundit që do t'i bëhej këtij strukturimi do të ishte ai i hedhur nga Radford (2000) (një propozim i dytë i ristrukturuar), ku projekcioni Se në pozicionin kokë të së cilit do të realizohet klitiku –'s, si element i vetëm i shprehjes së marrëdhënieve të pronësisë dhe gjithashtu si markues i vetëm i rasës gjinore, i cili në rastin e gjuhës angleze përfaqëson gjithashtu një determinues, të zëvendësohet nga projekcioni funksional sintagma e determinuesit të pronësisë SDetPron (DetPossN) .

Skema 65



Si rezultat i përshtatjes predikative caktohet roli tematik, ndërsa duke qënë se –‘s dikur përbënte një morfemë eptimore e cila në ditët e sotme është e vetmja gjurmë e tillë e gjuhës angleze që vërteton ekzistencën e një sistemi eptimor rasor të mirëfilltë që ka ekzistuar në anglishten e vjetër, mund lehtësisht të analizohet si markues rasor.

#### **7.4 CAKTIMI I RASËS GJINORE SE TË GJUHËS SHQIPE NË KËNDVËSHTRIMIN GJENERATIVIST.**

Përsa i përket gjuhës shqipe, ashtu siç pohuan edhe në fillim të këtij punimi, ajo përbën një gjuhë flektive e cila në rastin e ndërtimit të rasës gjinore përveç prapashtesës (markues i treguesve të gjinisë, numrit dhe kategorisë së shquarsisë) karakterizohet edhe nga përdorimi i nyjës së përparme *i, e, të, së*. Nyjat e përparme të lindura si rezultat i sinkretizimit të formave rasore në gjinore dhe dhanore shërbejnë së pari, për të bërë të mundur dallimin midis këtyre dy rasave dhe së dyti, për t'i bërë të dukshme marrëdhëniet e pronësisë të shprehura nga rasa gjinore. Por, krejt ndryshe nga gjuha angleze ku –‘s klitik i rasës gjinore e cila duke shërbyer njëkohësisht si markues i shquarsisë dhe i rasës është në përndarje plotësuese me elementët e tjerë përbërës të kategorisë së determinuesit, ku gjenerimi i saj në kokën Det<sup>0</sup> nuk do të përbënte

shkelje, në gjuhën shqipe kemi të bëjme me dy markues të ndryshëm: nyjën e përparme dhe atë të prapme të cilat do të kërkojnë përkatësisht dy pozicione gjenerimi. Nëse për një moment të vetëm do të pranohet gjenerimin e këtyre dy elementëve në të njëjtin pozicion do të duhej të pranohet gjithashtu se ato kryejnë të njëjtin funksion, gjë që do të përbënte shkelje të Parimit të Ekonomisë, sipas së cilit në asnjë gjuhë njerëzore nuk mund të ekzistojnë dy elementë të ndryshëm që kodojnë të njëjtin informacion.

Një nga studiuesit që ka ofruar në gjuhën shqipe një analizë gjeneruese të ndërtimeve në gjinore është Josif Mita<sup>192</sup>, i cili duke u bazuar kryesisht në prejardhjen e nyjës së përparme nga një dëftorth i hershëm i çintegruar si në formë dhe në përmbajtje (duke pasur një theksim gjithnjë e më të dobët shoqëruar me ndryshime të karakterit fonetik duke u shndëruar nga një dëftorth në një mjet morfologjik ndihmës të njohur me termin nyjë), ka vënë theksin mbi funksionin individualizues të nyjës. Nisur nga ky funksion J. Mita (2005) është i mendimit se ajo përbën të njohurën. Në vijim, për të plotësuar pohimin e mësipërm ai propozon gjenerimin e një sintagme funksionale, Sintagma e Njohur (SNjoh) e gjeneruar midis dy projeksioneve SDet, ku në kokën Njoh<sup>0</sup> të së cilës do të gjenerohet nyja e përparme, ndërsa kokat emërore do të zhvendosen drejt kokave determinative të SDet për t'iu bashkuar nyjave të prapme tregues të gjinisë, numrit dhe kategorisë së shquarsisë.


*Shembull*

169.a veshja *e* djalit

---

<sup>192</sup> Mitaj J., "Hyrye në sintaksën gjenerative", 2005, fq 19-23

**Skema 66**




Propozimi i mësipërm, përveç se na jep një mundësi gjenerimi, nuk na ndihmon në identifikimin e caktuesit rasor dhe të modelit që ky caktues rasor përfaqëson. Ndonëse, modeli i caktimit të rasës gjinore të gjuhës angleze dhe asaj shqipe është i ndryshëm, gjë që i dedikohet parametrave të tyre gjuhësore, do të shohim që parimet bazë janë universale jo vetëm për këto dy gjuhë, por për të gjitha gjuhët njerëzore.

Në vijim, përsa i përket caktimit të rasës gjinore, një nga mendimet<sup>193</sup> është ai sipas të cilit kemi të bëjmë me caktimin e rasës gjinore në strukturën [SE;SE] ku emri drejtues pranohet si caktues rasor i vetmjaftueshëm. Nga ky pohim del qartë se mjafton që një emër të varet nga një emër tjetër që ai të marrë rasë gjinore dhe marrëdhëniet midis kokës emërore dhe SE që merr rasë gjinore janë të tipit kokë-plotësor. Kjo gjë presupozon vetvetiu që emri i varur jo vetëm që pozicionohet në një pozicion [+rasë; +argument] por shfaq edhe strukturë argumentale.

<sup>193</sup> Buxheli L., "Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe", Tiranë, 2007, fq. 233-240

**Skema 67**



Nëse do t'i referoheshim teorisë së lidhjes dhe drejtimit me të drejtë do të ngriheshin këto çështje: Ku ndodhet në pemën strukturore pozicioni [+argumet] i emrit në gjinore? Si e merr rolin tematik emri në gjinore? A përbëjnë emrat caktues rasor të vetmjaftueshëm?

Përsa u përket këtyre çështjeve, është e vështirë të pohohet që emri në gjinore pozicionohet në pozicion argumenti, pasi ai në varësi të ndërtimeve herë sillet si plotësor e herë sillet si modifikues duke mos qënë një komponent i domosdoshëm në realizimin e kuptimit të emrit drejtues. Pavarësisht faktit se emri në gjinore mund të jetë modifikues ose komponent jo i domosdoshëm me karakter fakultativ ai përsëri në ndërtime të caktuara me emër drejtues prejfoljor ose emra veprimi mund të sillet si plotësor duke mbartur një rol semantik të brendshëm.

*Shembull*

169.b Vërshimi i ujit  
Veprues

169.c Uji vërshon  
Veprues

Nisur nga këto ndërtime, mund të ngrihen pohime përgjithësuese ku emrat, qofshin këta foljorë ose jo, kanë strukturë argumentale të ngjashme me foljet duke marrë argumente të brendshme të cilave u caktojnë role tematike. Pra, ashtu siç kemi pohuar edhe në ndërtimet gjinore të gjuhës angleze ajo që përbën një çështje problematike është dilema nëse emrat mund të caktojnë ose jo rasë.

Për gjuhën shqipe një pohim i tillë do të rezultonte i dyshimtë, pasi ajo nuk arrin të shpjegojë se përse në ndërtimet e mëposhtme i njëjti emër i varur, në të njëjtin pozicion strukturor, i drejtuar nga e njëjta SE shfaqet herë në rasë gjinore e herë në rasë rrjedhore.

*Shembull*

170.a Miell i grurit (SE në rasën gjinore)

170.b Miell gruri (SE në rasën rrjedhore)

Shembujt e mësipërm mjaftojnë për të theksuar se emrat, qofshin këta prejfoljorë ose jo nuk mund të karakterizohen dhe për më tepër nuk mund të përcaktohen si caktues rasor të vetëmjaftueshëm të specializuar në caktimin e rasës gjinore. Vlen të theksojmë se, në ndërtimet e mësipërme ndryshimi i vetëm është prania e nyjës së përparme në ndërtimet me SE në gjinore e cila ka si funksion të saj shprehjen e marrëdhënieve të pronësisë ndërsa në shembullin 170.b marrëdhëniet që vendosen midis dy SE janë ato të burimit ose origjinës. Kjo vërteton që emri në rasë gjinore është shumë i ndjeshëm ndaj rolit tematik i cili përbën një rol tematik të brendshëm, atë të pronësisë të realizuar morfologjikisht .

Kjo nënkupton se caktimi i rasës gjinore SE që në këto ndërtime do të prihet nga nyja e përparme lidhet jo vetëm me emrin drejtues, por edhe me rolin tematik të brendshëm. Rëndësia e nyjës së përparme nuk ka nevojë të diskutohet pasi ajo nuk mund të mungojë, në rast të kundërt do të kishim ndërtime emërore jo gramatikore.


#### *Shembull*

171.a Si të duket libri i Blertës, po i Agimit?

Në këtë shembull, kemi të bëjmë me dukurinë e elipsës, rënia e emrit drejtues, funksionin sintaksor të së cilit e kryen emri në gjinore. Mungesa e nyjës së përparme do të bënte fjalinë e mësipërme jogramatikore, por nga ana tjetër prania e detyrueshme e kësaj nyje duke i dhënë SE të varur karakteristikat gramatikore të rasës gjinore i jep kësaj të fundit aftësinë për të caktuar rasë gjinore. Pra, nyja e përparme do të përbëjë caktuesin e rasës gjinore.

Nisur nga prejardhja e saj, prej përemrave dëftorë si dhe nga funksioni i saj kryesor i shprehjes së marrëdhënieve të pronësisë bazuar gjithashtu edhe në gjuhën angleze, do të japim të njëjtin strukturim gjenerues. Pra, do të propozojmë lindjen e sintagmës funksionale të determinuesit të pronësisë në kokën e të cilit do të gjenerohet nyja e përparme.

**Skema 68**



Midis ndërtimeve të gjuhës angleze dhe atyre të gjuhës shqipe nuk mund të kemi simetri përse i përket gjenerimit strukturor, pasi në rastin e parë kemi të bëjmë me gjinore paraemërore, ndërsa në rastin e dytë kemi të bëjmë me gjinore në pozicion fundor.

Ajo që i bashkon është gjenerimi brenda projekSIONIT maksimal SDet të projekSIONIT funksional SDetPron, koka e të cilit, që në rastin e gjuhës angleze do të zihet nga klitiku –'s, ndërsa në gjuhën shqipe kjo kokë do të zihet nga nyja e përparme “i, e, të, së”, që i caktojnë rasë gjinore SE pronar. Pra, për të dyja gjuhët ajo është një kokë funksionale që përcakton rasën gjinore e cila në ndërtimet emërore të gjuhës angleze caktohet në konfiguracionin Kokë-Specifikues, ndërsa në gjuhën shqipe kjo rasë caktohet në konfiguracionin kokë-plotësor.

Përse i përket rotit tematik të pronësisë mendojmë se ai përbën një rol tematik të brendshëm dhe të pashpjegueshëm i cili i dedikohet vetë strukturës emërore të këtij përbërësi në gjinore.

**7.5 RASA STRUKTURE E PËRKUNDREJT RASËS INHERENTE.**

Në kapitujt e mëparshëm kemi trajtuar caktimin e rasave emërore, kallëzore dhanore dhe së fundmi edhe caktimin e rasës gjinore. Këto rasa përfaqësojnë modele të ndryshme të caktimit rasor të njohura si caktim rasor strukturor ose inherent. Fillimisht rasa emërore dhe kallëzore përfshiheshin në modelin e caktimit rasor strukturor dhe njiheshin si rasa strukturore. Me rasë

strukture nënkuptohet caktimi i rasës emërore ose kallëzore në një pozicion të caktuar përkatësisht SpecSEpt (rasa emërore) dhe [SE;SF] (rasa kallëzore). Për caktimin e këtyre dy rasave kërkohet përmbushje e një kushti, lidhjes strukture të drejtimit brenda konfiguracioneve të caktuara të cilat janë specifikues-kokë (për rasën emërore), dhe kokë-plotësor (për rasën kallëzore).

Dy rasat e tjera, rasa dhanore dhe gjinore, po në këtë periudhë të hershme të zhvillimit të gramatikës gjenerative përfaqësonin modelin inherent të caktimit rasor dhe njiheshin si rasa inherente. Me rasë inherente nënkuptohet caktimi rasor që lidhet me një rol tematik të caktuar. Pra, midis SE në rasë dhanore dhe SE që i caktohet roli tematik i përfituesit si dhe SE në rasë gjinore dhe SE që i caktohet roli tematik i pronësisë ekziston një lidhje e fortë.

Megjithatë, me zhvillimet e mëtejshme që shoqëruan gramatikën gjenerative, të cilat përkojnë konkretisht me lindjen e *hipotezës së subjektit të brendshëm*, *hipotezës së ndarjes së SEpt*, *hipotezës së ndarjes së SF* si dhe propozimit të gjenerimit të projeksioneve funksionale të përshtatjes, rasa dhanore u shkëput nga grupi i rasave inherente dhe u përfshi në grupin e rasave strukture. Përfshirjen e rasës dhanore në grupin e rasave strukture e kemi shtrirë dhe përjasur edhe në ndërtimet emërore me SE kundrinor i zhdrejtë të gjuhës shqipe. Caktimi strukturor i rasës dhanore në të dyja gjuhët argumentohet kryesisht me lindjen e projeksioneve të përshtatjes të argumenteve të foljes, përkatësisht të projeksionit të përshtatjes së kundrinorit të zhdrejtë në pozicionin e specifikuesit të së cilit do të zhvendosej SE kundrinor i zhdrejtë për të marrë rasë dhanore. Në këtë kontekst, duke qënë se SE argumente të foljes (qofshin të jashtëm apo të brendshëm) rasa u caktohet në pozicion specifikuesi, më saktë në konfiguracionin specifikues-kokë, të tria rasat emërore, kallëzore dhe dhanore përfaqësojnë modelin strukturor të caktimit rasor.

Përsa i përket rasës gjinore si dhe pyetjes se a përbën kjo një rasë inherente apo strukture kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë përjasje të ndryshme nisur edhe nga karakteristikat e gjuhëve në studim.

Vetë Abney (1987) dhe Alexiadou and Wilder (1988) nisur nga ndërtimet me gjinore posesive të gjuhës angleze (në pozicion paraemëror), duke qënë se emri pozicionohet në pozicionin e SpecSDEt, ashtu sikundër ndodh edhe më pozicionimin e SE kryefjalë në SpecSEpt, e shohin si të papranueshme pohimin sipas të cilit rasa gjinore përbën një rasë inherente, përkundrazi ajo përbën një rasë strukture ashtu sikundër rasa e kryefjalës së fjalisë.



Chomsky (1997) i hedh poshtë këto teori (pasi edhe ai fillimisht mbronte të njëjtën tezë duke pranuar si caktues të rasës gjinore kategorinë e emrit), pasi kjo e fundit çonte në një përgjithësim të gabuar duke i grupuar të gjitha gjuhët në gjuhë me rasa abstrakte të cilave u mungon markimi morfologjik. Themi pohim i gabuar, pasi ai për gjuhë flektive si shqipja është i papranueshëm. Chomsky (1997) e trajton këtë rasë të caktuar qoftë nga koka DetPron<sup>0</sup> e SDetPron qoftë nga koka P<sup>0</sup> e SP si rasë inherente e cila lidhet ngushtë me rolin semantik të pronësisë.

Në vijim L. Buxheli (2007) rradhit disa nga karakteristikat e caktimit rasor inherent të cilat për mendimin tim i përshtaten caktimit inherent të rasës gjinore pasi rasa dhanore përbën një rasë strukturore.

- Caktuesi rasor inherent është gjithmonë koka DetPron<sup>0</sup>.
- Caktuesi rasor inherent është pranuar një kategori leksikore folje ose emër por ky pohim nuk qëndron për të gjitha ndërtimet dhe të gjitha gjuhët. Ai mund të jetë gjithashtu edhe një kokë funksionale ( 's ose nyjat e përparme të gjuhës shqipe).
- Caktimi rasor inherent nuk e përjashton karakterin strukturor të rasës, pasi ai realizohet brenda një strukture të caktuar.
- Marrëdhëniet midis caktuesit rasor inherent dhe SE që merr rasë janë të tipit kokë-plotësor ( e pranuar më parë), por jo vetëm në ndërtimet gjinore të gjuhës angleze ato janë edhe të tipit specifikues-kokë për analogji të strukturës së fjalisë.
- Gjatë caktimit të rasave inherente roli semantik është jo vetëm i rëndësishëm por edhe përcaktues në caktimin e rasës falë marrëdhënive të brendshme që ekzistojnë midis tij dhe rasës. Më konkretisht kur flasim për shprehjen e marrëdhënive semantike të pronësisë midis dy SE, ku njëra përfaqëson pronën dhe tjetra pronarin ky i fundit lidhet përsosshmërisht me caktimin e rasës gjinore.
- Një SE, të cilës i caktohet rasë inherente, nuk i nënshtrohet procesit të zhvendosjes në rast pasivizim

Si përfundim mospërmbushja e kushteve për caktimin rasor strukturor si dhe ndjeshmëria e lartë që emrat në gjinore kanë përkundrejt caktimit të rolit semantik inherent bën që midis këtij të fundit dhe SE të cilës i caktohet rasë gjinore të ekzistojë një lidhje e ngushtë e për rrjedhoje ky model i caktimit rasor të gjinores do të përbëjë një model inherent.

## ***PËRFUNDIME***

Rasa gjinore paraqitet si një rasë e veçantë për të dy gjuhët. Kjo veçanti qëndron: së pari, në renditjen e SE përcaktor-i përcaktuar të cilat përfaqësojnë përkatësisht pronën dhe pronarin. Përsa i përket renditjes në gjuhën angleze ajo është e tipit pronar-pronë në ndërtimet kur ajo realizohet nëpërmjet përdorimit të klitikut 's dhe pronë-pronar në ndërtimet kur ajo realizohet si rezultat i përdorimit të parafjalës *-of*.

### *Shembull*

- 1.a John's gift
- 1.b The gift of John

Gjuha shqipe nga ana tjetër i shfaq ndërtimet emërore në gjinore si të tipit pronë-pronar të cilat realizohen si rezultat i përdorimit të nyjës së përparme "i, e, të, së"

### *Shembull*

- 2.a Dhurata e Jonit.

Elementet kryesorë të sipërpërmendur 's dhe nyjat "i, e, të, së" të cilat për të dyja gjuhët përbëjnë markues ose më saktë caktues të rasës gjinore mendohet të kenë prejardhje historike të ndryshme. Klitiku 's argumentohet si i prejardhur nga ngurtësimi deri në humbje i mbaresave rasore që karakterizonin kategorinë e emrit në anglishten e vjetër. Këto mbaresa rasore u zhdukën të gjitha përveç "-es" të rasës gjinore njëjës e cila në periudha të ndryshme të zhvillimit gjuhësor mendohet të ketë humbur zanoren "-e" e cila është zëvendësuar nga apostrofi. Kjo 's e formuar përbën të vetmen gjurmë të ekzistencës të një sistemi eptimor të plotë në këtë gjuhë. Për këtë element është hedhur gjithashtu mendimi i prejardhjes së tij nga përdorimi menjëherë pas emrit në gjinore të pronorit të vetës së tretë njëjës "his". Kjo hipotezë është e dyshimtë.

### *Shembull*

- 3.a The boy *his* book.
- 3.b The boy's book.

Për gjuhën shqipe është pranuar prejardhja e nyjës së përparme të rasës gjinore nga përemrat dëftor të dikurshëm të cilët me kalimin e kohës degraduan si formalisht edhe semantikisht duke u shndërruar në një mjet morfologjik ndihmës.

### ***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

---

Ajo që i bashkon këto dy gjuhë është fakti se emri në gjinore është mbartës i shprehjes së kuptimit të pronësisë, pra në gjuhësinë gjenerative sipas teorisë së roleve tematike ai përfaqëson rolin tematik të pronarit. Si i tillë, duke qënë se midis SE në gjinore dhe rolit tematik të pronësisë ekziston një lidhje e ngushtë, argumentohet se caktimi i rasës gjinore përfaqëson një model inherent të caktimit rasor.

Nisur nga sa më sipër, u pa me vend lindja dhe gjenerimi i projeksionit funksional të determinuesit të pronësisë SDetPron në kokën e të cilit do të gjenerohet klitiku 's i gjuhës angleze dhe nyja e përparme e gjuhës shqipe si të vetmit caktues të rasës gjinore.

## KREU VIII

### RASA RRJEDHORE. MODELI I CAKTIMIT TË SAJ

#### 8.1 CAKTIMI I RASËS RRJEDHORE NË GJUHËN SHQIPE

Në përgjithësi veç emërores, gjinore, dhanore dhe kallëzore gjuhës shqipe i njihet edhe një rasë e pestë e quajtur rrjedhore. Kjo rasë mund të përdoret me folje, mbiemra prejfoljorë ose emra. Rrjedhorja e përdorur me folje mbart kuptime të ndryshme si atë të shkakut, mjetit, vendit, kohës, etj.

Shembull

172.a Në fillim të Janarit **maleve** ra dëborë.

Rrjedhorja pranë-foljore përdoret shpesh e paraprirë nga një parafjalë si:

Shembull

173.a **buzë lumit, afër shtëpisë, anash rrugës, pranë shkollës, prej druri.**

Rrjedhorja pranë-emërore përdoret kryesisht pa parafjalë, në funksionin e përcaktorit e ngjashme me rasën gjinore. Në rasë rrjedhore emri del vetëm në trajtë të pashquar dhe mund të shërbejë si përcaktor për një emër po në trajtë të pashquar.

Shembull

173.b **këngë trimash, jehonë dasme, aromë lulesh, etj.**

Si rrjedhim, shfaqja e emrit në rrjedhore në dy kontekstet gramatikore të mësipërme lidhet ngushtë me funksionet sintaksore të rrethorit dhe përcaktorit.

Si në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe ka ndodhur procesi i sinkretizimit, d.m.th dy ose më shumë kuptime rasore janë shkrirë në një formë të vetme çka ka çuar në thjeshtimin e trajtave gramatikore. Pra, si pasojë e këtij evolucionin fonetik, janë përputhur disa forma rasore më konkretisht rrjedhorja në njëjës in e pashquar e të shquar del me të njëjtën formë gramatikore si dhanorja (lisi; lisit), ndërsa në shumësin e pashquar dallohet nga dhanorja nëpërmjet mbaresës – sh (malesh; lisash).

Për këtë rasë F.Agalliu<sup>194</sup> shprehet – “Për ne do të jetë e papranueshme ekzistenca e një rase të një emri vetëm me dy mbaresa të ndryshme,”

Në shqipen e dokumentuar rasia rrjedhore dallohet nga dhanorja vetëm nëpërmjet formatit –*sh* i cili e ka burimin e vet te mbaresa e vendores së dikurshme të indoeuropianishtes –*su*.

Problemi vështirësohet më tej kur në përcaktimin rase të një trajte rase janë sinonime edhe funksionet e saj përkatëse me një rasë tjetër siç ndodh me ndërtimet emërore të gjuhës shqipe “dru lisi/ qumësht lope”, ku SE e dytë përcaktuese është e ngjashme nga forma me rasën dhanore, ndërsa nga funksioni është e ngjashme me ndërtimet emërore në rasë gjinore si “druri i lisit/ qumështi i lopës”. Përsa i përket kësaj ngjashmërie, disa gjuhëtarë i shohin ndërtimet në rrjedhore si një gjinore e pashquar pa një të përparme. Sh. Demiraj<sup>195</sup> duke u nisur nga funksioni sintaksor i përcaktorit që kjo SE mbulon argumenton: “Gjymtyra e dytë është në gjinore se ka funksion përcaktori, pra është përcaktor i gjymtyrës së parë dhe gjymtyra e dytë kthehet detyrimisht në gjinoren e shquar të paranyjzuar në rastet kur shquhet gjymtyra e parë. Gjithashtu gjymtyra e dytë e ka ruajtur ndër vite formën e gjinores së dikurshme të paranyjzuar në trajtë të pashquar.”

Sipas Xh. Gosturanit (1989) sa më sipër kemi të bëjmë me një homonimi morfologjike, por jo një homonimi semantike. Po sipas tij në ndërtimet “dru *lisi*; lule *mali*” SE e dytë “*lisi/mali*” është në rasë rrjedhore për këto arsye:

Së pari, nëse kjo SE e dytë do të përdoret në shumësin e pashquar, atëherë ajo do të dalë me formatin –*sh* karakteristike e rasës rrjedhore.

#### *Shembull*

174.a dru lisi – dru lisash

174.b ujë mali – ujë malesh.

Së dyti, po të ndjekim logjikën e përjashtimit, kjo SE e dytë nuk mund të jetë në gjinore pasi dihet që emri në gjinore, qoftë në të shquarën a të pashquarën, del gjithmonë i paraprirë nga nyja e përparme.

Së treti, nga ana kuptimore ndërtimet me rasë rrjedhore dhe gjinore me SE të dytë në funksionin e përcaktorit nuk paraqesin ngjashmëri. Të parat përdoren me kuptim përgjithësues, ndërsa të dytat me kuptim individualizues, të realizuar falë përdorimit të njëjës së përparme.

<sup>194</sup> Agalliu F., “Rrjedhorja si një rasë me një vlerë jo të plotë në gjuhën shqipe”, Studime Filologjike, Nr 3, 1989.

<sup>195</sup> Gosturanit Xh., “Rasë rrjedhore apo gjinore”, Studime filologjike, Nr. 3, 1989

Së katërti, në shkrimet e autorëve të vjetër ndërtimet emërore me SE të dytë në rrjedhore, qoftë në të shquarën qoftë në të pashquarën i gjejëm të paraprirë nga parafjala e vjetër “-n” si element ndërtues i rrjedhores:

*Shembull*

175.a bukë **n**'elbi (Buzuku)

175.b furka **n**'hekuri (Bardhi)


175.c rrasa **n**'guri (Bogdani)<sup>196</sup>

Përsa i përket fushës së funksioneve sintaksore, rasës rrjedhore i janë atribuar një gamë e gjerë funksionesh si: kohë, vend, shkak, mjet, veçim etj.

Ndërtimet emërore me emër në rrjedhore në funksionin e përcaktorit në gjuhësinë gjenerative përfaqësohen nga struktura [SE;SE], ku për caktimin e kësaj rase SE të dytë duhet të përmbushet kushti i lidhjes strukturore të drejtimit dhe së dyti të ekzistojë një lidhje midis SE në rrjedhore dhe rolit semantik të burimit ose origjinës. Pra, është ky rol semantik i cili së bashku me përfaqësimin morfologjik e dallon këtë rasë nga rasia gjinore e cila semantikisht përfaqëson pronarin.

Strukturën e këtyre ndërtimeve bazuar në interpretimin e dhënë nga tradita gramatikore e shqipes mund ta japim si më poshtë:

**Skema 69**



Për caktimin e rasës rrjedhore SE “*mali*” duket se rasia caktohet brenda lidhjes së drejtimit nga një SE tjetër, në këtë rast nga SE “*lule*”. Gjithashtu caktimi i kësaj rase duhet të realizohet në një pozicion strukturor kokë-plotësor. Ashtu sikundër kemi theksuar për ndërtimet emërore në gjinore caktuesi rasor kokë emërore nuk është i vetëmjaftueshëm. Gjithashtu, nëse do të pranonim si caktues të rrjedhores emrin paraprijës atëherë duhet të pranojmë që po ky emër merr


<sup>196</sup> Gosturani Xh. “*Rasë rrjedhore apo gjinore*”, Studime Filologjike, Nr. 3, 1989, fq 144

si argument të brendshëm një SE (në rrjedhore) me rol semantik të burimit ose të origjinës duke bërë që në këto struktura kjo SE të jetë e ndjeshme ndaj rolit semantik.

Karakteristikë e SE së varur në rrjedhore “*mali*” është se si kokë sintagmatike përveç kufizimeve kuptimore ka dhe kufizime gramatikore, pasi ajo del gjithmonë në trajtë të pashquar njëjës dhe shumës.

Gjithashtu karakteristikat e SE në rrjedhore janë të ndryshme nga ato të SE në gjinore, jo vetëm në planin kuptimor (ku SE në rrjedhore përfaqëson një sintagmë burimore ose të origjinës, ndërsa SE në gjinore përfaqëson një sintagmë posesive), por edhe në planin strukturor, pasi pretendohet se SE në rrjedhore në strukturën e thellë mund të interpretohet si një komplement i një SP e cila në strukturën sipërfaqësore nuk realizohet fonetikisht, por pozicioni i saj është i gjeneruar. Kjo do të thotë, që në strukturën e thellë emri në rrjedhore përfshihet brenda një SP (parafjalë + SE në rrjedhore), ku parafjala plotëson kuptimin e emrit “*lule,*”. Koka parafjalore e kësaj SP përbën një parafjalë eliptike<sup>197</sup>.

#### Skema 70



Në vijim theksojmë se, një SE në rrjedhore e hasim edhe në strukturën [SE; SF], pra si SE të varur nga koka foljore jokalimtare, pasi dihet që foljet kalimtare nuk mund të caktojnë rasë tjetër përveç rasës kallëzore që ia caktojnë SE argument të brendshëm në pozicionin e plotësorit.

#### *Shembull*

176.a Ai ecte **rrugës**.

176.b Pushuesit shëtisnin **mbrëmjeve**.

<sup>197</sup> Buxheli L., “Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe”, 2007, fq. 277

Për këto ndërtime mendojmë se kemi të bëjmë me caktimin e një rase rrjedhore semantike, model ky i cili ka nevojë për argumentim.

Në këto struktura [SE;SF] emri në rrjedhore nuk sjell informacion të domosdoshëm në plotësimin e kuptimit të shprehur nga folja, por përkundrazi ai sjell informacion shtesë përse i përket vendit, kohës, hapësirës, shkakut, etj të realizimit të veprimit. Kjo ndikon në vendosjen e një lidhjeje të dobët të drejtimit të karakterizuar nga një marrëdhënie nënrenditëse midis kokës foljore dhe SE në rasë rrjedhore, e cila është një lidhje e mundshme por jo e domosdoshme. Gjithashtu, sipas teorisë së lidhjes dhe drejtimit caktimi i rrjedhores nga foljet jokalimtare si dhe ato kalimtare është i dyshimtë, sepse dihet që foljet shërbejnë si rasëcaktues vetëm për SE argumente të brendshme, pra për ato SE që shprehin raporte kundrinore. Përse i përket emrave në rrjedhore, për shkak të informacionit shtesë që ato sjellim, nuk përfaqësojnë një përbërës të domosdoshëm për strukturën argumentale të foljes dhe si rezultat midis SE në rrjedhore dhe kokës foljore vendosen marrëdhënie rrethore.

Mbështetur në faktin se midis caktimit rasor dhe strukturës argumentale ekziston një lidhje e ngushtë, pasi SE merr rasë vetëm kur ajo realizohet në një pozicion [+argument]. Pra, nisur nga kjo më parë duhet të argumentojmë nëse emri në rrjedhore ndodhet apo jo në një pozicion të tillë [+ argument foljor].

Për ilustrim.

#### *Shembull*

177.a Ai ecte rrugës. [SE<sub>pt</sub>[SE Ai[E<sub>pt</sub>[SF[F ecte[SE rrugës]]]<sup>198</sup>

Brenda strukturës SF të foljes “ec” ndodhet e pozicionuar SE “rrugës” për të cilën mund të pretendohet caktimi i rasës rrjedhore nga kjo folje joakuzative. Një pretendim i tillë është i papranueshëm, pasi foljet joakuzative pranojnë vetëm një argument të brendshëm “ai” i cili do të duhet të zhvendoset drejt pozicionit SpecSE<sub>pt</sub> për të marrë rasë emërore nga folja “eci” (ndërtimet me folje ngritëse). Folja “eci” e ka të pamundur caktimin e rasës SE “rrugës”, pasi ajo nuk përbën një argument të saj dhe si rezultat nuk realizohet në pozicion [+argument foljor]. Kjo SE nuk bën pjesë në kornizën nënkategorizuese të foljes, pra midis foljes “eci” dhe SE “rrugës” ekziston një lidhje strukturore e dobët duke bërë që kjo SE të mund të hiqet pa ndikuar në gramatikalitetin e fjalisë

---

<sup>198</sup> Buxheli L., "Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe", Tiranë 2007, fq 276




### *Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.*

Pamundësia për të marrë rasë nga koka foljore të shpie në përfundimin se SE “*rrugës*” edhe pse në strukturën sipërfaqësore ndodhet brenda projekcionit SF, ajo përbën një komponent të një SP që do të thotë që në strukturën e thellë kjo SE përfaqëson një plotësor të një koke parafjalore e cila në strukturën sipërfaqësore duke mos u realizuar fonetikisht përbën një element eliptik që mund të futet lehtë në fjali. Ky propozim bazohet edhe në argumentimin e Sh. Demiraj<sup>199</sup> sipas të cilit emri “*rrugës*” në strukturën “*eci rrugës*” në trajtë të shquar njëjës, ndonëse përdoret pa parafjalë mund të shoqërohet nga një e tillë pa ndikuar në gramatikalitetin e fjalisë.

*Shembull*

Eci **anës** rrugës. Eci **ndanë** rrugës

#### **Skema 71**



Kjo kokë parafjalore i cakton rasë rrjedhore SE plotësor të parafjalës në strukturën e saj të thellë. Caktimi i kësaj rase nuk përfshihet as në modelin e caktimit të rasave strukturore as në atë të caktimit të rasave inherente. Në këto ndërtime bëhet fjalë për caktimin semantik të rasës rrjedhore.

<sup>199</sup> Demiraj Sh., sipas Buxheli L., "Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe", Tiranë 2007, fq 274

## PËRFUNDIME

Në këtë kapitull i jemi referuar rasës rrjedhore të gjuhës shqipe, pasi gjuha angleze nuk e disponon një rasë të tillë (duke qënë se kjo gjuhë ofron një sistem rasor me katër rasa: emërore (Nominativ), kallëzore (Accusative), gjinore (Genitive) dhe dhanore (Dative)). Për rasën rrjedhore janë hedhur mendime të ndryshme, ku disa gjuhëtarë e kanë identifikuar atë herë me gjinoren e herë me dhanoren.

Kjo rasë diferencohet prej tyre si nga forma rasore (ku në numrin shumës ajo merr mbaresën –sh) ashtu edhe nga kuptimi, pasi ajo lidhet me kuptimin semantik të burimit ose origjinës. Gjithashtu, një fakt tjetër morfologjik është edhe paraprirja e SE në këtë rasë nga parafjalët përkatëse (më e përdorshmja “prej”). Ky fenomen nuk është i detyrueshëm, por ai është karakterizues, pasi edhe në shkrimet e vjetra të dokumentuara në gjuhën shqipe SE në rasë rrjedhore del e paraprirë nga parafjalë si: bukë n’gruri.

Sintaksorisht kjo SE në rasë rrjedhore nuk përfaqëson një argument të foljes, por një plotës të saj i cili ofron një informacion shtesë. Mungesa e kësaj SE në rrjedhore nuk ndikon në gramatikalitetin e fjalisë, pasi ajo krahasohet me ballkonin e një hyrjeje. Kur je në ballkon ti nuk je as fare jashtë e as tërësisht brenda. E njëjta ndodh edhe me SE në këtë rasë e cila nuk është një përbërës i rëndësishëm në strukturën e fjalisë, por nga ana tjetër nuk është fare i padobishëm.

Nisur nga fakti historik i përdorimit të një parafjale para kësaj SE të trashëguar deri në ditët e sotme është propozuar që kjo SE në rrjedhore të përfaqësojë plotësin e kokës  $P^0$  të SP. Ky projektion do të gjenerohet edhe në ndërtimet me parafjalë të munguar. Në këto ndërtime ajo do të përfaqësojë një kategori të zbrazët. Është kjo kokë  $P^0$  (qoftë edhe e zbrazët) që i cakton rasë rrjedhore kësaj SE. Ky model caktimi rasor njihet si caktim semantik i rasës rrjedhore.

## KREU IX

### CAKTIMI I RASËS SË ÇUDITSHME/QUIRKY.

#### 9.1 RASA QUIRKY/E ÇUDITSHME NË GJUHËN ANGLEZE DHE SHQIPE

Caktimi rasor strukturor i SE në rolin e kryefjalës ose kundrinorit të fjalisë ka raste që nuk kryhet sipas modeleve rasëcaktuese, pra nuk realizohet në një nga pozicionet e caktuara. Përkatësisht për caktimin e rasës emërore në pozicionin e specifikuesit të SPrKr (sintagma e përshtatjes së kryefjalës), të rasës kallëzore në pozicionin e specifikuesit të SPrKd (sintagma e përshtatjes së kundrinorit të drejtë) ose të rasës dhanore në pozicionin e specifikuesit të SPrKzh (sintagma e përshtatjes së kundrinorit të zhdrejtë).

Raste të tilla të caktimit rasor u njohën si rase quirky ose rase të çuditshme. Për herë të parë ky term u përdor në gjuhësinë gjenerative nga Levin dhe Simpson (1981)<sup>200</sup> të cilët e përshkruajnë këtë model të caktimit rasor si një proces gjatë të cilit markimi i rasës strukturore emërore të kryefjalës së fjalisë zëvendësohet nga një markim jonomativ (joemëror), ndërsa markimi i rasës strukturore kallëzore të kundrinorit të drejtë zëvendësohet nga një markim joakuzativ (jokallëzor). Pra, quirky mendohet të jetë sinonim me termin inherent i cili i referohet rasës së caktuar në lidhje me një rol tematik. Nga ana tjetër asnjë prej këtyre termave nuk mund të jetë sinonim me caktimin rasor semantik i cili i referohet caktimit të rasës SE joargumente të foljeve të cilat në strukturën e fjalive marri një interpretim semantik specifik (rasti i caktimit të rasës rrjedhore SE plotës i foljes).

Caktimi i rasës së çuditshme nuk përbën një tregues morfosintaksor të një grupi foljesh, kalimtare ose jokalimtare, por ajo përbën një karakteristikë të ndërtimeve foljore të caktuara të cilat devijojnë nga të dy prototipet e mësipërme, duke përfaqësuar jo vetëm parregullsi, por edhe një mundësi në përzgjedhjen e foljeve në caktimin rasor.

Më konkretisht, në gjuhët gjermanike dhe veçanërisht në gjuhën angleze nuk hasim ndërtime me caktim rasor të çuditshëm/quirky, pasi mendohet se argumenteve të foljes në gjuhën angleze u

---

<sup>200</sup> Scutze C., "Toward a minimalist approach of quirky case and licensing in Icelandic", MIT working papers in linguistics, 1993

caktohet rasë strukturore dhe jo inherente. Nëse do të rezultonte e kundërta, pra nëse në gjuhën angleze argumenteve të foljes do t'u caktohej rasë inherente atëherë do të ishte i mundur caktimi i rasës emërore të çuditshme. Për këtë gjuhë moscaktimi i kësaj të fundit ndodh për dy arsye:

Së pari, rasi emërore nuk mund të mbetet e pakontrolluar dhe së dyti, ajo nuk mund të kontrollohet mbi një kundrinor.

Deri tani kemi folur për një pamundësi të gjuhës angleze në caktimin e rasës së çuditshme, por kjo nuk mund të pranohet për anglishten e vjetër e cila në dokumentet e vjetra evidenton ndërtime me caktim rasor të çuditshëm.

*Shembull*

178.a Ac gode ne likode na heora geleafleast ac sende  
But **God (dat)** not liked their unfaithfulness (Nom) but pro sent

him to fyr of heafenun  
them to fire of heaven<sup>201</sup>

But God did not like their unfaithfulness but pro sent them fire from heaven.

Zoti nuk e vlerësoi pabesinë (jo besnikerinë) e tyre dhe u dërgoi atyre zjarr nga qielli.

Në fjalinë e mësipërme të anglishtes së vjetër SE “*gode*” përben një prej argumenteve kryesor të foljes “*lician*” (like), ku kjo e fundit nuk i cakton rol semantik SE “*gode*” e cila edhe pse në pozicion kryefjale del në rasë dhanore. Kjo SE argument në dhanore përfaqëson një kontrollues sintaksor të foljes duke u përshtatur me të në vetë dhe numër. Ky model i caktimit të rasës dhanore SE në pozicionin e kryefjalës përben një model të caktimit të dhanores së çuditshme.

Gjithashtu po në anglishten e vjetër e hasim këtë model të caktimit rasor edhe me foljet a-tranzitive si “*be hungry*” (të jesh i uritur) dhe “*be thirsty*” (të jesh i etur).

*Shembull*

179.a Him hingrode  
Him (dat) was hungry  
Atij ishte i uritur

He was hungry (Ai ishte i uritur) Caktimi i rasës dhanore të çuditshme SE në pozicionin e kryefjalës.

<sup>201</sup> Arista M.J., dhe Caballero L., “Arguments or macroroles? Two functional approaches to Old English quirky case” Journal of English Studies, 2001-2

179.b Hine            ðyrste

Him (Acc)      was thirsty

Atij            ishte i etur.

He was thirsty<sup>202</sup> (Ai ishte i etur)

Caktimi i rasës kallëzore të çuditshme SE në

pozicionin e kryefjalës

Vëmë re se këto folje nuk licensojnë rolin tematik të vepruesit. Kjo është arsyeja pse nuk i caktohet rasë emërore SE kryefjalë të fjalisë.

Në këto ndërtime kemi një konfuzion midis caktimit rasor të rregullt dhe atij të çuditshëm, pasi SE në rasë dhanore dhe kallëzore, edhe pse kontrollojnë treguesit e përshtatjes në vetë dhe numër nuk mund të dalin në rasë emërore. Në këtë kontekst, për anglishten e vjetër caktimi rasor quirky i referohet trajtimit Sapirian<sup>203</sup> i cili e konsideron atë si rrjedhje nga norma e përgjithshme. Parë në këtë këndvështrim, do të duhej të sqaronim shqetësimin nëse rasa quirky i zbeh apo jo treguesit funksionalë. Përsa i përket këtij shqetësimi pohojmë se nuk kemi zbehje të treguesve funksionalë, pasi rënia e tyre në gjuhën angleze zevendësohet nga rritja në rëndësi të elementeve të tjerë strukturorë si markimi parafjalor dhe rendi i ngulitur.

Në vijim, parashtrojmë se përsa i përket gjuhës shqipe përveç ndërtimeve me rasë emërore të çuditshme (të cilat do t'i shohim në vijim) hasim edhe ndërtime me rasë dhanore të çuditshme në pozicionin e kryefjalës<sup>204</sup> si:

*Shembull*

180.a Mua më fle djali      Caktim i dhanores etike të çuditshme

180.b Më iku frika.      Caktim i dhanores etike të çuditshme

Modeli i caktimit të kësaj dhanoreje është i çuditshëm, pasi mendojmë se këto folje si rasëcaktuese të dhanore së çuditshme duhet të jenë të njëjtit tip, jokalmimtare.

*Shembull*

181.a Mua më pihet **ujë**.      SE në emërore

181.b Mua më hahet **bukë**.      SE në emërore

181.c Mua më flihet **gjumë**. SE në emërore

---

<sup>202</sup> Arista M.J., dhe Caballero L., "Arguments or macroroles? Two functional approaches to Old English quirky case" Journal of English Studies, 2001-2

<sup>203</sup> Po aty

<sup>204</sup> Buxheli L., "Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe" 2007, fq. 264-265

Në këto ndërtime krahas SE në dhanore, në pozicionin e kryefjalës logjike me rol semantik të përjetuesit të një gjendjeje, kemi edhe një SE në rasë emërore, kuptimisht në rolin e plotësorit të foljes, por që gramatikisht shërben si kryefjalë.

Në këto fjali kryefjala logjike realizohet me një SE që zëvendëson kryefjalën gramatikore. Rasa dhanore i caktohet kësaj SE nëpërmjet parimit të përgjithshëm të caktimit të dhanores SE të cilës i është caktuar paraprakisht roli tematik i përfituesit/përjetuesit. Nga ana tjetër SE “ujë, bukë, gjumë” si plotësorë të foljeve pavetore (pasi në fjalitë veprare ato janë në rasë kallëzore) kanë rol semantik të objektit të veprimit.

*Shembull*

182.a Unë dua të pi **ujë**. SE në rasë kallëzore

182.b Unë dua të ha **bukë**. SE në rasë kallëzore.

182.c Unë dua të fle **gjumë**. SE në rasë kallëzore.

Në shembujt e parë këto SE dalin në emërore e cila nuk ka të bëjë as me zhvendosjen e SE për shkak të formës pavetore dhe as me absorbim të rasës kallëzore. Ajo është një emërore pasfoljore e caktuar çuditshëm, pasi prishmëria do të ishte për një SE në kallëzore. Në ndërtime të tilla kemi të bëjmë me një model të çuditshëm të caktimit rasor. Ka raste kur mendohet se struktura me rasë të çuditshme në dhanore dhe emërore duket se mund të pasivizohet dhe si rezultat dhanorja e çuditshme absorbohet nga forma pësore e foljes, e në vend të saj përdoret rasa emërore kryefjalë<sup>205</sup>.

*Shembull*

183.a Petritit i pëlqejnë librat artistikë.  
(dhan) (em)

183.b Librat artistikë pëlqehen nga Petriti.  
(em) (em)

Nga ana tjetër kemi:

*Shembull*

184.a Petriti pëlqen librat artistikë  
(em) (kall)

184.b Librat artistikë pëlqehen nga Petrit  
(Em) (em)

---

<sup>205</sup> Buxheli L., “Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe” 2007, fq. 264-265

Duket qartë se 184.b është forma pësore e ndërtimit vepror 184.a e cila përmban rasë strukturore të caktuar në pozicionet përkatëse.

Po të krahasojmë 183.b dhe 184.b del qartë se ato kanë të njëjtën formë pësore, pavarësisht karakterit inherent ose jo të caktimit të rasës SE kryefjalë dhe SE kundrinë.

Sa më sipër të çon në përfundimin se si te 183.b ashtu edhe 184.b ka zhvendosje të emrit “librat” nga pozicioni [-rasë] në pozicion [+rasë]. SE “Petriti” si në 183.b ashtu edhe në 184.b shërben si komplement duke ruajtur rolin semantik të vepruesit. Nëse 183.b do të ishte pasivizimi i 183.a atëherë do të prananim se kemi zhvendosje të SE “librat” e cila e merr rasën emërore në një pozicion tjetër për shkak të absorbimit rasor. Por kjo nuk ndodh sepse SE “librat” mbetet përsëri në emërore.

Fjalja pësore 183.b si pësore e 183.a me rasë inherente të çuditshme vë në dyshim karakterin inherent të dhanores, pasi në pësore kjo dhanore zëvendësohet nga një emërore me caktues rasor parafjalën “nga”. Si rregull, dhanorja nuk ndryshon gjatë pasivizimit. Për këtë arsye mendojmë se 183.b nuk është pësore e 183.a, pasi kjo e fundit nuk mund të pasivizohet. Kështu fjalia 183.b dhe 184.b është formë pësore e 184.a me rasë strukturore.

Folja pësore “pëlqehen” nuk mund të caktojë as rasën kallëzore as rolin semantik të vepruesit. Absorbimi i rolit tematik të jashtëm shoqërohet me absorbimin e rasës kallëzore.

## ***PËRFUNDIME***

Caktimi i rasës SE argumente të foljes jo gjithmon kryhet sipas dy modeleve të bëra të ditura në kretë e trajtuar deri tani. Pra, SE argumente të foljes jo gjithmon u caktohet rasa përkatëse në pozicionet e specifikuesit. Kemi raste që këtyre SE u caktohet rasë quirky/e çuditshme. Përsa i përket gjuhës angleze, me pranimin e faktit se ajo që ne trashëgojmë në ditët e sotme është një anglishte analitike, ku si mjet kryesor i shprehjes së marrëdhënieve midis SE të një fjalisë është rendi i ngulitur dhe përdorimi i parafjalës, është e vështirë ose e pamundur që në këtë gjuhë të hasen ndërtime të tilla me rasë quirky. Nga ana tjetër, në materialet e dokumentuara të anglishtes së vjetër (OE) hasen ndërtime të cilat lejojnë caktimin e rasës quirky. Ky fakt i dedikohet vetë natyrës sintetike të kësaj gjuhe gjatë kësaj periudhe, ku si shprehëse të marrëdhënieve midis SE shërbenin mjetet morfologjike të eptimit të cilat krijojnë lirshmëri në vendosjen e SE në strukturën e fjalisë.

### *Shembull*

1.a Him hingrode

Him (dat) was hungry.

He was hungry.

Në këtë shembull kemi caktim të rasës dhanore në pozicionin strukturor të SE argument i jashtëm, kryefjalë.

Përsa i përket gjuhës shqipe vetë fakti i natyrës së saj si gjuhë sintetike i jep kësaj të fundit mundësinë e ekzistencës së ndërtimeve të tilla me caktim rasor quirky si:

### *Shembull*

2.a Mua më pihet ujë

e cila është semantikisht e njëjtë me:

2.b Unë dua të pi ujë.

ku SE “ujë” në ndërtimin e parë me folje pavetore në pozicionin e plotësorit të foljes merr rasë emërore ndërsa në shembullin e dytë ajo në po të njëjtin pozicion i caktohet rasë kallëzore.

Kjo ndodh për shkak të absorbimit nga folja pavetore të rasës kallëzore, gjë që e bën të detyrueshëm daljen e kësaj SE në rasë emërore.



## **KONKLUSIONE**

Në të nëntë kretë e këtij punimi mëtojmë të sjellim një studim bashkëkohor duke synuar përfaqimin dhe zbatimin e teorive gjenerativiste pa neglizhuar arritjet e deritanishme të gjuhësisë tradicionale. Në këtë kontekst, për çështje dhe probleme të ngritura dhe të trajtuara në këtë punim i jemi drejtuar shpesh drejtimit gjuhësor tradicional.

Në qëndër të këtij studimi është përndarja e sintagmave emërore sipas një prej teorive kryesore të gjuhësisë gjenerative të njohur si teoria e rasës. Për një analizë sa më të thukët të këtij përbërësi emëror në ndërtimet sintaksore të gjuhës angleze dhe asaj shqipe, kërkohen njohuri të kënaqshme, sa historike dhe aktuale të sistemeve rasore të tyre. Gjuha shqipe dhe gjuha angleze, edhe pse bija të indoeuropeanishtes mëmë, nuk i kanë shpëtuar evolucionit gjuhësor ndër vite i cili ka bërë që këto dy gjuhë të shfaqen si gjuhë krejt të ndryshme nga njëra-tjetra.

Për më tepër, gjuha shqipe në ditët e sotme trashëgon një sistem eptimor të pasur, mungesë kjo e dukshme te gjuha angleze e cila plotësohet nga përdorimi në këtë gjuhë të mjeteve sintaksore si rendi i fjalëve në fjali, parafjala, etj. Pra, në varësi të mungesës apo pranisë së paradigmës së eptimit këto dy gjuhë klasifikohen më tej si gjuhë analitike (anglishtja) dhe gjuhë sintetike (shqipja). Ky klasifikim pasqyrohet më së miri edhe në karakterizimin e kategorisë së rasës duke ndikuar në klasifikimin e saj si më poshtë:

**Rasë morfologjike** - rasti i gjuhës shqipe, ku rasa realizohet si rezultat i përdorimit të mjeteve eptimore, më saktë mbaresave eptimore.

**Rasë abstrakte** - term i përdorur nga gjuhësia gjenerative i cili përfshin sistemet rasore të atyre gjuhëve në të cilat rasa nuk realizohet me mjete eptimore, por ajo realizohet si rezultat i pozicionit që sintagma emërore zë në strukturën e fjalise.

Klasifikimet e mësipërme të gjuhëve si analitike apo sintetike nuk shërbejnë për gjë tjetër, veçse për të përshkruar gramatikat e gjuhëve me synimin e nxjerrjes në pah të ndryshimeve që ekzistojnë midis tyre.

Përkundrazi, studiuesit gjenerativistë priren të zbulojnë strukturat e brendshme të përbashkëta të gjuhëve dhe t'i paraqesin ato si një varg rregullash universalë. Jo pa qëllim ata propozojnë rasën abstrakte e cila ndërthet në vetvete edhe realizimin morfologjik të saj.

Pra, si sintagmat emërore të gjuhës angleze, të cilat e kanë të domosdoshëm realizimin e tyre në një pozicion të caktuar për të marrë rasë, edhe sintagmat emërore të gjuhës shqipe, të cilat rasi bëhet e ditur nga eptimi, duhet të shfaqen në po të njëjtin pozicion strukturor për t'u pajisur me rasë.

Para se të pajisen me rasë SE, në bazë të Parimit të Visibilitetit, duhet të bëhen të dukshme në strukturën e fjalisë. Visibiliteti i tyre varet kryesisht nga marrëdhëniet që ato vendosin me predikatin. Nga ana tjetër marrëdhëniet predikat-SE argument licensojnë edhe treguesit semantikë ose më saktë rolet tematike përkatëse që i caktohen çdo SE argument. Treguesit semantikë të SE argumente (qofshin këto argumente të brendshëm apo të jashtëm) kontrollohen brenda rrafshit leksikor i cili përfaqësohet nga sintagma foljore (SF). Pra, treguesit semantikë të SE argumente caktohen në konfiguracionin specifikues-kokë të projeksioneve leksikore Sf, Sf<sub>mes</sub>, dhe SF të përfituara si rezultat i hipotezës së ndarjes së projeksionit leksikor SF.

Me licensimin e treguesve leksikore SE argumente e kanë të domosdoshme licensimin e treguesve morfosintaksore dhe si rezultat pajisjen me rasë. Sa më sipër lidhet kryesisht me Teorinë e Rasës, një prej moduleve kryesore të gjuhësisë gjenerative, përmbushja e së cilës bazohet në realizimin e tre detyrave të mëposhtme:

Së pari të përcaktojmë caktuesin rasor për secilën rasë, së dyti të përcaktojmë pozicionin në të cilin duhet të realizohet një sintagmë emërore për tu pajisur me rasë dhe së treti të përshkruajmë modelin rasor që secila rasë përfaqëson. Këto detyra vlejné dhe shoqërojnë analizën që i është bërë caktimit të katër rasave sintagmave emërore të gjuhës angleze dhe caktimit të pesë rasave sintagmave emërore të gjuhës shqipe. Katër rasat e para, emërore, kallëzore, dhanore dhe gjinore janë të përbashkëta për të dyja gjuhët. Ndryshimi qëndron te prania në gjuhën shqipe të një rase të pestë, rasës rrjedhore, e cila në periudhat e hershme të zhvillimit të gjuhës angleze nuk ka munguar.

Por, nga ana tjetër, ekzistenca e këtyre katër rasave nuk është e vetmja e përbashkët që këto dy gjuhë ndajnë. Në punim pranohet se struktura e thellë e fjalive të të dyja gjuhëve është e njëjtë, pasi për caktimin e këtyre katër rasave është i njëjtë si caktuesi rasor edhe pozicioni i caktimit të tyre.

Kjo përbën edhe propozimin risi të këtij punimi sipas të cilit caktimi i rasave SE argumente të foljes realizohet në konfiguracionin specifikues-kokë, duke përfshirë në modelin strukturor të caktimit rasor jo vetëm argumentin e jashtëm por edhe dy argumentet e brendshëm.

Zanafilla e këtij propozimi lidhet kryesisht me bindjen e Chomsky-it se kategoria e përshtatjes përbën mekanizmin kryesor në caktimin e rasës. Në vijim Pollock (1989) propozon ndarjen e projeksionit funksional të sintagmës së eptimit (SEpt) në dy projeksione funksionale, përkatësisht sintagmën funksionale të kohës (SKohe) dhe sintagmën funksionale të përshtatjes (SPr). Propozimit të Pollock-ut i bashkëngjiten propozimet e Chomsky-it (1993;1995) dhe Kratzer (1994;1996) të cilët propozojnë ndarjen e projeksionit leksikore SF në dy projeksione Sf më të lartë dhe SF më të ulët. Në të njëjtën linjë Ura (1996; 2000) propozon një ndarje të trefishtë të projeksionit leksikore SF duke i shtuar dy projeksioneve të mësipërm edhe një sintagmë foljore të ndërmjetme SF<sub>mes</sub>.

Chomsky (1997), nisur nga hipotezat e ndarjes së projeksionit leksikore SF dhe projeksionit funksional SEpt, përmbledh se projeksionet leksikore (në njëjën e specifikuesit të së cilave licensohen treguesit leksikorë) do të ndërpriten nga projeksionet funksionale të përshtatjes (në njëjën e specifikuesit të së cilave do të zhvendosen SE argumente për të licensuar treguesit morfosintaksorë si dhe për të marrë rasë).

Më konkretisht:

1. Sintagmës emërore argument i jashtëm, e cila përbën subjektin e fjalisë, në të dyja gjuhët i caktohet rasë emërore nga tipari i përshtatjes së kategorisë së eptimit në pozicionin e specifikuesit të sintagmës funksionale të përshtatjes së kryefjalës (SpecSPrKr)

2. Sintagmës emërore argument i brendshëm, e cila përbën kundrinorin e drejtë, në të dyja gjuhët i caktohet rasë kallëzore nga folja kallëzues e fjalisë në pozicionin e specifikuesit të sintagmës funksionale të përshtatjes së kundrinorit të drejtë (SpecSPrKd).

3. Sintagmës emërore argument i brendshëm, e cila përbën kundrinorin e zhdrejtë, në të dyja gjuhët i caktohet rasë dhanore nga folja kallëzues e fjalisë në pozicionin e specifikuesit të sintagmës funksionale të përshtatjes së kundrinorit të zhdrejtë (SpecSPrKzh)

Si në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe hasim edhe një formë të katërt rasore të njohur si rasë gjinore. Në gjuhën angleze sintagmat emërore në gjinore dalin me dy variante të ndryshme: ndërtimet me of-preposition (the destruction **of the city**) dhe ndërtimet me gjinore posesive (**the boy's** book). Ndërsa në gjuhën shqipe gjinorja realizohet falë pranisë së dy

determinuesve, përkatësisht nyjës së përparme dhe morfemës së lidhur të prapavendosur e cila licenson kategorinë e shquarsisë, të numrit dhe të gjinisë (libri *i djalit*). Në të dyja gjuhët ekziston një lidhje e fortë e brendshme midis SE në gjinore dhe rolit tematik të pronësisë, çka ndikon në caktimin e gjinore inhereente. Si caktues i rasës gjinore në gjuhën angleze, për ndërtimet me gjinore posesive, pranohet klitiku 's (në anglishten e vjetër ai përfaqëson mbaresën -es të rasës gjinore), ndërsa në gjuhën shqipe si caktues i rasës gjinore do të pranohet nyja e përparme, mungesa e së cilës do ta kthente ndërtimin emëror në jogramatikor. Elementët determinative 's dhe nyjë e përparme "i, e, të, së" të të dyja gjuhëve janë përgjegjës për licensimin e treguesve leksikorë (shprehjen e marrëdhënieve të pronësisë) dhe për licensimin e treguesve morfosintaksorë (caktimin e rasës gjinore). Për këto arsye Abney (1987) propozon një zgjatim në përbërje të projeksionit SDet të përfaqësuar nga projeksioni funksional i determinuesit të pronësisë (SDetPron) në kokën DetPron të së cilit do të realizohen klitiki 's i gjuhës angleze dhe nyjat e përparme "i, e, të, së" të gjuhës shqipe.

Dy kapitujt përmyllës të punimit trajtojnë caktimin e rasës rrjedhore dhe rasës quirky të cilat janë karakteristike për gjuhën shqipe, por nuk mungojnë dëshmitë që vërtetojnë se ato kanë ekzistuar edhe në anglishten e vjetër.

Përmbledhim se, edhe pse midis gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe pranohet ekzistenca e një hendeku të madh leksikor, morfologjik dhe sintaksor, ato ndajnë të njëjën strukturë bazë. Sa më sipër përbën edhe objektin e synuar të gjuhësisë gjenerative.

## Litëratëra e shfrytëzuar.

- Abney S. *A grammar of projection*, Manuscript 1996, material marrë nga [www.vinartus.net/spa/96c.pdf](http://www.vinartus.net/spa/96c.pdf)
- Abney S. *Functional elements and licensing*, Paper presented at GLOW, Gerona, Spain. 1986, material marrë nga [www.vinartus.net/spa/96c.pdf](http://www.vinartus.net/spa/96c.pdf)
- Abney S. *The English noun phrase in its sentential aspect*, Doctoral dissertation, MIT, Cambridge, MA. 1987
- Adger. D., *Core Syntax. A minimalist approach*, Cambridge University press, 2002.
- Agalliu F. *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1988
- Agalliu F. *Ndërtimi dëftor + emër i shquar*, Studime Filologjike, Nr. 1, 1975
- Agalliu F. *Një apo morfemë eptimi*, Studime Filologjike, Nr. 1, 1987
- Agalliu F. *Rrjedhorja si një rasë me vlerë jo të plotë në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, Nr. 3, 1989
- Agalliu F. *Sa rasa ka gjuha shqipe* Studime filologjike, Nr. 3, 1980.
- Akademia e Shkencave e RSh, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995.
- Akademia e Shkencave e RSh, *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa)*, Tiranë, 1995.
- Alexiadou A., Heageman L., dhe Stavrou M., *Noun phrase in generative perspective*, Walter de Gruyter, 2007
- Aristo M. J. & Caballero L. *Arguments and macroroles; Two functional approaches to OE quirky case*, Journal of English Studies, Vol. 3, 2001-2
- Baker M. *Thematic roles and syntactic structures*, McGill University, Vol.2, revised, June 1996
- Bezhani. H., *A short historical grammar of English*, Tiranë 2002.
- Bresnan A. Rosenbach A. *Dative and genitive variables in late modern English, Exploring cross-construtional variation and change*, material marrë nga [web.stanford.edu/~bresnan/WBRS](http://web.stanford.edu/~bresnan/WBRS).
- Buxheli. L., *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë 2007
- Cambridge University Press, *The Cambridge Grammar of English Language*, 2002.
- Çeliku M. *Kontribut për dy probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Studime Filologjike Nr. 1, 1971
- Chomsky N. *Linguistics and brain science*, LAUD, 1999, marrë nga <http://www.chomsky.info/articles/2000>

- Chomsky N. *Syntactic Structures*, Second Edition, New York 2002
- Chomsky N. *The Minimalist Program*, The MIT Press, Cambridge 1995.
- Chomsky N., *Aspects of the Theory of Syntax*, The MIT Press, Cambridge 1995.
- Chomsky N., *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Leksionet e Managuas (perkthyer ne shqip nga Blerta Topalli) version elektronik.
- Chomsky N., *Le Structure della Sintassi* (perkthyer ne italisht nga Francesco Antinucci) 1974
- Chomsky N., *Lectures on Government and Binding*, The Pisa lectures, New York 1993.
- Chomsky N., *Structures Syntaxiques* (perkthyer ne frengjisht nga Michel Braudeau) 1957.
- Chomsky N., *WH- movement*, The MIT Press, Cambridge 2006
- Chomsky. N., *Three factors of language design*, Linguistic inquiry, 2005 - MIT Press
- Cipo. K., *Gramatika Shqipe*, Tiranë 1949
- Cipo. K., *Sintaksa*, Tiranë 1952
- Demiraj, Sh., *Morfologjia historia e gjuhës shqipe (pjesa e II)*, Tiranë 1973
- Dhima Th. “Çështje të sintaksës në gjuhën shqipe”, Tiranë 2013
- Dhima Th. *L. Buxheli: Modelet e caktimit rasor në gjuhën shqipe* Studime Filologjike, Nr. 1-2, 2008
- Dhima Th., “Rreth analizës sintaksore të fjalisë”, Artikull i përgatitur për revistën Studime Filologjike.
- Dhima Th., *Sintaksa e shqipes përballë zhvillimeve të reja*, Konferenca Shkencore “Zhvillimet moderne në gjuhësi dhe studimet në fushën e shqipes.” , Tiranë 2012
- Dhima, Th., *Gjuha shqipe, Sintaksa*, Tiranë, 2005.
- Dhima. Th., *Mbi klasifikimin e foljeve në gjuhën shqipe*, Seminari i XXI për gjuhën, letërsinë dhe kulturen shqiptare, Prishtinë 2002.
- Dhima. Th., *Mbi lëvizjen e frazës emërore*, Buletini shkencor i Universiteti “E. Cabej”
- Dhima. Th., *Mbi lëvizjen e frazës emërore*, *Kërkime Universitare*, Universiteti “Eqrem Çabej” 2005.
- Dhima. Th., *Mbi subjektin e formave të pashtjelluara foljore*, Konferenca shkencore “Studime Filologjike Shqiptare”, Prishtinë 2007.
- Dhima. Th., *Probleme të njësisve sintaksore (Togfjalëshi dhe Sintagma)*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturen shqiptare, Prishtinë 2005.
- Dhima. Th., *Valenca e emrave dhe çështje të klasifimit të tyre*, Prishtinë 2007

- Dikken D. M. *Complex noun phrases and linkers*, Syntax, 2004 - Wiley Online Library
- Domi M. *Çështje të përgjithshme të sintaksës* Studime filologjike, Nr. 3, 1980
- Floqi. S. *Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme* Studime Filologjike Nr. 3, 1980
- Giusti G. *The functional structure of NP. A bare phrase structure approach*. University of Venice working papers in linguistics, 1999 (elektronikisht pdf from researchgate.net)
- Gosturani Xh. *Rasë rrjedhore apo gjinore* Studime Filologjike, Nr. 3, 1989
- Graffi G., *Ç'është gramatika gjenerative*, (përkthyer nga Memushaj R.) Tiranë 2008
- Graffi. G., Scalise. S., *Le lingue e il linguaggio*, Il Mulino 2003
- Havav R. M., Levin B., *The English dative alternation. The case for verb sensitivity*, Journal of Linguistics, 2008 - Cambridge University Press.
- Heageman L. *Elements of grammar. Handbook in generative syntax*, Cambridge University Press, 1997
- Heageman. L., *Introduction to government and binding theory*, Cambridge University Press, 1991
- Hogg R *An introduction to old English*, Edinburgh University Press 2002
- Hospelmath M. *Terminology of case*, Handbook of case, Oxford University Press, 2006
- Inoue K *Case (with special reference to Japanese)*, The Blackwell Companion to Syntax, 2005 Wiley Online Library
- Koike I., *The history of the genitive case from the Old English period onwards*, English Language and Linguistics, 2006, Cambridge University Press
- Koleci F. dhe Turano G., *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Tiranë 2011,
- Kreyer R., *Genitive and –of constructions in modern written English. Processability and human involvement*, International Journal of Corpus Linguistics, 2003 (pdf from sjsu.edu)
- Likaj E. *Mbi formimin e gjinoreve së emrave në gjuhën shqipe* Studime Filologjike, Nr. 3-4, 1998
- Likaj E. *Mbi vendin e mjeteve të eptimit në gjuhën shqipe* Studime Filologjike, Nr. 1-2, 2002
- Manzini R & Roussou A. *A minimalist theory of A movement and control*, Lingua, 2000, Elsevier (pdf from ucl.ac.uk)
- Matushansky O. *Head movement in linguistic theory*. Linguistic Inquiry, 2006 - MIT Press (pdf from mit.edu)
- McCloskey J. *Subjecthood and subject position*. përfshirë te Heageman L. *Elements of grammar. Handbook in generative syntax*, Cambridge University Press, 1997

- Memushaj R. *Tri koncepte themelore të sintaksës moderne*, Studime Filologjike, Nr. 1-2, 2008
- Memushaj,R., *Gjuhësia Gjenerative*,Tiranë 2003.
- Memushaj,R., *Hyrje në gjuhësi*,Tiranë ,2004.
- Mita, J., *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Prishtinë 2005
- Mita. J., *Struktura e sintagmave në gjuhën shqipe sipas gjenerativizmit*, Studime Albanologjike 2000.
- Radford,A., *Transformational grammar,(a first course)*,Cambridge University press,1992.
- Radford. A., *Minimalist Syntax. Exploring the structure of English*, Cambridge University press, 2004.
- Reuland E. *Binding Theory: Terms and concepts*, The Blackwell companion to syntax, 2007.
- Rill J. *A unified analysis of dative shift in English and the applicative construction in Chichewa*, Master Thesis, 2011
- Riza S. *Probleme të njave të shqipes* Studime Filologjike, Nr 1, 1982.
- Rizzi L. *The fine structure of left periphery*, përfshirë te Heageman L. *Elements of grammar. Handbook in generative syntax*, Cambridge University Press, 1997
- Rosenbach A. *Aspects of iconicity and economy in the choice between the 's genitive and of-genitive in English*. Topics in English Linguistics, 2003
- Rrokaj, Sh., *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë 2007.
- Rrokaj, Sh., *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë 2000
- Schulze C. *Toward a minimalist account of quirky case and licensing in Icelandic*, MIT working papers in linguistics, 1993 - linguistics.ucla.edu, (pdf from ucla.edu)
- Sells P. *Lectures on contemporary syntactic theories*, Center for the study of language and information, 1992
- The Blackwell Companion to Syntax*, Volume I-V, (version elektronik)
- Tsimpli. I., M., *The close structure and word order in modern Greek*, paper marrë nga [https://www.ucl.ac.uk/pals/research/linguistics/publications/wpl/90papers/UCLWPL2\\_12\\_Tsimpli](https://www.ucl.ac.uk/pals/research/linguistics/publications/wpl/90papers/UCLWPL2_12_Tsimpli).
- Turano. G., *Albanian noun phrase domain*, Quaderni del dipartimento di linguistica, Università della Calabria, 2001.
- Turano. G., *Nominali indefiniti in albanese*, Quaderni del dipartimento di linguistica, Università della Calabria, 2001.



***Caktimi i rasave në sintagmat emërore të gjuhës angleze në përqasje me gjuhën shqipe.***

---

Turano. G., *On (A) Telicity and Casa in Albanian*, Quaderni del dipartimento di linguistica, Universita di Firenze, 1999.

Turano. G., *Overt and covert dependencies in Albanian*, Studia Linguistica, A journal of general linguistics 1998.

Vasques E. *Case assignment in double object constructions*, Revista Alicantina de Estudios Ingleses, 1997

Yule G. *Introduzione alla linguistica*, Il Mulino 2008.